



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
I
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Mbi ri-auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, në Postën Shqiptare Sh.a.



POSTA SHQIPTARE

Tiranë, Janar 2022



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI RI-AUDITIMIN E SISTEMEVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË POSTËN SHQIPTARE SH.A.

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“MBI RI-AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT NË POSTËN SHQIPTARE SH.A.”

Tiranë, Janar 2022

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	8
II.	HYRJA	8
1.	Objekti i auditimit	9
2.	Qëllimi i auditimit	9
3.	Identifikimi i çështjes	9
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
5.	Përgjegjësitë e audituesve	10
6.	Kriteret e vlerësimit	10
7.	Standardet e auditimit	11
8.	Metodat e auditimit	11
9.	Dokumentimi i auditimit	11
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	14
2.1	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	14-27
a.	<i>Verifikimi i procedurave dhe burimeve njerëzore në TIK</i>	
b.	<i>Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve në TIK</i>	
2.2	Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit	28-102
a.	<i>Procedurat e investimeve në teknologjinë e informacionit</i>	
b.	<i>Marrëveshjet e nivelit të shërbimit (Service Level Agreement)</i>	
2.3	Auditimi i Sigurisë së Informacionit	103-125
a.	<i>Siguria e të dhënave dhe të drejtat e përdoruesve</i>	
b.	<i>Ruajtja e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit</i>	
2.4	Auditimi i Sistemeve	126-157
a.	<i>Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output</i>	
2.5	Të tjera	158-163
a.	<i>Auditimi i brendshëm në drejtim të TI</i>	
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	164

☞ LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	- Kontrolli i Lartë i Shtetit
INTOSAI	- Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
AKSHI	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
VKM	- Vendim i Këshillit të Ministrave
TIK	- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
DDOS	- Distributed Denial-of-Service
MNSH	- Marrëveshje Nivel Shërbimi
TI (IT)	- Teknologji Informacioni
BCP	- Business Continuity Plan
BCC	- Business Continuity Center
DRC	- Disaster Recovery Center
RTO	- Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes
RPOs	- Objektivat e Punës së Ripërtëritjes
OE	- Operator Ekonomik
AK	- Autoriteti Kontraktor
IP	- Internet Protocol
VPN	- Virtual Private Network
KVO	- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
VLAN	- Virtual Local area network
B2B	- Business-to-business
B2C	- Business-to-consumer
DST	- Dokumenta Standarde të Tenderit
APP	- Agjencia e Prokurimit Publik
MFK	- Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit
FSHU	- Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA
LPP	- Ligji për Prokurimin Publik
TVSH	- Tatimi mbi vlerën e shtuar
OSHEE	- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA
MFE	- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
AKEP	- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
MIE	- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
INSTAT	- Instituti i Statistikave
BI	- Business intelligence
VOIP	- Voice over Internet Protocol
DVR	- Digital video recorder
NVR	- Network video recorder
NAS	- Network Attached Storage
SAN	- Storage Area Network
PTC	- Postal Technology Center
ZVRPP	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
IPS	- International Postal System
CDS	- Custom Declaration System
ALCIRT	- Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike
AKCESK	- Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
ISACA	- Information Systems Audit and Control Association
FTP	- File Transfer Protocol
BMS	- Building Management System

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Postën Shqiptare Sh.a, nga data 03.09.2021 deri më datë 19.11.2021.

Duke qenë në kushtet e ri-auditimit të këtij subjekti, grupi i auditimit i ka rivlerësuar ato fusha që kanë rezultuar si fusha me risk, nga auditimi i mëparshëm, dhe hartoi programin e auditimit të ngjashëm me atë të auditimit IT të zhvilluar më përpara në këtë subjekt.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, në Postën Shqiptare Sh.a., ka qenë pjesë e planit të auditimit për muajin Shtator të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH me shkresën nr. 1138/10, datë 03.09.2021. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që Posta Shqiptare disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi i auditimit, filloi fazën e studimit paraprak, ku u administrua dosja e mëparshme e auditimit të ushtruar në Postën Shqiptare, u dërgua pyetësori i hartuar, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Grupi i auditimit i ka rivlerësuar ato fusha që kanë rezultuar si fusha me risk dhe hartoi programin e auditimit. Programi i auditimit me nr. 877/1 u miratua nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me datë 14.09.2021.

Auditimi i teknologjisë së informacionit është ekzaminimi i implementimit të sistemeve IT për të siguruar përmbushjen e nevojave të institucionit apo organizatës pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elementet e tjera kritike të institucionit. Pra siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i asetëve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

Gjetja Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi u konstatua se, Posta shqiptare Sh.a, nuk ka plan strategjik institucional të miratuar me qëllim përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave	faqe 14-27	e lartë	Organet drejtuese në Posta Shqiptare Sh.a, duke marrë në

	<p>institucionale. Gjithashtu u konstatua se nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planifikimeve strategjike institucionale mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës.</p>			<p>konsideratë rëndësinë e shërbimeve postare dhe financiare që ofron shoqëria si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni zotëron dhe përpunon me qëllim përcaktimin e objektivave dhe adresimin e burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik Institucional ku të përfshihet edhe planifikimi strategjik mbi teknologjinë e informacionit dhe ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare. Gjithashtu organet drejtuese të Postës Shqiptare Sh.a të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të përcaktuara.</p>
2	<p>Nga auditimi u konstatua se, Rregullorja e Brendshme, “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare nuk është përshtatur (amenduar) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në rregulloren e brendshme të Postës Shqiptare Sh.a. detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara jo në mënyrë të detajuar. Në përcaktimin e kompetencave të drejtorit të IT dhe zhvillimit, në rregulloren e brendshme “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a” ka mbivendosje të këtyre kompetencave, pasi disa prej tyre tejkalojnë nivelin hierarkik të drejtorit të drejtorisë. Për shembull në pikën 16 të rregullores së brendshme ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e drejtorit të IT dhe zhvillimit, ku citohet se drejtori i IT “Përcakton, zhvillon dhe përsos më tej strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të automatizimit të Postës Shqiptare SH.A”, drejtori i IT, merr përgjegjësitë e Administratorit. Në disa raste përgjegjësi i sektorit të sistemeve ka më shumëtribute se sa drejtori i drejtorisë, për shembull në pikën 2, të Detyrave dhe Përgjegjësisë të përgjegjësit të sektorit dhe sistemeve. Kjo problematikë haset edhe në sektorët e tjerë ku ka raste që kalojnë kompetencat hierarkike. - në disa raste konstatohet se mungojnë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësisë për disa funksione që janë në strukturën organizative por nuk gjenden të reflektuara në rregulloren e brendshme të funksionit të administratës qendrore. 	faqe 14-27	e lartë	<p>Organet drejtuese në Posta Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojë, amendojë dhe miratojë, rregulloren e brendshme, “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a”, me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite në shoqëri. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale si dhe me legjisllacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.</p>

<p>3</p>	<p><u>Gjetje nga auditimi:</u> Nga auditimi u konstatua se: Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i përdoruesve të sistemit Eterna Financiare realizohet nga Sektori i Aplikimit & Administrimit të Dhënave, detyrë kjo e atribuar pa një shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë së Postës Shqiptare sh.a.</p> <p>-Administratorin e sistemeve eterna postar dhe financiar si dhe IPS (International Postal System) dhe CDS (Custom Declaration System) e ushtron përgjegjësi i sektorit të aplikimit dhe administrimit të të dhënave në drejtorinë IT dhe zhvillimit. Detyra e Administratorit të sistemit eterna i është atribuar pa asnjë shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë. Pavarësisht se nuk është e emëruar zyrtarisht si Administratore sistemi, ajo ushtron të gjitha detyrat e administratorit të sistemit. “Administratori i Përgjithshëm” i sistemit Eterna që ka të drejta universale është kompania H. e cila ka ndërtuar dhe zhvilluar sistemin Eterna.</p> <p>-Atributet dhe rolet e userave në sistemin Eterna Postar dhe Financiar nuk janë të përcaktuara sipas detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në rregulloren e brendshme administrative por sipas funksionaliteteve që punonjësi ushtron në praktikë përgjatë procesit të punës.</p> <p>- Për periudhën objekt auditimi, Posta Shiptare sh.a. nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve të Sistemit Eterna Financiare dhe Eterna Postare në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve.</p> <p>Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email. Kërkesat për krijim/aktivizim/çaktivizim apo modifikim të përdoruesve (ndryshim i zyrës së aksesit apo i profilit të të drejtave) realizohen me email në dijeni nga Drejtoritë e Shërbimeve përkatëse, ose nga shefja e shërbimit në filialin përkatës apo specialistet e shërbimit. Ndërsa në sistemin IPS për krijimin e një përdoruesi është kusht krijimi më parë i userit në domain, pastaj krijimi i login-it në bazën e të dhënave i tipit “Windows Authentication”.</p> <p><u>Gjetje nga auditimi:</u> Nga auditimi mbi dhënat mbi përdoruesit u konstatuan raste për të cilat “loginID” është e ndryshme nga “fullname”, duke sjellë risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem si dhe duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.</p>	<p>faqe 103-125</p>	<p>e lartë</p>	<p><u>Rekomandimi:</u> Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit të cilat ka në përdorim institucioni, me qëllim pasqyrimin e saktë të përgjegjësi, detyrave dhe të drejtave për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemeve të IT.</p> <p><u>Rekomandimi:</u> Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që Posta Sh.a ka në përdorim me qëllim përcaktimin e përgjegjësi dhe të drejtave të administratorit të sistemeve IT.</p>
<p>4</p>	<p><u>Gjetje nga auditimi:</u> Nga auditimi mbi raportet e gjeneruara prej sistemit Eterna Financiar u konstatuan disa problematika në lidhje me gjenerimin e tyre, konkretisht:</p> <p>- Të gjitha raportet që u gjeneruan, kërkojnë patjetër përpunime në Excel sepse dhe raportet përmbledhëse janë konceptuar në nivel filiali edhe në rastet kur kërkesa për informacion ekzekutohet në nivel republike;</p> <p>- Nuk ka asnjë opsion të gjenerosh të dhëna për të dy monedhat EUR dhe LEK;</p> <p>- Nuk ka asnjë raport për përdoruesit, roli dhe zyrat në të cilat kanë akses;</p> <p>- Për përdoruesit në modulet Magazina, Moduli i Blerjeve, Inventari, Menaxhimi i Dokumenteve rezulton se nuk është ndërtuar asnjë raport në strukturën e raporteve, madje për këto shërbime nuk rezulton se janë hedhur të dhëna me qëllim vënien në funksion të tyre.</p> <p><u>Gjetje nga auditimi:</u> Nga testimet të ndryshme në sistemin Eterna Postar përgjatë gjenerimit të raporteve nga pema e raporteve u konstatuan disa parregullsi/mangësi, konkretisht:</p>	<p>faqe 126-157</p>	<p>e lartë</p>	<p><u>Rekomandimi:</u> Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi mbi raportet që gjenerojnë të dhëna të sistemit të cilat nuk kanë filtrat e aplikuar, nuk zgjidhin kërkesat e përdoruesve të cilët krijojnë mënyra alternative të përpunimit të mëtejshëm të informacionit jashtë sistemit Eterna Financiar dhe Postar, çfarë do të lehtësonte veprimet manuale të punonjësve.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - sistemi nuk gjeneron raporte dorëzimi për një periudhë të gjatë kohore; - nuk shfaqet asnjë e dhënë që përdoruesi të përzgjedhi me qëllim gjenerimin e raporteve; - opsioni RPO40 shfaq një tabelë pa asnjë të dhënë për opsionet e përzgjedhura nga përdoruesi; - raporte supervizori kanë shumë vonesa në gjenerimin e raporteve. 			
5	<p><u>Gjetje nga auditimi:</u> Posta Shqiptare, që prej vitit 2012 e në vazhdim, për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të Eternës ka investuar (blerë) në totale 176,091,320 lekë, pa TVSH. Ndërsa për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve që nga viti 2014 ka lidhur 10 kontrata të njëpasnjëshme që vazhdojnë të kenë afat deri në mesin e vitit 2024, me vlerë të përgjithshme 158,200,000 lekë pa TVSH. Sistemet e Eterna përfshijnë dhe mbulojnë, shërbimet financiare (arkëtime, pagesa, transfera bankare, etj.) dhe proceset e shërbimeve postare. Të gjitha procedurat e prokurimeve si të blerjeve të sistemit ashtu edhe të mirëmbajtjes së tij, janë fituar nga i njëjti Operator Ekonomik, “H. S.”. Fillimisht në korrik të vitit 2012 është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje informatizimi i sporteve, gjurmimi kombëtar i objekteve postare dhe euroxhiro kombëtare”. Kjo blerje e sistemit është realizuar me procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për arsye të së drejtës së autorit dhe është konkretizuar më lidhjen kontratës së furnizimit nr.1029/4, datë 21.08.2012, me operatorin fitues “H. S.”, me vlerë 51,791,320 lekë, pa TVSH. Mbas vënies në funksionim së sistemit, në datën 03.04.2014 është realizuar edhe procedura me negociim për mirëmbajtjen e këtij sistemi, me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Në këtë procedurë për arsye të së drejtës së autorit i është dërguar ftesë për ofertë operatorit “H. S.” me të cilin është lidhur edhe kontrata e mirëmbajtjes nr.1069/7, datë 14.05.2014, me vlerë 26,850,000 lekë, pa TVSH, me afat 3 vjet (deri në datën 13.05.2017). Hartimi dhe kohëzgjatja e kontratës së mirëmbajtjes, ka buruar nga kërkesat e VKM nr. 723, datë 01.09.2010, i ndryshuar me VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, e cila përcakton se, kontratat e mirëmbajtjes duhet të jenë jo më të shkurtra se 2 (dy) vjet. Në zbatim të kësaj VKM, Ministrin për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, ka nxjerrë Udhëzimin nr.2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”. Në germën “e”, të pikës 8, të kreut II, të këtij udhëzimi përcaktohet se, për propozimet e kërkuara, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet që: “Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”</p> <p>Kontrata e mirëmbajtjes e sipërcituar me nr.1069/7, datë 14.05.2014, në asnjë nen të saj nuk ka të përcaktuar këtë dispozitë, por në nenin 11, ka përcaktuar se: “Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të</p>	faqe 28-102	e lartë	<p>Posta Shqiptare, në Dokumentet e Tenderit dhe në kushtet e kontratave të çdo procedure prokurimi që do të realizojë për blerjen edhe mirëmbajtjen e çdo sistemi teknologjie informacioni që do të aplikojë dhe zhvillojë, duhet të përcaktojë që:</p> <p>-“Posta Shqiptare, në përfundim të kontratës së furnizimit apo të afatit të garancisë së pajisjeve dhe sistemit, apo në përfundim të afatit të kontratës së parë të mirëmbajtjes (sipas përcaktimeve të VKM. 710, datë 21.8.2013), pronësia e Kodeve Burimore (source code), analizat e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të sistemit, do ti kalojnë Postës Shqiptare sh.a, pa asnjë kosto shtesë”.</p>

<p>mbetet pronë e Kontraktuesit”. Pra, Posta Shqiptare ndryshe nga ç ‘kërkohej në përcaktimet apo rekomandimet e këtij udhëzimi, nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim, Analizat e Projektimit, burimin dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha moduleve të sistemeve të Eternës. Problematika e trajtuar më sipër, është mbartur dhe konstatuar në të gjitha procedurat e prokurimeve të realizuara për blerjen edhe mirëmbajtjen e sistemeve Eterna edhe gjatë periudhës objekt auditimi.</p>			
---	--	--	--

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit:

Grupi i auditimit mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH" datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e strategjisë institucionale dhe strategjisë në drejtim të teknologjisë së informacionit mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës Shqiptare.

Gjithashtu mungesa e kontrolleve dhe mekanizmave të duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe mungesa e akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera.

Zhvillimet e sistemit kryesor të informacionit Eterna që i kanë dhënë shoqërisë Posta Shqiptare mundësi të shumta në shtimin e shërbimeve, kanë ndodhur në kushtet e të drejtës së autorit dhe në mungesë të pronësisë me kodin në burim. Këto elementë kanë ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe mirë përdorimin e fondeve publike.

Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pamjaftueshëm.

II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 877/1 prot, datë 14.09.2021 miratuar nga Kryetari i KLSH, ndryshuar me shkresën nr. 877/2 prot, datë 14.10.2021, me afat auditimi 03.09.2021 deri në 19.11.2021, në subjektin e auditimit “Posta Shqiptare Sh.a”, ku periudha e audituar ishte 01.01.2019 deri në 30.06.2021, u krye auditimi me objekt “Ri-auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, me grup auditimi të përbërë nga:

1. B. H., *Përgjegjës grupi*
2. B. A., *anëtar*
3. K. S., *anëtare*
4. E. K., *anëtar*

II.1. Objekti i auditimit:

Objektivi i ri-auditimit IT është përcaktimi nëse institucioni arrin objektivat e tij duke përdorur burimet IT në mënyrë efektive dhe në përputhje me: kërkesat ligjore/rregullative, integritetin, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2. Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i ri-auditimit IT është vlerësimi nëse se ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

Objektivat e këtij projekt auditimi, u vendosën në koherencë me veprimtarinë, vizionin, qëllimin dhe objektivat e shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a., duke marrë në konsideratë të gjithë kuadrin rregullator në bazë të të cilit institucioni zhvillon veprimtarinë e tij. Për të arritur në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë efiçente.

II.3. Identifikimi i çështjeve:

Duke qenë në kushtet e ri-auditimit të këtij subjekti, grupi i auditimit i ka rivlerësuar ato fusha që kanë rezultuar si fusha me risk, nga auditimi i mëparshëm, ku janë vlerësuar si me risk drejtimet e auditimit si më poshtë:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

Auditimi i kësaj fushe është konsideruar i rëndësishëm për shkak të rëndësisë që ka institucioni në ofrimin e shërbimeve. Kjo fushë është struktura e përgjithshme që udhëheq operacionet IT në një institucion. Elementet kyç të audituar janë, Strategjia dhe planifikimi TI, Struktura, standardet, politikat dhe proceset e institucionit, politikat e burimeve njerëzore, përshkrimet e punës në këtë strukturë, ndarja e detyrave, zhvillimi i burimeve njerëzore si dhe identifikimi dhe vlerësimi mbi risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

Nga kontrolli në regjistrin e procedurave të prokurimit realizuar në vitin 2019 – 30.06.2021 rezulton se Posta Shqiptare Sh.a, ka zhvilluar afërsisht 18 procedura që lidhen me shërbime në teknologjinë e informacionit (*pajisje hardware, sisteme software, MNSH*) me vlerë kontrate afërsisht 439,606,000 lekë (pa tvsh) dhe me fond limit 512,481,000 lekë (pa tvsh). Për arsyet e mësipërme, auditimi mbi procedurat e prokurimit për teknologjinë e informacionit janë vlerësuar si të rëndësishme.

3. Auditimi i Sigurisë së Informacionit

Ky drejtim është audituar me qëllim vlerësimin e sigurisë së të dhënave të cilat kërkojnë monitorim të vazhdueshëm, mbrojtjen e tyre, të drejtat e përdoruesve në sisteme si dhe ofrimin e shërbimit pa ndërprerje nga Posta Shqiptare Sh.a.

4. Auditimi i sistemeve

Auditimi i sistemeve funksionale me të cilat subjekti realizon dhe monitoron aktivitetin e tij ka patur si qëllim vlerësimin e kontroleve të implementuara nëpërmjet sistemit si dhe hyrjen dhe saktësinë e të dhënave dhe raportimin e tyre në funksion të vendimmarrjeve të ndryshme.

5. Të tjera

Në këtë pikë, grupi i auditimit ka përfshirë të gjitha ato çështje të pa adresuara që kanë dalë nga auditimi dhe janë gjykuar me siguri të arsyeshme nga grupi i auditimit për tu përfshirë në

raportin e auditimit siç ishte trajtimi i Auditimit të TI në subjekt, nga Auditi i Brendshëm i subjektit.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Posta Shqiptare Sh.a është shoqëria më e madhe tregtare që operon në tregun e shërbimeve postare dhe financiare. Ndër vite, Posta Shqiptare Sh.a nuk ka pasur në fokus vetëm aktivitetin tregtar, por ka shërbyer si një ndërmjetëse vitale midis biznesit, qytetarëve dhe institucioneve. Shoqëria ka si qëllim sigurimin e një shërbimi të qëndrueshëm, të sigurt, të shpejtë dhe me kosto konkurruese. Rritjen në cilësi dhe në lloje të shërbimeve, monitorimin e shërbimeve për shmangien e risqeve dhe abuzimeve gjatë shërbimeve.

Veprimtaria e shoqërisë “Posta Shqiptare Sh.a”, orientohet dhe organizohet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, legjislacionit në fuqi, Vendimit të Këshillit të Ministrave si dhe programit të qeverisë në fushën e shërbimeve postare. Posta shqiptare ka një shtrirje të gjerë përgjatë gjithë territorit të Republikës me rreth 533 zyra postare dhe me rreth 2500 punonjës.

Misioni i shoqërisë “Posta Shqiptare Sh.a”, është të zgjerojë e përmirësojë shërbimet tradicionale të Postës, të sjell shërbime të reja postare, financiare e bankare në përputhje dhe në zbatim të politikës e strategjisë dhe zhvillimit të Postës Shqiptare Sh.a. Të automatizojë, kompjuterizojë e standardizojë shërbimet postare, financiare dhe bankare. Të sigurojë dhe të mbështesë rezultatin ekonomik në rritje të Postës Shqiptare Sh.a, nëpërmjet planeve ekonomike financiare, operative dhe strategjike

Objektivi kryesor është konsolidimi i pozicionit dhe rritja e reputacionit të kompanisë në tregun e shërbimeve, duke synuar arritjen e standardeve në të njëjtin nivel me shoqëritë homologe të rajonit e më gjerë.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, auditoi Postën Shqiptare Sh.a, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2019 deri në 30.06.2021, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me cilësinë e shërbimeve të ofruara nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit, sigurisë së të dhënave dhe arritjes së objektivave institucional nëpërmjet përdorimit të burimeve të TIK.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 877/1 prot, datë 14.09.2021, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit si dhe në legjislacionin e fushës në të cilën operon Posta Shqiptare Sh.a. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur për nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve.

II.6. Kriteret e vlerësimit:

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165 si dhe nenet 78, 83);
- Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” ;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;

- Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 2/2017, “Për Sigurinë Kibernetike”;
- Ligji nr.1029, datë 8.7.2010 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Ligji nr.114/2015 për “Auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit TI si dhe Standardet e COBIT.

II.7. Standardet e auditimit:

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknika auditimi, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310 si dhe standardet ndërkombëtare të teknologjisë së informacionit.

II.8. Metodat e auditimit:

Grupi i auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit, ka përdorur metoda si intervista me gojë zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës, testim me zgjedhje, verifikimin e zbatimit të kontratave të marrëveshjeve në nivel shërbimi në varësi të rëndësisë dhe vlerës monetare, ka verifikuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe të paraqitur nga subjekti i audituar me qëllim përmbushjen e drejtimeve të auditimit, ka testuar me teknikat CAAT të dhënat e sistemeve, si dhe ka kryer testim dhe verifikime mbi shkallën e sigurisë së rrjetit dhe sistemeve që subjekti i audituar përdor, analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi, analizimi i të dhënave të raportuara nga ana e subjektit.

II.9. Dokumentimi i auditimit:

Dokumentimi i auditimit është bazuar në manualin e auditimit të teknologjisë së informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren;
- Pyetësorë dhe përgjigje të punonjësve që veprojnë nëpërmjet sistemit.

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Rregullorja e brendshme e administratës qendrore; Struktura e përgjithshme organizative e miratuar e institucionit; Lista e të gjithë punonjësve në IT sipas kategorisë, hierarkisë, pozicionit të punës në strukturë si dhe përshkrimet e punës sipas akteve rregullative në fuqi; Organigrama; Aktet rregullative të shoqërisë që lidhen me sistemet dhe veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit; Rregullore e administrimit të rrezikut operacional; Metodologjia e vlerësimit të riskut; Parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit; Gjithashtu grupi i auditimit mblodhi informacione duke zhvilluar pyetësorë e intervista me stafin e Postës Shqiptare dhe mbi informacionin e mbledhur u zhvilluan analizime; etj.

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i Sigurisë së Informacionit*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Verifikime onsite të dhomës së serverave të Postës Shqiptare dhe DRC në Kinostudio dhe networkut të institucionit; Skema e komunikimit të network-ut; Politikat mbi sigurinë e informacionit; Lista e përdoruesve në sistemet TIK; U mor akses me përdorues me të drejta “lexuesi” në sistemin Eterna; Konfigurimet mbi switch-et dhe firewall; Procedurat për backup-in e të dhënave; Verifikimi e dokumentimi i planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat; Konsultim me faqen e web-it të Postës Shqiptare; etj.

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i Sistemeve*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Përshkrim i përgjithshëm i Sistemit të Teknologjisë së Informacionit në Postën Shqiptare Sh.a; Të dhënat e gjeneruara nga sistemet për shërbimet e standardizuara; Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e përgjithshme; U mor akses me përdorues me të drejta “lexues” në sistemin Eterna, Kibana dhe ndërfaqja e e-Albania e dedikuar për Postën Shqiptare Sh.a; Aktet rregullative të shoqërisë që lidhen me sistemet dhe veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit; Manuallet e përdorimit të sistemeve; Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administronin shërbime të caktuara; Të dhënat për përdoruesit e sistemeve Eterna Financiare dhe Eterna Postare; Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Postës Shqiptare Sh.a dhe AKSHI; Të dhënat e përdoruesve në e-Albania; Evidencat që shoqëria gjeneron për qëllime rakordimi apo raportimi; Verifikimi i raporteve në sistemet Eterna.

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Mbi procedurat e investimeve në fushën TIK; Marrëveshjet në nivel shërbimi (u shqyrtua zbatimi i MNSH në lidhje me raportet dhe me kërkesat kontraktuale), etj. Vlerësime nëse subjekti ka zhvilluar një procedura prokurimi konform udhëzimeve dhe ligjeve në fuqi, vlerësime nëse kërkesat e sigurisë janë adresuar në prokurime dhe janë në përputhje me to.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:



Posta Shqiptare Sh.a është shoqëria më e madhe tregtare që operon në tregun e shërbimeve postare dhe financiare. Ndër vite, Posta Shqiptare Sh.a nuk ka pasur në fokus vetëm aktivitetin tregtar, por ka shërbyer si një ndërmjetëse vitale midis biznesit, qytetarëve dhe institucioneve.



Shoqëria ka si qëllim sigurimin e një shërbimi të qëndrueshëm, të sigurt, të shpejtë dhe me kosto konkurruese. Rritjen në cilësi dhe në lloje të shërbimeve, monitorimin e shërbimeve për shmangien e risqeve dhe abuzimeve gjatë shërbimeve.

Veprimtaria e shoqërisë “Posta Shqiptare Sh.a”, orientohet dhe organizohet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, legjislationit në fuqi, Vendimit të Këshillit të Ministrave si dhe programit të qeverisë në fushën e shërbimeve postare. Posta Shqiptare ka një shtrirje të gjerë përgjatë gjithë territorit të Republikës me rreth 533 zyra postare dhe me rreth 2500 punonjës.

Misioni i shoqërisë “Posta Shqiptare Sh.a”, është të zgjerojë e përmirësojë shërbimet tradicionale të Postës, të sjell shërbime të reja postare, financiare e bankare në përputhje dhe në zbatim të politikës e strategjisë dhe zhvillimit të Postës Shqiptare Sh.a. Të automatizojë, kompjuterizojë e standardizojë shërbimet postare, financiare dhe bankare. Të sigurojë dhe të

mbështesë rezultatin ekonomik në rritje të Postës Shqiptare Sh.a, nëpërmjet planeve ekonomike financiare, operative dhe strategjike.

Objektivi kryesor është konsolidimi i pozicionit dhe rritja e reputacionit të kompanisë në tregun e shërbimeve, duke synuar arritjen e standardeve në të njëjtin nivel me shoqëritë homologe të rajonit e më gjerë.

Veprimtaria e subjektit të audituar mbështetet në bazën ligjore si më poshtë:

- Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” ;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 2/2017, “Për Sigurinë Kibernetike”.
- Ligji nr.1029, datë 8.7.2010 për “Menaxhimin financiar dhe Kontrollin”;
- Ligji nr.114/2015 për “Auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- Aktet e brendshme rregullative të shoqërisë.

Nisur nga fakti se shoqëria Posta Shqiptare Sh.a, ofron shërbime të shumta për nga natyra, dhe për këtë ka ndërtuar sisteme informatike të cilat janë prej vitesh si mbështetje kryesore me qëllim ofrimin e shërbimit të sigurve, të shpejtë dhe të saktë, u vlerësua me rëndësi auditimi i TI nga KLSH, me qëllim vlerësimin e kontrolleve dhe mekanizmat që janë ndërtuar për krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

III.2. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

a. Verifikimi i procedurave dhe burimeve njerëzore në TIK:

➤ Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK

➤ *Strategjia TIK*

Dokumenti strategjik i administruar nga grupi i auditimit është “*Strategjia për vitet 2018-2022*”, version draft. Ky dokument strategjik nuk është i miratuar nga organet drejtuese të Postës Shqiptare¹. Ky dokument iu paraqit grupit të auditimit si përgjigje mbi pyetësorin e dërguar. Nga administrimi i këtij draft dokumenti u konstatua se ky draft dokument nuk përcakton politika shteruese për veprimtarinë institucionale duke përfshirë dhe teknologjinë e informacionit.

Nga auditimi u konstatua se:

-Posta shqiptare Sh.a, nuk ka plan strategjik institucional të miratuar me qëllim përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave institucionale.

-Gjithashtu nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar për teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planifikimeve strategjike institucionale mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës.

➤ *Verifikim i politikave dhe procedurat në TIK*

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit në Postën Shqiptare, verifikoi Rregulloren e Brendshme të institucionit si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje, pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara si dhe nga praktikat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

❖ Aktualisht, institucioni e ushtron aktivitetin e tij mbështetur në rregulloren “*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a*”, miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare.

Nga auditimi u konstatua se, Rregullorja e Brendshme, “*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a*” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare nuk është përshtatur (*amenduar*) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare, konkretisht:

- në rregulloren e brendshme të PSH Sh.a. detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara jo në mënyrë të detajuar. Në përcaktimin e kompetencave të drejtorit të IT dhe zhvillimit, në rregulloren e brendshme “*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A*” ka mbivendosje të këtyre kompetencave, pasi disa prej tyre tejkalojnë nivelin hierarkik të drejtorit të drejtorisë. Për shembull në pikën 16 të rregullores së brendshme ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e drejtorit të IT dhe zhvillimit, ku citohet se drejtori i IT “*Përcakton, zhvillon dhe përsos më tej strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të automatizimit të Posta Shqiptare SH.A*”, drejtori i IT, merr përgjegjësitë e Administratorit.

Në disa raste përgjegjësi i sektorit të sistemeve ka më shumëtribute se sa drejtori i drejtorisë, për shembull në pikën 2, të Detyrave dhe Përgjegjësisë të përgjegjësit të sektorit dhe sistemeve. Kjo problematikë haset edhe në sektorët e tjerë ku ka raste që kalojnë kompetencat hierarkike.

¹ Organet drejtuese të Shoqërisë janë Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm.

- në disa raste konstatohet se mungojnë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësive për disa funksione që janë në strukturën organizative por nuk gjenden të reflektuara në rregulloren e brendshme të funksionit të administratës qendrore.

❖ Gjatë fazës së auditimit në terren grupi i auditimit administroi një sërë rregulloresh dhe manualesh, të tjera nga ku u konstatua se institucioni administroi dhe ka në përdorim një bazë rregullative, konkretisht:

- Rregullore mbi veprimtarinë operacionale;
- Rregullore për lidhjen në distancë (Remote Access);
- Rregullore për Transparencën;
- Log management user and administration manual;
- Përdorimi i e-mail në smart phone;
- Si të ndërrohet password në kompjuterin e punës në zyrë dhe nga faqja e web.

Nga auditimi u konstatua se këto dokumente nuk janë të miratuara nga asnjë prej organeve drejtuese të Postës Shqiptare. Ato i janë paraqitur grupit të auditimit si përgjigje ndaj pyetësorit dhe përdorën si bazë rregullatore nga administrata e Postës, pavarësisht se nuk janë të miratuara.

❖ Nga administrimi i bazës rregullatore që i është vendosur në dispozicion grupit të auditimit, konkretisht:

- Politikat e përdorimit dhe sigurisë së sistemeve TIK (*shkresa 1952/2, datë 19.08.2008*);
- Analiza e riskut për sistemet TIK (*shkresa nr. 1952/2, datë 19.08.2008*);
- Standardi i menaxhimit të problemeve dhe incidenteve (*shkresa 1952/2, datë 19.08.2008*);
- Procedurat e sigurimit të Postës Shqiptare (*shkresa 3678, datë 16.11.2006*).

U konstatua se këto dokumente nuk janë rishikuar duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite dhe ndryshimet në investime në fushën e teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare. Ndër të tjera tre dokumentet e parë të cituar më lart, mbajnë të njëjtën datë dhe numër protokollit në kundërshtim me nenet 36-41 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Aktualisht këto rregullore janë ende në përdorim nga administrata e Postës.

❖ Nga administrimi i “Rregullores mbi procedurat e backup-it të Postës Shqiptare Sh.a” miratuar me shkresën nr. 583/1, datë 25.02.2019, të drejtorit të sigurisë dhe cilësisë u konstatua se kjo rregullore është nënshkruar jo nga organet drejtuese të Postës Shqiptare Sh.a, por nga një nivel menaxherial që nuk ka kompetenca juridike për nënshkrimin dhe nxjerrjen e akteve administrativ institucionale, në kundërshtim me nenet 7, 11 dhe 14 të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare.


❖ Nga administrimi i Rregullores “Për administrimin e rrezikut operacionale” u konstatua se kjo rregullore është miratuar dy herë brenda vitit. Kjo rregullore është miratuar me shkresën nr. 583/2, datë 25.02.2019, të administratorit të shoqërisë, e cila ka shfuqizuar rregulloren nr. 1579, datë 31.08.2011 “Për administrimin e rrezikut operacionale”. Nga auditimi u konstatua se kjo rregullore është miratuar edhe me shkresën nr. 2144, datë 09.08.2019 të administratorit të Postës, e cila është e njëjtë në përmbajtje por nuk ka shfuqizuar rregulloren me shkresën nr. 583/2, datë 25.02.2019. Kjo gjë sjell konfuzion në përdorim dhe në zbatim të këtij dokumenti nga administrata sepse në disa raste i referohen rregulloreve të ndryshme.

Në opinionin e grupit të auditimit hartimi dhe ndërtimi i një rregulloreje koncize të përgjithshme mbi teknologjinë e informacionit do të ndihmonte dhe lehtësonte stafin IT dhe përdoruesit e sistemeve, të mos shpërqendroheshin nga numri i madh i rregulloreve që duhet të administrojnë gjatë punës së tyre. Ata mund të konsultojnë dhe ti referohen një rregulloreje të vetme mbi teknologjinë e informacionit.

➤ **Vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK**

Posta Shqiptare Sh.a funksionon në bazë të ligjit nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe mbi aktet ligjore dhe nënligjore në funksion të saj. Posta Shqiptare Sh.a ka në total një numër prej 2568 punonjësish nga të cilët 166 janë pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme, të vendosur në Tiranë. Numri më i madh i punonjësve të drejtorive rajonale është i përqendruar në qytetet më të mëdha: Tiranë (644), Elbasan (211), Durrës (179), Tranziti (162), Korçë (152), Shkodër (144), Berat (141), Fier (128) dhe Vlorë (107).

Figura nr. 1: Në figurën e mëposhtme paraqitet struktura organike e Postës Shqiptare Sh.a



Burimi: Subjekti i auditimit.

Struktura e teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare, është e ngritur në nivel drejtorie, me emrin “Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit”.

Drejtoria e IT-së dhe Zhvillimit është pjesë e Departamentit të Shërbimeve dhe është e organizuar në 4 (katër) sektorë, *Sektori i Sistemeve*, *Sektori i Suportit Teknik*, *Sektori i Rrjetit dhe Sektori i Aplikimit dhe Administrimit të të Dhënave*. Marrëdhëniet e punës në institucion rregullohen në bazë të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

Struktura aktuale e Drejtorisë së IT-së dhe Zhvillimit në Postën Shqiptare Sh.a, është e përbërë nga 16 punonjës: një drejtor drejtorie, 4 (katër) përgjegjës sektori dhe 12 specialist. Pozicioni i drejtuesit të këtij departamenti është plotësuar në muajin Qershor të vitit 2021 me largimin e drejtorit të mëparshëm i cili ka qëndruar në këtë pozicion për një periudhë 1 vjeçare.

Për vitin 2021 struktura e sektorit të sistemeve në Drejtorisë së IT-së dhe Zhvillimit është e paplotësuar sipas strukturës organike të përcaktuar (*specialisti i sektorit të sistemeve është vakant*). Gjatë periudhës së auditimit ka patur 3 (tre) largime të stafit IT 2 (dy) prej të cilave janë zëvendësuar me lëvizje brenda përbrenda Drejtorisë, dhe 3 (tre) pozicione janë zëvendësuar me staf të ri.

Struktura IT paraqitet grafikisht si më poshtë:




Tabela nr. 1: Struktura TIK Plan/Fakt

Nr.	Emërtimi	Niveli arsimor	Viti 2019		Viti 2020		6 mujori i I-rë i 2021	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Drejtor	Inxhinieri Elektronike	-	-	1	1	1	1
2	Përgjegjës Sektori i Sistemeve	Inxhinieri Elektronike	1	1	1	1	1	1
3	Specialist Sistemesh	Informatik						
4	Specialist Sistemesh	Teknologji Informacioni			3	3	3	2
5	Specialist Sistemesh	Informatik						
6	Përgjegjës Sektori Teknik	Informatik -Ekonomike	1	1	1	1	1	1
7	Specialist Suportit Teknik	Elektronik						
8	Specialist Suportit Teknik	Informatik e Aplikuar			3	3	3	3
9	Specialist Suportit Teknik	Informatik						
10	Përgjegjës Sektori i Rrjetit	Teknologji Informacioni	1	1	1	1	1	1
11	Specialist Rrjeti	Inxhinieri Elektronike						
12	Specialist Rrjeti	Teknologji Informacioni, Master në Informatike Ekonomike	3	3	3	3	3	3
13	Specialist Rrjeti	Inxhinieri Elektrike						
14	Përgjegjës Sektori i Aplikimit & Administrimit të dhënave	Informatik -Ekonomike	1	1	1	1	1	1
15	Specialist i Aplikimit & Administrimit të dhënave	Inxhinieri Elektronike						
16	Specialist i Aplikimit & Administrimit të dhënave	Teknologji Informacioni, Master në Informatike Ekonomike	2	2	2	2	2	2

Burimi: Posta Shqiptare Sh.a. Përpunuar nga grupi i auditimit.

Në rregulloren e brendshme të administratës qendrore të Postës Shqiptare Sh.a. miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 6, datë 20.02.2018, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë IT dhe Zhvillimit sipas pozicioneve: Drejtor, Përgjegjës Sektori dhe Specialist.

Nga dokumentacioni administruar dhe i paraqitur nga Posta Shqiptare Sh.a., si dhe nga intervistat e zhvilluara nga grupi i auditimit, u konstatua se mungojnë përshkrimet e punës për stafin e Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit mbi mënyrën dhe organizimin, funksionimin dhe ndarjen e përgjegjësive specifike të roleve, punëve dhe veprimeve operacionale brenda

drejtorisë, në mospërputhje me përcaktimet në nenin 4 pika 20, neni 20 pika c dhe neni 22 pika b të ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Nga auditimi u konstatua se për punonjësit e drejtorisë së IT dhe Zhvillimit nuk janë hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës si dhe kriteret për kualifikimet e punonjësve për këtë drejtori. Përshkrimet e punës që gjenden në dosjen individuale të çdo specialisti të kësaj drejtorie janë marrë nga rregullorja e brendshme e Postës Shqiptare, duke mos përcaktuar qartësisht përgjegjësitë dhe detyrat e gjithsecilit në proceset e punës.

Nga auditimi mbi ndërtimin dhe organizmin e strukturës së Postës Shqiptare Sh.a. u konstatua se Sektori i Sigurisë së Informacionit është në varësi të Drejtorisë së Sigurisë dhe Cilësisë pjesë e Departamentit të Zhvillimit dhe Standardeve.

Ky sektor ka qenë nën varësinë e Drejtorisë TIK, por që prej vitit 2018 ka kaluar në varësinë e Drejtorisë së Sigurisë dhe Cilësisë. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të këtij sektori përcaktohet kryerja e auditimit të rrjetit dhe sistemeve, gjetja e dobësive në sisteme si dhe shqyrtimi i raporteve të auditit të sistemeve.

Një ndër detyrat e përcaktuara për Specialistin e Sektorit të Sigurisë së Informacionit është “sigurimi që të jenë zhvilluar dhe zbatuar procedurat standarde, udhëzimet e sigurisë dhe masat që mbështesin sigurinë e të gjithë rrjetit dhe sistemeve si dhe të gjithë komponentët e rrjetit”.

Duke vlerësuar rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore në Postën Shqiptare Sh.a, nga auditimi u konstatua se:

Nisur nga shtrirja e teknologjisë së informacionit në institucion si dhe nga rëndësia e të dhënave që ruhen dhe përpunohen nga Sektori i Sigurisë së Informacionit dhe ofrimit të shërbimeve postare dhe financiare me anë të sistemit informatik “Eterna”, grupi i auditimit gjykon se organizimi i kësaj strukture nën Drejtorinë e Sigurisë dhe Cilësisë, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare.

Në opinion të grupit të auditimit ky sektor duhet të jetë i pozicionuar në varësi të Drejtorisë së IT-së dhe Zhvillimit me qëllim përmbushjen më efektivitet të objektivave sektoriale dhe koordinimin e aktivitetit të saj me sektorët e tjerë që janë pjesë e të njëjtës fushë duke sjellë rritjen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e Postës Shqiptare.

➤ **Trajnimet**

Trajnimi është një nga shtyllat e rëndësishme për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore. E rëndësishme është që i gjithë personeli që ka akses në asetet dhe sistemet e teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare të aftësohet për tu bërë i vetëdijshëm për rregullat dhe standardet e sigurisë dhe të jenë të aftë t'i zbatojnë dhe ndjekin ato gjatë punës së tyre.

-Me qëllim që të sigurohet parashikimi, programimi dhe implementimi i suksesshëm i veprimtarive trajnuese është e nevojshme që procesi të mbështetet në një identifikim dhe analizë të nevojave për trajnim të stafit.

Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Posta Shqiptare, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2019-6-mujori i parë i vitit 2021 për burimet njerëzore të drejtorisë së Teknologjisë e Informacionit dhe Zhvillimit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Mbështetur në rregulloren për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a, është detyrë dhe kompetencë e niveleve menaxheriale propozimi dhe hartimi i kërkesave për trajnime. Trajnimet e përfituara nga zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

b. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit

Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: Rreziku i biznesit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e IT në Postën Shqiptare. Në lidhje me këtë çështje grupi i auditimit administroi dokumentin “*Metodologjia e vlerësimit të riskut*”, miratuar me shkresën nr. 2144/2, datë 09.08.2019, firmosur nga Administratori i Shoqërisë. Ky dokument trajton hapat që duhet të ndërrohen institucioni për përcaktimin e risqeve mbi sigurinë e informacionit. Në përfundim nuk është gjeneruar asnjë dokument lidhur me përcaktimin e këtyre risqeve.

Nga administrimi i dokumentacionit se si Posta Shqiptare, identifikon dhe menaxhon risqet institucionale dhe risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se Posta Shqiptare nuk disponon regjistër rrisiku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet Eterna, IPS, CDS, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përsa i përket arritjes së objektivave institucionale.

Nisur sa më sipër dhe mbështetur në nenin 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “*Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve*”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”, shoqëria Posta Shqiptare duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e funksionimit të Qeverisjes TIK, mbajnë përgjegjësi z. L. D. në cilësinë e ish-Administratorit të Shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 7, 11 dhe 14 të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe “Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm” përcaktuar në rregulloren e brendshme “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A”, si dhe znj. A. K. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Administrimit të Shoqërisë, z. V. A. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Zhvillimit dhe Standardeve, znj. E. C. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve, znj. M. H. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë të Burimeve Njerëzore dhe z. E. K. në cilësinë e ish- Drejtorit të Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit, sipas detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në rregulloren e brendshme institucionale “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 9, datë 19.11.2021, protokolluar në Postën Shqiptare Sh.a me nr. 1667/11 datë 19.11.2021, si dhe është trajtuar në faqet 9-21 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione mbi Aktkonstatimin nr. 9, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 877/31, datë 06.12.2021.

1. Pretendimi i subjektit:

Ju bëj me dije:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është ministri e linjës. Posta Shqiptare përpilon strategjinë e saj pas finalizimit të miratimit të politikave të shërbimit postar nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ; deri sipas informacioneve, “Dokumenti i politikës së shërbimeve”, është përpiluar si draft por nuk është miratuar ende...

Lidhur me konstatimin se rregulloret për TIK nuk janë të miratuara nga asnjë prej organeve drejtuese të Posta Shqiptare. sqarojmë se: në statutin e shoqërisë “Posta Shqiptare”, në pikën 14.10 theksohet se “Marrëdhëniet brenda shoqërisë, funksionet dhe kriteret e vendeve të punës përcaktohen në rregulloren e funksionimit të brendshëm të shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës”. Ndërkohë në procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës përkatësisht të datës 21.11.2018, është parashikuar nga ana e Këshillit Mbikëqyrës mos kompetenca në miratimin e rregulloreve për filiale apo të tjera, duke ja kaluar këtë kompetencë administratorit të shoqërisë...

Gjithashtu ju bëj me dije se Posta Shqiptare Sh.a, e cila operon në një treg të gjerë shërbimesh postare,... dhe aktivitetin e trajnimeve të stafit të kompanisë, në të gjitha nivelet e hierarkisë, por veçanërisht për sa i përket sistemeve të reja të teknologjisë si dhe shërbimeve të implementuara në këto sisteme ...

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Fakti është, që grupi i auditimit e ka konstatuar këtë gjë, gjatë fazës së auditimit në terren mbi dokumentacionin e venë në dispozicion nga subjekti. Argumentet e parashtruara nga subjekti i audituar janë përgjithësisht shpjeguese pa fakte të reja. Fakti është që Posta Shqiptare nuk ka plan strategjik institucional me qëllim përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave institucionale duke mbartur riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës, gjë e cila nuk mund të ngelet pas në hartimin e politikave të brendshme duke pritur finalizimin e politikave makro të ministrisë.

Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo problematikë, pa anashkaluar punën e bërë deri në këtë kohë nga ana e Postës, për pasojë konstatimet e grupit të auditimit nuk ndryshojnë.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 9, datë 19.11.2021, protokolluar në Postën Shqiptare Sh.a me nr. 1667/11 datë 19.11.2021, si dhe është trajtuar në faqet 9-21 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1667/64, datë 10.01.2022, protokolluar në KLSH me nr. 877/33, datë 12.01.2022. “Observacion në lidhje me Projektraportin për Auditimit e Teknologjisë së Informacionit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” nga znj. A. K..

1. Pretendimi i subjektit:

Nisur nga ky akt konstatimi i Juaj, kërkoj t’ju informoj se auditimi i funksioneve të qeverisjes TIK, nuk është pjesë e detyrave dhe kompetencave të Drejtorit të Departamentit të Administrimit të Shoqërisë, detyrë funksionale të cilën e kam mbajtur nga data 13 Korrik 2020 me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.20, deri më 13/12/2021 me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 09/12/2021. Ky funksion është pjesë e Departamentit të Shërbimeve dhe IT-së, sikundër dhe e strukturës së pavarur të Auditit të Brendshëm dhe menaxhimit të riskut.

1.1. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me sa më lart grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje observacionin në lidhje me identifikimin dhe menaxhimin e risqeve institucionale por edhe mbi IT që ne e kemi trajtuar gjatë auditimit të modulit “Auditimi i funksionimit të qeverisjes TIK”, duhet një bashkëpunim i të gjithë strukturave organizative të shoqërisë aq më tepër niveli drejtues menaxherial që ju keni.

Mbështetur në rregulloren e brendshme “Për organizimin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare” Kreu III “Struktura Organizative”, pika 2 Organet

ekzekutive të administrimit të shoqërisë, në kohën kur është zhvilluar auditimi ju keni mbajtur pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Administrimit të Shoqërisë që ka patur nën varësi: Drejtorinë Juridike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Ekonomike.

Në ndarjen e Detyrave dhe Kompetencave e Drejtorit të Departamentit të Administrimit që edhe ju e keni përmendur në observacion, në pikat 1,8,9, përcaktohet qartë detyrat dhe kompetencat. Pra hartimi i rregjistrit të riskut është detyrë edhe e juaja për veprimtarinë që mbulon departamenti juaj.

Hartimi i regjistrit të riskut ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit është detyrë e të gjithë strukturës organizative e Postës Shqiptare Sh.a ku secili duhet të marra masa për të veprimtarinë e departamentit që mbulon për të konkludaur në një dokument të vetëm.

Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo çështje, pa anashkaluar punën e bërë deri në këtë kohë nga ana e Postës, për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon dhe është lënë rekomandimi përkatës.

2. Pretendimi i subjektit:

Ju bëjmë me dije se strategjia e operatorit Posta Shqiptare përpilohet pas finalizimit të politikave të shërbimit postar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila për momentin ka përpiluar dokumentin e politikës së shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë (draft). Ky dokument prezanton politikën e zhvillimit të sektorit postar në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2021-2026. Qëllimi i këtij dokumenti të ri të politikës për zhvillimin e sektorit postar është përcaktimi i objektivave për përshtatjen me zhvillimet e fundit të sektorit në Bashkimin Evropian dhe atë global, përmirësimin e performancës së sektorit si dhe adoptimi i zhvillimeve të reja në kuadër të tregtisë elektronike (e-commerce). Dokumenti bazohet në eksperiencën e Bashkimit Evropian dhe në Strategjinë globale të zhvillimit të shërbimeve postare të miratuar nga Bashkimi i Përbotshëm Postar (UPU). Dokumenti përcakton objektivat afatmesëm dhe afatgjatë për zhvillimin e sektorit postar në Shqipëri në periudhën 2021-2026. Ky dokument do të zëvendësojë dokumentin e politikës të miratuar në vitin 2013, dhe synon të reflektojë zhvillimet e ndodhura në treg, si ato teknologjike dhe zhvillimet globale, duke i përshtatur ato me tregun shqiptar.

Nisur nga sa më sipër, Posta Shqiptare konfirmon se njëherë që ky draft dokument miratohet nga “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, zbatohet në një plan strategjik konkret afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë nga ana e operatorit “Posta Shqiptare”, që në rekomandimin tuaj përbën strategjinë e operatorit për 2021-2026, ku do të mund të reflektohen rekomandimet tuaja. Jemi ende në pritje të konfirmimit zyrtar nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të këtij dokumenti strategjik. Ndërkohë ju bëjmë me dije se programi ekonomik i çdo viti i shoqërisë, parashtron strategjinë tonë në investime sipas prioriteteve të përcaktuara nga drejtoritë respektive dhe aprovuara nga Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës.

2.1. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion, rezultoi se, këto observacione janë të njëjta dhe përsëritje të observacioneve të bëra mbi aktkonstatimin e mbajtur, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në Projektraport se, ato nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë. Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo problematikë.

3. Pretendimi i subjektit:

Bazuar në ligjin nr. 8237, datë 01/09/1997 “Për transferimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare (i ndryshuar), në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për kodin e punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr.9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar); në ligjin nr.46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimin Postare në Republikën e

Shqipërisë”, si dhe Vendimin nr.14, datë 09/12/2021 të miratuar në Këshillin Mbikëqyrës mbi “ Miratimin e ndryshimeve në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme dhe Filialit të Postës Hibride Mail”, ka vendosur ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Rregullores së Brendshme të Administratës Qendrore të Postës Shqiptare, bashkëlidhur Urdhri.

Gjithashtu referuar dhe disa sugjerimeve të lëna nga Raporti i Auditimit, me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.14, datë 09.12.2021 janë miratuar ndryshimet strukturore të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare Sh.a., si shkrirja si shkrirja e Drejtorisë së IT dhe Sigurisë në një të vetme dhe krijimi i Njesisë së Menaxhimit të Riskut e përbërë nga një Kryetar Njësie dhe dy Specialistë të Sektorit të Menaxhimit të Riskut.

Bazuar në vendimin e asamblesë së aksionerit nr. 11, datë 15/01/2018 për Miratimin e disa ndryshimeve në statusin e shoqërisë “Posta Shqiptare Tiranë”, në pikën 14.10 theksohet se “Marrëdhëniet brenda shoqërisë, funksionet dhe kriteret e vendeve punës përcaktohen në rregulloren e funksioneve të brendshëm të shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.” Ndërkohë në procesverbalin e këshillit mbikëqyrës përkatësisht të datës 21.11.2018, është parashikuar nga ana këshillit mbikëqyrës mos kompetenca në miratimin e rregulloreve për filiale apo të tjera, duke ja kaluar këtë kompetencë administratorit. Kjo është arsyeja pse gjithë rregulloret tona të periudhës objekt auditimi nga ana juaj janë të aprovuara nga administratori. Propozojmë që në vijim të projekti raportit të auditimit dhe akt konstatimeve tuaja të ndryshojë statusin duke i dhënë të drejtën e aprovimit të gjithë rregulloreve të kompanisë dhe Këshillit Mbikëqyrës.

3.1. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Posta Shqiptare e ka pranuar konstatimin e grupit të auditimit për pasojë më tej do të rekomandohet/en masat e duhura për përmirësimin e situatës.

1.Titulli i gjetjes: Mungesa e planifikimit strategjik institucional.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, Posta shqiptare Sh.a, nuk ka plan strategjik institucional të miratuar me qëllim përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave institucionale. Gjithashtu u konstatua se nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planifikimeve strategjike institucionale mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës.

Kriteri: Standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira

Ndikimi/Efekt: Zhvillimi pa strategji çon në mospërdorim me 3E të burimeve.

Shkaku: Mos zbatimi Standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira

Rëndësia: E lartë.

1.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a, duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimeve postare dhe financiare që ofron shoqëria si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni zotëron dhe përpunon me qëllim përcaktimin e objektivave dhe adresimin e burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik Institucional ku të përfshihet edhe planifikimi strategjik mbi teknologjinë e informacionit dhe ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare. Gjithashtu organet drejtuese të Postës Shqiptare Sh.a të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësisht të objektivave të përcaktuara.

2.Titulli i gjetjes: Mos përditësimi i rregullores së brendshme administrative, për funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, Rregullorja e Brendshme, “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare nuk është përshtatur (amenduar) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare, konkretisht:

- Në rregulloren e brendshme të Posta Shqiptare Sh.a. detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara jo në mënyrë të detajuar. Në përcaktimin e kompetencave të drejtorit të IT dhe zhvillimit, në rregulloren e brendshme “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a” ka mbivendosje të këtyre kompetencave, pasi disa prej tyre tejkalojnë nivelin hierarkik të drejtorit të drejtorisë. Për shembull në pikën 16 të rregullores së brendshme ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e drejtorit të IT dhe zhvillimit, ku citohet se drejtori i IT “Përcakton, zhvillon dhe përsos më tej strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të automatizimit të Posta Shqiptare SH.A”, drejtori i IT, merr përgjegjësitë e Administratorit.

Në disa raste përgjegjësi i sektorit të sistemeve ka më shumëtribute se sa drejtori i drejtorisë, për shembull në pikën 2, të Detyrave dhe Përgjegjësisë të përgjegjësit të sektorit dhe sistemeve. Kjo problematikë haset edhe në sektorët e tjerë ku ka raste që kalojnë kompetencat hierarkike.

- Në disa raste konstatohet se mungojnë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësisë për disa funksione që janë në strukturën organizative por nuk gjenden të reflektuara në rregulloren e brendshme të funksionit të administratës qendrore.

Kriteri: Nenet 7, 11, 14, të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe neni 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si dhe “Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm” përcaktuar në rregulloren e brendshme.

Ndikimi/efekti: Mos adresim i përgjegjësisë si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësisë.

Shkaku: Mos menaxhimi i ndryshimit në bazën ligjore, nënligjore dhe aktet rregullative

Rëndësia: E lartë

2.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojë, amendojë dhe miratojë, rregulloren e brendshme, “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a”, me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në shoqëri. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontroleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale si dhe me legjisllacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

3.Titulli i gjetjes: Mos miratim i akteve nënligjore të shoqërisë, të cilat kanë ndikim në veprimtarinë institucionale.

Situata: Gjatë fazës së auditimit në terren grupi i auditimit administroi një sërë rregulloresh dhe manualesh, të tjera nga ku u konstatua se institucioni administroi dhe ka në përdorim një bazë rregullative, konkretisht:

- Rregullore mbi veprimtarinë operacionale;
- Rregullore për lidhjen në distancë (Remote Access);
- Rregullore për Transparencën;
- Log management user and administration manual;
- Përdorimi i e-mail në smart phone;
- Si të ndërrohet password në kompjuterin e punës në zyrë dhe nga faqja e web.

Nga auditimi u konstatua se këto dokumente nuk janë të miratuara nga asnjë prej organeve drejtuese të Posta Shqiptare. Ato i janë paraqitur grupit të auditimit si përgjigje ndaj pyetësorit dhe përdorën si bazë rregullatore nga administrata e Postës, pavarësisht se nuk janë të miratuara.

Kriteri: Nenet 7, 11, 14, të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe neni 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si dhe “Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm” përcaktuar në rregulloren e brendshme. Vendimin nr. 32, datë 03.05.2006 të Bankës së Shqipërisë Për miratimin e Rregullores “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”

Ndikimi/efekti: Mos adresim i përgjegjësive si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive.

Shkaku: Mos miratim në bazën ligjore, nënligjore dhe aktet rregullative

Rëndësia: E lartë

3.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masa për miratimin e këtyre rregulloreve dhe amendimin e tyre me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në shoqëri.

4.Titulli i gjetjes: Mos përditësim i akteve rregullatore nënligjore dhe miratimi i tyre në kundërshtim me përcaktimet ligjore mbi arkivat në Republikën e Shqipërisë.

Situata 1: Nga administrimi dhe auditimi i bazës rregullatore si: Politikat e përdorimit dhe sigurisë së sisteme TIK (*shkresa 1952/2, datë 19.08.2008*); Analiza e riskut për sistemet TIK (*shkresa nr. 1952/2, datë 19.08.2008*); Standardi i menaxhimit të problemeve dhe incidenteve (*shkresa 1952/2, datë 19.08.2008*); Procedurat e sigurimit të Postës Shqiptare (*shkresa 3678, datë 16.11.2006*); u konstatua se kjo bazë rregullatorë nuk ka reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite dhe ndryshimet në investime në fushën e teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare. Disa nga dokumentet e mësipërme mbajnë të njëjtën datë dhe numër protokoll në kundërshtim me nenet 36-41 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Aktualisht këto rregullore janë ende në përdorim nga administrata e Postës.

Situata 2: Nga administrimi i “Rregullores mbi procedurat e backup-it të Posta Shqiptare Sh.a” miratuar me shkresën nr. 583/1, datë 25.02.2019, të drejtorit të sigurisë dhe cilësisë u konstatua se kjo rregullore është nënshkruar jo nga organet drejtuese të Posta Sh.a, por nga një nivel menaxherial që nuk ka kompetenca juridike për nënshkrimin dhe nxjerrjen e akteve administrative institucionale, në kundërshtim me nenet 7, 11 dhe 14 të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare.

Situata 3: Nga administrimi i Rregullores “Për Administrimin e Rrezikut Operacional” u konstatua se kjo rregullore është miratuar dy herë brenda vitit. Kjo rregullore është miratuar me shkresën nr. 583/2, datë 25.02.2019, të administratorit të shoqërisë, e cila ka shfuqizuar rregulloren nr. 1579, datë 31.08.2011 “Për administrimin e rrezikut operacional”. Nga auditimi u konstatua se kjo rregullore është miratuar edhe me shkresën nr. 2144, datë 09.08.2019 të administratorit të Postës, e cila është e njëjtë në përmbajtje por nuk ka shfuqizuar rregulloren me shkresën nr. 583/2, datë 25.02.2019. Kjo gjë sjell konfuzion në përdorim dhe në zbatim të këtij dokumenti nga administrata sepse në disa raste i referohen rregulloreve të ndryshme.

Kriteri: Nenet 7, 11, 14, të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe neni 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si dhe “Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm” përcaktuar në rregulloren e brendshme. Vendimin nr. 32, datë 03.05.2006 të Bankës së Shqipërisë Për miratimin e Rregullores “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”. Nenet 36-41 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Ndikimi/efekti: Mos adresim i përgjegjësive si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive.

Shkaku: Mos përditësim i akteve rregullatore nënligjore.

Rëndësia: E lartë

4.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojnë, amendojnë dhe miratojnë, aktet rregullative të cituara më lart në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare.

Gjatë hartimit dhe miratimit të tyre të respektohen rigorozisht përcaktimet ligjore për arkivat në Republikën e Shqipërisë.

5.Titulli i gjetjes: Identifikimi dhe vlerësimi i problematikave mbi burimet njerëzore të strukturës TIK si dhe mungesa e parashikimit dhe zhvillimit të trajnimeve.

Situata 1: Për vitin 2021 struktura e sektorit të sistemeve në Drejtorisë së IT-së dhe Zhvillimit është e paplotësuar sipas strukturës organike të përcaktuar. Gjatë periudhës së auditimit ka patur 3 (tre) largime të stafit IT 2 (dy) prej të cilave janë zëvendësuar me lëvizje brenda përbrenda Drejtorisë, dhe 3 (tre) pozicione janë zëvendësuar me staf të ri.

Nga auditimi u konstatua se mungojnë përshkrimet e punës për stafin e Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit mbi mënyrën dhe ndarjen e përgjegjësive specifike të roleve, punëve dhe veprimeve operacionale brenda drejtorisë, në mospërputhje me përcaktimet në nenin 4 pika 20, neni 20 pika c dhe neni 22 pika b të ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar.

Situata 2: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Posta Shqiptare, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2019-6-mujori i parë i vitit 2021 për burimet njerëzore të drejtorisë së Teknologjisë e Informacionit dhe Zhvillimit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Mbështetur në rregulloren për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A, është detyrë dhe kompetencë e niveleve menaxheriale propozimi dhe hartimi i kërkesave për trajnime.

Kriteri: Standardet ndërkombëtare të TIK për rritjen e kapaciteteve, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë. Nenet 20, 22 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar si dhe “*Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm*” përcaktuar në rregulloren e brendshme.

Ndikimi/efekti: Mungesa e aftësive për zbatimin e rregullave dhe standardeve të sigurisë së informacionit gjatë përdorimit të aseteve. Mos adresim i përgjegjësive si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive.

Shkaku: Mos identifikimi i problematikave mbi burimet njerëzore dhe mungesë planifikimi për zhvillimin e trajnime për burimet njerëzore.

Rëndësia: E mesme.

5.1.Rekomandimi: Administratori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare Sh.a në bashkëpunim me Departamentet përkatëse në Posta Sh.a dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për menaxhimin e burimeve njerëzore, me qëllim adresimin e përgjegjësive dhe përcaktimin e detyrave si dhe plotësimin e vendeve vakante sipas strukturës organike. Gjithashtu të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

6.Titulli i gjetjes: Organizimi hierarkik i strukturës TIK në Postën Shqiptare.

Situata: Nga auditimi mbi ndërtimin dhe organizmin e strukturës së Posta Shqiptare Sh.a. u konstatua se Sektori i Sigurisë së Informacionit është në varësi të Drejtorisë së Sigurisë dhe Cilësisë pjesë e Departamentit të Zhvillimit dhe Standardeve. Ky sektor ka qenë nën varësinë e Drejtorisë TIK dhe që prej vitit 2018 ka kaluar në varësinë e Drejtorisë së Sigurisë dhe Cilësisë. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të këtij sektori përcaktohet kryerja e auditimit të rrjetit dhe sistemeve, gjetja e dobësive në sisteme si dhe shqyrtimi i raporteve të auditit të sistemeve, detyrë kjo e cila sjell mbivendosje të

kompetencave me auditin IT. Një ndër detyrat e përcaktuara për Specialistin e Sektorit të Sigurisë së Informacionit është *“sigurimi që të jenë zhvilluar dhe zbatuar procedurat standarde, udhëzimet e sigurisë dhe masat që mbështesin sigurinë e të gjithë rrjetit dhe sistemeve si dhe të gjithë komponentët e rrjetit”*.

Nisur nga shtrirja e teknologjisë së informacionit në institucion si dhe nga rëndësia e të dhënave që ruhen dhe përpunohen nga Sektori i Sigurisë së Informacionit dhe ofrimit të shërbimeve postare dhe financiare me anë të sistemit informatik *“Eterna”*, gjykojmë se organizimi i kësaj strukture nën Drejtorinë e Sigurisë dhe Cilësisë, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare.

Kriteri: Praktikant më të mira ndërkombëtare në TIK në organizimin funksional të strukturave.
Ndikimi/efekti: Mos pasqyrimin e qartë të objektivave të Posta Shqiptare lidhur me zhvillimet teknologjike dhe zbeheje e ndikimit të strukturave TIK në vendimmarrje.

Shkaku: Paqartësi mbi rëndësinë e strukturave TIK dhe mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

6.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrin masa për pozicionimin e Sektorit të Sigurisë së Informacionit në varësi të Drejtorisë së IT-së dhe Zhvillimit me qëllim përmbushjen në mënyrë sa më efektive të objektivave sektoriale dhe koordinimin e aktivitetit të saj me sektorët e tjerë që janë pjesë e të njëjtës fushë duke sjellë rritjen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e Postës Shqiptare.

7.Titulli i gjetjes: Posta Shqiptare sh.a nuk disponon regjistër risku institucional ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

Situata: Nga administrimi i dokumentacionit se si Posta Shqiptare, identifikon dhe menaxhon risqet institucionale dhe risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se Posta Shqiptare nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet Eterna, IPS, CDS, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekte negative përsa i përket arritjes së objektivave institucionale.

Nisur sa më sipër rezulton se shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar regjistrin e riskut ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit, kjo mbështetur në nenin 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 *“Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”*, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”*.

Kriteri: Nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 *“Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”*, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”*.

Ndikimi/efekti: Shkelje e sigurisë, prishje e imazhit dhe humbje e të dhënave.

Shkaku: Mos përmbushje e dispozitave ligjore, sipas ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Rëndësia: E Lartë

7.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me Drejtorët e Departamenteve të marrin masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, në të cilin të përcaktohen edhe risqet në teknologjinë e informacionit. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin/ parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

II.2.2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

Posta Shqiptare Sh.a, bazuar në regjistrin e realizimeve vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe në verifikimin e Sistemit të Prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, për gjatë vitit 2019, 2020 dhe 2021 ka realizuar 43 procedura prokurimi me bazë Teknologjinë e Informacionit si më poshtë:

Procedurat e prokurimit mbi teknologjinë e informacionit për vitin 2019

Nr.	Objekti i Prokurimit	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Diferenca	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit kontratës
1	Blerje Materiale të imta IT	Blerje me vlerë të vogël	548,600	499,000	49,600	I. sh.p.k.	10.01.2020	2 ditë
2	Blerje Internet –Intranet”, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 2 vite”.	E hapur	85,824,000	28,546,560	57,277,440	BO C. P.	08.03.2021	24 muaj
3	Posta retail outlet (blerje on line për objekte postare si pulla, suvenire, etj. si dhe Mirëmbajtje për 4 vite pas implementimit	E Hapur	30,999,850	29,664,000	1,335,850	“H. S.” sh.p.k	25.05.2019	4 vite
4	Blerje pajisje it (kompjuter, printer, printer termik, printer matricor, fotokopje a4, barcode reader, palmar, tableta instanter)”	E hapur	42,144,000	39,296,530	2,847,470	B. E.	26.12.2019	60 ditë
5	Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të alarmit e të vëzhgimit, marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit, verifikimit dhe reagimi me grup të gatshëm në të gjitha Filialet e Degët dhe shërbimin me GPS/GPRS për automjete e Postës Shqiptare	E hapur	37,793,147	36,153,600	1,639,547	Bashkimit të OE: “S.” sh.p.k & “E.” sh.p.k., & “A. S.” & “Na.-2.” sh.p.k., , & “T.” sh.p.k	18.10.2019	1 vit
6	Blerje pajisje sigurie (pajisje GPS/GPRS, sistem alarmi, kamera për automjetet, sistem vëzhgimi DVR/NVR 4 kamera, sistem vëzhgimi dvr/nvr 8 kamera, sistem vëzhgimi DVR/NVR 16 kamera)	E Hapur	17,785,730	16,948,148	837,582	E. sh.p.k	11.09.2019	60 ditë
7	Blerje Eterna BI + Datawarehouse + Reporting Services, log management, manaxhim të dokumenteve, statistikë si dhe Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit	E Hapur	41,000,000	39,360,000	1,640,000	H. S. sh.p.k	16.09.2019	4 vite
8	Mirëmbajtje Sistemi VOIP	E hapur	11,992,000	11,280,000	712,000	C. P. sh.p.k.	01.10.2020	2 vite
9	Mirëmbajtja e Moduleve të Eternes (Finance-kontabilitet, Burimet njerëzore, Magazina, Help Desk) për 4 vite	E hapur	9,450,000	9,072,000	378,000	H. S.	18.07.2019	4 vite
10	Mirëmbajtje Eterna Gateway Application për 4 vite	E hapur	20,000,000	19,200,000	800,000	H. S.	18.07.2019	4 vite
11	Blerje sistem i dixhitalizuar radhe për klientët dhe përmirësimin e imazhit jashtë të zyrave qendër filial	E hapur	19,940,000	18,027,840	1,912,160	I. & C. P.” sh.p.k & “M. A.” sh.p.k	21.06.2019	60 ditë
12	Blerje Skaner në Qendrën Tranzite	Kërkesë për propozim	6,375,858	5,973,332	402,526	E.	28.05.2019	2 ditë
13	Blerje SMS	Kërkesë për propozim	2,460,000	2,246,400	213,600	I. & C. P.” sh.p.k	13.05.2019	1 vit
14	Blerje Automatizimi i Zyrës së Këmbimit	E hapur	49,907,726	47,786,665	2,121,061	E.	02.05.2019	6 muaj
15	Blerje Tonera, Bojëra Printeri	Procedurë e Hapur	32,889,500	22,157,280	10,732,220	E. C. sh.p.k.	24.05.2019	45 ditë
16	Shërbim printimi dhe fotokopje	Kërkesë për propozim	2,354,000	1,584,000	770,000	S. C. sh.p.k.	10.04.2019	1 vit
17	Mirëmbajtjen e Data Center	E hapur	12,000,000	11,422,176	577,824	B OE D. & B. E.	18.03.2019	1 vit
18	Blerje Internet-Intranet	Procedurë e hapur	44,820,000	22,934,016	21,885,984	B OE “C. P.” sh.p.k & A. sh.a.	15.03.2019	1 vit
19	Blerje Hibrid Mail	E Hapur	175,122,533	167,726,400	7,396,133	S. C.	20.01.2020	4 muaj
TOTAL			612,407,094	529,877,947				

Procedurat e prokurimit mbi teknologjinë e informacionit për vitin 2020

Nr.	Objekti i Prokurimit Viti 2020	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Diferenca	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit kontratës
1	Upgrade Licensa Software për sistemin e menaxhimit të radhës.	Blerje me vlerë të vogël	798,000	774,000	24,000	E. Xh.	11.11.2020	11/22/20
2	Blerje pajisje sigurie (pajisje GPS/GPRS, Sisteme alarmi, Sisteme vëzhgimi DVR/NVR 4 kamera, Sisteme vëzhgimi DVR/NVR 8 kamera, Kamera për automjetet) dhe Monitor LED 6m x 3.3 m për Qendrën e Monitorimit”	E hapur	28,505,600	26,773,332	1,732,268	L.s.s	26.11.2020	120 ditë
3	Blerje Palmar Profesional, Barkod Reader Me wires, Lexues Barkodesh	E hapur	33,731,000	32,821,000	910,000	S. C.	11.11.2020	45 ditë
4	Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të alarmit e të vëzhgimit, marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit, verifikimit dhe reagimi me grup të gatshëm në të gjitha Filialet e Degët dhe shërbimin me GPS/GPRS për automjetet e Postës Shqiptare	Blerje me vlerë të vogël	41,388,900	39,629,548	1,759,352	“E.” & “E.-S.& ”A. S.” & “S.A.S & ”T.”. & ”T.”	19.10.2020	1 vit
5	Mirëmbajtja E-Posta për 4 vite	E hapur	20,000,000	19,200,000	800,000	H. S. sh.p.k.	31.08.2020	48 ditë
6	Blerje Materiale të imta IT si dhe pjesë këmbimi, aksesori, riparime, shërbime e mirëmbajtje të ndryshme për pajisje elektronike të tilla	Blerje me vlerë të vogël	791,900	679,000	112,900	P.C.	27.07.2020	1 ditë

7	Shërbim printimi dhe fotokopje	Kërkesë për Propozim	1,936,000	1,784,640	151,360	S. C.	03.07.2020	1 vit
8	Mirëmbajtja Data Center	E Hapur	12,000,000	11,422,176	577,824	"D." dhe "B. E."	23.06.2020	1 vit
9	Blerje tonera, bojëra printeri	E hapur	60,034,800	37,053,897	22,980,903	I. O.	15.02.2021	45 ditë
10	Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite	E Hapur	27,000,000	25,920,000	1,080,000	H. S. sh.p.k	03.06.2020	3 vite
11	Blerje SMS-së	Kërkesë për Propozim	2,469,000	2,304,000	165,000	I. & C. P.	08.05.2020	1 vit
TOTAL			228,655,200	198,361,593				

Procedurat e prokurimit mbi teknologjinë e informacionit për vitin 2021

Nr.	Objekti i Prokurimit Viti 2021	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Diferenca	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit kontratës
1	Blerje pajisje sigurie (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi DVR/NVR 4 kamera, 8 kamera, 16 kamera + instalim kabull, kanalim, adaptor, investim monitor, sisteme inteligjente sigurie 4 Ch dhe 8 Ch, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit	E hapur	50,194,820	46,933,332	3,261,488	I.S.S (I. S. S.)	17.06.2021	2 muaj
2	Blerje Biznes Hub	E hapur	25,000,000	24,000,000	1,000,000	H. S. sh.p.k	22.06.2021	12 muaj
3	Mirëmbajtje UPS dhe vendosje sistem akses kontroll tek dhoma e serverave.	Blerje me vlerë të vogël	799,000	772,500	26,500	S. C.	16.03.2021	1 ditë
4	Blerje UPS backup, për dhomën qendrore te serverave.	Blerje me vlerë të vogël	398,333	394,500	3,833	S. C.	18.03.2021	5 ditë
5	Blerje të imta IT	Blerje me vlerë të vogël	797,333	789,000	8,333	J. B.	29.03.2021	3 ditë
6	Blerje makina kontrolli dhe numërimi elektronik parash	Kërkesë për Propozim	5,329,406	4,707,360	622,046	P. I. sh.p.k.	21.05.2021	45 ditë
7	Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 1 vit	E hapur	30,000,000	13,381,868	16,618,132	I. S.s" sh.p.k.	26.03.2021	2 vite
8	Pajisje It: (Printer Termik, Kompjuter Inxhinierik, Printer, Laptop	E hapur	7,981,600	7,631,040	350,560	P. S. shpk	15.02.2021	10 ditë
9	Ndërtimi i një faqe web, për blerjet online dhe gjurmimin e paketave postare.	Blerje me vlerë të vogël	798,000	779,000	19,000	I. S.	13.01.2021	20 ditë
10	Konfigurimi i sistemit ekzistues te menaxhimit të radhëve ne disa Zyra dhe Filiale.	Blerje me vlerë të vogël	795,000	789,000	6,000	Ilmi Biba	01.12.2020	
11	Dixhitalizimi i Arkivës dhe dokumenteve, Dixhitalizimi i Arkivës së Pullës si dhe Mirëmbajtje për 4 vite pas implementimit	E hapur	20,700,000	19,673,280	1,026,720	I. T. A." SH.A	03.12.2020	4 vite
12	Shërbime për riparime defekteve softwerike dhe integrimin të sistemeve softwere midis tyre	Blerje me vlerë të vogël	736,666	690,000	46,666	J. B.	02.11.2020	7 ditë
13	Blerje e sistemit të mbrojtjes antivirus, program menaxhimi software dhe sistemi për monitorim të qendëruar të infrastrukturës IT për analizë të ngjarjeve të sistemeve software në përdorim	E hapur	19,000,000	1,188,640	17,811,360	P. S. shpk		45 ditë
Total			165,719,598					

Bazuar në tre kriteret mbi përzgjedhjen e procedurave të prokurimit dhe në kryqëzimin e të dhënave mbi këto kriteret janë marrë për auditim procedurat e mëposhtme:

II.2.2.1. Prokurimet e realizuara, për blerjen dhe mirëmbajtjen e sistemit Eterna, për periudhën nga data 01.2019 deri në datën 30.06.2021:

Auditimi mbi prokurimet për blerjen edhe mirëmbajtjen e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit u përqendrua kryesisht në investimet dhe shpenzimet e bëra gjatë periudhës objekt auditimi për aplikacionin e quajtur Eterna, i cili është sistemi kryesor për administrimin e veprimeve operationale në shoqërinë Posta Shqiptare Sh.a. Ky sistem përfshin: shërbime financiare si, arkëtime e pagesa, transfertat bankare, etj si dhe mbulon proceset të shërbimeve postare.

Historiku i zhvillimit të këtij aplikacioni paraqitet më poshtë:

Data e lidhjes së kontratave	Kontrata	OE Fitues	Investimi (lekë) Pa TVSh		Mirëmbajtja (lekë) Pa TVSh		
			Vlera e Kontratave të blerjes	Fatura	Vlera e kontratave të mirëmbajtjes	Vitet	Vlera e paguar deri në 31.12.2020
21.08.2012/14.05.2014*	Blerje informatizimi i sporteleve, gjurmimi kombëtar i objekteve postare dhe euroxhiro kombëtare.	H. S.	51,791,320	48,650,000	26,850,000	3 vite	26,850,000
22.05.2017	Mirëmbajtja e Sistemit Eterna	H. S.	-	-	27,000,000	3 vite	27,000,000
03.06.2020	Mirëmbajtja e Sistemit Eterna	H. S.	-	-	27,000,000	3 vite	5,250,000

09.03.2018/ 18.07.2019*	Kalimi i sistemit eterna në web dhe zhvillime të tjera, programi i informatizimit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe finance kontabilitet, si dhe sistem software për ndjekjen dhe menaxhimin e çështjeve (help desk)	H. S.	29,500,000	29,500,000	9,450,000	4 vite	3,150,000
	Dorëzimi i funksioneve grupi i pare	H. S.	-	-	-		-
	Dorëzimi i funksioneve grupi i dyte	H. S.	-	-	-		-
	Integrimi i funksioneve (mod Financës)	H. S.	-	-	-		-
	Integrimi i funksioneve (te tjerat)	H. S.	-	-	-		-
04.08.2018	Shërbim ndërfaqe ndërmjet sistemit Eterna dhe kompanisë Digicom	H. S.	-	-	800,000	Një here	800,000
03.08.2018/ 18.07.2019*	Eterna Gateway Application	H. S.	25,000,000	25,000,000	20,000,000	4 vite	6,666,667
03.08.2018	Eterna E-Posta	H. S.	25,000,000	25,000,000	20,000,000	4 vite	1,666,667
	Faza I	H. S.	-	-	-		-
	Faza II	H. S.	-	-	-		-
25.06.2019	Posta Retail Outlet	H. S.	19,800,000	19,800,000	11,100,000	4 vite	1,387,500
	Faza I	H. S.	-	-	-		-
	Faza II	H. S.	-	-	-		-
16.09.2019	Blerje Eterna BI + Data Warehouse + Reporting Services, Log Management, Manaxhim të dokumenteve, Statistike	H. S.	25,000,000	25,000,000	16,000,000	4 vite	1,000,000
	Faza I	H. S.	-	-	-		-
	Faza II	H. S.	-	-	-		-
	Totali	H. S.	176,091,320	172,950,000	158,200,000		73,770,833

Siç tregon tabela e mësipërme që prej vitit 2012, janë investuar për blerjen e sistemeve Eterna Postare dhe Eterna Financiare në vlerën 176,091,320 lekë pa TVSH dhe me 211,309,000 lekë me TVSh (afërsisht 1.7 milion euro). Ndërsa për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve janë lidhur 10 kontrata që vazhdojnë më afat deri në mesin e vitit 2023 me vlerë të përgjithshme 158,200,000 lekë pa TVSH dhe 189,840,000 lekë me TVSH (afërsisht 1.5 milion euro) dhe deri në 30 qershor 2021, për kontrata e mirëmbajtjes janë shpenzuar (paguar) rreth 93,000,000 lekë, pa TVSH dhe rreth 110,000,000 lekë (afërsisht 910,000 euro).

Vlen të theksohet se, të gjitha procedura e prokurimeve si të blerjeve të sistemit ashtu edhe të mirëmbajtjes së tyre janë fituar nga i njëjti operator Ekonomik, “H. S”.

Fillimisht në korrik të vitit 2012 është realizuar procedura e prokurimit për “Blerje informatizimi i sporteleve, gjurmimi kombëtar i objekteve postare dhe euroxhiro kombëtare”. Kjo blerje e sistemit është realizuar me procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për arsye të së drejtës së autorit dhe është konkretizuar më lidhjen kontratës së furnizimit nr.1029/4, datë 21.08.2012, midis operatorin fitues “H. S” dhe Postës Shqiptare, me vlere 51,791,320 lekë, pa TVSH.

Mbas vënies në funksionim së sistemit, në datën 03.04.2014 është realizuar edhe procedura me negociim pa shpallje të paraprake të njoftimit të kontratës për mirëmbajtjen e këtij sistemi

me afat 3 vjet, me vlerë 8,950,000 lekë, pa TVSH në vit, dhe për 3 vjet me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Në këtë procedurë për arsye të së drejtës së autorit i është dërguar ftesë për ofertë operatorit “H. S” me të cilin është lidhur edhe kontrata e mirëmbajtjes nr.1069/7, datë 14.05.2014, me kohëzgjatje 3 vjet nga data e nënshkrimit (deri në datën 13.05.2017), me vlerë 32,220,000 lekë me TVSH. Konkretizimi i kontratës së mirëmbajtjes sipas nenit 1, të saj, ka buruar nga kërkesat e VKM nr. 723, datë 01.09.2010 “Për projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemeve të informacionit” i cili në germën c, të pikës 1, përcakton se: *“Institucionet që janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e teknologjisë së informacionit duhet, detyrimisht, të kuotojnë dhe të parashikojnë marrëveshjen për mirëmbajtjen e sistemit (“Service Level Agreement”, SLA), si pjesë e së njëjtës procedurë të realizimit të investimit për këto sisteme. Mirëmbajtja fillon në përfundim të afatit të garancisë së sistemit (“Service Level Agreement”, SLA) me kohëzgjatje minimale 4-vjeçare”.*

Gjatë kohës së realizimit të procedurës së prokurimit dhe të lidhjes së kontratës së mirëmbajtjes, VKM nr. 723, datë 01.09.2010 i sipërcituar ka qenë e shfuqizuar me VKM. 710, datë 21.8.2013, *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”.* Mirëpo edhe kjo VKM, në germën “a” të pikës 2, përcakton të njëjtën kohëzgjatje të kontratave që, duhet të jenë jo më të shkurtra se, 2 (dy) vjet.

Në zbatim të VKM nr. 710, datë 21.8.2013, Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, ka nxjerrë Udhëzimin nr.2, datë 02.09.2013 *“Për standardizimin e Hartimin e termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”.* Në germën “e”, të pikës 8, të kreut II, të këtij udhëzimi përcaktohet se, për propozimet e kërkuara, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet si më poshtë:

“Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”.

Kontrata e mirëmbajtjes e sipërcituar me nr.1069/7, datë 14.05.2014, në asnjë nen të saj nuk ka të përcaktuar se, në përfundim të shërbimit, Kodet Burimore, Analiza e Projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara të Eternës do ti kalojnë në pronësi pa asnjë kosto shtesë Postës Shqiptare. Por ndryshe nga kjo dispozite, në nenin 11, të kësaj kontrate përcaktohet se:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit”.

Pra sa sipër, Posta Shqiptare ndryshe nga ç ‘kërkohe dhe rekomandohet në udhëzimin e sipërcituar, nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj kodet në burim, analizat e projektimit, burimin dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha moduleve të sistemeve të Eternës.

Nisur nga mos posedimi i kodeve në burim, Posta Shqiptare në të gjitha procedurat e zhvilluar për mirëmbajtjen e këtij sistemi duke filluar nga viti 2017 dhe deri në datën 30.06.2020 ka vendosur dhe kërkuar në kriteret e veçanta në Dokumentet Standarde të çdo Tenderi që:

-OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

-Operatori ekonomik, qofte zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

Po kështu në të gjitha kontratat e mirëmbajtjes duke filluar nga viti 2017 dhe deri në 30.06.2020 ka vendosur kushtin që:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit**”.

Gjithashtu, në të gjitha kontratat e mirëmbajtjes duke filluar nga viti 2017 dhe deri në datën 30.06.2020, vlera e kontratave të mirëmbajtjes (fondi limit) është llogaritur në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin Publik” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke marrë në treg (testuar tregun), 3 apo më shumë oferta dhe ka përlllogaritur fondin limit bazuar në ofertën më të ulët. Pra nga njëra anë vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mundë të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S”.

Prokurimet e realizuar për vitin 2019, 2020 dhe 6 mujorin e parë 2021, për blerjen dhe mirëmbajtjen e sistemit Eterna, paraqiten më poshtë:

Problematikat e trajtuara më sipër, janë konstatuar në të gjitha procedurat e prokurimeve të realizuara si para periudhës objekt auditimi dhe gjatë periudhës objekt auditimi. Konkretisht, gjatë periudhës objekt auditimi, janë realizuar 6 procedura prokurimi me fond limit në totale 103,649,850 lekë, pa TVSH dhe janë lidhur 6 kontrata për mirëmbajtjen e sistemeve të Eterna me vlerë totale 103,550,000 lekë, pa TVSH (**124,260,000 lekë me TVSH**). Nga 6 procedurat e realizuar 2 prej tyre, përveç prokurimit të mirëmbajtje kanë të përfshinë edhe blerjen e moduleve të sistemit Eterna.

Në tabelën e mëposhtme po pasqyrojmë të dhënat e këtyre procedurave:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit i blerjes	Fondi limit i Mirëmbajtjes	Vlera e kontratës e Blerjes	Vlera e kontratës Mirëmbajtje	Date e zhvillimit te tenderit	OE Fitues	Data e lidhjes së kontratës	Afati i kontratës Mirëmbajtjes
1	Mirëmbajtje Eterna Gateway Application për 4 vite	-	20,000,000	-	20,000,000	14.05.2019	H. S.	18.7.19	48 muaj
2	Mirëmbajtja e Moduleve të Eternes	-	9,450,000	-	9,450,000	31.05.2019	H. S.	18.7.19	48 muaj
3	Blerje Posta retail outlet dhe mirëmbajtje për 4 vjet	19,800,000	11,199,850	19,800,000	11,100,000	13.05.2019	H. S.	25.06.19	48 muaj
4	Blerje Eterna BI dhe Mirëmbajtje BI për 4 vite	25,000,000	16,000,000	25,000,000	16,000,000	22.07.2019	H. S.	16.9.19	48 muaj
5	Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite	-	27,000,000	-	27,000,000	05.05.2020	H. S.	03.6.20	36 muaj
6	Mirëmbajtja E-Posta për 4 vite	-	20,000,000	-	20,000,000	03.08.2020	H. S.	31.08.20	48 muaj
	Totali	44,800,000	103,649,850	44,800,000	103,550,000				

Nga auditimi mbi zbatimin e rregullave të prokurimit publik për realizimin e këtyre procedurave u konstatuan problematika të njëjta me problematika që u trajtuan më lartë, të cilat po i përmendim shkurtimisht dhe njëherë për të 6 procedurat:

1. Siç shihet nga të dhënat e mësipërme të 6 procedurat janë zhvilluara te hapura, por në këto procedura ka pasur mungesë konkurrence pasi në to ka marrë pjese vetëm operatori “H. S”, i cili është shpallur edhe fitues dhe ka lidhur kontratat e zbatimit.

Mungesa e theksuar e konkurrencës ka ardhur si pasoje e vendosjes në DT të kërkesës së veçantë që:

-OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

-Operatori ekonomik, qofte zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, **pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.**

Kërkesë kjo që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” duhet të vendoset dhe përdoret për procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, pasi përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

Vendosja e kësaj kërkesë nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim të sistemeve të Eternës, mbas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes të lidhur me nr. 1069, datë 14.05.2014. Pra në bazë të kësaj kërkesë zhvillohen vetëm procedurat me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit dhe jo procedurat e hapura dhe procedurat e tjera.

2. Po kështu në të 6 kontratat e mirëmbajtjes është vendosur kushti që:

-“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit**”.

Ky veprim ka bërë që ky operatorë të këtë të drejtën ekskluzive ose të drejtën e autorit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi për një kohë të gjatë, të paktën deri në vitin 2024. Me vendosjen e këtij kushti në përfundim të çdo kontrate, kodet në burim nuk i kalojnë në pronësi të Postës Shqiptare.

3. Gjithashtu, në të 6 procedurat e prokurimit, vlerat e kontratave të mirëmbajtjes (fondet limite) janë llogaritur në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin Publike” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për çdo procedurë janë marrë në treg, 3 apo më shumë oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët. Në të 6 procedurat e prokurimit, një nga operatorët që u është kërkuar dhe marrë ofertë është edhe OE “H. S”. Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mund të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të mirëmbajtjes e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S”.

Gjithashtu, në llogaritjen e fondit limit për të gjitha kontratat e mirëmbajtjes nuk është marrë në konsideratë raporti kosto-përfitim, bazuar në amortizimin moral dhe fizik të këtij sistemi dhe në vlerën e mbetur në kontabilitet sipas pasqyrave financiare të çdo viti.

Sa sipër, mungesa e pronësisë së kodeve në burime ka bërë që të gjitha kontratat e mirëmbajtjes së sistemit Eterna duke filluar që nga viti 2017, edhe pse janë zhvilluar me procedura të hapura, janë lidhur në mungesë të theksuar të konkurrencës, pasoja e të cilës ka sjellë ekskluzivitetin dhe monopolizimin e blerjeve dhe të mirëmbajtjes së sistemit Eterna, duke i përqendruar këto blerje dhe shërbime vetëm te i njëjti operatorë, te operator “H. S”.

Nga ky veprim nuk është rritur pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit dhe nuk është siguruar mirë përdorimi i fondeve publike dhe ulja e shpenzimit procedurale për shërbimin e mirëmbajtjes, pasi ky operatorë në të gjitha procedurat e prokurimit ka ofruar ofertën ekonomike pothuajse të barabartë me fondin limit. Për pasojë

shpenzimet për mirëmbajtjen janë relativisht të larta kundrejt kostos së blerjeve së vetë sistemit Eterna, të cilat llogariten rreth 15-18 % për çdo vit.

Megjithatë kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemeve të teknologjisë së informacionit vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtij shërbimi, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në tregun vendas sepse nuk janë të natyrës fizike por me tepër janë të një natyre intelektuale që lidhen me të drejtën ekskluzive apo të drejtën e autorit dhe për këto shpenzime në treg nuk ka kosto të normuar apo çmime referuese. Kjo për faktin se, AKSH apo ministria e linjës që mbulon fushën e Teknologjisë së Informacionit nuk kanë hartuar normativa, manuale, preventiva, apo udhëzues, për përcaktimin e çmimeve orientuese, mbështetur në specifikimet teknike të çdo lloj sistemi të teknologjisë së Informacionit dhe në modelet dhe praktikatat më të mira të vendeve Evropiane dhe mbi bazën e këtyre çmimeve të llogariteshin shpenzimet e mirëmbajtjes.

Më hollësisht po pasqyrojmë rezultatet e auditimit të kryer për të 6 procedurat për blerjen dhe mirëmbajtjen e sistemit Eterna, si më poshtë:

II.2.2.1.A.Procedura e prokurimit me objekt: “Posta retail outlet (blerje on line për objekte postare si pulla, suvenire, etj., si dhe Mirëmbajtje për 4 vite pas implementimit” të realizuar në vitin 2019.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që do të prokurohet:

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një dyqani Online ose tregtisë elektronike Online për Posten Shqiptare. Tregtia elektronike e-commerce është një mënyrë e re për të bërë biznes duke shfrytëzuar rrjetet më të mëdha elektronike siç është interneti. E ashtuquajtura e-commerce, tregtia elektronike në masë të madhe lehtëson transaksionet midis Postës Shqiptare dhe konsumatorëve (B2C), dhe kompanive të tjera (B2B). Shumë kompani postare e kanë futur me sukses këtë shërbim duke rritur gamën e shërbimeve të tyre gjithashtu edhe numrin e klientëve që operojnë nëpërmjet këtyre formave të ofrimit të shërbimeve online. Shërbime të tilla rrisin besimin tek klientët duke u krahasuar me shërbimet e postave më të mira siç janë Royal Mail etj.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 12, datë 18.04.2019	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: M. Z. E. S. A. S.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: Zh. B. O. P. B. Q.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 30.999.850 lekë: -blerje 19.800.000 Lekë, -Mirëmbajtje 11.199.850 Lekë për 4 vite.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: M. Z. N. L. A. S.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: V. A. R. Ll. E. S.
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: “ H. S ” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 30,900,000 lekë: -blerje 19.800.000 lekë, -Mirëmbajtje 11.199.850 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 99,850 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 13.05.2019	11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1 (një)	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1 (një)	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të skualifikuar: ska
14. Ankimimet: Ka, për ndryshimin e DST datë 30.04.2019	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nr.1084/6, datë 02.05.2019	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: ska
17. Lidhja e kontratës: Datë 18.07.2019	18. Vlera e kontratës (me tvsh): -blerje 23,760,000 lekë, -Mirëmbajtje 13.320,000 lekë	19. Afati i kontratës 48 muaj

1. Hartimi i specifikimeve teknike (termat e referencës):

Për këtë procedurë prokurimi, specifikimet teknike të shërbimit të mirëmbajtjes janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës me specialistë të fushës, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 59, datë 25.03.2019. Në përfundim ky grup pune me shkresën nr.838, datë 03.04.2019 ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të shërbimit, të cilat shkurtimisht janë përshkruar në Aktkonstatimin nr.1, datë 19.11.2021, bashkëlidhur Projektraportit.

2. Llogaritja e vlerës Limit të Kontratës (fondi limit) dhe Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.62, datë 04.04.2019, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike, 3 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

-Operatorit Ekonomik (OE), “S. A.”, i cili ka dërguar ofertën në vlerën 33,000.150 lekë, përkatësisht, zhvillimi i sistemit në vlerën 2,200,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 12,800,150 lekë;

-OE, “H. S” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 32,000,000 lekë, përkatësisht, zhvillimi i sistemit në vlerën 20,000,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 12,200,000 lekë;

-OE, “S. A.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 30,999,850 lekë, përkatësisht, zhvillimi i sistemit në vlerën 19,800,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 11,199,850 lekë.

Bazuar në ofertat e marra, grupi i punës llogarit fondin limit, bazuar në ofertën më të ulët, të cilën e kishte dërguar operatori S. A.” **në vlerën 30,999,850 lekë**, përkatësisht, zhvillimi i sistemit në vlerën 19,800,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 11,199,850 lekë.

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të “Hapur”. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit të këtyre kriterëve u konstatua se, disa nga kriteret e veçanta kualifikuese nuk krijojnë kushte të barabarta për operatorët ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në procedurë prokurimi, pengojnë konkurrencën e lirë dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Konkretisht, është kërkuar, në shtojcën 9 të DT, në pikat, 2.3.2 dhe 2.3.3, “Kapaciteti Teknik”, që operatorët ekonomik të kualifikohen, duhet të paraqesin:

-OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

- Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

Kërkesa këto që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” duhet të vendoset dhe përdoret për procedura “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, në të cilat përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

Vendosja e këtyre kërkesave nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim të sistemeve të Eternës. Kodi në burim i këtij sistemi duhet të merrej në pronësi nga Posta, menjëherë mbas përfundimit të kontratës së parë të mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Kjo kontratë është realizuar në vitin 2014 me procedura “me negociim pa shpallje të paraprake të njoftimit të kontratës” për arsyen të së drejtës së autorit, pasi Kodin në Burim e kishte OE “H. S.” i cili kishte furnizuar dhe vendosur në funksionim sistemet e Eternës në vitet 2012-2014. Në kontratën e mirëmbajtjes mbas vënies në funksion të këtij sistemi me nr.1069/7, datë 14.05.2014, por edhe në kontratat e tjera vijuese që nga viti 2017 (të lidhura pas realizimit të procedurave të prokurimeve të hapura) deri në momentin e kësaj procedure prokurimi, është vendosur kushtin që:

-“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do të përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit**”.

Sa sipër vendosja në DT e kërkesave të veçanta të mësipërme, nuk janë kërkesa të hartuara në përputhje me rekomandimet e VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” dhe të Udhëzimit të Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e Hartimin e termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”. Ky udhëzim i dalë në zbatim të kësaj VKM, në germën “e”, të pikës 8, të kreut II, përcakton se, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet si më poshtë:

“Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”

Siç u tha më lartë, vlera e kontratave të mirëmbajtjes (fondi limit) është llogaritur nga testimi i tregut duke kërkuar dhe marrë 3 oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët. Një nga OE që, i është kërkuar ofertë për llogaritjen e fondit limit është dhe operatori “H. S.” i cili zotëronte të Drejtën e Autorit për programin Eterna të instaluar tek Posta Shqiptare dhe dispononte Kodin në Burim, të këtij sistemi, pasi Posta Shqiptare nuk kishte marrë në pronësi këtë kod, me përfundimi e kontratës nr.1069/7, datë 14.05.2014 .

Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mundë të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S.”.

Përveç se është konstatuar nga Auditimi që këto kritere të veçanta kualifikuese nuk janë hartuar në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën kontratës, janë diskriminuese dhe nuk krijojnë kushte të barabarta të operatorëve dhe pengojnë konkurrencën e lirë dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë vërejtur dhe janë rekomanduar për ti ndryshuar edhe nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP). Kështu, me shpalljen e kësaj procedure në sistemin elektronik të APP, në datën 18.04.2019, APP nëpërmjet emailit të datës 25.04.2019, ka njoftuar Postën Shqiptare (Përgjegjësia e Njësisë së prokurimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm) duke i sjell në vëmendje nevojën për saktësimin dhe argumentimin e kritereve, si më poshtë:

Në pikat, 2.3.2 dhe 2.3.3 dhe 2.3.4 “Kapaciteti Teknik”, të DT, AK ka kërkuar:

2.3.2. OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

2.3.3 Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

2.3.4 OE duhet të ketë të punësuar jo më pak se 8 (tetë) punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Profesional të cilët të jenë të përfshirë në listë pagesat e sigurimeve shoqërore sipas formatit E-sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësorë dhe të ardhurat nga punësimi për periudhën Shtator 2018 - Shkurt 2019.

Për sa më sipër në lidhje me pikën 2.3.2, APP sheh të arsyeshme mirë argumentimin ligjor dhe teknik nga ana e AK në lidhje me disponimin e së Drejtës së Autorit për programin Eterna Software, duke mbajtur parasysh faktin se, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen, jo diskriminuese dhe konform rregullave të prokurimit publik. Ndërsa në lidhje me 2.3.3, rekomandojmë një argumentim teknik në lidhje me faktin e mos disponimit të kodit në burim nga ana e AK, duke mbajtur në konsideratë faktin se sistemi në fjalë është ekzistues, dhe rrjedhimisht ***mund të ishte i disponueshëm nga vetë AK pas implementimit të sistemit aktual, nga OE fitues.***

Po kështu, APP në lidhje me pikën 2.3.4, sqaron se, në rastin kur AK konsideron të nevojshëm ndryshimin e DT (përfshi këtu edhe kriteret për kualifikim), mbështetur në përcaktimet e nenit 42 të LPP, ju nuk duhet të anuloni procedurën por duhet të bëni ndryshimet përkatëse përmes hartimit të një shtojce, e cila ju vihet në dispozicion OE, në DST e publikuara në SPE.

Mirëpo AK nuk ka bërë ndryshimin e këtyre kriterëve, por i ka dërguar APP në datën 02.05.2019, informacion për të sqaruar konstatimet e saj. Në thelb ky informacion apo sqarim qëndron:

Në lidhje me pikat 2.3.2 dhe 2.3.3, AK nuk ka asnjë të drejtë mbi këtë sistem as të drejtën e autorit dhe as pronësinë e Kodit në Burim sepse, në kontratën e mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 në nenin 11 të saj është përcaktuar se:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do të përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. ***Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.***

AK argumenton me tej duke cituar se, vendosja e këtyre kriterëve mbështetet në, germën b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 55, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, duke interpretuar se, për arsye teknike dhe artistike që kanë lidhje me të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale kontrata mund të ekzekutohet vetëm me një operatorë të veçantë.

Kjo bazë ligjore bën fjalën se, në çfarë rastesh mund të përdoret procedura e prokurimi “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Pra ky sqarim apo interpretim i AK është i pakuptimit sepse nga njëra anë përpiqet të argumentojë hartimin dhe vendosjen e këtyre kërkesave ***si të mbështetura dhe bazuara në nenin 33 të LPP dhe nenin 55 të VKM, dhe nga ana tjetër organizon procedurën e “Hapur” dhe jo “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”***.

Ndërsa në lidhje me pikat 2.3.4, sqarimi i AK konsiston se, ky kriter është vendosur në zbatim të nenit 46 të LPP. AK ka kërkuar minimumin e mundshëm 8 punonjës për realizimin e kësaj procedure duke marrë në konsideratë faktin se, bëhet fjalë për një objekt prokurimi me fond limit 30,999,850 lekë, me shumë rëndësi dhe me kompleksitet të lartë në ndërtimin e tij dhe përshtatjen e tij me sistemet ekzistuese.

Po kështu, vlen të theksohet se, në datën 30.04.2019, në Postën Shqiptare është depozituar një ankesë nga OE “K.” shpk e cila mbanë datën në datën 25.04.2019. Me këtë ankesë ky operatorë kërkon nga AK të ndryshojë pikërisht këto kriteret të veçanta të vendosura në DT, me pretendimi se janë hartuar dhe vendosur në kundërshtim me rregullat prokurimit publik. Ndër to dhe kriterin që:

-OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

- Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

Për shqyrtimin e kësaj ankese me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm është pezulluar vazhdimi i procedurës deri në shqyrtimin e ankesës si dhe është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës me përbërje: K. C., B. D. dhe R. M.

Në përfundim të shqyrtimit ky komision ka dalë me konkluzionin se, kërkesa është paraqitur në datën në Postën Shqiptare në datën 30.04.2019 që është 11 ditë pas datës së publikimit dhe është dorëzuar jashtë afateve ligjore të parashikuara nga rregullat e prokurimit publik. Megjithatë komisioni lidhur me pretendimet e ankuesit ka dalë me konkluzionin se, kriteret kualifikuese janë mbështetur në parimet dhe dispozitat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe nuk i ka ndryshuar këto kriteret kualifikuese.

Gjithashtu, u konstatua se: edhe dy nga kriteret e veçanta kualifikuese që kanë lidhje me përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik, janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b, të pikës 4, të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT është kërkuar që:

-OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2016, 2017, 2018) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kriterëve që, kërkon xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jenë mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

3. Zhvillimi i procedurës:

Kufizimin e konkurrencës për shkak të së drejtës së autorit dhe mos marrjes në pronësi të Kodit në Burim nga Posta Shqiptare, ka sjell: pjesëmarrjen e ulët të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit; keq përdorimin e fondeve publike; mos uljen e shpenzimeve procedurale të shërbimit e mirëmbajtjes. Këto probleme janë shfaqur qartazi në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 31.05.2019, në të cilën ka qenë pjesëmarrës vetëm një ofertues, pikërisht OE “H. S.” i cili ka paraqitur ofertën ekonomike të barabartë me fondin limit në vlerën në vlerën 30,999,850 lekë, përkatësisht, zhvillimi i sistemit në vlerën 19,800,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 11,199,850 lekë.

Në përfundim të shpalljes fitues të OE “H. S.”, Posta Shqiptare ka lidhur me këtë operatore kontratën e mirëmbajtjes me nr.11089/10, datë 25.06.2019, me kohëzgjatje 4 vjet, me vlerë totale 37,080,000 lekë me TVSH, përkatësisht, zhvillimi i sistemit në vlerën 23,760,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 13,320,000 lekë.

Në nenin 8 kjo kontratë ka të përcaktuar përsëri kushtin që:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do të përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 2 të nenit 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Ngarkohet me përgjegjësi: Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare z. L. D.dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me përbërje: z. M. Z., z. A. S. dhe z. N. L..

II.2.2.1.B.Procedura e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje Eterna Gateway Application për 4 vite” të realizuar në vitin 2019:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që do të prokurohet:

Posta Shqiptare kërkon të mirëmbajë platformën Eterna Gateway Application, e cila u mundëson institucioneve financiare dhe bankare që të lidhin sistemin e tyre me sistemin Eterna të Postës Shqiptare, në mënyrë që të kryejnë nëpërmjet sporteleve të saj disa prej shërbime të tyre dhe në të njëjtën kohë për të rritur gamën e shërbimeve që sportelet e Postes Shqiptare ofrojnë për klientët.

Sipas kësaj kontrate, duhet të mirëmbahen funksionet: ndërfaqe me sisteme pagesash dhe Core banking (depozitë parash dhe pagesë këstesh).

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 13 datë 18.04.2019	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: R. K. E. S. O. B.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: E. A. A. K. K. H.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 20,000,000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E. M. O. B. L. M.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: V. A. O. P. E. S.
8. Data e hapjes së tenderit: 14.05.2019	9. Operatori fitues: “H. S” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 20,000,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 (zero)lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1 (një)	12. Operatore te Kulifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të skualifikuar: ska
14. Ankimimet: ska	15. Përgjigje Ankesës nga AK ska	16. Përgjigje Ankesës: ska
17. Lidhja e kontratës: Datë, 18.07.2019	18. Vlera e kontratës (me tvsh) 24,000,000 lekë	19. Afati i kontratës 48 muaj

1. Hartimi i specifikimeve teknike (termat e referencës):

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të shërbimit të mirëmbajtjes janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës me specialistë të fushës me urdhër te Drejtorit të Përgjithshëm nr. 58, datë 25.03.2019. Në përfundim ky grup pune me shkresën nr.837/1, datë 01.04.2019 ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të shërbimit, të cilat shkurtimisht janë përshkruar në Aktkonstatimin nr.2, datë 19.11.2021, bashkëlidhur projektraportit.

2. Llogaritja e vlerës Limit të Kontratës (fondi limit) dhe Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.63, datë 04.04.2019, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike, 3 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

-OE, “S. A.”, i cili ka dërguar ofertën në vlerën 20,050,000 lekë;

-OE, “H. S.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 20,000,000 lekë;

-OE, ”S. A.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 20,032,000 lekë.

Bazuar në ofertat e marra, grupi i punës llogariti fondin limit, bazuar në çmimin më të ulët, që e kishte operatori “H. S.” **në vlerën 20,000,000 lekë.**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të “Hapur”. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit të këtyre kriterëve u konstatua se, dy nga kriteret e veçanta kualifikuese nuk krijojnë kushte të barabarta për operatorët ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në procedurën e prokurimit, pengojnë konkurrencën e lirë dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Konkretisht, është kërkuar në shtojcën 8 dokumentet e tenderit, në pikat, 2.3.2 dhe 2.3.3, “Kapaciteti Teknik”, që operatorët ekonomik të kualifikohen, duhet të paraqesin:

-OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

- Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

Kërkesa këto që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” duhet të vendoset dhe përdoret për procedura “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, në të cilat përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

Vendosja e këtyre kërkesave nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim të sistemeve të Eternës. Kodi në burim i këtij sistemi duhet të merrej në pronësi nga Posta, menjëherë mbas përfundimit të kontratës së parë të mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Kjo kontratë është realizuar në vitin 2014 me procedura “me negociim pa shpallje të paraprake të njoftimit të kontratës” për arsyen të së drejtës së autorit, pasi Kodi në Burim e kishte OE “H. S.” i cili kishte furnizuar dhe vendosur në funksionim sistemet të Eternës në vitet 2012-2014. Në kontratën e mirëmbajtjes mbas vënies në funksion të këtij sistemi me nr.1069/7, datë 14.05.2014, por edhe në kontratat e tjera vijuese që nga viti 2017 (të lidhura pas realizimit të procedurave të prokurimeve të hapura) deri në momentin e kësaj procedure prokurimi, është vendosur kushti që:

-“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktuesi gjatë kontratës do të përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit**”.

Sa sipër vendosja në DT e kërkesave të veçanta të mësipërme, nuk janë kërkesa të hartuara në përputhje me rekomandimet e VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit

të shërbimit” dhe të Udhëzimit të Ministrisë për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimit e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”. Ky udhëzim i dalë në zbatim të kësaj VKM, në germën “e”, të pikës 8, të kreut II, përcakton se, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet si më poshtë: **“Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”**

Siç u tha më lartë, vlera e kontratave të mirëmbajtjes (fondi limit) është llogaritur nga testimi i tregut duke kërkuar dhe marrë 3 oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët, të cilën e kishte paraqitur pikërisht operatori “H. S.”. Ky operatorë zotëronte të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare dhe dispononte Kodin në Burim, pasi Posta Shqiptare nuk e kishte marrë në pronësi këtë kod, menjëherë me përfundimi e kontratës së mirëmbajtjes nr.1069/7, datë 14.05.2014.

Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mundë të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S.”.

Përveç se është konstatuar nga Auditimi që këto kriteret të veçanta kualifikuese nuk janë hartuar në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën kontratës, janë diskriminuese dhe nuk krijojnë kushte të barabarta të operatorëve dhe pengojnë konkurrencën e lirë dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë vërejtur dhe janë rekomanduar për ti ndryshuar edhe nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP). Kështu, me shpalljen e kësaj procedure në sistemin elektronik të APP, në datën 28.04.2019, APP nëpërmjet emailit të datës 10.05.2019, ka njoftuar Postën Shqiptare (Përgjegjësin e Njësisë së prokurimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm) duke i sjell në vëmendje nevojën për saktësimin dhe argumentimin e kriterëve, si më poshtë:

Në pikat, 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4, “Kapaciteti Teknik”, të DT, AK ka kërkuar:

2.3.2. OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

2.3.3 Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

2.3.4 OE duhet të ketë të punësuar jo më pak se 8 (tetë) punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Profesional të cilët të jenë të përfshirë në listë pagesat e sigurimeve shoqërore sipas formatit E-sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të ardhurat nga punësimi për periudhën Shtator 2018 - Shkurt 2019.

Për sa më sipër në lidhje me pikën 2.3.2, APP sheh të arsyeshme mirë argumentimin ligjor dhe teknik nga ana e AK në lidhje me disponimin e Drejtës së Autorit për programin Eterna Software, duke mbajtur parasysh faktin se, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen, jo diskriminuese dhe konform rregullave të prokurimit publik. Ndërsa në lidhje me 2.3.3, rekomandon një argumentim teknik në lidhje me faktin e mosdisponimit të kodit në burim nga ana e AK, duke mbajtur në konsideratë faktin se sistemi në fjalë është ekzistues, dhe rrjedhimisht mund të ishte i disponueshëm nga vetë AK pas, implementimit të sistemit aktual, nga OE fitues.

Po kështu, APP në lidhje me pikën 2.3.4, sqaron se, në rastin kur AK konsideron të nevojshëm ndryshimin e DT (përfshi këtu edhe kriteret për kualifikim), mbështetur në përcaktimet e neni 42 të LPP, ju nuk duhet të anuloni procedurën por duhet të bëni ndryshimet përkatëse përmes hartimit të një shtojce, e cila ju vihet në dispozicion OE, në DST e publikuara në SPE.

Mirëpo AK nuk ka bërë ndryshimin e këtyre kriterëve por i ka dërguar APP në datën 13.05.2019, informacion për të sqaruar konstatimet e saj. Në thelb ky informacion apo sqarim qëndron se:

AK nuk ka asnjë të drejtë mbi këtë sistem as të drejtën e autorit dhe as pronësinë e Kodit ne Burim sepse, në kontratën e mirëmbajtjes me nr. 1069/7, datë 14.05.2014 ne nenin 11 të saj është përcaktuar se:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.**

AK argumenton me tej duke cituar se, vendosja e këtyre kriterëve mbështetet në, germën b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, duke interpretuar se, për arsye teknike dhe artistike që kanë lidhje me të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale kontrata mund të ekzekutohet vetëm me një operatorë të veçantë.

Kjo bazë ligjore bën fjalën se, në çfarë rastesh mund të përdoret procedura e prokurimi “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Pra ky sqarim apo interpretim i AK është i pakuptimit sepse nga njëra anë përpiqet të argumentojë hartimin dhe vendosjen e këtyre kërkesave si të mbështetura dhe bazuara në nenin 33 të LPP dhe nenin 55 të VKM, dhe nga ana tjetër organizon procedurën e “Hapur” dhe jo “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.

Ndërsa në lidhje me pikat 2.3.4, sqarimi i AK konsiston se, ky kriter është vendosur në zbatim të nenit 46 të LPP. AK ka kërkuar minimumin e mundshëm 8 punonjës për realizimin e kësaj procedure duke marrë në konsideratë faktin se, bëhet fjalë për një mirëmbajtje 4 vjeçare referuar edhe vlerës së prokurimit që është 20,000,000 pa TVSH e cila është relativisht e lartë. Gjithashtu, u konstatua se: edhe dy nga kriteret e veçanta kualifikuese që kanë lidhje me përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik, janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b të pikës 4 të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT është kërkuar që:

-OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

- OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2016, 2017, 2018) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kriterëve që, kërkon xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo me pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jene mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

3. Zhvillimi i procedurës:

Kufizimin e konkurrencës për shkak të së drejtës së autorit dhe mos marrjen në pronësi të Kodit në Burim nga Posta Shqiptare, ka sjell pjesëmarrjen e ulët të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit, jo mirë përdorimin e fondeve publike dhe mos uljen e shpenzimeve procedurale të shërbimit e mirëmbajtjes. Këto probleme janë shfaqur qartazi në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 14.05.2019, në të cilën ku ka qenë pjesëmarrës vetëm një ofertues, pikërisht OE “H. S.” i cili ka paraqitur ofertë ekonomike të barabartë me fondin limit në vlerën **20,000,000 lekë**, pa TVSH.

Në përfundim të shpalljes fitues të OE “H. S.”, Posta Shqiptare ka lidhur me këtë operatore kontratën e mirëmbajtjes me nr.1087, datë 18.07.2019, me kohëzgjatje 4 vjeçare me vlerë totale 24,000,000 lekë me TVSH. Ne nenin 8 kjo kontratë ka të përcaktuar kushtin që:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do të përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.”

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me piken 2 të nenit 1, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Ngarkohet me përgjegjësi: Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare z. L. D. dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me përbërje: z. E. M. , z. O. B. dhe znj. L. M..

II.2.2.1.C.Procedura e prokurimit me objekt: Mirëmbajtja e Moduleve të Eternës (Finance-kontabilitet, Burimet njerëzore, Magazina, Help Desk) për 4 vite” të realizuar në vitin 2019:

Një përshkrimi të shkurtër të kontratës që do të prokurohet e gjeni në Aktkonstatimin nr.3, datë 19.11.2021, bashkëlidhur këtij projektraporti.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 15, datë 06.05.2019	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: A. S., E. S. K. H.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: O. P. E. M. E. T.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 9,450,000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E. M. K. H. N. L.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: V. A. E. S. A. K.
8. Data e hapjes së tenderit: 31.05.2019	9. Operatori fitues: “H. S.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 9,450,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 (zero)lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1 (një)	12. Operatore te Kulifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të skualifikuar: ska
14. Ankimimet: ska	15. Përgjigje Ankesës nga AK ska	16. Përgjigje Ankesës: ska
17. Lidhja e kontratës: Datë 18.07.2019	18. Vlera e kontratës (me tvsh) 11,340,000 lekë	19. Afati i kontratës 48 muaj

1. Hartimi i specifikimeve teknike (termat e referencës):

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të shërbimit të mirëmbajtjes janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës me specialistë të fushës më Urdhër te Drejtorit të Përgjithshëm nr.75, datë 23.04.2019. Në përfundim ky grup pune me shkresën nr.1132/1, datë 25.04.2019 ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të

shërbimit, të cilat shkurtimisht janë përshkruar në Aktkonstatimin nr.3, datë 19.11.2021, bashkëlidhur këtij Projektraporti.

2. Llogaritja e vlerës Limit të Kontratës (fondi limit) dhe Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.78, datë 26.04.2019, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike, 3 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

-OE, “S. A.”, i cili ka dërguar ofertën në vlerën 10,500,150 lekë;

-OE, “H. S.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 10,000,000 lekë;

-OE, ”B. S.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 9,450,000 lekë.

Bazuar në ofertat e marra, grupi i punës llogarit fondin limit, bazuar në çmimin më të ulët, të ofertës së dërguar nga operatorit “B. S.” në vlerën 9,450,000 lekë.

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të “Hapur”. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjorë të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit të këtyre kriterëve u konstatua se, një nga kriteret e veçanta kualifikuese nuk krijon kushte të barabarta për operatorët ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në procedurë prokurimi, pengon konkurrencën e lirë dhe nuk stimulon pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Konkretisht, është kërkuar në shtojcën 8 dokumentet e tenderit, në pikat, 2.3.2 dhe 2.3.3, “Kapaciteti Teknik”, që operatorët ekonomik të kualifikohen, duhet të paraqesin:

-OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

- Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

Kërkesa këto që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” duhet të vendoset dhe përdoret për procedura “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, në të cilat përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

Vendosja e kësaj kërkesë nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim të sistemeve të Eternës. Kodi në burim i këtij sistemi duhet të merrej në pronësi nga Posta, menjëherë mbas përfundimit të kontratës së parë të mirëmbajtjes me nr. 1069/7, datë 14.05.2014 me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Kjo kontratë është realizuar në vitin 2014 me procedura “me negociim pa shpallje të paraprake të njoftimit të kontratës” për arsyen të së drejtës së autorit, pasi Kodi në Burim e kishte OE “H. S.” i cili kishte furnizuar dhe vendosur në funksionim sistemet të Eternës në vitet 2012-2014. Në kontratën e mirëmbajtjes mbas vënies në funksion të këtij sistemi me nr.1069/7, datë 14.05.2014, por edhe në kontratat tjera vijuese që nga viti 2017 (të lidhura pas realizimit të procedurave të prokurimeve të hapura) deri në momentin e kësaj procedure prokurimi, në këto kontratat mirëmbajtje është vendosur kushtin që:

-“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit**”.

Sa sipër vendosja në DT e kërkesave të veçanta të mësipërme, nuk janë kërkesa të hartuara në përputhje me rekomandimet e VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” dhe të Udhëzimit të Ministrisë për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e Hartimit e termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”. **Ky udhëzim i dalë në zbatim të kësaj VKM, në gjuhën “e”, të pikës 8, të kreut II, përcakton se, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet si më poshtë:**

“Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”

Siç u tha më lartë, vlera e kontratave të mirëmbajtjes (fondi limit) është llogaritur nga testimi i tregut duke kërkuar dhe marrë 3 oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët. Një nga operatorët ekonomik që i është kërkuar ofertë për llogaritjen e fondit limit është dhe operatori “H. S.” i cili zotëronte të Drejtën e Autorit për programin Eterna të instaluar tek Posta Shqiptare dhe dispononte Kodin në Burim, të këtij sistemi, pasi Posta Shqiptare nuk kishte marrë në pronësi këtë kod, me përfundimi e kontratës nr.1069/7, datë 14.05.2014 .

Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mund të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S.”.

Përveç se është konstatuar nga Auditimi që këto kriteret të veçanta kualifikuese nuk janë hartuar në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën kontratës, janë diskriminuese dhe nuk krijojnë kushte të barabarta të operatorëve dhe pengojnë konkurrencën e lirë dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë vërejtur dhe janë rekomanduar për ti ndryshuar edhe nga Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Kështu, me shpalljen e kësaj procedure në sistemin elektronik të APP, në datën 06.05.2019, APP nëpërmjet emailit të datës 24.05.2019, ka njoftuar Postën Shqiptare (Përgjegjësin e Njësisë së prokurimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm) duke i sjell në vëmendje nevojën për saktësimin dhe argumentimin e kriterëve, si më poshtë:

Në pikat, 2.3.2 dhe 2.3.3, “Kapaciteti Teknik”, të DT, AK ka kërkuar:

2.3.2. OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

2.3.3 Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

Për sa më sipër në lidhje me pikën 2.3.2, APP sheh të arsyeshme mirë argumentimin ligjor dhe teknik nga ana e AK në lidhje me deponimin e Drejtës së Autorit për programin Eterna Software, duke mbajtur parasysh faktin se, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen, jo diskriminuese dhe konform rregullave të prokurimit publik. Ndërsa në lidhje me 2.3.3, rekomandon një argumentim teknik në lidhje me faktin e mos deponimit të kodit në burim nga ana e AK, duke mbajtur në konsideratë faktin se sistemi në fjalë është ekzistues, dhe rrjedhimisht mund të ishte i disponueshëm nga vetë AK pas implementimit të sistemit aktual, nga OE fitues.

Mirëpo AK nuk ka bërë ndryshimin e këtyre kriterëve por i ka dërguar APP në datën 28.05.2019, informacion për të sqaruar konstatimet e saj. Në thelb ky informacion apo sqarim qëndron se:

AK nuk ka asnjë të drejtë mbi këtë sistem as të drejtën e autorit dhe as pronësinë e Kodit në Burim sepse, në kontratën e mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 në nenin 11 të saj është përcaktuar se:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.**

AK argumenton me tej duke cituar se, vendosja e këtyre kritereve mbështetet në, germën b, të pikës 2, të nenit, të 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 55, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, duke interpretuar se për arsye teknike dhe artistike që kanë lidhje me të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale kontrata mund të ekzekutohet vetëm me një operatorë të veçantë.

Kjo bazë ligjore bën fjalën se në çfarë rastesh mund të përdoret procedura e prokurimit “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Pra ky sqarim apo interpretim i AK është i pakuptimit sepse nga njëra anë përipiqet të argumentojë hartimin dhe vendosjen e këtyre kërkesave ***si të mbështetura dhe bazuara në nenin 33 të LPP dhe nenin 55 të VKM, dhe nga ana tjetër organizon procedurën e “Hapur” dhe jo “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”***.

Gjithashtu, u konstatua se: edhe dy nga kriteret e veçanta kualifikuese që kanë lidhje me përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik, janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b të pikës 4 të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT është kërkuar që:

-OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2016, 2017, 2018) ***me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet***

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-***Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,***

-***Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.***

Vendosja e kritereve që, kërkon xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) ***me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jene mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.***

3. Zhvillimi i procedurës:

Kufizimin e konkurrencës për shkak të së drejtës së autorit dhe mos marrjes në pronësi të Kodit në Burim nga Posta Shqiptare, ka sjell: pjesëmarrjen e ulët të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit; jo mirë përdorimin e fondeve publike; mos uljen e shpenzimeve procedurale të shërbimit e mirëmbajtjes. Këto probleme janë shfaqur qartazi në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 31.05.2019, në të cilën ka qenë pjesëmarrës vetëm një ofertues,

pikërisht OE “H. S.” i cili ka paraqitur ofertë ekonomike të barabartë me fondin limit në vlerën 9,450,000 lekë, pa TVSH.

Në përfundim të shpalljes fitues të OE “H. S.”, Posta Shqiptare ka lidhur me këtë operatore kontratën e mirëmbajtjes nr.1240/6, datë 18.07.2019, me kohëzgjatje 4 vjet me vlerë totale 11,340,000 lekë me TVSH. Ne nenin 8 kjo kontratë ka të përcaktuar përsëri kushtin që:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.”

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me piken 2 të nenit 1, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Ngarkohet me përgjegjësi: Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare z. L. D. dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me përbërje: z. E. M. , z. K. H. dhe z. N. L..

II.2.2.1.D.Procedura e prokurimit me objekt: ”Blerje Eterna BI + Datawarehouse + Reporting Services, log management, menaxhim të dokumenteve, statistikë si dhe Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit”, të realizuar në vitin 2019:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që do të prokurohet:

Objektivi është ndërtimi i një magazine të dhënash (Data Warehouse), inteligjencë biznesi (Business Intelligence) dhe administrim logesh (Log Managament) që do të shërbejnë si një burim kryesor raportimi dhe analize për punonjësit e Postës Shqiptare Sh.a, për shërbimet që ofron si: për shërbimin e OSHEE, për shërbimin e Ujësjellësit ,për shërbimin e gjobave, për shërbimin e doganave, për shërbimin e taksave të bashkisë, për shërbimet postare, etj.

Në mënyrë që Posta Shqiptare të ofrojë këto shërbime, duhet të kryhen këto hapa: zhvillimi i modulit të aplikacionit; konfigurimi i infrastrukturës IT që do të mbajë aplikacionin; trajnimi i punonjësve të Posta Shqiptare, Punonjësit e Shërbimeve Financiare dhe postare (trajnim i trajnuesve të postës);trajnimi i administratorëve të TI; krijimi i manualit të administratorëve; krijimi i manualit të përdorimit.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 25 datë 24.06.2019	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: M. T., E. S. I. B.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: E. S. K. F. R. M.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 41,000,000 lekë (25,000,000 blerja dhe 16,000,000 mirëmbajtja)		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e DT: E. S. I. B. N. L.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: V. A. E. S. K. C.
8. Data e hapjes së tenderit: 22.07.2019	9. Operatori fitues: “H. S.”. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH: 41,000,000 lekë (25,000,000 blerja dhe 16,000,000 mirëmbajtja)	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 (zero)lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1 (një)	12. Operatore te Kulifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të skualifikuar: ska
14. Ankimimet: ska	15. Përgjigje Ankesës nga AK ska	16. Përgjigje Ankesës: ska
17. Lidhja e kontratës: Datë 16.09.2019	18. Vlera e kontratës (me tvsh) 49,000,000 lekë (30,000,000 blerja e sistemit dhe 19,200,000 mirëmbajtja	19. Afati i kontratës: Blerja dhe vendosja e sistemet 12 muaj Mirëmbajtjes 48 muaj nga data e funksionimit te sistemit

1. Hartimi i specifikimeve teknike (termat e referencës):

Për këtë procedurë prokurimi, specifikimet teknike të shërbimit të mirëmbajtjes janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës më urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 82, datë 08.05.2019. Në përfundim ky grup me shkresën nr.1265/, datë 13.05.2019, ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të shërbimit, të cilat shkurtimisht janë përshkruar në Aktkonstatimin nr.4, datë 19.11.2021, bashkëlidhur Projektraportit.

2. Llogaritja e vlerës Limit të Kontratës (fondi limit) dhe Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.94, datë 10.06.2019, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike, 3 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

-OE, “H. S.”, i cili ka dërguar ofertën në vlerën 41,000,000 lekë, përkatësisht, blerja e sistemit në vlerën 25,000,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 16,600,000 lekë;

-OE, “B. E.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 42,850,000 lekë, përkatësisht, blerje e sistemit në vlerën 25,200,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 17,650,000 lekë;

-OE, “S. A.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 42,100,000 lekë, përkatësisht, blerja e sistemit në vlerën 25,600,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 16,500,000 lekë.

Bazuar në ofertat e marra, grupi i punës llogarit fondin limit, bazuar në çmimin më të ulët, të operatorit “H. S.”, **në vlerën 41,000,000 lekë**, përkatësisht, blerja e sistemit në vlerën 25,000,000 lekë dhe mirëmbajtja për 4 vjet në vlerën 16,000,000 lekë.

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të “Hapur”. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjorë të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit të këtyre kriterëve u konstatua se, disa nga kriteret e veçanta kualifikuese nuk krijojnë kushte të barabarta për operatorët ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në procedurë prokurimi, pengojnë konkurrencën e lirë dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Konkretisht, është kërkuar në shtojcën 9 dokumentet e tenderit, në pikat, 2.3.2 dhe 2.3.3, “Kapaciteti Teknik”, që operatorët ekonomik të kualifikohen, duhet të paraqesin:

-OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

- Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

Kërkesa këto që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” duhet të vendoset dhe përdoret për procedura “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, në të cilat përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

Vendosja e kësaj kërkesë nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim të sistemeve të Eternës. Kodi në burim i këtij sistemi duhet të merrej në pronësi nga Posta, menjëherë mbas përfundimit të kontratës së parë të

mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Kjo kontratë është realizuar në vitin 2014 me procedura “me negociim pa shpallje të paraprake të njoftimit të kontratës” për arsyen të së drejtës së autorit, pasi Kodin në Burim e dispononte OE “H. S.” i cili kishte furnizuar dhe vendosur në funksionim sistemet të Eternës në vitet 2012-2014. Në kontratën e mirëmbajtjes mbas vënies në funksion të këtij sistemi me nr.1069/7, datë 14.05.2014, por edhe në kontratat tjera vijuese që nga viti 2017 (të lidhura pas realizimit të procedurave të prokurimeve të hapura) deri në momentin e kësaj procedure prokurimi, në këto kontratat mirëmbajtje është vendosur kushtin që:

-“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit**”.

Sa sipër vendosja në DT e kërkesave të veçanta të mësipërme, nuk janë kërkesa të hartuara në përputhje me rekomandimet e VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” dhe të Udhëzimit të Ministrisë për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”. Ky udhëzim i dalë në zbatim të kësaj VKM, në germën “e”, të pikës 8, të kreut II, përcakton se, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet si më poshtë:

“Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”.

Siç u tha më lartë, vlera e kontratave të mirëmbajtjes (fondi limit) është llogaritur nga testimi i tregut duke kërkuar dhe marrë 3 oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët. Një nga operatorët ekonomik që i është kërkuar ofertë për llogaritjen e fondit limit është dhe operatori “H. S.” i cili zotëronte të Drejtën e Autorit për programin Eterna të instaluar tek Posta Shqiptare dhe dispononte Kodin në Burim, të këtij sistemi, pasi Posta Shqiptare nuk kishte marrë në pronësi këtë kod, me përfundimi e kontratës nr.1069/7, datë 14.05.2014 .

Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mund të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S.”.

Përveç se është konstatuar nga auditimi që këto kriteret të veçanta kualifikuese nuk janë hartuar në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën kontratës, janë diskriminuese dhe nuk krijojnë kushte të barabarta të operatorëve dhe pengojnë konkurrencën e lirë dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë vërejtur dhe janë rekomanduar për ti ndryshuar edhe nga Agjencisë së Prokurimit Publik(APP). Kështu, me shpalljen e kësaj procedure në sistemin elektronik të APP, në datën 26.06.2019, APP nëpërmjet emailit të datës 12.06.2019, ka njoftuar Postën Shqiptare (Përgjegjës in e Njësisë së Prokurimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm) duke i sjell në vëmendje nevojën për saktësimin dhe argumentimin e kriterëve, si më poshtë:

Në pikat, 2.3.2 dhe 2.3.3 “Kapaciteti Teknik”, të DT, AK ka kërkuar:

2.3.2. OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

2.3.3 Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

Për sa më sipër në lidhje me pikën 2.3.2 APP sheh të arsyeshme mirë argumentimin ligjor dhe teknik nga ana e AK në lidhje me disponimin e Drejtës së Autorit për programin Eterna Software, duke mbajtur parasysh faktin se, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në

përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen, jo diskriminuese dhe konform rregullave të prokurimit publik. Ndërsa në lidhje me 2.3.3, rekomandon një argumentim teknik në lidhje me faktin e mos disponimit të Kodit në Burim nga ana e AK, duke mbajtur në konsideratë faktin se sistemi në fjalë është ekzistues, dhe rrjedhimisht mund të ishte i disponueshëm nga vetë AK pas implementimit të sistemit aktual, nga OE fitues.

Mirëpo AK nuk ka bërë ndryshimin e këtyre kriterëve, por i ka dërguar APP në datën 02.05.2019, informacion për të sqaruar konstatimet e saj. Në thelb ky informacion apo sqarim qëndron:

Në lidhje me pikat 2.3.2 dhe 2.3.3, AK nuk ka asnjë të drejtë mbi këtë sistem as të drejtën e autorit dhe as pronësinë e Kodit në Burim sepse, në kontratën e mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 në nenin 11 të saj është përcaktuar se:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do të përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.**”

AK argumenton me tej duke cituar se, vendosja e këtyre kriterëve mbështetet në, germën b, të pikës 2, të nenit 33, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 55, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, duke interpretuar se për arsye teknike dhe artistike që kanë lidhje me të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale kontrata mund të ekzekutohet vetëm me një operatorë të veçantë.

Kjo bazë ligjore bën fjalën se në çfarë rastesh mund të përdoret procedura e prokurimi “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Pra ky sqarim apo interpretim i AK është i pakuptimit sepse nga njëra anë përpikët të argumentojë hartimin dhe vendosjen e këtyre kërkesave si të mbështetura dhe bazuara në nenin 33, të LPP dhe nenin 55 të VKM, dhe nga ana tjetër organizon procedurën e “Hapur” dhe jo “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” .

Gjithashtu, u konstatua se: edhe dy nga kriteret e veçanta kualifikuese që kanë lidhje me përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik, janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b, të pikës 4, të nenit 28, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT është kërkuar që:

-OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2016, 2017, 2018) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kriterëve që, kërkon xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të

jene mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

3. Zhvillimi i procedurës:

Kufizimin e konkurrencës për shkak të së drejtës së autorit dhe mos marrjes në pronësi të Kodit në Burim nga Posta Shqiptare, ka sjell: pjesëmarrjen e ulët të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit; jo mirë përdorimin e fondeve publike; mos uljen e shpenzimeve procedurale të shërbimit e mirëmbajtjes. Këto probleme janë shfaqur qartazi në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 22.07.2019, në të cilën ka qenë pjesëmarrës vetëm një ofertues, pikërisht OE “H. S.” i cili ka paraqitur ofertë ekonomike të barabartë me fondin limit në vlerën 41,000,000 lekë, pa TVSH, respektivisht:

-Blerje Eterna BI + Dataëarehouse + Reporting Services, log management, menaxhim te dokumenteve, statistikë”, me ofertë 25,000,000 lekë;

-Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit, me ofertë 16,000,000) lekë.

Në përfundim të shpalljes fitues të OE “H. S.”, Posta Shqiptare ka lidhur me këtë operatore kontratën e mirëmbajtjes nr.1762/6, datë 16.09.2019, me kohëzgjatje 4 vjet me vlerë totale 49,200,000 lekë me TVSH, respektivisht:

-Blerje Eterna BI + Datawarehouse + Reporting Services, log management, menaxhim te dokumenteve, statistikë”, me ofertë 30,000,000 lekë, me TVSH;

-Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit, me ofertë 19,200,000) lekë, me TVSH. Vlen të theksohet se, në nenin 8, kjo kontratë ka të përcaktuar kushtin që:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.”

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me piken 2 të nenit 1, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Ngarkohet me përgjegjësi: Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare z. L. D. dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me përbërje: znj. E. D., znj. I. B. dhe z. N. L.

II.2.2.1.E.Procedura e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite”, të realizuar në vitin 2020:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që do të prokurohet:

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e sistemeve Eterna-Financiare dhe Eterna Postare, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në të gjitha zyrat postare në të cilat është instaluar ky sistem.

-Eterna Financiare është një program që mbulon të gjitha aktivitetet e një institucioni financiar në kohë reale, mbështetur mbi infrastrukturën e rrjetit të degëve dhe rolet administrative. Përbëhet nga serverat: “Application server”, “Database Server” dhe “Datawarehouse Server”;

-Eterna Postare është një program që mbulon të gjitha proceset e shërbimeve postare dhe rolet përgjegjës për këto procese që nga momenti i pranimit të objektit postar deri tek dorëzimi në destinacion. Përbëhet nga serverat: Application server, Database Server dhe Aplikacionet Eterna Posta dhe Financiare.

Modulet dhe funksione që do të mirëmbahen janë:

-Modulet e Eternës Financiare: Administrimi i sistemit; Informacion klienti; Transaksione; Aprovime; Shërbime; Transferim fondesh; Ndihmat ekonomike; Transaksione per Kopshte/Cerdhe; Kërkimi Global; Bono Thesari; Databaza e studenteve; Eposta; Raportet;

-Modulet e Eternës Postare: Pranimi i objekteve; Numrat e Dërgesave Postare; Përpunimi i Thasëve Postarë; Transporti i Thasëve; Shpërndarja; Ngjarjet Manuale; Konfigurime Sistemi; Konfigurimet Sekondare; Aksesi në sistem; Konfigurimi i kompjuterave; Lidhje me Eterna Postare; Gjurmimi; Ndryshimi i fjalëkalimit; IPS Import Export; Pema e raporteve.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 03 datë 19.03.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: M. T., E. H. E. B.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: O. P. E. M. E. T.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 27,000,000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: N. L. M. T. E. B.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: E. K. M. Z. E. T.
8. Data e hapjes së tenderit: 05.05.2020	9. Operatori fitues: “H. S.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 27,000,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 (zero)lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1 (një)	12. Operatore te Kulifikuar: 1(një)	13. Operatorë të skualifikuar: ska
14. Ankimimet: ska	15. Përgjigje Ankesës nga AK ska	16. Përgjigje Ankesës: ska
17. Lidhja e kontratës: Datë 03.06.2020	18. Vlera e kontratës (me tvsh) 32,400,000 lekë	19. Afati i kontratës 36 muaj

1. Hartimi i specifikimeve teknike (termat e referencës):

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të shërbimit të mirëmbajtjes janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës më urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 5, datë 03.03.2020. Në përfundim ky grup me shkresën nr.486/1, datë 09.03.2020, ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të shërbimit, të cilat shkurtimisht janë përshkruar në Aktkonstatimin nr.5, datë 19.11.2021, bashkëlidhur këtij Projektraporti.

2. Llogaritja e vlerës Limit të Kontratës (fondi limit) dhe Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.14, datë 11.03.2020, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike, 3 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

- OE, “H. S.”, ka dërguar ofertën në vlerën 27,000,000 lekë;
- OE, “B. El.” ka dërguar ofertën në vlerën 27,000,100 lekë;
- OE, ”S. A.” ka dërguar ofertën në vlerën 27,000,900 lekë.

Bazuar në ofertat e marra, grupi i punës llogariti fondin limit, bazuar në çmimin më të ulët, të cilin e kishte operatorit “H. S.” **në vlerën 27,000,000 lekë.**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të “Hapur”. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

Nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit të këtyre kriterëve u konstatua se, një nga kriteret e veçanta kualifikuese nuk krijon kushte të barabarta për operatorët ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në procedurë prokurimi, pengon konkurrencën e lirë dhe nuk stimulon pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Konkretisht, është kërkuar në

shtojcën 8 dokumentet e tenderit, në pikën, 2.3.2 “Kapaciteti Teknik”, që operatorët ekonomik të kualifikohen, duhet të paraqesin:

-OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

Kërkesë kjo që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” duhet të vendoset dhe përdoret për procedura “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, në të cilat përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

Vendosja e kësaj kërkesë nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim, Analiza e Projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara të Eternës. Të gjitha këto duhet të merreshin në pronësi nga Posta Shqiptare, menjëherë mbas përfundimit të kontratës së parë të mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Kjo kontratë është realizuar në vitin 2014 me procedura “me negociim pa shpallje të paraprake të njoftimit të kontratës” për arsyen të së drejtës së autorit, pasi Kodet në Burim, Analiza e Projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara të Eternës i dispononte OE “H. S.” i cili kishte furnizuar dhe vendosur në funksionim sistemet e Eternës në vitet 2012-2014. Në këtë kontratë (nr.1069/7, datë 14.05.2014), por edhe në kontratën tjetër vijuese të lidhur me nr.1052/5, datë 22.05.2017 me vlerë 27,000,000 lekë për mbulimin me mirëmbajtje të sistemit Eterna për tre vite të tjera, deri në datën 22.05.2020 (në pritje të përfundimit të kësaj kontrate në datën 31.03.2020, kanë filluar procedurat e prokurimi të hapur për “Mirëmbajtje e Sistemit Eterna edhe për tre vite të tjera”), është vendosur kushti që:

-“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit**”.

Sa sipër vendosja në DT e kësaj kërkesë, nuk është në përputhje me rekomandimet e VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” dhe të Udhëzimit të Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimit të Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”. Ky udhëzim i dalë në zbatim të kësaj VKM, në germën “e”, të pikës 8, të kreut II, përcakton se, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet si më poshtë:

“Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”

Siç u tha më lartë, vlera e kontratave të mirëmbajtjes (fondi limit) është llogaritur nga testimi i tregut duke kërkuar dhe marrë 3 oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët. Një nga operatorët ekonomik që i është kërkuar ofertë për llogaritjen e fondit limit është dhe operatori “H. S.” i cili zotëronte të Drejtën e Autorit për programin Eterna të instaluar tek Posta Shqiptare dhe dispononte Kodin në Burim, të këtij sistemi, pasi Posta Shqiptare nuk kishte marrë në pronësi këtë kod, me përfundimi e kontratës nr.1069/7, datë 14.05.2014 apo dhe në përfundim të kontratës nr.1052/5, datë 22.05.2017 .

Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mund të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S.”.

Përveç se është konstatuar nga auditimi që ky kriter i veçantë kualifikues, nuk është hartuar në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën kontratës, është diskriminuese dhe nuk krijon kushte të barabarta të operatorëve dhe pengon konkurrencën e lirë dhe nuk stimulon pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, është konstatuar dhe është rekomanduar për ta ndryshuar edhe nga Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Kështu, me shpalljen e kësaj procedure në sistemin elektronik, në datën 19.03.2020, APP nëpërmjet emailit të datës 31.03.2020, ka njoftuar Postën Shqiptare (Përgjegjësën e Njësisë së Prokurimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm) se:

Kriterin e vendosur në pikën 2.3.2, në DT që: OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program, e sheh të arsyeshme të rivlerësohet, pasi:

Kjo kërkesë mund të kufizojë pjesëmarrjen në këtë procedurë për operatorët ekonomik që zotërojnë të gjitha kapacitetit tekniko profesionale për të realizuar me sukses kontratën. Në rast se AK i qëndron nevojës dhe domosdoshmërisë së këtij kriteri, duhet ta mirë argumentojë atë nga ana ligjore dhe teknike në lidhje me deponimin e Drejtës së Autorit për programin Eterna Software, duke mbajtur parasysh faktin se, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen, jo diskriminuese dhe konform rregullave të prokurimit publik.

Mirëpo AK nuk ka bërë ndryshimin e këtij kriteri, por i ka dërguar APP në datën 01.04.2020, informacion për të sqaruar konstatimet e saj. Në thelb ky informacion apo sqarim qëndron se: AK nuk ka asnjë të drejtë mbi këtë sistem as të drejtën e autorit dhe as pronësinë e Kodit në Burim sepse, në kontratën e mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 në nenin 11 të saj është përcaktuar se:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do të përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.**”

AK argumenton me tej duke cituar se, vendosja e këtyre kriterëve mbështetet në, germën b, të pikës 2, të nenit 33, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 55, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, duke interpretuar se për arsye teknike dhe artistike që kanë lidhje me të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale kontrata mund të ekzekutohet vetëm me një operatorë të veçantë.

Kjo bazë ligjore bën fjalën se në çfarë rastesh mund të përdoret procedura e prokurimi “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Pra ky sqarim apo interpretim i AK është i pakuptimit sepse nga njëra anë përpiqet të argumentojë hartimin dhe vendosjen e kësaj kërkesë ***si të mbështetura dhe bazuara në nenin 33 të LPP dhe nenin 55 të VKM, dhe nga ana tjetër organizon procedurën e “Hapur” dhe jo “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”***.

Gjithashtu, u konstatua se: edhe dy nga kriteret e veçanta kualifikuese që kanë lidhje me përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik, janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b, të pikës 4 të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT është kërkuar që:

-OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllorarit të kontratës që prokurohet.

- OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2016, 2017, 2018) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kritereve që, kërkon xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo me pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jene mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

3. Zhvillimi i procedurës:

Kufizimin e konkurrencës për shkak të së drejtës së autorit dhe mos marrjes në pronësi të Kodit në Burim nga Posta Shqiptare, ka sjell: pjesëmarrjen e ulët të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit; jo mirë përdorimin e fondeve publike; mos uljen e shpenzimeve procedurale të shërbimit e mirëmbajtjes. Këto probleme janë shfaqur qartazi në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 05.05.2020, në të cilën ka qenë pjesëmarrës vetëm një ofertues, pikërisht OE “H. S.” i cili ka paraqitur ofertë ekonomike të barabartë me fondin limit në vlerën 27,000,000 lekë, pa TVSH.

Në përfundim të shpalljes fitues të OE “H. S.”, Posta Shqiptare ka lidhur me operatorin kontratën e mirëmbajtjes nr. 618/10, datë 03.06.2020, me kohëzgjatje 3 vjet me vlerë totale **32,400,000 lekë, me TVSH.**

Vlen të theksohet se, në nenin 8, kjo kontratë ka të përcaktuar kushtin që:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do të përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me piken 2 të nenit 1, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Ngarkohet me përgjegjësi: Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare z. L. D. dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me përbërje: znj. M. T., znj. E. B. dhe z. N. L..

II.2.2.1.F.Procedura e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja E-Posta për 4 vite”, të realizuar në vitin 2020.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që do të prokurohet:

Qëllimi i kësaj procedure është Mirëmbajtja e sistemit e-posta për një periudhe 4 vjeçare. Mirëmbajtja e sistemit konsiston në mirëmbajtjen e shërbimeve financiare dhe postare on-line për klientët e postës për ofrimin e shërbimeve financiare dhe postare.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 12, datë 02.07.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: E. H. R. M. K. H.	4. Komisioni i llogaritjes së fondit limit: B. Q. B. A. E. N.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 20,000,000 lekë		

5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: K. H. R. M. N. L.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: E. K. H. B. N. B.
8. Data e hapjes së tenderit: 03.08.2020	9. Operatori fitues: “H. S.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 20,000,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 (zero)lekë
11.Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1 (një)	12. Operatore te Kulifikuar: 1(një)	13. Operatorë të skualifikuar: ska
14. Ankimimet: ska	15. Përgjigje Ankesës nga AK ska	16. Përgjigje Ankesës: ska
17. Lidhja e kontratës: Datë 31.08.2020	18. Vlera e kontratës (me tvsh) 24,000,000 lekë	19. Afati i kontratës 48 muaj

1. Hartimi i specifikimeve teknike (termat e referencës):

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të shërbimit të mirëmbajtjes janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës më urdhër te Drejtorit të Përgjithshëm nr.28, datë 08.06.2020. Në përfundim ky grup me shkresën nr.1105/1, datë 12.06.2020, ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të shërbimit, të cilat shkurtimisht janë përshkruar në Aktkonstatimin nr.6, datë 19.11.2021, bashkëlidhur këtij Projektraporti.

2. Llogaritja e vlerës Limit të Kontratës (fondi limit) dhe Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.34, datë 29.06.2020, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike, 3 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

- OE, “H. S.”, ka dërguar ofertën në vlerën 20,000,000 lekë;
- OE, “B. E.” ka dërguar ofertën në vlerën 20,060,000 lekë;
- OE, ”S. A.”, ka dërguar ofertën në vlerën 20,000,100 lekë.

Bazuar në ofertat e marra, grupi i punës llogariti fondin limit, bazuar në çmimin më të ulët, të cilin e kishte operatorit “H. S.” **në vlerën 20,000,000 lekë.**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të “Hapur”. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

Nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit të këtyre kriterëve u konstatua se, një nga kriteret e veçanta kualifikuese, nuk krijon kushte të barabarta për operatorët ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në procedurë prokurimi, pengon konkurrencën e lirë dhe nuk stimulon pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Konkretisht, është kërkuar në shtojcën 8 dokumentet e tenderit, në pikën, 2.3.2 “Kapaciteti Teknik”, që operatorët ekonomik të kualifikohen, duhet të paraqesin:

- OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program.

Kërkesë kjo që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave te Prokurimit Publik” duhet të vendoset dhe përdoret për procedura

“me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, në të cilat përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

Vendosja e kësaj kërkesë nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim, Analiza e Projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara të Eternës. Të gjitha këto duhet të merreshin në pronësi nga Posta Shqiptare, menjëherë mbas përfundimit të kontratës së parë të mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Kjo kontratë është realizuar në vitin 2014 me procedura “me negocim pa shpallje të paraprake të njoftimit të kontratës” për arsyen të së drejtës së autorit, pasi Kodet në Burim, Analiza e Projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara të Eternës i dispononte OE “H. S.” i cili kishte furnizuar dhe vendosur në funksionim sistemet të Eternës në vitet 2012-2014. Në këtë kontratë (nr.1069/7, datë 14.05.2014), por edhe në kontratat e tjera vijuese të lidhura mbas përfundimit të kësaj kontrate në datën 14.05.2017 për mbulimin me mirëmbajtje të sistemeve dhe moduleve të Eternës, është vendosur kushti që:

-“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit**”.

Sa sipër vendosja në DT e kësaj kërkesë, nuk është në përputhje me rekomandimet e VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” dhe të Udhëzimit të Ministrisë për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimit të Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”. Ky udhëzim i dalë në zbatim të kësaj VKM, në germën “e”, të pikës 8, të kreut II, përcakton se, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet si më poshtë:

“Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”

Siç u tha më lartë, vlera e kontratave të mirëmbajtjes (fondi limit) është llogaritur nga testimi i tregut duke kërkuar dhe marrë 3 oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët. Një nga operatorët ekonomik që i është kërkuar ofertë për llogaritjen e fondit limit është dhe operatori “H. S.” i cili zotëronte të Drejtën e Autorit për programin Eterna të instaluar tek Posta Shqiptare dhe dispononte Kodin në Burim, të këtij sistemi, pasi Posta Shqiptare nuk kishte marrë në pronësi këtë kod, me përfundimi e kontratës nr.1069/7, datë 14.05.2014 apo dhe në përfundim të kontratave të tjera vijuese të mirëmbajtjes së sistemeve dhe moduleve të Eternës.

Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mund të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S.”.

Përveç se është konstatuar nga auditimi që ky kriter i veçantë kualifikues, nuk është hartuar në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën kontratës, është diskriminuese dhe nuk krijon kushte të barabarta të operatorëve dhe pengon konkurrencën e lirë dhe nuk stimulon pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, është konstatuar dhe është rekomanduar për ta ndryshuar edhe nga Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Kështu, me shpalljen e kësaj procedure në

sistemin elektronik, në datën 06.07.2020, APP nëpërmjet emailit të datës 27.07.2020, ka njoftuar Postën Shqiptare (Përgjegjësin e Njesisë së prokurimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm) se:

Kriterin e vendosur në pikën 2.3.2, në DT që: OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program, e shih të arsyeshme të rivlerësohet, pasi:

Kjo kërkesë mundë të kufizojë pjesëmarrjen në këtë procedurë për operatorët ekonomik që zotërojnë të gjitha kapacitetit tekniko profesionale për të realizuar me sukses kontratën. Në rast se, AK i qëndron nevojës dhe domosdoshmërisë së këtij kriteri, duhet ta mirë argumentojë atë nga ana ligjore dhe teknike në lidhje me deponimin e Drejtës së Autorit për programin Eterna Software, duke mbajtur parasysh faktin se, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen, jo diskriminuese dhe konform rregullave të prokurimit publik.

Mirëpo AK nuk ka bërë ndryshimin e këtij kriteri, por i ka dërguar APP në datën 29.07.2020, informacion për të sqaruar konstatimet e saj. Në thelb ky informacion apo sqarim qëndron se:

AK nuk ka asnjë të drejtë mbi këtë sistem as të drejtën e autorit dhe as pronësinë e Kodit ne Burim sepse, në kontratën e mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014 në nenin 11 të saj është përcaktuar se:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.**

AK argumenton me tej duke cituar se, vendosja e këtyre kriterëve mbështetet në, germën b, të pikës 2, të nenit 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, duke interpretuar se për arsye teknike dhe artistike që kanë lidhje me të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale kontrata mundë të ekzekutohet vetëm me një operatorë të veçantë.

Kjo bazë ligjore bën fjalën se, në çfarë rastesh mund të përdoret procedura e prokurimi “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Pra ky sqarim apo interpretim i AK është i pakuptimit sepse nga njëra anë përpiqet të argumentojë hartimin dhe vendosjen e këtij kriteri si të mbështetura dhe bazuara në nenin 33 të LPP dhe nenin 55 të VKM, dhe nga ana tjetër organizon procedurën e “Hapur” dhe jo “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” .

Gjithashtu, u konstatua se: edhe dy nga kriteret e veçanta kualifikuese që kanë lidhje me përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik, janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b të pikës 4, të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT është kërkuar që:

-OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2016, 2017, 2018) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që

prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kriterëve që, kërkon xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo me pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo me pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jene mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

3. Zhvillimi i procedurës:

Kufizimin e konkurrencës për shkak të së drejtës së autorit dhe mos marrjes në pronësi të Kodit në Burim nga Posta Shqiptare, ka sjell: pjesëmarrjen e ulët të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit; jo mirë përdorimin e fondeve publike; mos uljen e shpenzimeve procedurale të shërbimit e mirëmbajtjes. Këto probleme janë shfaqur qartazi në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 03.08.2020 në të cilën ka qenë pjesëmarrës vetëm një ofertues, pikërisht OE “H. S.” i cili ka paraqitur ofertë ekonomike të barabartë **me fondin limit në vlerën 20,000,000 lekë, pa TVSH.**

Në përfundim të shpalljes fitues të OE “H. S.”, Posta Shqiptare ka lidhur me operatorin fitues, kontratën e mirëmbajtjes nr.1299/6, datë 31.08.2020, me kohëzgjatje 4 vjet me vlerë totale **24,000,000 lekë, me TVSH.**

Vlen të theksohet se, në nenin 8, kjo kontratë ka të përcaktuar kushtin që:

“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. **Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit.**”

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me piken 2 të nenit 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Ngarkohet me përgjegjësi: Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare z. L. D. dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me përbërje: z.K. H., z.R. M.dhe z.N. L..

Posta shqiptare me shkresë nr.1667/66 datë 11.01.2022 ka kthyer Projektraportin se bashku me 6 observacionet përkatëse të anëtarëve të njësive të hartimit të DT të procedurave të mësipërme. Observacionet kanë hyrë në KLSH me nr.877/333 prot, datë 12.01.2022. Nga shqyrtimi i tyre rezultoi se:

Të gjitha këto observacione kanë të njëjtën tekst dhe të njëjtin trajtim dhe janë të njëjta dhe përsëritje të observacioneve të bëra për 6 aktkonstatimet e mbajtura, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në projektraport se, ato nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë.

1. Titulli i gjetjes: Kodet Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të sistemeve të Eternës nuk janë pronë e Postës Shqiptare Sh.a.

Situata: Posta Shqiptare, që prej vitit 2012 e në vazhdim, për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të Eternës ka investuar (blerë) në totale **176,091,320 lekë, pa TVSH.** Ndërsa për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve që nga viti 2014 ka lidhur 10 kontrata të njëpasnjëshme që vazhdojnë të kenë afat deri në mesin e vitit 2024, me vlerë të përgjithshme **158,200,000 lekë pa TVSH.** Sistemet e Eterna përfshijnë dhe mbulojnë, shërbimet financiare (arkëtime, pagesa, transfertat bankare, etj.) dhe proceset e shërbimeve postare. Të gjitha procedurat e prokurimeve si të blerjeve të sistemit ashtu edhe të mirëmbajtjes së tij, janë fituar nga i njëjti Operator Ekonomik, “H. S.”. Fillimisht në korrik të vitit 2012 është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje informatizimi i sporteleve, gjurmimi kombëtar i objekteve postare dhe euroxhiro kombëtare”. Kjo blerje e sistemit është realizuar me procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për arsye të së drejtës së autorit dhe është

konkretizuar më lidhjen kontratës së furnizimit nr.1029/4, datë 21.08.2012, me operatorin fitues “H. S.”, me vlerë 51,791,320 lekë, pa TVSH. Mbas vënies në funksionim së sistemit, në datën 03.04.2014 është realizuar edhe procedura me negociim për mirëmbajtjen e këtij sistemi, me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Në këtë procedurë për arsye të së drejtës së autorit i është dërguar ftesë për ofertë operatorit “H. S.” me të cilin është lidhur edhe kontrata e mirëmbajtjes nr.1069/7, datë 14.05.2014, me vlerë 26,850,000 lekë, pa TVSH, me afat 3 vjet (deri në datën 13.05.2017). Hartimi dhe kohëzgjatja e kontratës së mirëmbajtjes, ka buruar nga kërkesat e VKM nr. 723, datë 01.09.2010, i ndryshuar me VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, e cila përcakton se, kontratat e mirëmbajtjes duhet të jenë jo më të shkurtra se 2 (dy) vjet. Në zbatim të kësaj VKM, Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, ka nxjerrë Udhëzimin nr.2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”. Në germën “e”, të pikës 8, të kreut II, të këtij udhëzimi përcaktohet se, për propozimet e kërkuara, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet që: **“Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”**

Kontrata e mirëmbajtjes e sipërcituar me nr.1069/7, datë 14.05.2014, në asnjë nen të saj nuk ka të përcaktuar këtë dispozitë, por në nenin 11, ka përcaktuar se: **“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit”**. Pra, Posta Shqiptare ndryshe nga ç ‘kërkohet në përcaktimet apo rekomandimet e këtij udhëzimi, nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim, Analizat e Projektimit, burimin dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha moduleve të sistemeve të Eternës.

Kriteri: VKM nr. 723, datë 01.09.2010, i ndryshuar me VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, Udhëzimin i Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit nr.2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”, kontrata e mirëmbajtjes nr.1069/7, datë 14.05.2014.

Ndikimi/Efekt: Posta Shqiptare nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim, Analizat e Projektimit, burimin dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha moduleve të sistemeve të Eternës.

Shkaku: Kontrata e mirëmbajtjes me nr.1069/7, datë 14.05.2014, ka përcaktuar se: **“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit”**.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Posta Shqiptare, në Dokumentet e Tenderit dhe në kushtet e kontratave të çdo procedure prokurimi që do të realizojë për blerjen edhe mirëmbajtjen e çdo sistemi teknologjie informacioni që do të aplikojë dhe zhvillojë, duhet të përcaktojë që:

-“Posta Shqiptare, në përfundim të kontratës së furnizimit apo të afatit të garancisë së pajisjeve dhe sistemit, apo në përfundim të afatit të kontratës së parë të mirëmbajtjes (sipas përcaktimeve të VKM. 710, datë 21.8.2013), pronësia e Kodeve Burimore (source code),

analizat e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të sistemit, do ti kalojnë Postës Shqiptare sh.a. pa asnjë kosto shtesë".

2. Titulli i gjetje: Në 6 procedurat e prokurimeve të zhvilluara të hapura, ka pasur mungesë të theksuar konkurrence.

Situata: Problematika e trajtuar më sipër, është mbartur dhe konstatuar në të gjitha procedurat e prokurimeve të realizuara për blerjen edhe mirëmbajtjen e sistemeve Eterna edhe gjatë periudhës objekt auditimi. Gjate kësaj periudhe, janë realizuar 6 procedura prokurimi të "Hapura" me fond limit në totale 103,649,850 lekë, pa TVSH dhe janë lidhur 6 kontrata për mirëmbajtjen e sistemeve të Eterna me vlerë totale 103,550,000 lekë, pa TVSH. Konkretisht: "Blerje Posta retail outlet dhe mirëmbajtje për 4 vjet", me fond limit: 30,999,850 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 13.05.2019, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit; "Mirëmbajtje Eterna Gateway Application për 4 vite", me fond limit 20,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 14.05.2019, me fitues OE "H. S.", me vlerë oferte të barabartë me fondin limit; "Mirëmbajtja e Moduleve të Eternes për 4 vjet", me fond limit 9,450,000lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 31.05.2019, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit; "Blerje Eterna BI dhe Mirëmbajtje BI për 4 vite", me fond limit 41,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 22.07.2019, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit; "Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për 3 vite", me fond limit 27,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 05.05.2020, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit; "Mirëmbajtja E-Posta për 4 vite", me fond limit 20,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 03.08.2020, me fitues OE "H. S.", me vlere oferte të barabartë me fondin limit. U konstatua:

- Të 6 procedurat janë zhvilluara të hapura, por në procedura ka pasur mungesë të theksuar konkurrence pasi në to ka marrë pjese vetëm operatori "H. S.", i cili është shpallur edhe fitues dhe ka lidhur kontratat e zbatimit. Mungesa e theksuar e konkurrencës ka ardhur si pasojë e hartimit dhe vendosjes në DT të kërkesave të veçantë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Konkretisht është kërkuar që: *"OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program"*; *"Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës se autorit ose i autorizuar prej tij, duhet te disponoje kodin ne burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod"*. Kërkesa këto që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" duhet të vendoset dhe përdoret për procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, pasi në këto dispozita përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore. Pra në bazë të këtyre dispozitave zhvillohen vetëm procedurat me negociim, dhe jo procedurat e hapura apo dhe procedurat e tjera. Vendosja e këtyre kërkesave nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare mbas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes të lidhur me **nr. 1069, datë 14.05.2014**, duhet të kishte marrë dhe të bënte pronë të saj, Kodet në Burim të sistemeve të Eternës.

- Përveç se është konstatuar nga auditimi që këto kriteret të veçanta kualifikuese janë hartuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, janë vërejtur si të tilla dhe janë rekomanduar për ti ndryshuar edhe nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP). Me shpalljen e të 6 procedurave në sistemin elektronik, APP për çdo procedurë, nëpërmjet emaileve, ka njoftuar Postën Shqiptare duke i sjell në vëmendje nevojën e saktësisimit dhe mirë argumentimin ligjor dhe teknik në lidhje me disponimin e së Drejtës së Autorit për programin Eterna Software, duke mbajtur parasysh faktin se, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen, jo diskriminuese dhe konform rregullave të prokurimit

publik. Po kështu, rekomandon një argumentim teknik në lidhje me faktin e mos disponimit të Kodit në Burim nga ana e AK se, sistemi në fjalë është ekzistues, dhe rrjedhimisht ***mund të ishte i disponueshëm nga vetë AK pas implementimit të sistemit aktual, nga OE fitues***. Mirëpo, AK nuk ka bërë ndryshimin e këtyre kriterëve, por për të 6 procedurat i ka dërguar informacion APP se, vendosja e këtyre kriterëve mbështetet në, germën b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 55, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Dhe ka interpretuar se, këto kërkesa janë vendosur, për arsye teknike dhe artistike që kanë lidhje me të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale dhe kontrata mundë të ekzekutohet vetëm me një operatorë të veçantë. Ky sqarim apo interpretim i AK është i pakuptimit sepse nga njëra anë përpiket të argumentojë se, hartimi dhe vendosja e këtyre kërkesave është mbështetur dhe bazuar në nenin 33 të LPP dhe nenin 55 të VKM, dispozita të cilat përcaktojnë rastet kur përdoret procedura “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” dhe nga ana tjetër ka organizuar procedura të “Hapura”.

- Po kështu në të 6 kontratat e mirëmbajtjes së lidhur me OE “H. S.” është vendosur kushti që: “Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. ***Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit***”.

Ky veprim ka bërë që ky operatorë të këtë të drejtën ekskluzive ose të drejtën e autorit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi për një kohë të gjatë, të paktën deri në përfundimin e kontratës së datës 31.08.2020 që ka afat deri në mesin e vitit 2024. Pra, me vendosjen e këtij kushti në përfundim të çdo kontrate, kodet në burim nuk i kalojnë në pronësi Postës Shqiptare, por mbeten përsëri pronë e kontraktuesit, madje deri në amortizimin e plotë dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të sistemit Eterna. Për pasojë nga vendosja e këtij kushti kontraktual, blerja e moduleve të tjera të sistemit Eterna dhe shërbimi i mirëmbajtjes së tyre, përqendrohet dhe monopolizohet vetëm te operatori “H. S.”.

Kriteri: Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe 6 kontratat e mirëmbajtjes së lidhur me OE “H. S.”

Ndikimi/Efekt: Vetëm OE “H. S.” ka të drejtën ekskluzive ose të drejtën e autorit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi.

Shkaku: Hartimi dhe vendosja në DT dhe në kushtet e kontratave të mirëmbajtjes, kriterë të veçanta, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Posta Shqiptare sh.a, të gjejë rrugët e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit për të negociuar me OE “H. S.” me qëllim heqjen nga kontrata e datës 31.08.2020, për “Mirëmbajtjen E-Posta për 4 vite” të kushtit: “Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit”.

Rekomandimi: Posta Shqiptare, në Dokumentet e Tenderit të çdo procedure prokurimi të hapur që do të realizojë për blerjen e moduleve dhe për mirëmbajtjen e sistemeve Eterna, të marrë në konsideratë rekomandimet e APP, dhe të mos vendosë kërkesat e veçanta që: “OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program”;

“Operatori ekonomik, qofte zotëruesi i të drejtës se autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod”.

Rekomandim: Posta Shqiptare sh.a, me përfundimin të kontratës së lidhur në datën 31.08.2020, me OE “H. S.” për “Mirëmbajtjen E-Posta për 4 vite”, me vlerë 20,000,000 lekë, pa TVSH, në DT, në kushtet e Veçanta dhe të Përgjithshme të kontratave që do të realizohen në procedurat e prokurimeve vijuese për shërbimin e mirëmbajtjes të sistemeve Eterna, të vendosë kushtin që: “Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit do të jetë dhe do të mbetet pronë e Postës Shqiptare”.

3. Titulli i gjetjes: Në llogaritjen e fondit limit për të gjitha kontratat e mirëmbajtjes nuk është marrë në konsideratë raporti kosto-përfitim.

Situata: Në të 6 procedurat e prokurimit, vlerat e kontratave të mirëmbajtjes (fondet limite) janë llogaritur në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin Publike” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për çdo procedurë janë marrë në treg, 3 apo 4 oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët. Në të 6 procedurat e prokurimit, një nga operatorët që u është kërkuar dhe marrë ofertë është edhe OE “H. S.”. Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mundë të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të mëparshme të mirëmbajtjes e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S.”. Po kështu, në llogaritjen e fondit limit për të gjitha kontratat e mirëmbajtjes nuk është marrë në konsideratë raporti kosto-përfitim, bazuar në amortizimin moral dhe fizik të këtij sistemi dhe në vlerën e mbetur në kontabilitet sipas pasqyrave financiare të çdo viti.

Kriteri: Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe 6 kontratat e mirëmbajtjes së lidhur me OE “H. S.”

Ndikimi/Efekti: Kosto e larte e kontratave të shërbimit të mirëmbajtjes

Shkaku: Mungesa e analizimit të kostove faktike të shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemeve Eterna.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Posta Shqiptare, të analizojë shpenzimet dhe kostot faktike të shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemeve Eterna dhe në procedurat e tjera të prokurimeve që do të realizojë, të llogarisë vlerën e kontratës së mirëmbajtjes (fondin limit) duke marrë në konsideratë, amortizimin moral dhe fizik të këtij sistem, vlerën e pasqyruar në kontabilitet dhe raportin kosto-përfitim.

4. Titulli i gjetje: Ekskluzivitet dhe monopolizim i blerjeve dhe i mirëmbajtjes së sistemit Eterna.

Situata: Mungesa e pronësisë së kodeve në burime ka bërë që të gjitha kontratat e mirëmbajtjes së sistemit Eterna duke filluar që nga viti 2017, edhe pse janë zhvilluar me procedura të hapura, janë lidhur në mungesë të theksuar të konkurrencës, pasoja e të cilës ka sjellë ekskluzivitetin dhe monopolizimin e blerjeve dhe të mirëmbajtjes së sistemit Eterna, duke i përqendruar këto mallra dhe shërbime vetëm te i njëjti operatorë, te operator “H. S.”. Nga ky veprim nuk është rritur pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit dhe nuk është siguruar mirë përdorimi i fondeve dhe ulja e shpenzimet procedurale për shërbimin e mirëmbajtjes, pasi ky operatorë në të gjitha procedurat e prokurimit ka ofruar ofertën ekonomike pothuajse të barabartë me fondin limit. Për pasojë shpenzimet e mirëmbajtjes janë relativisht të larta kundrejt kostos së blerjeve së vetë sistemit Eterna, të cilat shkojnë rreth 15-18 % për çdo vit. Kështu, për gjatë gjithë kohës së funksionimit të sistemit që nga viti 2014

deri në vitin 2024, shpenzimet progresive për shërbimin e mirëmbajtjes kanë shkuar në vlerën **158,200,000** lekë pa TVSH, ose përbëjnë 90%, të vlerës progresive të blerjeve të gjithë sistemit Eterna që janë në shumën **176,091,320** lekë, pa TVSH. Megjithatë kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemeve të teknologjisë së informacionit vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtij shërbimi, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në tregun vendas sepse ato nuk janë të natyrës fizike por me tepër janë të një natyre intelektuale që lidhen me të drejtën ekskluzive apo të drejtën e autorit dhe për këto shpenzime në treg nuk ka kosto të normuara apo çmime referuese. Kjo dhe për faktin se, AKSHI apo ministria e linjës që mbulon fushën e Teknologjisë së Informacionit nuk kanë hartuar normativa, manuale, preventiva, apo udhëzues të veçantë, për përcaktimin e çmimeve orientuese, mbështetur në specifikimet teknike të çdo lloj sistemi teknologjie informacionit dhe në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve Evropiane dhe mbi bazën e këtyre çmimeve të llogariteshin shpenzimet e mirëmbajtjes.

Kriteri: Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe 6 kontratat e mirëmbajtjes së lidhur me OE “H. S.”

Ndikimi/Efekti: Ekskluzivitet dhe monopolizimi i blerjeve dhe i mirëmbajtjes së sistemit Eterna dhe mungesa e çmimeve referuese, ka reflektuar kosto të larta të shpenzimeve të mirëmbajtjes.

Shkaku: Mungesa e normativave, manualeve, preventiva, apo udhëzues të veçantë, për përcaktimin e çmimeve orientuese të mirëmbajtjes.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Posta Shqiptare, bazuar në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve Evropiane, të marrë iniciativën dhe ti kërkojë, MFE me cilësinë e aksionerit, AKSH dhe Ministrisë së linjës që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit që, të hartojnë normativa, manuale, apo udhëzues të veçantë, për përcaktimin e çmimeve orientuese për çdo lloj sistemi që ka të bëjë me teknologjinë e informacionit dhe mbi bazën e tyre të llogariten vlerat e kontratave të blerjeve dhe kontratave të shërbimeve për mirëmbajtjen e tyre.

II.2.2.2.Prokurimet e realizuara, mirëmbajtjen e sistemit dhe pajisjeve të Data Center, për periudhën nga data 01.2019 deri në datën 30.06.2021:

Gjatë vitin 2013, por dhe para këtij viti, Posta Shqiptare sh.a. ka blerë dhe ka vendosur në funksionim rrjetin dhe pajisjet e rrjetit Data Center. Sipas regjistrimit në kontabilitet në fund të vitit 2013, këto pajisje janë në vlerën **totale 35,500,200 lekë**, pa TVSH. Deri në fund të vitit 2018 (31.12.2018) kanë akumuluar një amortizim në vlerën 29,908,996 lekë dhe vlera e mbetur e tyre në fund të këtij viti është 5,591,2014 lekë. Po në vitin 2018 është bërë rivlerësimi i aseteve të Postës Shqiptare dhe rrjeti dhe pajisjet e Data Center kanë marrë një vlerë të re, duke u rivlerësuar në vlerën 10,650,080 lekë.

Mirëmbajtja e pajisjeve të rrjetit të Data Center kryhet pranë dhomës së serverëve, të Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare sh.a. Mirëmbajtja kryhet për një periudhë 1 vjeçare nëpërmjet një kontrolli dhe mirëmbajtjeje periodike. Shkurtimisht po përshkruajmë specifikimet teknike të sistemit dhe pajisjeve për shërbimin e mirëmbajtjes që kërkohet për çdo vit:

-Përshkrimi i kërkesave për garancinë e produkteve: hardware Fujitsu Blad System/Servers si dhe shërbimet ne site (On-Site); hardware EMC Data Storage si dhe shërbimet ne site (On-Site); hardware të Quantum Tape Library si dhe shërbimet ne site (On-Site); Juniper si dhe shërbimet ne site (On-Site); CheckPoint si dhe shërbimet ne site (On-Site);Cisco si dhe shërbimet ne site (On-Site); hardware IBM System Servers si dhe shërbimet ne site (On-Site); hardware HP ProLiant DL380 G5 Server si dhe shërbimet ne site (On-Site); hardware HP ProLiant DL360 G6 Server si dhe shërbimet ne site (On-Site); IBM Storage V5030 si dhe shërbimet ne site (On-Site).

Për mbulimin me shërbimin e Mirëmbajtjes së Data Center, nga vënia në funksionim në vitin 2014 dhe deri në vitin 2021, Posta shqiptare ka realizuar 6 procedura prokurimi të hapura dhe ka lidhur 6 kontrata me vlerë totale 73,291,455 lekë pa TVSH dhe 87,949,746 lekë me TVSH, si më poshtë:

- Kontrata me nr.1751/5, datë 16.09.2013, me afat 1 vjeçar, me vlerë 16,187,280 lekë;
- Kontrata me nr.3388/5, datë 30.12.2015, me afat 1 vjeçar, me vlerë 15,208,376 lekë;
- Kontrata me nr.406/15, datë 22.12.2017, me afat 1 vjeçar, me vlerë 13,721,520 lekë;
- Kontrata me nr.3377/13, datë 18.03.2019, me afat 1 vjeçar, me vlerë 14,277,720 lekë;
- Kontrata me nr.751/13, datë 23.06.2020, me afat 1 vjeçar, me vlerë 14,277,720 lekë;
- Kontrata me nr.1069/8, datë 06.08.2021, me afat 1 vjeçar, me vlerë 14,277,600 lekë.

Siç tregojnë këto shifra, vlerat vjetore të shpenzimeve për mirëmbajtjen kundrejt vlerës së blerjes së sistemit dhe të pajisjeve Data Center, shkojnë për çdo vit rreth 34-35%, ose vlera e shpenzimeve progresive të mirëmbajtjes kundrejt vlerës totale të blerjes së sistemit dhe pajisjeve Data Center që nga viti 2014 deri në vitin 2021, ka shkuar rreth 206% (73,291,455 lekë/ 35,500,200 lekë).

Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe rrjetit të Data Center vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtij shërbimi, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në tregun vendas sepse përveç se janë të natyrës fizike janë edhe të një natyre intelektuale profesionale dhe për shpenzimet e këtij shërbimi në tregun vendas nuk ka kosto të normuar apo çmime referuese. Kjo për faktin se, AKSH apo ministria e linjës që mbulon fushën e Teknologjisë së Informacionit nuk kanë hartuar normativa, manuale, preventiva, apo udhëzues, për përcaktimin e çmimeve orientuese, mbështetur në specifikimeve teknike të çdo lloj sistemi të teknologjisë së Informacionit dhe në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve Evropiane dhe mbi bazën e këtyre çmimeve të llogariteshin shpenzimet e mirëmbajtjes.

Kosta e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit dhe pajisjeve Data Center, tregohet qartazi në procedurat prokurimeve të realizuara, për shërbimin e mirëmbajtjes gjatë periudhës, 01.01.2019 - 30.06.2021. Konkretisht:

Gjatë kësaj periudhe, Posta Shqiptare sh.a, për mbulimin me shërbimin e Mirëmbajtjes Data Center (pajisjet e dhomës së serverëve), ka realizuar 3 procedura prokurimi të hapura me fond limit në total 36,000,000 lekë, pa TVSH dhe ka lidhur 3 kontrata mirëmbajtje me vlerë 35,694,200 lekë, pa TVSH (42,833,040 lekë me TVSH), me një kursim të fondeve në vlerën 305,800 lekë, si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit te procedure	OE fitues	Data e lidhjes se kontratës	Data e përfundimit kontratës
1	Mirëmbajtje Data Center	12,000,000	Hapur	11,898,100	06.02.2019	“D. B.”	18.03.2019	22.6.2020
2	Mirëmbajtje Data Center	12,000,000	Hapur	11,898,100	18.05.2020	“D. B.”	230.6.2020	22.6.2021
3	Mirëmbajtje Data Center	12,000,000	Hapur	11,898,000	14.06.2021	“D. B.”	08.06.2021	08.5.2022
	Totali	36,000,000		35,694,200				

Nga auditimi mbi zbatimin e rregullave të prokurimit publik për realizimin e këtyre procedurave rezultoi:

II.2.2.2.A.Procedura e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja Data Center” e realizuar në vitin 2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës që do të prokurohet:

Mirëmbajtja e pajisjeve te rrjetit dhe te Data Center do të kryhet pranë dhomës së serverëve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare sh.a. për një periudhe 1 vjeçare nëpërmjet një kontrolli dhe mirëmbajtjeje periodike.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 51 datë 23.11.2018	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: E. T. E. S. A. S.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: V. K. K. H. E. A.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 12.000.000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E. T., E. M. L. M.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: H. B. A. K. E. S.
8. Data e hapjes së tenderit: 06.02.2019	9. Operatori fitues: “D. B.” . Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 11,898,100 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 101,900 lekë
11.OE pjesëmarrës: 1 (një)	12. OE te Kulifikuar: 1 (një)	13. OE të skualifikuar: Ska
14. Ankimet: datën 03.12.2018	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nr.51/3, datë 4.12.2018	16. Përgjigje Ankesës KPP: vendimi nr.25//1 datë 17.01.2019
17. Lidhja e kontratës: Datë 18.03.2019	18. Vlera e kontratës (me tvsh) 14,277,720 lekë	19. Afati i kontratës 12 muaj

1. Hartimi i specifikimeve teknike:

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të shërbimit të mirëmbajtjes janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës me specialistë të fushës, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.497, datë 07.11.2018. Në përfundim ky grup pune me shkresën nr.3162/1, datë 13.11.2018 ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të shërbimit, të cilat shkurtimisht janë përshkruar në Aktkonstatimin nr.7, datë 19.11.2021, bashkëlidhur Projektraportit.

2. Llogaritja e vlerës së Kontratës (fondi limit):

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.520, datë 16.11.2018, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike 3 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

-Operatorit Ekonomik, “D.”, i cili ka dërguar ofertën në vlerën 12,445,400 lekë

-Operatorit Ekonomik, “S. A.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 12,000,150 lekë;

-Operatorit Ekonomik, ”J. G.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 12,209,500 lekë,

Bazuar në ofertat e marra, grupi i punës llogarit fondin limit, bazuar në çmimin më të ulët, të cilin e kishte dërguar operatori ”I. S.” **në vlerën 12,000,000 lekë.**

Në lidhje me llogaritjen e fondit limit vihet re se, AK edhe pse ka përlllogaritur fondin limit, në përputhje me parashikimet e nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit Data Center, për vitin 2019 janë llogaritur në vlera të konsiderueshme që shkojnë rreth 33-34%, kundrejt kostos së përgjithshme të blerjes së sistemit Data Center, e cila sipas regjistrimit në kontabilitetin e vitit 2013, janë në shumën 35,500,200 lekë. Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve të rrjetit të Data Center, vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtyre shërbimeve, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në tregun vendas sepse përveç se, janë të natyrës fizike, janë edhe të një natyre tekniko profesionale dhe për shpenzimet e këtij shërbimi në tregun vendas nuk ka kosto të normuar apo çmime referuese. Kjo për faktin se, AKSHI apo ministria e linjës që mbulon fushën e Teknologjisë së Informacionit nuk kanë hartuar normativa, manuale, preventiva, apo udhëzues, për përcaktimin e çmimeve orientuese, mbështetur në specifikimeve teknike të

sistemeve Data Center dhe në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve Evropiane dhe mbi bazën e këtyre çmimeve të llogariteshin shpenzimet e mirëmbajtjes.

3.Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit, mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të “Hapur”. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumente përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Mbas shpalljes të njoftimit të kontratës në datën 27.11.2018, Operatorë Ekonomik “B. E.” në datën 03.12.2018 ka bërë ankesë për ndryshimin e disa kërkesave të veçanta të kërkuara në DT. AK me shkresën nr.51/3, datë 4.12.2018, ka pezulluar procedurën e prokurimit dhe ka ngritur komisionin e shqyrtimit të kësaj ankesë, i cili në përfundim të shqyrtimit ka dalë në konkluzionin se, pretendimet e ngritura në ankesë nuk vlerësohen si të drejta. Operatorë Ekonomik “B. E.” me shkresën 1757, në datën 17.12.2018, njofton AK se, ka bërë ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik (KPP).

Me vendimin nr.1900/1 datë 20.12.2018, KPP ka marrë në shqyrtim ankesën dhe ka urdhëruar AK të pezullojë procedurën e prokurimit. Me vendimin nr.25/1 datë 17.01.2019, KPP ka vendosur të pranojë pjesërisht ankesën dhe ka urdhëruar AK të modifikojë DT dhe të vazhdojë procedurën e prokurimit

Po kështu edhe APP nëpërmjet emailit të datës 20.12.2018 i ka kërkuar AK (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Prokurimit), ndryshimin e disa kriterëve të veçanta sepse nuk përmbushin parashikimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP. AK në zbatim të vendimit të KPP dhe të rekomandimeve të APP, ka bërë ndryshimin e këtyre kërkesave dhe me shkresën nr.2, datë 24.01.20 ka dërguar në APP njoftimin për modifikimin e DT dhe shtyrjen e afatit të prokurimit për në datën 06.02.2019.

Megjithatë, nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit e kriterëve të veçanta u konstatua se: dy nga kriteret e veçanta kualifikuese janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b të pikës 4 të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT është kërkuar që:

-OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

- OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2015, 2016, 2017) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kriterëve që, kërkon xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo me pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të

jene mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

4. Zhvillimi i procedurës:

Në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 06.02.2019 ka marrë pjesë vetëm Bashkimi i Operatorë Ekonomik (BOE) “D. dhe B. E.”, i cili ka paraqitur ofertë ekonomike **në vlerën 11,898,100 lekë, pa TVSH.**

Në përfundim të shpalljes fitues të BOE “D. dhe B. E.”, Posta Shqiptare ka lidhur me këtë BOE kontratën e mirëmbajtjes me nr.3377/13 datë 18.03.2019, me kohëzgjatje 1 vit, me vlerë totale 14,277,720 lekë me TVSH.

Për sa mësipërm, përgjegjësi mbajnë, Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: z.E. T., znj.E. M., znj.L. M. dhe Drejtori i Përgjithshëm z. L. D..

II.2.2.2.B.Procedura e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja Data Center” të realizuar në vitin 2020.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. Nr.07, datë 16.04.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: B. Q. O. B. A. S.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: J. S. E. K. D. M.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 12.000.000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: B. Q. V. K. A. S.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: E. K. R. Ll. R. K.
8. Data e hapjes së tenderit: 18.05.2020	9. Operatori fitues: “D. B.” . Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 11,898,100 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 101,900 lekë
11.OE pjesëmarrës: 1 (një)	12. OE të Kulifikuar: 1 (një)	13. OE të skualifikuar: Ska
14. Ankimimet: Ska	15. Përgjigje Ankesës nga AK	16. Përgjigje Ankesës:
17. Lidhja e kontratës: Datë 23.06.2020	18. Vlera e kontratës (me tvsh) 14,277,720 lekë	19. Afati i kontratës 12 muaj

1. Hartimi i specifikimeve teknike:

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të shërbimit të mirëmbajtjes janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës me specialistë të fushës, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 7, datë 03.03.2020. Në përfundim ky grup pune me shkresën nr.488/1, datë 06.03.2020 ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të shërbimit, të cilat shkurtimisht janë përshkruar në Aktkonstatimin nr.7, datë 19.11.2021, bashkëlidhur Projektraportit.

2. Llogaritja e vlerës së Kontratës (fondi limit):

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.19, datë 26.03.2020, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike 3 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

-Operatorit Ekonomik, “P. S.”, i cili ka dërguar ofertën në vlerën 12,650,000 lekë

-Operatorit Ekonomik, “S. A.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 12,173,500 lekë;

-Operatorit Ekonomik, ”I. S.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 12,000,000 lekë,

Bazuar në ofertat e marra, grupi i punës llogariti fondin limit, bazuar në çmimin më të ulët, të cilin e kishte dërguar operatori ”I. S.” **në vlerën 12,000,000 lekë.**

Në lidhje me llogaritjen e fondit limit vihet re se, AK edhe pse ka përlllogaritur fondin limit, në përputhje me parashikimet e nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit Data Center, për vitin 2020 janë llogaritur në vlera të konsiderueshme që shkojnë rreth 33-34%, kundrejt kostos së përgjithshme të blerjes së sistemit Data Center, e cila sipas regjistrimit në kontabilitetin e vitit 2013, janë në shumën 35,500,200 lekë. Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve të rrjetit të Data Center, vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtyre shërbimeve, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në tregun vendas sepse përveç se, janë të natyrës fizike, janë edhe të një natyre tekniko profesionale dhe për shpenzimet e këtij shërbimi në tregun vendas nuk ka kosto të normuar apo çmime referuese. Kjo për faktin se, AKSH apo ministria e linjës që mbulon fushën e Teknologjisë së Informacionit nuk kanë hartuar normativa, manuale, preventiva, apo udhëzues, për përcaktimin e çmimeve orientuese, mbështetur në specifikimeve teknike të sistemeve Data Center dhe në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve Evropiane dhe mbi bazën e këtyre çmimeve të llogaritëshin shpenzimet e mirëmbajtjes.

3.Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit, mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të “Hapur”. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

Mbas shpalljes në datën 16.04.2020 të njoftimit të kontratës, Operatorë Ekonomik (OE) “A.” në datën 23.04.2020 ka bërë ankesë për ndryshimin e disa kërkesave të veçanta të kërkuara në DT. Po kështu edhe APP nëpërmjet emailit të datës 30.04.2020 i ka kërkuar AK (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Prokurimit), ndryshimin e disa kriterëve të veçanta sepse nuk përmbushin parashikimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP. AK ka marrë në konsideratë ankesën e OE dhe rekomandimet e APP dhe ka bërë ndryshimin e këtyre kërkesave dhe me shkresën nr.751, datë 05.05.2020 ka dërguar në APP njoftimin për modifikimin e DT dhe shtyrjen e afatit të prokurimit.

Megjithatë, nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit e kriterëve të veçanta u konstatua se: dy nga kriteret e veçanta kualifikuese janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b të pikës 4 të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT është kërkuar që:

-“OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet”; “OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kriterëve që, kërkon xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme

të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, kuptohet sikur vlere e xhiros vjetore dhe vlere e kontratave të ngjashme duhet të jene mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

4. Zhvillimi i procedurës:

Në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 18.05.2020 ka marrë pjesë vetëm BOE “D. dhe B. E.” i cili ka paraqitur ofertë ekonomike **në vlerën 11,898,100 lekë, pa TVSH.**

Në përfundim të shpalljes fitues të BOE “D. dhe B. E.”, Posta Shqiptare ka lidhur me këtë BOE kontratën e mirëmbajtjes me nr.751/13, datë 23.06.2020, me kohëzgjatje 1 vit, me vlerë totale 14,277,720 lekë me TVSH.

Për sa më sipër, përgjegjësi mbajnë, Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: z. O. B., znj. B. Q. dhe z. A. S. dhe Drejtori i Përgjithshëm z.L. D.

II.2.2.2.C. Procedura e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja Data Center” e realizuar në vitin 2021.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi Nr. 13 datë 19.05.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: R. K. E. A. E. K.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: J. S. E. H. D. M.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 12,000,000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e DT (njesia e Prokurimit): V. K. E. H. E. H.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: K. H. A. S. A. K.
8. Data e hapjes së tenderit: 14.06.2021,	9. Operatori fitues: “D. & B. E.”. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 11,898,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 102,000 lekë
11. OE pjesëmarrës 1 (një)	12. Operatore te Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të skualifikuar: Ska
14. Ankimimet: Ska	15. Përgjigje Ankesës nga AK	16. Përgjigje Ankesës:
17. Lidhja e kontratës: Datë 06.08.2021	18. Vlera e kontratës (me tvsh) 14,277,600 lekë	19. Afati i kontratës 12 muaj

1. Hartimi i specifikimeve teknike:

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të shërbimit të mirëmbajtjes janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës me specialistë të fushës, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 25, datë 18.03.2021. Në përfundim ky grup pune, me shkresën nr.621/2, datë 24.03.2020 ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të shërbimit, të cilat shkurtimisht janë përshkruar në Aktkonstatimin nr.7, datë 19.11.2021, bashkëlidhur Projektraportit.

2. Llogaritja e vlerës së Kontratës (fondi limit):

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.36, datë 29.03.2021, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike 3 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

-OE, “A. C.”, i cili ka dërguar ofertën në vlerën 12,625,000 lekë;

-OE, “J. G.”, i cili ka dërguar ofertën në vlerën 13,559,535 lekë;

-OE, "I. S.", i cili ka dërguar ofertën në vlerën 12,000,000 lekë,

Bazuar në ofertat e marra, grupi i punës llogariti fondin limit bazuar në çmimin më të ulët, të cilin e kishte dërguar operatori "I. S." **në vlerën 12,000,000 lekë.**

Edhe në këtë procedurë ashtu si në dy procedurat e mësipërme, në lidhje me llogaritjen e fondit limit vihet re se, AK edhe pse ka përllogaritur fondin limit, në përputhje me parashikimet e nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit Data Center, për vitin 2021 janë llogaritur në vlera të konsiderueshme që shkojnë rreth 33-34%, kundrejt kostos së përgjithshme të blerjes së sistemit Data Center, e cila sipas regjistrimit në kontabilitetin e vitit 2013, janë në shumën 35,500,200 lekë. Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve të rrjetit të Data Center, vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtyre shërbimeve, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në tregun vendas sepse përveç se, janë të natyrës fizike, janë edhe të një natyre tekniko profesionale dhe për shpenzimet e këtij shërbimi në tregun vendas nuk ka kosto të normuar apo çmime referuese. Kjo për faktin se, AKSHI apo ministria e linjës që mbulon fushën e Teknologjisë së Informacionit nuk kanë hartuar normativa, manuale, preventiva, apo udhëzues, për përcaktimin e çmimeve orientuese, mbështetur në specifikimeve teknike të sistemeve Data Center dhe në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve Evropiane dhe mbi bazën e këtyre çmimeve të llogariteshin shpenzimet e mirëmbajtjes.

3.Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të "Hapur". Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

Mbas shpalljes në datën 19.05.2020 të njoftimit të kontratës, APP nëpërmjet emailit të datës 27.05.2020, i ka kërkuar AK (Njësisë së Prokurimit dhe Drejtorit të Përgjithshëm), ndryshimin e disa kriterëve të veçanta sepse nuk përmbushin parashikimet e pikës 1, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik" dhe pikës 2 të nenit 28 të nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Po kështu i ka kërkuar që AK duhet të marrë në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 duke i përshtatur me DST ekzistuese, së pari, në lidhje me referencat që kanë për ligjin e shfuqizuar dhe së dyti, aty ku është e mundur edhe përmbajtjen sipas kërkesave të ligjit 162/2020.

AK ka marrë pjesërisht në konsideratë rekomandimet e APP dhe ka bërë ndryshimin e disa kërkesave, dhe me shkresën nr.1069/4, datë 02.06.2020 ka dërguar në APP njoftimin për modifikimin e DT dhe shtyrjen e afatit të prokurimit për në datën 14.06.2021.

Megjithatë, nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit e këtyre kriterëve të veçanta u konstatua se: dy nga kriteret e veçanta kualifikuese janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b të pikës 4 të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Konkretisht në DT është kërkuar që:

"OE duhet te paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës së përllogaritur te kontratës qe prokurohet"; "OE duhet te paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2018, 2019, 2020) me vlere jo me pak se 39 % e vlerës limit te kontratës qe prokurohet".

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kritereve që kërkojnë xhiron mesatare vjetore (2018, 2019, 2020 me vlere jo me pak se 39 % e vlerës se përllogaritur te kontratës qe prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës se përllogaritur te kontratës qe prokurohet, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jene mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

4. Zhvillimi i procedurës:

Në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 14.06.2021 ka marrë pjesë vetëm BOE “D. dhe B. E.”, i cili ka paraqitur ofertë ekonomike **në vlerën 11,898,000 lekë, pa TVSH.**

Në përfundim të shpalljes fitues të këtij BOE, Posta Shqiptare ka lidhur kontratën e mirëmbajtjes me nr.1069/8, datë 06.08.2021, me kohëzgjatje 1 vit, me vlerë totale **14,277,600 lekë me TVSH.**

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi: Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: znj. V. K., znj. E. H.dhe z. E. H. dhe Drejtori i Përgjithshëm z. H. B..

Posta shqiptare me shkresë nr.1667/66 datë 11.01.2022 ka kthyer Projektraportin sebashku me observacionet përkatëse të anëtarëve të njësisive të hartimit të DT të 3 procedurave të mësipërme. Observacionet kanë hyrë në KLSH me nr.877/333 prot, datë 12.01.2022. Nga shqyrtimi i tyre rezultoi se, këto observacione janë të njëjta dhe përsëritje të observacioneve të bëra për aktonstatimin e mbajtur, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në projektraport se, ato nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë.

5.Titulli i gjetjes: Në llogaritjen e fondit limit për të gjitha kontratat e mirëmbajtjes së Data Center, nuk është marrë në konsideratë raporti kosto-përfitim.

Situata: Gjatë vitin 2013, por dhe para këtij viti, Posta Shqiptare sh.a. ka blerë dhe ka vendosur në funksionim rrjetin dhe pajisjet e rrjetit Data Center (serverët). Sipas regjistrimit në kontabilitet në fund të vitit 2013, këto pajisje janë në vlerën **totale 35,500,200 lekë**, pa TVSH. Deri në fund të vitit 2018 (31.12.2018) kane akumuluar një amortizim në vlerën 29,908,996 lekë dhe vlera e mbetur e tyre në fund të këtij viti është 5,591,2014 lekë. Po në vitin 2018 është bërë rivlerësimi i aseteve të Postës Shqiptare dhe rrjeti dhe pajisjet e Data Center kanë marrë një vlerë të re, duke u rivlerësuar në vlerën 10,650,080 lekë. Për mbulimin me shërbimin e mirëmbajtjes së Data Center, nga vënia në funksionim në vitin 2014 dhe deri në datën 30.06. 2021, Posta shqiptare ka realizuar 6 procedura prokurimi të hapura dhe ka lidhur 6 kontrata me afate 1 vjeçare, me vlerë totale 73,291,455 lekë, pa TVSH (87,949,746 lekë, me TVSH). Konkretisht: kontrata me nr.1751/5, datë 16.09.2013, me vlerë 16,187,280 lekë; kontrata me nr.3388/5, datë 30.12.2015, me vlerë 15,208,376 lekë; kontrata me nr.406/15, datë 22.12.2017, me vlerë 13,721,520 lekë; kontrata me nr.3377/13, datë 18.03.2019, me vlerë 14,277,720 lekë; kontrata me nr.751/13, datë 23.06.2020, me vlerë 14,277,720 lekë; kontrata me nr.1069/8, datë 06.08.2021, me vlerë 14,277,600 lekë.

Siç tregojnë këto shifra, vlera vjetore e shpenzimeve për mirëmbajtjen kundrejt vlerës së blerjes së sistemit dhe të pajisjeve Data Center, shkojnë për çdo vit rreth 34-35%, ose vlera e shpenzimeve progresive të mirëmbajtjes kundrejt vlerës totale të blerjes së sistemit dhe pajisjeve Data Center, që nga viti 2014 deri në datën 30.06.2021, ka shkuar rreth 206% (73,291,455 lekë/ 35,500,200 lekë). Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe të rrjetit Data Center vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtij shërbimi, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në

treg vendas sepse përveç se janë të natyrës fizike janë edhe të një natyre intelektuale profesionale dhe për shpenzimet e këtij shërbimi në tregun vendas nuk ka kosto të normuar apo çmime referuese. Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit dhe pajisjeve Data Center, tregohet qartazi edhe në procedurat prokurimeve të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, për shërbimin e mirëmbajtjes. Konkretisht, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 3 procedura prokurimi të hapura me fond limit në total 36,000,000 lekë, pa TVSH (12,000,000 lekë për procedurë). Të tre procedurat të realizuara për çdo vit, janë fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) “D. B.” me ofertë ekonomike pothuajse të barabartë me fondin limit, me një kursim të vogël në vlerën 305,800 lekë. Me këtë BOE janë lidhur 3 kontrata për shërbimin e mirëmbajtjes së Data Center, me vlerë totale 35,694,200 lekë, pa TVSH (42,833,040 lekë, me TVSH), përkatësisht, kontrata e datës 18.03.2019, me vlerë 14,277,720 lekë; kontrata e datës 23.06.2020, me vlerë 14,277,720 lekë dhe kontrata e datës 06.08.2021, me vlerë 14,277,600 lekë.

Kriteri: Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe 3 kontratat e mirëmbajtjes së Data Center të lidhur me BOE “D. & B.”.

Ndikimi/Efekti: Kosto e lartë e kontratave të shërbimit të mirëmbajtjes

Shkaku: Mungesa e analizimit të kostove faktike të shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemit Data Center.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Posta Shqiptare, të ngrejë një grup pune të veçantë me specialistë të fushës për të analizuar gjendjen teknike e fizike të rrjetit dhe pajisjeve Data Center dhe në varësi të amortizimit të tyre, të analizoje kostot e mirëmbajtjes duke marrë në konsideratë raportin kosto-përfitim. Në rast se, përfitimimi është në raport të zhdrejtë me koston, pra shpenzimet e mirëmbajtjes tejkalojnë vlerën e sistemit dhe të pajisjeve, atëherë të shikohet mundësia e blerjes së sistemit dhe pajisjeve të reja. Në procedurat e prokurimit që do të realizohen, në dokumentet e tenderit të kërkohet që, shërbimi i mirëmbajtjes të kryhet nga operatori fitues, me afat sipas përcaktimeve të VKM 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”.

II.2.2.3.Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Tonera, Bojëra Printerit” e realizuar në vitin 2020

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 4, datë 26.03.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: K. H. A. S. E. P.	4. Komisioni i llogaritjes së fondit limit: B. A. K. F. K. S.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 60,034,800 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: V. K. A. S. E. P.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: H. B. K. B. M. Z.
8. Data e hapjes së tenderit: 13.05.2020	9. Operatori fitues: “I. O.”. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 38,597,810.82 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 21,436,989 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 2 (dY)	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të skualifikuar: 1 (një)
14. Ankimimet: AK, po; APP, po; KPP, po	15. Përgjigje Ankesës nga AK Po	16. Përgjigje Ankesës nga : APP,po KPP, po

17. Lidhja e kontratës: nr.635/46 datë 15.02.2021	18. Vlera e kontratës (me tvsh) 46,317,372.98 lekë	19. Afati i kontratës në muaj Parashikuar 45 ditë
---	--	---

1. Hartimi i specifikimeve teknike:

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të Tonerëve dhe Bojërave të Printerit janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për hartimin e specifikimeve teknike është ngritur grupi i punës me specialistë të fushës, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.6, datë 03.03.2020. Në përfundim ky grup me shkresën nr.487/1, datë 09.03.2020 ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike të shërbimit.

2. Llogaritja e vlerës Limit të Kontratës (fondi limit):

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.18, datë 18.03.2020, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës limit të kontratës. Grupi i punës, ka testuar tregun dhe i ka dërguar “kërkesë për ofertë”, duke i bashkangjitur edhe specifikimet teknike 4 operatorëve ekonomik, si më poshtë:

-OE, “P.”, i cili ka dërguar ofertën në vlerën 63,999,650 lekë

-OE, “E. O.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 79,146,500 lekë;

-OE, “K.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 61,890,300 lekë,

-OE, “I. T.” i cili ka dërguar ofertën në vlerën 60,034,800 lekë,

Bazuar në këto ofertat të marra, grupi i punës llogarit fondin limit, bazuar në ofertën me çmime më të ulët, të cilin e kishte dërguar operatori “I. T.” **në vlerën 60,034,800 lekë.**

3.Hartimi i Dokumenteve të Tenderit:

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të “Hapur”. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumente përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Në lidhje me hartimin dhe vendosjen në DT të kriterëve e veçanta kualifikuese, në datën 02.04.2020, OE “M. & D.” sh.p.k. ka bërë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor (AK) me të cilin kërkon modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. Konkretisht ka kërkuar të ndryshojë pika 2.3.8 “Kapacitetit teknike” të shtojcës 9, të DT, e cila përcakton se: “OE në orën dhe ditën e hapjes së tenderit duhet të paraqes fizikisht mostrat të mallit me kodet përkatëse të vulosura nga OE pjesëmarrës sipas tabelës të vendosur në shtojcën e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit. *Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara përbën kusht për s ‘kualifikim’.*”

Ky operator ka pretenduar se, vendosja e këtij kriteri është diskriminuese dhe favorizuese, dhe është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46, të LPP dhe nenin 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duke e argumentuar hollësisht dhe ka bashkëngjitur për referencë edhe një Vendim të KPP me nr. 803, datë 24.12.2019.

Nisur nga kjo ankesë, me shkresë të Titullarit të AK nr.635/5., datë 03.04.2020, është pezulluar procedura e prokurimit dhe është ngritur komisioni përkatës për shqyrtimin e kësaj ankesë me përbërje: B. Dh., E. T. dhe K. C.. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni ka dalë në konkluzionin se, pretendimet e paraqitura në ankesë nuk qëndrojnë dhe me shkresë të Titullarit të AK nr.635/8, datë 06.04.2020, është njoftuar ankuesi OE “M. & D.”.

-Në datën 17.04.2020, OE “M. & D.”, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si të ankesës së paraqitur pranë AK. Me Vendim nr. 354, Datë 17.04.2020, Komisioni i Prokurimeve Publike ka vendosur të mos e pranojë ankesën e OE “M.

& D.” për këtë procedurë dhe i jep AK lejen për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

-Po kështu, në datën 14.04.2020, OE “I. O.” kërkon sqarim pranë AK për kriteret e veçanta dhe konkretisht për, germën f, të pikës 2.3.6 të shtojcës 9 të DT, e cila përcakton se: *“Tonerat e printereve dhe fotokopjeve duhet të jene brenda afateve të skadencës dhe garancisë, te cilat duhet të jene te stampuara ne ambalazh. Nuk do te pranohet asnjë Toner pa ambalazhin përkatës”*. Për këtë, AK sqaron operatorin “I. O.” se, kjo kërkesë do të hiqet nga DT dhe me shkresën nr. 635/12, datë 24.04.2020 njofton APP për modifikimin e kësaj kërkesë (heqjen e saj nga DT)

-Gjithashtu, mbas shpalljes në datën 26.03.2020 të njoftimit të kontratës, edhe APP nëpërmjet emailit të datës 01.04.2020 i ka kërkuar AK (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njësisë së Prokurimit), ndryshimin e disa kriterëve të veçanta sepse nuk përmbushin parashikimet e pikës 1, të nenit 46, të LPP dhe nenin 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duke cenuar kështu edhe kërkesat e nenit 20 të LPP, për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomik, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Konkretisht:

Në pikën 2.3.6. nënpika c), AK ka kërkuar: OE, të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë:

c) Tonerat do të jenë bojra origjinale, me vulë origjinaliteti, të pahapura jo kompatibel dhe jo të rimbushura, të shoqëruara me pulle sigurie nga prodhuesi.

Në lidhje me përcaktimin e mësipërm APP sjell në vëmendje AK se, duke specifikuar “bojërat duhet të jenë kompatibel”, AK përcakton në mënyrë indirekte “markën e tonerëve apo /dhe të prodhuesit dhe kufizon ndjeshëm pjesëmarrjen e ofertuesve të cilët mundë të ofrojnë tonerë origjinalë, me pullë sigurie e jo të mbushur”.

Për sa më lartë AK, duhet të mbaje në konsideratë që në zbatim të nenit 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet me procesverbal.

AK fillimisht nuk ka marrë në konsideratë këtë rekomandimin të APP, dhe nuk ka bërë ndryshimin e kësaj kërkesë dhe me shkresën e datë 01.04.2020 i ka dërguar në APP informacioni me argumentimin përkatës, përse nuk ndryshon kërkesën. Por, gati rreth 1 muaj më vonë, AK ka marrë në konsideratë pjesërisht rekomandimet e APP dhe me shkresën nr.7 datë 07.05.2020 e ka njoftuar për ndryshimin e kësaj kërkesë dhe të disa specifikimeve teknike të tonerëve si dhe shtyrjen e afatit të hapjes së ofertave për në datën 13.05.2020.

Pra, AK ka ndryshuar DT vetëm për rekomandimet e APP dhe nuk ka ndryshuar edhe kërkesën e bërë në ankesën e operatorit “M. & D.” për ndryshimin e pikës 2.3.8, “Kapacitetit teknike” të shtojcës 9, të DT, pasi kjo kërkesë është lënë e pa ndryshuar me Vendimin e KPP nr. 354, Datë 17.04.2020.

Përveç sa më sipër, nga auditimi mbi argumentimin dhe ligjshmërinë e përcaktimit e kriterëve të veçanta u konstatua se dhe, dy nga kriteret e veçanta kualifikuese janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 4 dhe germës b të pikës 5 të nenit 27 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT në shtojcën 9, në pikat 2.2.1 dhe 2.3.1 është kërkuar që:

-OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Ndërsa sipas dispozitave të sipërcituara kërkohet që:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe,

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose, kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kriterëve që, kërkon xhiron mesatare vjetore (2017, 2018, 2019) me vlerë jo me pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo me pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jene mbi 40% të vlerës që prokurohet. Pra, vendosja e këtij kufiri është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

Për gjithçka më sipër, arrihet në përfundimin se, disa kriterë të veçanta, nuk janë hartuar në mënyrë të qartë dhe të saktë sipas kërkesave të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, dhe nuk përmbushin parashikimet e pikës 1, të nenit 46, të LPP, duke cenuar kështu edhe kërkesën e nenit 20 të LPP që: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj tyre....”. Këto kriterë janë bërë shkak që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave teknike, të shkualifikojë një operatorë pikërisht për paqartësi në përmbushjen e pikës 2.3.8 “Kapacitetit teknike” të shtojcës 9, të DT, e cila përcakton se: “OE në orën dhe ditën e hapjes së tenderit duhet të paraqes fizikisht mostrat të mallit me kodet përkatëse të vulosura nga OE pjesëmarrës sipas tabelës të vendosur në shtojcën e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit (më poshtë po trajtojmë zhvillimin e procedurës së prokurimit).

4. Zhvillimi i procedurës së prokurimit:

Në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 13.05.2020 kanë marrë pjesëmarrës 2 OE:

-OE “I. O.”, i cili ka paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 38,597,810.82 lekë, pa TVSH, ose 35.7 %, më të ulët se, fondi limit;

-OE, “E. C.” i cili ka paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 47,130,000 lekë, pa TVSH, ose 21.5 %, më të ulët se, fondi limit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, mori në shqyrtim ofertat teknike të të dy operatorëve dhe në përfundim me njoftimin e klasifikimit të datës 27.05.2020 ka njoftuar operatorët pjesëmarrës se:

-OE “E. C.”, me ofertën ekonomike në vlerën 47,130,000 lekë është kualifikuar dhe është shpallur fitues;

-OE “I. O.”, me ofertën ekonomike në vlerën 38,597,810.82 lekë ose më të ulët se, operatori “E. C.” me diferencë 8,523,190 lekë, pa TVSH dhe 10,238,628 me TVSH, është s`kualifikuar. Sipas KVO, s`kualifikimi i këtij operatori është bërë për këto arsye:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush plotësisht kriteret e përcaktuara për kualifikim dhe konkretisht:

“Nuk plotësohet pika 2.3.8, sipas kërkesës në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në seksionin “Kapaciteti teknik” e DST. OE ka paraqitur fizikisht mostrat e mallit jo sipas kodeve përkatëse të kërkuara në shtojcën 10 të specifikimeve teknike, konkretisht për kodet:

-“Për artikullin me nr. rendor 14 është paraqitur mostra e bojës Part number 3480B012AA, ndërkohë që part number i kërkuar nga AK është 3480B002AA. KVO konstaton se mostra e paraqitur nuk është e njëjtë me atë të kërkuar, gjithashtu rezulton se OE po për këtë artikull në katalog ka paraqitur përshkrimin dhe fotografjin për bojën me Part number 3480B002AA ndërkohë si mostër është paraqitur një bojë e ndryshme nga ajo e paraqitur në katalog. Konkluzioni është se mostra e paraqitur është e ndryshme nga ajo e deklaruar në katalog. Gjithashtu, referuar akt dorëzimit nga vetë OE për mostrat e paraqitura rezulton se: në akt dorëzimin nga vete OE është deklaruar që është dorëzuar mostër me part number

3480B002AA, dhe nga mostra fizike e kërkuar rezulton që nr part number i bojës është 3480B012AA, pra këto artikuj nuk janë me part number të kërkuar nga AK pra nuk janë të njëjtat. E thënë më qartë katalogët teknike dhe akt dorëzimi të deklaruar dhe nënshkruar nga vetë OE nuk përputhet part number me mostrën e sjellë nga vetë OE”.

-“Për artikullin me nr rendor 29 rezulton se janë dorëzuar 4 mostra me kodet: Ct201381; Ct 201382; Ct 201383; Ct201384, ndërsa part number të kërkuara nga AK per artikullin me nr rendor 29 është si vijon: BK 593-10873; C 593-10876; M 593-10875; Y 593-10878, pra rezulton se bojrat e kërkuara nuk janë të njëjta me ato të dorëzuara. gjithashtu rezulton se në katalog ka paraqitur përshkrimin dhe fotografitë me kodet part number të kërkuara nga AK, dhe janë paraqitur part number të ndryshëm për këto bojra referuar mostrave fizike. Gjithashtu dhe në akt dorëzimin nga vetë OE është deklaruar sikur janë dorëzuar mostra me part numberat si vijon: BK 593-10873; C 593-10876; M 593-10875; Y 593-10878, ndërkohë fizikisht OE ka sjelleë mostrat fizike me part number të ndryshëm nga ato që AK ka kërkuar Ct201381; Ct 201382; Ct201383; Ct201384, pra rezulton që këto artikuj me këto part number të sjellë nga OE nuk janë të njëjta me part number të kërkuara nga Ak, pra janë të ndryshme”. Për sa më sipër, në zbatim të nenit 53, pikës 3, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, rezulton që **oferta e operatorit ekonomik “I. O.” shpk nuk kualifikohet**”.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e këtij s`kualifikimi u konstatua se:

Në datën 01.06.2020 OE ankues “I. O.” ka paraqitur fillimisht ankesë pranë AK për këtë s`kualifikim, duke dhënë në mënyrë të përmbledhur këto argumente:

- “Lidhur me artikullin me nr. rendor 14 sqarojmë se të gjitha tonerat e markës Canon identifikohen nga kodi i bojës që është një dhe i vetëm dhe një numër prodhuesi OEM Number i cili është i ndryshëm në varësi të kohës së prodhimit, rajonit ku është prodhuar etj por që në asnjë rast nuk përjashtojnë njëra tjetrën. Në rastin konkret OEM Number 3480B012AA dhe OEM Number 3480B002AA janë alternativa të njëjta të të njëjtës bojë me kod 719H. Elementi më i sigurt që identifikon tonerin është kodi dhe ai është elementi i pandryshueshëm. Këtë dhe ju e keni pasur të qartë pasi në kërkesën tuaj për artikujt nr. 15,16,17,18,26,27 q ë janë gjithashtu tonera Canon keni vendosur edhe kodin e bojës respektivisht 725/728/712/EXV40/724H/718 edhe OEM number pra dhe ju vetë i keni konsideruar të barasvlershme të dy të dhënat.

Për artikullin nr.14 kodi i bojës është 719H. Ne kemi paraqitur mostër pikërisht tonerin me kod 719H ashtu sikurse edhe operatori tjetër. Toneri i paraqitur ka të shprehur shumë qartë gjithashtu edhe prodhuesin që është Canon modelin e printerit për të cilin përdoret dhe kapacitetin është High capacity. Pra jemi në kushtet e bojërave tërësisht identike nga i njëjti prodhues me të njëjtin numër kopjesh me të njëjtin kod prodhuesi 719H. Nuk kuptojmë se përse duhet të bëjë përjashtim për gjykimin tuaj vetëm jo bojë , të mos konsiderohet kodi i bojës , ndërkohë që ju vetë e keni pranuar për të gjithë tonerat e tjerë Canon. Toneri Canon i paraqitur nga ana jonë është identik i njëjtë me atë që ju kërkonit dhe me atë që ka paraqitur operatori tjetër i kualifikuar nga ju.

Kemi paraqitur dhe deklaruar në dokumenta (katalog dhe akt dorëzimi) tonerin me kod 719H dhe kemi sjellë mostër pikërisht tonerin me kod prodhuesi 719H. Mostra e paraqitur nga ana jonë është identike me atë të deklaruar në katalog dhe në akt dorëzimi ku kemi deklaruar kodin e tonerit 719H. Duke qenë se këto tonera janë identike nuk mund të konsiderohet që tonerat e paraqitur në katalogun e paraqitur nga ana jonë janë të ndryshëm jo të njëjtë me ato të paraqitur mostër. Ata janë të njëjtë dhe plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të kërkuara nga ana juaj.

- Lidhur me pretendimin tuaj për tonerat DELL ju sqarojmë si më poshtë:

Edhe Dell sikurse shumë prodhues të tjerë pajisjesh (Canon, Oki, Xerox etj) vendos kode të ndryshme për tregëtim në rajone të ndryshme të të njëjtit toner me të njëjtat karakteristika të prodhuara nga i njëjti prodhues dhe që nuk përjashtojnë njëra tjetrën. Konkretisht për printerin tuaj Dell 7130CDM prodhohen tonera me kodet ekuivalente psh për ngjyrën Cyan 59310876/J5YD2/CT201382/59310876/4C8RP (bashkëngjitur dokumentet argumentuese.

Pra është shumë e qartë që kutitë me secilin nga këto numra përmbajnë bojëra identike me të njëjtat karakteristika të prodhuara nga i njëjti prodhues me të njëjtin numër kopjesh . Edhe në vetë kutinë e tonerit shkruhen qartë këto të dhëna pra prodhuesi Dell printeri për të cilin përdoren 7130CDM numri i kopjeve pikërisht i njëjtë me atë të kërkuar nga institucioni juaj. Në këto kushte toneri i paraqitur nga ne në katalog është tërësisht i njëjtë me atë të dorëzuar si mostër dhe nuk mund të quhet kurrsesi i ndryshëm sipas pretendimit tuaj.

Lidhur me tonerat e këtij printeri ju kujtojmë gjithashtu që kompania I. O. si mostër ka paraqitur tonera identikë , edhe në part number , me tonerat e paraqitura nga operatori i kualifikuar nga ana juaj me të vetmin ndryshim që operatori E. ka modifikuar ambalazhin e prodhuesit dell duke i vendosur një etiketë të ngjitur mbi kuti me të dhënat që përfshinin dhe kodin e kërkuar nga ana juaj. Në rastin më të mirë këtë veprim të operatorit E. mund ta quajmë përpjekje për tju bërë të ditur ekuivalencën e dy kodeve por kjo s'mund të jetë kurrsesi një arsye që tonerat tonë të quhen jo të njëjtë me kërkesën tuaj ndërsa tonerat e operatorit E. C. shpk të quhen të njëjta me kërkesën tuaj. Kemi paraqitur të dy operatorët identikë të njëjtat tonera që ka prodhuar Dell dhe ne skualifikohemi ndërsa E. kualifikohet vetëm dhe vetëm sepse ka manipuluar ambalazhin e prodhuesit Dell. Si ka mundësi që për operatorin E. të lexohen kodet e një etikete të ngjitur sipër kutisë kur ishin shumë të qarta edhe kodet e printuara në ambalazh nga prodhuesi Dell, kode identike të njëjta me ato të paraqitura nga ana jonë??. Bashkëngjitur foto argumentuese.

Përse janë vendosur dy standarde vlerësimi ndërkohë që kemi paraqitur identik të njëjtat mostra???

Part Number Ct201381, Ct201382, Ct201383, Ct201384 janë ekuivalente me BK 59310873, C 593-10876, M 593-10875, Y 593-10878 që do të thotë të dy part number bëjnë për të njëjtën pajisje ,janë tonera origjinale të prodhuesit të pajisjes , printojnë të njëjtin numër fletësh dhe këtë është përpjekur ta bëjë edhe operatori tjetër i kualifikuar duke ndryshuar ambalazhin origjinal të prodhuesit duke vendosur etiketë me të dhëna shtesë sic është edhe kodi i kërkuar nga ana juaj duke bërë kështu një manipulim të ambalazhit origjinal të prodhuesit që përbën një shkelje ligjore. (bashkëngjitur dokumente verifikuese.

Nuk ka asnjë ndryshim mes kodeve ekuivalente , janë të njëjta në çdo aspekt prandaj nuk qëndron arsyetimi që toneri i paraqitur si mostër nuk është i njëjti me tonerin e paraqitur në dokumentacion pasi janë ekzaktësisht të njëjta dhe për më tepër ekzaktësisht të njëjta me tonerat e paraqitura nga OE i kualifikuar nga ana juaj por ndryshe nga ai ekzaktësisht siç janë prodhuar nga prodhuesi dell dhe jo të manipuluar. Specialistët tuaj mund dhe duhet të verifikojnë nëpër site-et zyrtare në internet të gjithë argumentet tona për tu bindur për vërtetësinë e sa më sipër. Vetëm një përpjekje minimale e komisionit të vlerësimit dhe specialistëve tuaj IT (që është dhe detyrim ligjor i tyre), mund ti kursejnë institucionit tuaj dhe të shtetit një vlerë të tillë të konsiderueshme prej rreth 10 milion lekë të reja. Me skualifikimin tonë Posta Shqiptare do të furnizohet ekzaktësisht me të njëjta tonera por me një vlerë shumë më të lartë një diferencë prej rreth milion lekë.

Në këto kushte në bazë të nenit 46 dhe 53 të LPP kërkojmë nxjerrjen e një klasifikimi të ri ku oferta jote të klasifikohet e rregullt sepse kemi plotësuar të gjitha kërkesat e procedurës dhe nuk ka pasur asnjë mungesë në mostra, të gjitha mostrat plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në tender dhe skualifikimin e operatorit E. shpk për modifikim të ambalazhit të prodhuesit në mostrat e tonerave të pajisjes Dell 7130CDM”.

Me urdhër të Titullarit të AK nr.635/16, datë 02.06.2020 është pezulluar procedura e prokurimit dhe është ngritur komisioni për shqyrtimin e kësaj ankese i përbërë nga: E. K., E. T. dhe E. T.. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni ka dale me konkluzionin se, pretendimet e paraqitura në ankesë nuk pranohen dhe me shkresën nr.635/18 datën 08.06.2020 të Titullarit të AK, është njoftuar OE ankues “I. O.”.

Në datën 17.06.2020 OE ankues ka paraqitur ankesë pranë KPP me të njëjtin objekt ankese, dhe me shkresës nr. 635/21, datë 24.06.2020, AK ka dërguar informacion në KPP për procedurën e prokurimit. Në përfundim të shqyrtimit në themel të ankesës, KPP në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar si më poshtë:

“Në kushtet kur AK ka s`kualifikuar ankuesin vetëm për shkak të mospërputhjes së kodit të bojës pavarësisht se ajo është e prodhuar nga i njëjti prodhues, përmban të gjitha elementët e sigurisë të kërkuar në dokumentuat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, në asnjë rast nuk pohohet dhe as provohet me fakte mungesa e origjinalitetit të bojës të dorëzuar nga OE “I. O.”, në asnjë rast nuk pohohet se boja e paraqitur nga ankuesi nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, për të gjitha këto arsye s`kualifikimi i operatorit ekonomik “I. O.” nga AK në vlerësimin e Komisionit mbetet sipërfaqësor dhe i pabazuar.

“Për AK është e rëndësishme të përfitojë një produkt në përputhje me specifikimet teknike dhe në rastin konkret nuk provohet se produkti i paraqitur nga OE “I. O.” shpk nuk përmbush ndonjë nga elementët e specifikimeve teknike të kërkuara nga AK në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi”.

Sa më sipër KPP me Vendim Nr. 377/2020 datë 14.09.2020 vendosi:

-Të pranojë ankesën e paraqitur nga OE “I. O.” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje Tonera, Bojëra Printeri” me fond limit 60.034.800 lekë pa TVSH.
-Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi s`kualifikimin e OE “I. O.”, duke e kualifikuar atë.

Në vijim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të pikës 2, të VKPP nr. 377, datë 14.09.2020, mori në rishqyrtim ofertën e operatorit ekonomik “I. O. duke e kualifikuar operatorin për përmbushjen e pikës 2.3.8.

Më pas, KVO verifikoi ofertën ekonomike të paraqitur me vlerë 38,597,810.82 lekë pa TVSH, e cila mbas llogaritjeve rezultoi ofertë anomalish e ulët. Për këtë në datën 17.09.2020 nëpërmjet sistemit elektronik të APP, i ka kërkuar këtij operatori sqarim për ofertë anomalish të ulët. Në datën 22.09.2020 operatori “I. O.” ka paraqitur në AK, sqarimin për argumentimin e çmimeve të ofertës duke e shoqëruar me dokumentacionin përkatës. KVO, mori në shqyrtim këtë dokumentacion e konstatoi se, disa kontrata nuk kanë zëra furnizimi të njëjtë me zërat e preventivit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe disa kontrata nuk kanë të bashkëlidhur preventivin, faturën tatimore ose aneksin e kontratës me qëllim krahasimin e çmimeve për zëra furnizimi të ngjashme. Në përfundim të shqyrtimit në datë 29.09.2020, doli me konkluzionin se OE “I. O.” nuk e argumenton ofertën e tij anomalish të ulët dhe e s`kualifikon nga procedura e prokurimit dhe bënë edhe njëherë rivlerësimin e ofertave me këtë renditje përfundimtare:

Vendi i parë: OE “E. C.” me ofertë ekonomike 47,130,000 lekë, pa TVSH.

Në datë 05.10.2020, OE “I. O.” ka paraqitur ankesë panë AK , duke pretenduar që është s`kualifikuar padrejtësisht. Me urdhër të Titullarit të AK nr.635/31, datë 07.10.2020 përsëri është pezulluar procedura e prokurimit dhe është ngritur komisioni për shqyrtimin e kësaj ankese i përbërë nga: E. K., E. T. dhe E. T. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni ka dale me konkluzionin se, pretendimet e paraqitura në ankesë nuk pranohen dhe me shkresën e Titullarit të AK nr.635/33, datë 12.10.2020, është njoftuar OE ankues “I. O.”.

Në datën 19.10.2020 OE ankues ka paraqitur ankesë pranë KPP me të njëjtin objekt ankese. KPP me vendimin nr.1313/1, datë 23.10.2020 ka vendosur pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin në themel të ankesës. AK, me shkresës nr. 635/35, datë 30.10.2020, i ka dërguar informacion KPP për procedurën e prokurimit. Në përfundim të shqyrtimit në themel të ankesës, KPP ka gjykuar dhe arsyetuar se, nga operatori janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që të argumentojë ofertën anomalish të ulët duke krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme, dhe me Vendimin nr. 600, datë 24.12.2020 ka vendosur:

-Të pranojë ankesën e operatori “I. O.”;

-AK të anulohet vendimin e KVO për s`kualifikimin e OE “I. O.” dhe të korrigojë shkeljet duke e kualifikuar këtë OE.

Në vijim, KVO në datën 05.01.2021, në zbatim të pikës 2, të VKPP nr. 600, datë 24.12.2020, mori në rishqyrtim ofertën e operatorit ekonomik “I. O.” sh.p.k. duke e kualifikuar atë dhe në përfundim të rivlerësimit, bëri këtë renditje përfundimtare:

Vendi i parë: OE “I. O.” me ofertë ekonomike 38,597,810.82 lekë, pa TVSH;

Vendi i dytë: OE “E. C.” me ofertë ekonomike 47,130,000 lekë, pa TVSH.

Për këtë rivlerësim dhe kualifikim të OE “I. O.”, në datën 11.01.2021 tjetër, OE “E. C.” ka paraqitur ankesë pranë AK, duke dhënë edhe argumentet përkatëse. Me shkresë nr. 635/42, datë 13.01.2021, AK i kthen përgjigje operatorit ankuesit se, AK do të zbatojë Vendimin e KPP nr. 600, datë 24.12.2020 dhe referuar pikës 5 të këtij vendimi që, ju mund ti drejtoheni Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Në përfundim të kësaj procedure kaq të gjatë, AK me formularin e njoftimit të fituesit nr.635/43, datë 26.01.2021, ka njoftuar OE “I. O.” se, është shpallur fitues i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Tonera, Bojëra Printeri” me ofertë ekonomike në vlerën 38,597,810.82 lekë, pa TVSH. Me datë 15.02.2021 është lidhur kontrata e furnizimit me nr.635/46, midis Postës Shqiptare dhe OE “I. O.”, **me vlerë 46,317,372.98 lekë, me TVSH.**

Për gjithçka çfarë u trajtua më sipër, dalim në konkluzionin se:

AK, në kundërshtim me parashikimet e neneve 20 dhe 46 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ka hartuar dhe kërkuar në DT, disa kritere të veçanta në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik të cilat janë bërë shkak që, KVO gjatë shqyrtimit të ofertave teknike, të s`kualifikojë një operatorë i cili ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se, operatori tjetër pjesëmarrës me diferencë **10,238,628 lekë me TVSH.** Për pasojë, ky operatorë ka bërë disa ankime pranë AK dhe KPP, dhe për këtë arsye procesi i realizimit të kësaj procedure është tej zgajtur nga data 26.03.2020 e shpalljes së kontratës dhe ka përfunduar gati rreth 1 vit më vonë me lidhjen e kontratës së furnizimit në datën 15.02.2021. Pa harruar edhe faktin që Vendimi të KPP nr. 600, datë 24.12.2020, ka eliminuar shkeljet e procedurës së prokurimit dhe dëmin ekonomik që mund ti shkaktohej Postës Shqiptare në vlerën 10,238,628 lekë.

Si përfundim nga këto veprime është cenuar, qëllimi i ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të parashikuar në pikën 2 të nenit 1, që është:

-Rritja efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik; sigurimi për mirë përdorim e fondeve publike dhe për uljen e shpenzimeve procedurale; nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik; nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë; trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik; sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurën e prokurimit publik.

Ngarkohen me përgjegjësi: Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare z. L. D.; Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me përbërje: znj. V. K., z. A. S. dhe z. E. P.; Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje: z.H. B., z.K. B., dhe z. M. Z.; Komisioni për shqyrtimin e

2 ankesave të operatorit “I. O.” për skualifikimin e tij, me përbërje: z. E. K., z. E. T. dhe z.E. T..

Posta shqiptare me shkresë nr.1667/66 datë 11.01.2022 ka kthyer Projektraportin sebashku me observacionet përkatëse, të Anëtarëve të Njësisë së Hartimit të DT, Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarëve të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave. Këto bbservacionet kanë hyrë në KLSH me nr.877/333 prot, datë 12.01.2022.

Nga shqyrtimi i tyre rezultoi se, këto observacione kanë të njëjtën tekst dhe të njëjtin trajtim dhe janë të njëjta dhe përsëritje të observacioneve të bëra për aktkonstatimin e mbajtur, të cilave i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në projektraport se, ato nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë.

6.Titulli i gjetjes: Hartimi dhe vendosja e kriterëve të veçanta kualifikuese në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

Situata: Të shtrirë në vitin 2020 dhe vitin 2021, Posta Shqiptare ka realizuar procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Tонера, Bojëra Printeri”, me fond limit 60,034,800 lekë. Në tenderin e zhvilluar në datën 13.05.2020, kanë marrë pjesë 2 operatorë: OE “I. O.”, me ofertën ekonomike në vlerën 38,597,810.82 lekë, pa TVSH, ose 35.7%, më të ulët se fondi limit dhe OE “E. C.” me ofertën ekonomike në vlerën 47,130,000 lekë, pa TVSH, ose 21.5 %, më ulët se fondi limit. U konstatua se, Autoriteti Kontraktor (AK) në kundërshtim me parashikimet e neneve 20 dhe 46 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka kërkuar dhe vendosur në DT, disa kriterë të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk janë hartuar në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen dhe nuk janë konform rregullave të prokurimit publik. Një prej këtyre kriterëve është dhe kërkesa që: *“OE në orën dhe ditën e hapjes se tenderit duhet të paraqes fizikisht mostrat të mallit me kodet përkatëse të vulosura nga OE pjesëmarrës sipas tabelës të vendosur në shtojcën e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit dhe mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara përbën kusht për s’kualifikim”*. Pikërisht kjo kërkesë është bërë shkak që, KVO gjatë shqyrtimit të ofertave teknike të 2 operatorëve pjesëmarrës, ka s’kualifikuar OE “I. O.” i cili ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori tjetër, me diferencë **10,238,628 lekë me TVSH**. Për pasojë, OE “I. O.”, ka bërë disa ankime pranë AK dhe KPP, dhe për këtë arsye procesi i realizimit të kësaj procedurë është tej zgjatur, gati rreth 1 vit (ka filluar me shpalljen e kontratës për prokurim në datën 26.03.2020 dhe ka përfunduar me lidhjen e kontratës së furnizimit në datën 15.02.2021). Veprime apo mosveprime këto që, kanë cenuar, qëllimin e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të parashikuar në pikën 2 të nenit 1, që është: *“Rritja efiçencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik; sigurimi për mirë përdorimin e fondeve publike dhe për uljen e shpenzimeve procedurale; nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë; nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë; trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit; sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurën e prokurimit publik”*. Pasojat e kësaj parregullsie janë shmangur nga KPP, e cila me Vendimin nr. 600, datë 24.12.2020, ka vendosur kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE “I. O.”, duke eliminuar kështu, shkeljet dhe dëmin ekonomik që mund ti shkaktohej Postës Shqiptare në vlerën 10,238,628 lekë.

Kriteri: Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ndikimi/Efekt: S’kualifikim të një OE nga procedura e prokurimit.

Shkaku: Hartimi dhe vendosja e kriterëve të veçanta kualifikuese në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Posta Shqiptare sh.a, në të gjitha procedurat e tjera të prokurimeve, duhet të mbajë parasysh faktin që, kriteret e veçanta të kualifikimit, të hartohen konform rregullave të prokurimit publik, të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet dhe të sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

7.Titulli i gjetjes: Hartimi dhe vendosja e kriterëve të veçanta kualifikuese në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

Situata: Në të 6 procedurat e prokurimit të mirëmbajtjes së sistemeve Eterna, në 3 procedurat e prokurimit të mirëmbajtjes së Data Center dhe në procedurën e prokurimit për blerjen e tonerëve dhe bojërave te printerit, të trajtuar më sipër, konstatohet se: dy nga kriteret e veçanta kualifikuese që kanë lidhje me përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik, janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b, të pikës 4, të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT të çdo procedure është kërkuar që: “OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet”; “OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore të tre viteve të fundit me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet”. Pra vendosja e kufirit 39% për përmbushjen e këtyre kërkesave, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jete mbi 40% të vlerës që prokurohet, në kundërshtim kjo me dispozitat e sipërcituara të cilat përcaktojnë se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit dhe në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”;

“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon, kopje të deklaratave të xhiros vjetore, dhe në çdo rast, vlera e kërkuar nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

Kriteri: Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ndikimi/Efekti: Krijon keq interpretime dhe konfuzion në plotësimin e kërkesave nga operatorët ekonomik dhe në shqyrtimin e ofertave teknike nga KVO

Shkaku: Hartimi dhe vendosja e kriterëve të veçanta kualifikuese jo sipas kërkesave të rregullave të prokurimit publik

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, në të gjitha procedurat e tjera të prokurimeve, duhet të mbajë parasysh faktin që, për përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen dhe të jenë në përputhje dhe brenda kufijve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

Posta shqiptare me shkresë nr.1667/66 datë 11.01.2022 ka kthyer Projektraportin sebashku me observacionet përkatëse të cilat janë protokolluar në KLSH me nr.877/333 datë 12.01.2022. Ish Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare nuk ka paraqitur observacione për 6 procedurat e prokurimit për “Mirëmbajtjen e sistemeve te Eternës”, për procedurën e prokurimit për “Mirëmbajtjen e Data Center” dhe procedurën e prokurimit për “Blerje Tonerë, Bojërë Printerit”. Për çka është trajtuar në projektraport dhe me lartë në këtë Raport grupi i auditimit ka mbajtur 8 Aktkonstatime nga nr.1. deri të nr.9, datë 19.11.2021 dhe ish Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare në datën 27.11.2021 ka paraqitur observacionet përkatëse për këto Aktkonstatime të cilat kanë hyrë në KLSH me nr. 877/31 prot, date 06.12.2021. Observacionet për Aktkonstatimet kanë ardhur në KLSH jashtë afatit ligjor të përcaktuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH e miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH

nr.63, datë 22.06.2020. Ndërkohe në mungesë të observacioneve, grupi auditimit në përfundim të afatit ligjor të dërgimit të tyre, përgatiti dhe hartoi Projektraportin e Auditimit dhe e ka përcjell në Postën Shqiptare me shkresë nr.877/32, datë 10.12.2021. Megjithatë grupi i auditimit mori në shqyrtim observacionet për Aktkonstatimet dhe në përfundim doli me këtë konkluzion:

-Observacionet për 6 aktkonstatimet për procedurat e prokurimit për “Mirëmbajtjen e sistemeve të Eternës” nuk hedhin poshtë konstatimet e auditimit por në thelb i pranojnë ato se, blerja e moduleve dhe shërbimi i mirëmbajtjes të sistemit Eterna është bërë monopol dhe është ekskluziv i vetëm i operatorit “H. S.”. Me këto observacione, nga njeri anë justifikohet se referuar Ligjit 9643, 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe Ligjit nr. 10296,08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nuk është përgjegjësia e Titullarit të Institucionit për hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e Dokumenteve të Tenderit dhe nga ana tjetër e justifikon mos marrjen në pronësi të kodit në burim dhe të së drejtës së autorit, me arsyetimin se, ka buruar nga kontrata e mirëmbajtjes nr.1069/7, datë 14.05.2014, dhe nga kontrata e tjera që janë lidhur në përfundim të saj, të cilat kanë të përcaktuar kushtin që: Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit”.

Siç tregojnë edhe vetë këto observacione Titullari i Institucionit ka pasur dijeni dhe është njohur me këtë problem, por nuk ka bërë përpjekje për ta zgjidhur problemin duke i kërkuar mirëkuptimin kontraktuesit të shërbimit dhe nëse nuk gjente zgjidhje duhet të kishte ndjekur rrugën ligjore duke ngritur padi në gjykata për heqjen nga kontrata të këtij kushte me qëllim marrjen në pronësi të Postës Shqiptare, të kodit në burim dhe të së drejtës së autorit.

-Observacionet për Aktkonstatimin për procedurat e prokurimit për “Mirëmbajtjen e Data Center” nuk hedhin poshtë konstatimet e auditimit por me këto observacione justifikohet se Autoriteti Kontraktor nuk ka marrë asnjë ankesë nga operatorët ekonomik në lidhje me vendosjen e kriterit të veçantë.

-Edhe observacionet për Aktkonstatimin për procedurat e prokurimit për “Blerje Tонера, Bojëra Printerit” nuk hedhin poshtë konstatimet e auditimit, por sqarojnë se KPP i ka analizuar dhe ka marrë vendimet përkatëse në lidhje me pretendimet e operatorëve si dhe vonesa e procedurës apo zgjatja e procedurës nuk ka ardhur për shkak të AK, por ka ardhur si pasojë e vendimmarrjeve të KPP.

II.2.2.4. Bazuar në tre kriteret mbi përzgjedhjen e Procedurave të Prokurimit dhe në kryqëzimin e të dhënave mbi këto kritere janë marrë për auditim procedurat e mëposhtme:

Viti 2019

- Procedura “Mirëmbajtje e Sistemit VOIP”, procedurë e hapur me fond limit 11,992,000 lekë pa TVSH dhe me ofertë fituese 11,280,000 lekë ta TVSH, O.E. “C. P.” Sh.p.k.;
- Procedura “Blerje Hibrid Mail”, procedurë e hapur me fond limit 175,122,553 lekë pa TVSH dhe me ofertë fituese 167,726,400 lekë pa TVSH, O.E. “S. C.” Sh.p.k.

Viti 2020

- Procedura “Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë”, procedurë e hapur me fond limit 28,505,600 lekë pa TVSH dhe me ofertë fituese 26,773,332 lekë ta TVSH, O.E. “I.s.s” sh.p.k.;
- Procedura “Blerje Palmar Profesional, Barkod Reader Me wireless, Lexues Barkodesh”, procedurë e hapur me fond limit 33,731,000 lekë pa TVSH dhe me ofertë fituese 32,821,000 lekë pa TVSH, O.E. “S. C.” Sh.p.k.;

- Procedura “Shërbim printimi dhe fotokopje”, procedurë e hapur me fond limit 1,936,000 lekë pa TVSH dhe me ofertë fituese 1,784,640 lekë pa TVSH, O.E. “S. C.” Sh.p.k.

Viti 2021

- Procedura “Blerje pajisje sigurie (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi DVR/NVR 4 kamera, 8 kamera, 16 kamera + instalim kabull, kanalim, adaptor, investim monitor, sisteme inteligjente sigurie 4 Ch dhe 8 Ch, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit”, procedurë e hapur me fond limit 50,194,820 lekë pa TVSH dhe me ofertë fituese 48,888,888 lekë pa TVSH, O.E. “I.s.s” Sh.p.k.;
- Procedura “Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 1 vit”, procedurë e hapur me fond limit 30,000,000 lekë pa TVSH dhe me ofertë fituese 27,878,892 lekë pa TVSH, O.E. “I. S.” Sh.p.k.

II.2.2.4.A. Zhvillimi i Procedurës “Mirëmbajtje Sistemit VOIP”

1.Përshkrimi i procedurës

Sistemi VOIP mundëson komunikimin telefonik me kosto zero ndërmjet punonjësve të shoqërisë. Gjithashtu nëpërmjet këtij sistemi mundësohet edhe komunikimi nga rrjeti i telefonisë fikse ose mobile me rrjetin e brendshëm të telefonisë së shoqërisë.

2.Specifikimet Teknike

Kohëzgjatja e mirëmbajtjes së sistemit VOIP do të jetë 2 vite (24 muaj)

Mirëmbajtja do të përfshijë shërbimet e poshtëshënuara

- Shërbim Helpdesk dhe Suport Teknik
- Riparim dhe Zëvendësim të pajisjeve centrale telefonike
- Ndërhyrje korrigjuese në largësi dhe në vend.

OE do të kryejë këto shërbime:

- Riparojë apo këmbëjë pjesë nga inventari i tij. Pjesët e riparuar apo këmbëra do të jenë tërësisht kompatibël me pajisjen ku ato përdoren.
- Dërgoje pjesët e riparuar apo ato të reja në vendndodhjen e pajisjes së defektuar brenda termave kohore të përcaktuara.
- Të kryejë procedurat e update software për sistemin telefonik apo pjesë të tij për të cilat mund të kryhet kjo procedure, në versionin e fundit të miratuar nga prodhuesi i pajisjeve.

3.Fondi Limit

Fondi limit në vlerën **11.992.000 lekë (pa TVSH).**

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e Sistemit VOIP”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 23 datë 17.06.2019	2. Lloji i procedurës së Prokurimit “ E hapur” me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: znj. L. M. znj. E. H. znj. B. Q.
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 110 datë 24.07.2019 znj. R. M. z. E. T. znj. B. Q.	5. Komisioni për përlogaritjen e fondit limit znj. E. H. znj. Q. H. znj. M. R.	7. Fondi limit (pa tvsh) 11.992.000 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 12.07.2019	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 23/1 datë 17.06.2019 z. V. A.(Kryetar) znj. V. K. (Anëtar) z. E. S.(Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës • “A.” sh.p.k. pa oferte • “C. P.” sh.p.k 11,280,000 • “A.” sh.p.k 11,640,000	8. Oferta fituese (pa tvsh) 11,280,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 712,000 lekë

b) skualifikuar: • “A.” sh.p.k • “A.” sh.p.k		
11. Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës nga APP
14. Lidhja e kontratës: Nr. 1702/9 datë 01.10.2019		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 2 vite Zbatuar 2 vite	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës Nr. 34/29 datë 20.05.2020 me 3 muaj Nr. 2187/31 datë 19.08.2020 me 2 muaj	21. 20. Akt i marrjes në dorëzim Komisioni: E. T. E. S. A. S.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi Analiza Veprime Furnitori gjeneruar datë 27.10.2021 likuiduar me periodicitet mujor.	16. Likuiduar deri datë 31.12.2020

Për sa më sipër është mbajtur **Akt konstatimi nr. 13** datë 19.11.2021, për të cilin janë paraqitur observacione me nr.1667/51 datë 10.01.2022 protokolluar në KLSH me nr. 877/33 prot. Datë 12.01.2022.

Pretendimi i subjektit:

Për gjetjen e parë në Akt Konstatimin nr. 13 ju shpreheni se mungojnë procesverbalet e monitorimit të ofrimit të shërbimit, ndërkohë sqarojmë se procesverbalet e monitorimit të ofrimit të shërbimit janë dorëzuar të plotë për çdo monitorim mujor në Drejtorinë e Financës dhe janë pjesë e dokumentacionit justifikues për likuidimin e kryer. Grupi i monitorimit të kontratës gjatë takimit me përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shteti ka dorëzuar vetëm 3 procesverbale dhe se nuk u është kërkuar apo të kenë qenë në dijeni se duhet të dorëzoheshin të gjitha procesverbalet. Dhe si rrjedhojë nuk i ka dorëzuar të gjitha procesverbalet me arsyetimin se një kopje e plotë e dokumentacionit për monitorimin e kontratës është dorëzuar në drejtorinë e financës.

Për gjetjen e dytë sqarojmë se grupi i monitorimit ja ka dorëzuar librat e historikut (Log Book) grupit të auditimit, gjithsesi do tja u vendosim në dispozicion bashkëlidhur objeksionit.

Për gjetjen e tretë ju shpreheni se mungon njoftimi me shkrim për listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes, pra në përmbajtje të nenit 10.6 njoftimi me shkrim do të bëhet në rast ndryshim të listës së pajisjeve dhe për sa kohë nuk ka ndryshim liste si rrjedhojë nuk është bërë dhe njoftimi me shkrim.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Bazuar në observacionin drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit me 1667/51 datë 10.01.2022 protokolluar në KLSH me nr. 877/33 prot. Datë 12.01.2022, grupi i auditimit mban qëndrimin si më poshtë:

Përsa i përket observacionit dërguar është i njëjti me observacionin drejtuar KLSH-së me nr.1667/41 datë 26.11.2021 protokolluar në KLSH me nr. 877/28 prot. Datë 01.12.2021, për të cilën personat përmendur në Akt Konstatim kanë marrë përgjigjen dhe sqarimet e nevojshme.

1. Titulli i gjetjes: Mungojnë procesverbalet e monitorimit të ofrimit të shërbimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, krahas faturës së shërbimit mungojnë procesverbalet e monitorimit të ofrimit të shërbimit nga ana e përfaqësuesit të “Posta Shqiptare” Sh.a dhe përfaqësuesit të Kontraktuesit, ashtu siç janë sjell për muajin Nëntor, Dhjetor 2019 dhe Janar, Shkurt, Mars 2020.

Kriteri: Nenin 5 i Kontratës me objekt “Mirëmbajtje Sistemi VOIP” nr.1702/9 datë 01.10.2019

Ndikimi/efekti: Risk për ofrimin e shërbimit në mënyrë optimale.

Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të mbajnë procesverbalet mbi monitorimin e ofrimit dhe cilësisë të shërbimit sipas kushteve të kontratës.

2. Titulli i gjetjes: Mungojnë librat e historikut (LogBook) për secilën pajisje.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, mungojnë librat e historikut (LogBook) për secilën pajisje në të cilën shënohen të gjitha veprimet e kryera mbi pajisje

Kriteri: Nenin 10 pika 6 të Kontratës me objekt “Mirëmbajtje Sistemi VOIP” nr.1702/9 datë 01.10.2019

Ndikimi/efekti: Risk për krijimin e anomalive gjatë përdorimit të pajisjeve.

Shkaku: Nuk janë bazuar në kushtet e specifikuar të kontratës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur që për secilën pajisje të shoqërohet me logbook-un përkatës sipas kushteve të kontratës.

3. Titulli i gjetjes: Mungon njoftimi me shkrim për listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes duke përfshirë sasinë, vendndodhjen e këtyre pajisjeve 90 ditë para fillimit të negociimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, mungon njoftimi me shkrim për listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes duke përfshirë sasinë, vendndodhjen e këtyre pajisjeve 90 ditë para fillimit të negociimit për rinovim të marrëveshjes së mirëmbajtjes pasi më datë 1.10.2021 ka përfunduar Kontrata e mirëmbajtjes së Sistemit VOIP.

Kriteri: Nenin 10 pika 6 të Kontratës me objekt “Mirëmbajtje Sistemi VOIP” nr.1702/9 datë 01.10.2019

Ndikimi/efekti: Risk mbi moskrijimin e vazhdimësisë së shërbimit duke u krijuar anomali të ndryshme gjatë ofrimit të shërbimit.

Shkaku: Neglizhencë mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur që 90 ditë para fillimit të negociimit për rinovim të marrëveshjes së mirëmbajtjes të bëjnë njoftimin me shkrim për ndryshimet në listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes.

4. Titulli i gjetjes: mungojnë raportet mujore që duhet të ishin sjellë nga O.E. ku parashtrohen të gjitha aktivitetet e realizuara në atë muaj edhe nëse nuk ka pasur problematika.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, mungojnë raportet mujore që duhet të ishin sjellë nga O.E. ku parashtrohen të gjitha aktivitetet e realizuara në atë muaj edhe nëse nuk ka pasur problematika, në kundërshtim me Nenin 10 pika 5 të Kontratës me objekt “Mirëmbajtje Sistemi VOIP” nr.1702/9 datë 01.10.2019

Kriteri: Nenin 10 pika 5 të Kontratës me objekt “Mirëmbajtje Sistemi VOIP” nr.1702/9 datë 01.10.2019

Ndikimi/efekti: Risk për ofrimin e shërbimi në mënyrë optimale.

Shkaku: Nuk janë përmbushur pikat e kontratës.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur që 90 ditë para fillimit të negociimit për rinovim të marrëveshjes së mirëmbajtjes të bëjnë

njoftimin me shkrim për ndryshimet në listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes.

II.2.2.4.B Zhvillimi i Procedurës “Blerje Hibrid Mail”

1.Përshkrimi i procedurës

Projekti “Hybrid Mail” synon të kthejë institucionin e Postës Shqiptare në një shërbim printimi me një ndalesë (One-stop-shop Printing) si:

- Fatura (Fatura shërbimesh utilitare si ujë, drita etj...)
- Materiale promocionale të personalizuar
- Materiale transaksionale + informacioni promocionale (fatura shërbimesh telekomunikacioni).

2.Specifikimet Teknike

- Zgjidhja duhet të ketë një modul vizual (GUI) për lidhjen e të dhënave (data mapping) dhe hartimin e dokumenteve.
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të nxjerrë të dhëna nga burime të ndryshme dixhitale, të modifikojë të dhënat, të dizajnojë dokumentet dhe të krijojë produktin final. I tërë procesi duhet të jetë i automatizuar sa më shumë që të jetë e mundur.
- Të ofrojë mundësi për të pasur mjedise të veçantë për Backup / Testim / Zhvillim.
- Të ofrojë mundësi printimi në çdo printer, pavarësisht nga licenca (pa pasur nevojë për license për printer).
- Të ofrojë mundësi raportimi të automatizuar që mund të miratohet për nevojat e blerësit.
- Skalabiliteti - të lejojë organizatën të rrisi performancën e prodhimit për të përpunuar një kërkesë më të lartë kur është e nevojshme. (OPTION)
- Arkitektura e klasterit duhet të mbështetet plotësisht. Arkitekturimi e serverit duhet të jetë e mundur (p.sh. instalimi i një pjese të ndryshme të sistemit në servera të ndryshëm).

3.Fondi Limit

Fondi limit në vlerën **175,122,553 lekë (pa TVSH).**

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje Hibrid Mail”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 34 datë 14.08.2019	2. Lloji i procedurës së Prokurimit “ E hapur” me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: z. N. L. (përgjegjës) z. K. B. (specialist) z. A. S. (specialist)
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 110 datë 24.07.2019 znj. B. Z. znj. F. Gj. z. K. B. z. E. P. z. A. S.	5. Komisioni për përlogaritjen e fondit limit znj. J. S. z. R. K. znj. A. K.	7. Fondi limit (pa tvsh) 175,122,553 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 13.09.2019	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 34/1 datë 14.08.2019 z. V. A. (Kryetar) z. E. S. (Anëtar) z. H. B. (Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës • “S. C.” sh.p.k. 174,715,000 • “E.” sh.p.k. Pa ofertë ekonomike • “A. PSP” sh.p.k. Pa ofertë b) skualifikuar: • “E.” sh.p.k. • “A. PSP” sh.p.k.	8. Oferta fituese (pa tvsh) 174,715,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 407,553 lekë
11. Ankimime AK “Inform Albania” sh.p.k. me nr. 2187 prot. Datë 26.08.2019	12. Përgjigje Ankesës Urdhër i brendshëm nr. 34/4 datë 27.08.2019 mbi shqyrtimin e ankesës.	13. Përgjigje Ankesës nga APP Përgjigje nr.1475/3 datë 04.10.2019

Ankimime KPP Datë 16.09.2019, nr.2187/7 prot. Ankimime Ministria e Financave Datë 07.10.2019 nr.2594	Përgjigje ankesës me nr.2187/6 datë 29.08.2019 drejtuar OE. Përgjigje drejtuar KPP nr. 2187/8 datë 18.09.2019 Përgjigje drejtuar MF nr.2594/1 datë 10.10.2019	Përgjigje Ankesës nga KPP Përgjigje nr.2187/10 datë 22.10.2019
14. Lidhja e kontratës: Nr. 2187/25 datë 20.01.2020		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 120 ditë Zbatuar ___ditë	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës Nr. 34/29 datë 20.05.2020 me 3 muaj Nr. 2187/31 datë 19.08.2020 me 2 muaj	21. 20. Akt i marrjes në dorëzim M. Z. R. Ll. R. N. A. G. A. B.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi Fatura nr. 130R datë 20.10.2021	16. Likuiduar deri dt 04.08.2021

Në zbatim të programit ekonomik të Shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. më datë 22.07.2019 është dërguar shkresa me lëndë “Kërkesë për fillimin e procedurës të Postës Hibride (Hibrid Mail)” drejtuar Titullarit të Institucionit z. L. D. nga Drejtori i Dep. të Zhvillimit të Standardeve z. V. A..

Në shkresën në fjalë janë listuar të gjitha veçoritë dhe benefitet e përdorimit të Hibrid Mail, por nuk është marrë parasysh një analizë Kosto-Përfitim dhe kjo për shkak se implementimi i një teknologjie të tillë ka një kosto të lartë ashtu siç tregohet dhe në vlerën e prokuruar që arrin në shumën 174,715,000 lekë pa TVSH.

Veçori tjetër është edhe kostoja e lartë e mirëmbajtjes e cila nuk është parashikuar si zë në hartimin e procedurës. Duke qenë se është implementim i një sistemi të ri, nëse do të bazoheshit në praktikën më të mira si dhe në Udhëzimin nr. 1159, datë 17.03.2014, pika 3, atëherë, duhet të ishte parashikuar MNSH-ja (Marrëveshja në Nivel Shërbimi), si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këto sisteme. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë ishte jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.

Aktualisht përfitimet nga përdorimi i Hibrid Mail vijnë vetëm nga Kontrata e lidhur me Ujësjellës Kanalizime Tiranë, mbi faturimin e abonentëve përdorues të ujit.

Për sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr. 13 datë 19.11.2021, për të cilin nuk janë paraqitur observacione mbi Projektraportin e Auditimit, në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Titulli i gjetjes: Nuk është kryer një analizë kosto-përfitim e projektit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, shpenzimet për projekte investimesh ku përfshihen shpenzimet kapitale në infrastrukturë, ku në këtë rast janë blerje e pajisjeve të mëdha teknologjike, në fazën e planifikimit buxhetor të shpenzimeve nuk është kryer një analizë kosto-përfitim e projektit për një menaxhim sa më efektiv të shpenzimeve.

Kriteri: Udhëzimi nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe praktikën më të mira.

Ndikimi/efekti: Përfitim i ulët në krahasim me kostot e implementimit të teknologjisë.

Shkaku: Mos menaxhimi në mënyrë eficiente i burimeve të njësisë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi planifikimin buxhetor të shpenzimeve të njësisë, në rastet kur vlera e shpenzimeve/investimeve është në vlera të larta, të kryejnë një analizë kosto-përfitim të shpenzimeve/investimeve në fjalë.

6. Titulli i gjetjes: Sistemi i Hibrid Mail është sistem i ri në fushën e TIK-ut dhe ka nevojë për mirëmbajtje.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, meqenëse Sistemi i Hibrid Mail është sistem i ri në fushën e TIK-ut dhe ka nevojë për mirëmbajtje, duhet të ishte parashikuar MNSH-në, si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këtë sistem si dhe kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet ishte jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.

Kriteri: Praktikrat më të mira dhe vendimi nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”*

Ndikimi/efekti: Ndërprerje e ofrimit të shërbimit nga anomalitë e ndryshme.

Shkaku: Mos rakordimi me praktikrat më të mira mbi menaxhimin e sistemeve të reja të TI.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikrat më të mira.

7. Titulli i gjetjes: Mungon Procesverbali mbi marrjen në dorëzim.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, me anë të urdhrit nr. 34/26 datë 23.01.2020 është ngritur Komisioni mbi marrjen në dorëzim të “Blerje Hibrid Mail”, por mungon Procesverbali mbi marrjen në dorëzim gjithashtu i cili shoqërohet dhe më një kolaudim mbi funksionimin e saj.

Kriteri: Nenin 14 të Kontratës së nënshkruar midis dy palëve me nr. 2187/25 datë 20.01.2020.

Ndikimi/efekti: Risk për ofrimin e shërbimi në mënyrë optimale.

Shkaku: Mos rakordimi me praktikrat më të mira mbi menaxhimin e sistemeve të reja të TI.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore.

II.2.2.4.C. Zhvillimi i Procedurës “Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë”

1.Përshkrimi i procedurës

Pas analizimit të kërkesave të filialeve për mbulimin e shërbimit të sigurisë me sisteme sigurie të zyrave postare dhe ambienteve të tjera të rëndësishme, të pa pajisura me këto sisteme, për rinovimin me sisteme të reja të atyre të vjetrave të cilat nuk plotësojnë standardet në rritje të perfeksionit teknik të tyre për regjistrime e vëzhgime të qarta e cilësore të pamjeve filmike.

2.Specifikimet Teknike

- Sistem Alarmi - 80 copë

Mënyrat e transmetimit

-GPRS dhe SMS

SMS ose TCP/IP(program I monitorimit)

- SENSORE ALARMI ME TELA - 128 copë

Sensor pyroelektrik me element të dyfishtë

- DVR 4 KANALE - 52copë

- DVR 8 KANALE - 9copë

- DVR për Automjetet(2 KAMERA SECILA) 12 COPE

- KAMERA PER BRENDA - 140 copë

- KAMERA PER JASHTE - 140 copë

- KAMERA PER AUTOMJETET - 24copë

- EKRAN për automjetet

- Karta memorie për sistemin e automjeteve

3.Fondi Limit

Fondi limit në vlerën **28,505,600 lekë (pa TVSH).**

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë"		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 20 datë 20.08.2020	2. Lloji i procedurës së Prokurimit " E hapur" me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: z. L. M.(përgjegjës) z. O. Dh. (specialist) z. Xh. H. (specialist)
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 31 datë 16.06.2020 z. B. B. z. O. Dh. z. Xh. H.	5. Komisioni për përlogaritjen e fondit limit znj. Zh. B. znj. E. C. znj. E. K.	7. Fondi limit (pa tvsh) 28,505,600 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 15.09.2020 shtyrje e afatit 26.10.2020	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 34/1 datë 14.08.2019 z. V. A.(Kryetar) z. E. K. (Anëtar) z. H. K. (Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës <ul style="list-style-type: none"> • "F. sh.p.k. 28,293,511 lekë • "A." sh.p.k. 28,373,196 lekë • "E." sh.p.k. 28,473,012 lekë • "I.S.S." sh.p.k. 27,888,888 lekë b) skualifikuar: <ul style="list-style-type: none"> • "F. sh.p.k. • "A." sh.p.k • "E." sh.p.k 	8. Oferta fituese (pa tvsh) 27,888,888 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 616,712 lekë
11. Ankime AK "A. B. S." sh.p.k. me nr. 1648/3 prot. Datë 27.08.2020 "A. B. S." sh.p.k. me nr. 1648/9 prot. Datë 14.09.2020 Ankime KPP Datë 16.09.2020, nr.1648/10 prot.	12. Përgjigje Ankesës Urdhër i brendshëm nr. 20/4 datë 28.08.2020 mbi shqyrtimin e ankesës. Përgjigje ankesës me nr.1648/6 datë 31.08.2020 drejtuar OE. Përgjigje drejtuar KPP nr. 1648/11 datë 21.09.2020	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Përgjigje nr.1648/12 datë 13.10.2020
14. Lidhja e kontratës: Nr. 1648/20 datë 26.01.2020		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 120 ditë Zbatuar ___ditë	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës	21. 20. Akt i marrjes në dorëzim B. B. A. G. Xh. H.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi Situacion me pagesë intervalore	16. Likuiduar deri datë

Gjatë kërkesës për fillim procedurash për realizimin e prokurimit me objekt "Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë" drejtuar Administratorit z. L. D., Drejtoria e Sigurisë dhe Cilësisë kërkon mbulimin me shërbimin e sigurisë me sisteme sigurie të zyrave postare të cilat nuk kanë qenë të pajisura më parë me këto sistemi si dhe rinovimin e disa zyrave postare të tjera të cilat kanë pasur sisteme të vjetra.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit AK ka përcaktuar që duhet të ketë kompatibiliteti me sistemet ekzistuese që janë kamerat Hik vision, sistemet e alarmit Messer GPRS dhe Radio, Sistemet GPS Meitrack. Meqenëse shumica nga sistemet e implementuara janë të reja, gjithashtu dhe rinovimi i këtyre sistemeve do të bëhen me produkte të reja, nuk duhet që të ketë kompatibilitet me sistemet ekzistuese, ndërsa përsa i përket kompatibilitetit me platformën e menaxhimit të sistemeve të alarmit e cila është KRONOS si dhe platformës së menaxhimit të sistemeve GPS MS03 është e drejtë pasi duhet të integrohen midis tyre.

Gjatë përlogaritjes së fondit limit i janë dërguar shkresat për oferta 3 subjekteve si:

“S.A.S” sh.p.k., “Sh. S. S. Sh.p.k” dhe “A.T.D.” sh.p.k.. Gjatë hulumtimit në internet vihet re se distributori i platformës KRONOS për Shqipërinë është subjekti “E.” sh.p.k. nga ku minimumi i kërkesës për ofertë duhet të ishte subjekti në fjalë, si dhe nga të tre subjektet që kanë sjell ofertat e tyre asnjë nuk është paraqitur në garë për procedurën në fjalë.

Për sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr. 14 datë 19.11.2021, për të cilin nuk janë paraqitur observacione mbi Projektraportin e Auditimit, në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8. Titulli i gjetjes: Nuk janë sqaruar qartë zërat mbi skicimet mbi instalimin e pajisjeve dhe pozicionet e tyre.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, gjatë hartimit të specifikimeve teknike nuk janë sqaruar qartë zërat mbi skicimet mbi instalimin e pajisjeve, pozicionet e tyre për të arritur më pas në caktimin e dy zërave si F.V. Kabull Alarmi dhe F.V. Kabull rg59 + Ushqimi.

Kriteri: Pika 3 Neni 11 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Pjesëmarrje e ulët dhe përlllogaritje jo e saktë e fondit limit.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe rregullative mbi hartimin e specifikimeve teknike.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, të bazohen në rregulloret dhe legjislacionin përkatës.

9. Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të veçanta që nuk lejojnë zhvillimin e një gare të barabartë.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, vendosja e kriterëve të veçanta që O.E duhet të ketë kompatibiliteti me sistemet ekzistuese që janë kamerat Hikvision, sistemet e alarmit Messer GPRS dhe Radio, Sistemet GPS Meitrack nuk lejon zhvillimin e një gare të barabartë, dhe duket një kriter diskriminues.

Kriteri: Nenin 20 dhe Nenin 23 pika 5 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Pjesëmarrje e ulët dhe zhvillimi i një gare jo të barabartë.

Shkaku: Vendosja e kriterëve diskriminuese.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.

II.2.2.4.D. Zhvillimi i Procedurës “Blerje palmar profesional, barkod reader me wireless, lexues barkodesh”

1. Përshkrimi i procedurës

Blerja e pajisjeve do të shërbejë për kryerjen në mënyrë elektronike dhe automatike të disa shërbimeve të rëndësishme për institucionin si në terren ashtu edhe në sportele. Blerja e këtyre pajisjeve ul kostot operative dhe rrit performancën duke ofruar një pjesë të shërbimeve në mënyrë elektronike dhe të automatizuar.

2. Specifikimet Teknike

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
-----	------------	--------	-------

1	Palmar professional	Copë	300
2	Barkod reader me Wireless	Copë	20
3	Lexues barkodesh	Copë	250

Software duhet të jetë i përfshire dhe të ofrojë mundësinë e menaxhimit të të dhënave dhe të lejoj transmetimin e tyre nga programi në palmar dhe anasjelltas.

Palmaret duhet të ofrojnë mundësinë e ndryshimit/përshtatshmërisë të menuesë, opsioneve duke krijuar kështu politika specifike të përdorimit të pajisjeve nga përdorues. Për këtë qëllim prodhuesi duhet të ofroj një software i cili i jep mundësinë administratorit, të bëjë ndryshimet e nevojshme të parametrave si më poshtë:

- Karakteristika të pajisjes (Device Settings)
- Update i sistemit te operimit (OS Update)
- Instalim programesh (APK, Licence, etj.)
- Të hapë programet. (Run on APP)
- Të ofroj mundësinë e modifikimit të dokumenteve. (Modify, Create, Rename, Copy, Delete File or Directory)
- Të menaxhoj karakteristika të rrjetit (Network management)

3.Fondi Limit

Fondi limit në vlerën **33,731,000 lekë (pa TVSH)**

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt <i>“Blerje palmar profesional, barkod reader me wireles, lexues barkodesh”</i>		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 26 datë 16.09.2020	2. Lloji i procedurës së Prokurimit “ E hapur ” me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: z. V. K. (përgj.) z. A. K. (specialist) z. B. Dh. (specialist)
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 29 datë 12.06.2020 z. A. K. z. M. Z. znj. B. Dh.	5. Komisioni për përlogaritjen e fondit limit znj. Zh. B. znj. M. S. znj. E. K.	7. Fondi limit (pa tvsh) 33,731,000 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 12.10.2020	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 34/1 datë 14.08.2019 z. V. A.(Kryetar) z. E. K. (Anëtar) z. H. K. (Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës • “S. C.” sh.p.k. 32,821,000 lekë • “A.” sh.p.k. 28,373,196 lekë • “S. A.” sh.p.k. 29,800,000 lekë • “I.S.S.” sh.p.k. 33,000,000 lekë b) skualifikuar: • “F. sh.p.k. • “A.” sh.p.k. • “E.” sh.p.k	8. Oferta fituese (pa tvsh) 32,821,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 910,000 lekë
11. Ankime AK ska	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës nga KPP
14. Lidhja e kontratës: Nr. 1840/8 datë 21.11.2020		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 45 ditë Zbatuar ___ditë	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës me 35 ditë	21. 20. Akt i marrjes në dorëzim E. P. K. H. A. K.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi Faturë nr. 85/2021 datë 27.01.2021	16. Likuiduar deri datë

Për sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr. 14 datë 19.11.2021, për të cilin janë paraqitur observacione me nr.1667/62 datë 10.01.2022 protokolluar në KLSH me 877/33 datë 12.01.2022

Pretendimi i subjektit:

Ju sqarojmë se:

Në zbatim të Urdhërit të Brëndshëm Nr 1840/11 date 01.12.2020, komisioni i përbërë nga Z. E. P., Znj. A. K., Z. K. H., për marrjen në dorëzim të "Blerje Palmar Profesional, Barkod Reader me Wireles, Lexuesh Barkodesh" në zbatim të kontratës 1840/8 date 21.11.2020 ka marrë në dorëzim malli me objekt prokurimi dhe si rrjedhojë ka përpiluar procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit në përputhje me dispozitat e kontratës dhe konkretisht nenit 12 "Kushtet e dorëzimit". Gjithashtu sqarojmë se dhe në momentin e dorëzimit të procesverbalit dhe dokumentacionit shoqërues nga drejtoria e financës nuk kemi patur kontestime mbi mungesa mbi dokumentacionin e dorëzuar dhe se nga ana e kësaj drejtorie është vijuar dhe me likuidimin:

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Bazuar në Observacionin drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr.1667/62 datë 10.01.2022 protokolluar në KLSH me 877/33 datë 12.01.2022, grupi i auditimit mban qëndrimin si më poshtë:

Pas verifikimi të observacionit dhe dokumentacioni bashkëlidhur ekziston procesverbali i marrjes në dorëzim për procedurën në fjalë si dhe fatura elektronike por në procesverbalin e marrjes në dorëzim mungojnë elementët që vërtetojnë kolaudimin mbi funksionimin e saj. Observacioni qëndron pjesërisht.

10. Titulli i gjetjes: Brand i njohur Ndërkombëtar, kriter diskriminues.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, kriteri i veçantë nr.2.5 ku thuhet që produktet e ofruara duhet të jenë Brand i njohur Ndërkombëtar është kriter diskriminues.

Kriteri: Nenin 20 i Ligjit për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Pjesëmarrje e ulët dhe zhvillimi i një gare jo të barabartë.

Shkaku: Vendosja e kriterëve diskriminuesë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë, pasi në shpjegimin tuaj ky lloj kriteri do të plotësojë kërkesat e cilësisë, origjinalitetin e mallrave nuk qëndron sepse janë certifikatat ato që i japin këto attribute dhe jo emri.

11. Titulli i gjetjes: Mungon procesverbali mbi marrjen në dorëzim.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, Komisioni mbi marrjen në dorëzim të procedurës, nuk ka përpiluar procesverbalin mbi marrjen në dorëzim gjithashtu i cili shoqërohet dhe më një kolaudim mbi funksionimin e saj.

Kriteri: Neni 14 të Kontratës së nënshkruar midis dy palëve me Nr. 1840/8 datë 21.11.2020.

Ndikimi/efekti: Pjesëmarrje e ulët dhe zhvillimi i një gare jo të barabartë.

Shkaku: Risk për ofrimin e shërbimi në mënyrë optimale.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore.

II.2.2.4.E.Zhvillimi i Procedurës “Shërbim Printimi dhe fotokopje”

1.Përshkrimi i procedurës

Kryerja e printimeve dhe fotokopjeve me qëllim uljen e kostove të shërbimit të printimit dhe mirëmbajtjes së tyre

2.Specifikimet Teknike

- Postës Shqiptare Sh.a. duhet ti vihen në dispozicion nga Operatori Ekonomik (OE) minimalisht 25 (Njëzetë e pesë) printera multifunksional bardh e zi, të cilët duhet të plotësojnë minimalisht specifikimet e Tabelës së më poshtme.
- Për çdo pajisje, OE duhet të kryej pa kosto shtesë shërbimet e mëposhtme:
 - Zëvendësimin e pajisjes së defektuar ose riparimin e saj pa shkaktuar ndërprerje të shërbimit.
 - Zëvendësimin e të gjithë pjesëve të konsumueshme si p.sh Drum, Fuser etj.
- Defektet kritike që shkaktojnë ndërprerjen e shërbimit në një apo disa pajisje duhet të zgjidhen nga OE brenda 120 minutash pas raportimit të problemit, E Hënë-E Dielë 8:00-16:30.
- Defektet që nuk ndikojnë në aftësinë e pajisjes për të kryer shërbimin e printimit/fotokopjimit duhet të adresohen e të zgjidhen nga OE brenda dy ditësh. E Hënë-E Dielë 8:00-16:30.
- Printerat multifunksionale të jenë të përshtatshëm për tu përdorur në rrjet.
- Software menaxhimi qendror për pajisjet e printimit ku ndër të tjera:
 - Të jetë i qendëruar.
 - Të shfaqet në kohë reale sasia e fletëve të printuara/fotokopjuara.
 - Të shfaqet në kohe reale sasia e mbetur e bojës si edhe problematikat teknike për çdo pajisje.
 - Raport mbi numrin e faqeve të printuara nga çdo përdorues në një interval kohor të konfigurueshëm.
- Pagesa do të kryhet vetëm në bazë të faqeve të printuara/fotokopjuara deri në ezaurimin e plotë të njësive të prokuruar.
- Volumi i printimit në total do të jetë 2,200,000 (dy milion e dyqind mijë) faqe

3.Fondi Limit

Fondi limit në vlerën **1,936,000 lekë (pa TVSH)**

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbim Printimi dhe fotokopje”		
1. Urdhër Prokurimi Nr.8 datë 19.05.2020	2. Lloji i procedurës së Prokurimit “ E hapur” me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: znj. L. M.(përgj.) z. E. T. (specialist) z. K. H. (specialist)
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 29 datë 12.06.2020 z. K. H. z. O. B. z. E. T.	5. Komisioni për përlogaritjen e fondit limit znj. R. Ll. z. Th. N. znj. V. M.	7. Fondi limit (pa tvsh) 1,936,000 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 01.06.2020 behët 08.06.2020	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 8/1 datë 19.05.2020 z. E. A. (Kryetar) z. E. K. (Anëtar) z. H. B. (Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës <ul style="list-style-type: none">• “S. C.” sh.p.k. 1,859,000 lekë• “I. O.” sh.p.k. 1,874,000 lekë• “B. E.” sh.p.k. 3,300,000 lekë b) skuafikuar: <ul style="list-style-type: none">• I. O.” sh.p.k	8. Oferta fituese (pa tvsh) 1,784,640 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 910,000 lekë

• "B. E." sh.p.k		
11. Ankimime AK Kërkesë për sqarim nga "P. I. N. O." nr. 998 datë 26.05.2020 Ankesë nga "E. C." me nr. 962/3 datë 26.05.2020 dhe heqje dorë nga ankesa me nr. 962/6 datë 27.05.2020 Kërkesë për sqarim nga "I. O." datë 26.05.2020 Kërkesë për sqarim nga D. A. datë 20.05.2020	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës nga KPP
14. Lidhja e kontratës: Nr. 962/10 datë 03.07.2020		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 365 ditë Zbatuar ___ditë	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës me ditë	21. 20. Akt i marrjes në dorëzim A. K. O. B. E. T.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi Situacion me pagesë intervalore	16. Likuiduar deri datë

Për sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr. 14 datë 19.11.2021, për të cilin janë paraqitur observacione me nr.1667/61 datë 10.01.2022 protokolluar në KLSH me 877/33 datë 12.01.2022.

Pretendimi i subjektit:

Në vetvete printerat përmbajnë pjesë dhe materiale të cilat nëse nuk trajtohen me kujdes dhe profesionalizëm do të shkaktonin ndotje ambientale duke u bërë të dëmshme për personelin e Posta Shqiptare Sh.a. Konkretisht bëhet fjalë për menaxhimin e tonerave, bojërave dhe qarqeve elektronike që kanë këto pajisje.

Gjithashtu sqarojmë se në lidhje me vendosjen e këtij kriteri nuk është paraqitur asnjë ankesë apo kërkesë për sqarim nga O.E. Theksojmë se ky kriter është vlerësuar i drejtë dhe nga koordinatori i Agjencisë së Prokurimit Publik i cili në mënyrë sistematike monitoron të gjitha procedurat e prokurimit publik dhe në rastin konkret nuk ka konstatuar asgjë në lidhje me këtë dhe si rrjedhojë nuk ka kërkuar modifikimin e DST-së në lidhje me këtë pikë apo më tej akoma të ketë kërkuar heqjen e kësaj pike. Në lidhje me caktimin e 3 punonjësve të certifikuar për pajisjet multifunkionale ju sqarojmë se pajisjet e këtij shërbimi kanë tri funksionalitete Printim/Kopjim/skanim të cilat kanë specifikat e veta kur pësojnë defekt. Gjithashtu volumi i kërkuar ka nevojë për një sasi të caktuar specialistësh. Në këtë rast nevojiten të paktën dy persona për të kryer këtë veprim, pra përgjithësisht gjatë shërbimit OE dërgon dy persona ekspert për riparimin e defekteve on/site. Gjithashtu ju vë në dijeni se printerat janë të vendosur në disa ambiente dhe se ndodhen larg njëri tjetrit. Pra numri tre është numri minimal i cili do të sigurojë një shërbim të qëndrueshëm dhe profesional përgjatë gjithë periudhës. Përsa i përket mungesës së procesverbaleve të monitorimit të ofrimit të shërbimit ju sqarojmë se ato janë dorëzuar të plota për çdo monitorim mujor në Drejtorinë e financës dhe janë pjesë e dokumentacionit justifikues për likuidimin e kryer. Grupi i monitorimit nuk i ka dorëzuar me mendimin se do verifikoheshin në Drejtorinë e Financës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Bazuar në Observacionin drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit me 1667/61 datë 10.01.2022 protokolluar në KLSH me nr. 877/33 prot. Datë 12.01.2022, grupi i auditimit mban qëndrimin si më poshtë:

Përsa i përket observacionit dërguar është i njëjti me observacionin drejtuar KLSH-së me nr.1667/43 datë 26.11.2021 protokolluar në KLSH me nr. 877/27 prot. Datë 01.12.2021, për të cilën personat përmendur në Akt Konstatim kanë marrë përgjigjen dhe sqarimet e nevojshme.

12. Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të veçanta, kriterë diskriminues.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në

dispozicion grupit të auditimit, në caktimin e kriterëve të veçanta është caktuar dhe certifikata ISO 14001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit e cila nuk është në proporcion me objektin e procedurës së prokurimi si dhe caktimi i 3 punonjësve të certifikuar për pajisjet multifunkionale, duke vënë theksin në numrin 3 do të s'kualifikonte nga gara shumë Operatorë të tjerë duke e bërë garën diskriminuese.

Kriteri: Nenin 20 i Ligjit për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Pjesëmarrje e ulët dhe zhvillimi i një gare jo të barabartë.

Shkaku: Vendosja e kriterëve diskriminuese.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.

13. Titulli i gjetjes: kontrata nuk është trajtuar si një SLA (MNSH).

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në caktimin e kriterëve të veçanta cilësohet se shërbimi i kërkuar është i bazuar në një nivel të caktuar shërbimi SLA (Service Level Agreement), por që në asnjë rast kontrata nuk është trajtuar si një SLA.

Kriteri: Praktikat më të mira dhe vendimi nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”*

Ndikimi/efekti: Ndërprerje e ofrimit të shërbimit nga anomalitë e ndryshme.

Shkaku: Mos rakordimi me praktikat më të mira mbi menaxhimin e sistemeve të reja të TI.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.

14. Titulli i gjetjes: Mungon procesverbali mbi marrjen në dorëzim.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk është mbajtur asnjë procesverbal mbi ecurinë e shërbimit, duke matur cilësinë e shërbimit për të arritur afrimin optimal të tij.

Kriteri: Neni 14 të Kontratës së nënshkruar midis dy palëve me Nr. 1840/8 datë 21.11.2020.

Ndikimi/efekti: Risk për ofrimin e shërbimi në mënyrë optimale

Shkaku: Mos rakordimi me praktikat më të mira mbi menaxhimin e sistemeve të reja të TI.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore.

II.2.2.4.F. Zhvillimi i Procedurës “Blerje pajisje sigurie (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi DVR/NVR 4 kamera, 8 kamera, 16 kamera + instalim kabull, kanal, adaptor, investim monitor, sisteme inteligjente sigurie 4 Ch dhe 8 Ch, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit”

1. Përshkrimi i procedurës

Pas analizimit të kërkesave të filialeve për mbulimin e shërbimit të sigurisë me sisteme sigurie të zyrave postare dhe ambjenteve të tjera të rëndësishme, të pa pajisura me këto sisteme, për rinovimin me sisteme të reja të atyre të vjetrave të cilat nuk plotësojnë standartet në rritje të perfeksionit teknik të tyre për rregjistrime e vëzhgime të qarta e cilësore të pamjeve filmike si dhe do të blihet e instalohet sistemi SMART i cili do të shërbejë Sallës së Monitorimit të Postës

në Drejtorinë e Përgjithshme dhe Sallës së Monitorimit të Operatorit fitues për informim dhe eliminim të difekteve në kohë mjaft optimal.

2. Specifikimet Teknike

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Sisteme Vezhgimi DVR/NVR (Ch4)	Copë	51
2	Sisteme Vezhgimi DVR/NVR (CH8)	Copë	6
3	Sisteme Vezhgimi DVR/NVR (CH16)	Copë	3
4	Sisteme Alarmi	Copë	52
5	Blerje e vendosje monitor	Copë	2
6	Sisteme inteligjente sigurie CH4	Copë	30
7	Sisteme inteligjente sigurie CH8	Copë	20
8	Programi i shendetit te paisjeve te sigurise	Copë	329
9	Programi i monitorimit te sistemit te alarmit	Copë	301

3. Fondi Limit

Fondi limit në vlerën **50,194,820 lekë lekë (pa TVSH).**

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt <i>“Blerje pajisje sigurie (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi DVR/NVR 4 kamera, 8 kamera, 16 kamera + instalim kabëll, kanalim, adaptor, investim monitor, sisteme inteligjente sigurie 4 Ch dhe 8 Ch, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit”</i>		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 8 datë 29.04.2021	2. Lloji i procedurës së Prokurimit “E hapur” me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: z. E. P. (përgjegjës) z. Xh. H. (specialist) z. O. Dh. (specialist)
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 34 datë 29.03.2021 z. A. G. z. Xh. H. z. O. Dh.	5. Komisioni për përlogaritjen e fondit limit znj. O. T. znj. B. D. znj. E. A.	7. Fondi limit (pa tvsh) 50,194,820 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 17.05.2021	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 8/1 datë 29.04.2021 z. V. A. (Kryetar) z. N. S. (Anëtar) z. E. T. (Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës • “A.T.” sh.p.k. 49,861,300 lekë • “I.S.S” sh.p.k. 48,888,888 lekë • “G. S.” sh.p.k. 50,072,000 lekë • “I. S.” sh.p.k. Pa oferte b) skualifikuar: • “A. T.” sh.p.k. • “G. S.” sh.p.k. • “I. S.” sh.p.k.	8. Oferta fituese (pa tvsh) 48,888,888 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,305,932 lekë
11. Ankimime AK Ankimime KPP ska	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës nga KPP
14. Lidhja e kontratës: Nr. 937/7 datë 17.06.2021		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 60 ditë Zbatuar ___ ditë	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës	21. 20. Akt i marrjes në dorëzim O. Dh. T. H. Xh. H.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi Vlera me TVSH Vlera pa TVSH	16. Likuiduar deri dt

Për sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr. 15 datë 19.11.2021, për të cilin nuk janë paraqitur observacione mbi Projektraportin e Auditimit, në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

15. Titulli i gjetjes: Nuk kanë parashikuar Marrëveshjen në Nivel Shërbimi (MNSH)

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, salla e monitorimit të O.E. për eliminimin e defekteve mbulohet nga O.E. për 2 vite që është dhe garancia e produkteve. Pas dy vitesh meqenëse tërësia e produkteve funksionon si një sistem nuk është parashikuar mirëmbajtje dhe nuk është përcaktuar se kujt do ti kalojnë të drejtat e sallës së monitorimit. Meqenëse është zhvilluar një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit atëherë në procedurën e prokurimit duhet të ishte parashikuar dhe mirëmbajtja me qëllim ofrimin e shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit të të dhënave.

Kriteri: Praktikrat më të mira dhe vendimi nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”

Ndikimi/efekti: Ndërprerje e ofrimit të shërbimit nga anomalitë e ndryshme.

Shkaku: Mos rakordimi me praktikrat më të mira mbi menaxhimin e sistemeve të reja të TI.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikrat më të mira.

II.2.2.4.G.Zhvillimi i Procedurës “Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 1 vit.

1.Përshkrimi i procedurës

Nisur nga situata e krijuar nga COVID-19 Posta Shqiptare sh.a e konsideron të nevojshme përdorimin e platformave të punës nga shtëpia dhe komunikimit në distancë me platforma të përshtatshme për video-konferenca. Për këtë arsye Paketa e Microsoft 365 Apps for Enterprise duhet:

- Të ketë të përfshirë aplikimet Outlook, Word, Excel, PowerPoint, Microsoft Teams, OneNote. Këto aplikime duhet të marrin gjithë përditësimet nga Microsoft për periudhën e shërbimit.
- Të mundësojë bashkëpunim në vendndodhje të ndryshme nëpërmjet punës në kohë reale, dhe shpërndarjes së dokumenteve me grupet e punës në mënyrë të sigurtë dhe të thjeshtë.

2.Specifikimet Teknike

Nr.	Nr. Identifikues Produkti	Përshkrimi i Produkti	Sasia	Njësia	Shpjegime
1	AAA-03579	Windows Pro Device License	200	Licence	200 Licenca
2	AAA-04077	Microsoft 365 Apps for Enterprise User	200/vit	Përdorues për përdorim 1 vjeçar	200/vit për 2 vite
3	AAA-90052	Windows Server Datacenter 16 core-pack License	4	Licence	4 Licenca
4	AAA-03756	SQL Server Enterprise Core 2 core-pack License	4	Licence	4 Licenca
5	AAA-12628	Power BI Pro User	5/vit	Përdorues për përdorim 1 vjeçar	5/vit për 2 vite
6	5S2-00003	Azure subscription services	25 Kreditë/vit	Abonim për 1 vit	25 kredite/vit për 2 vite
7		Shërbime trajnimi dhe konsulence për paketën M365, PowerBI, Windows server, SQL server, Windows Desktop.	1	set	1 set
8		Implementimi i shërbimeve backup në Azure	1	set	1 set

3.Fondi Limit

Fondi limit në vlerën **30,000,000 lekë lekë (pa TVSH).**

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt <i>“Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite Marrëveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 1 vit”</i>		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 38 datë 29.12.2020	2. Lloji i procedurës së Prokurimit “ E hapur” me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: z. N. L. (përgjegjës) z. A. S. (specialist) z. O. B. (specialist)
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 89 datë 17.11.2020 z. M. Z. z. A. S. z. O. B.	5. Komisioni për përlogaritjen e fondit limit znj. K. K. znj. E. S. znj. E. B.	7. Fondi limit (pa tvsh) 30,000,000 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 25.01.2021 shtyhet 01.02.2021	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 38/1 datë 29.12.2021 z. H. B. (Kryetar) z. E. K. (Anëtar) z. K. C. (Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës • “I. B. S.” sh.p.k. 29,757,378 lekë • “I. S.” sh.p.k. 27,878,892 lekë b) skualifikuar: • “I. B. S.” sh.p.k. 29,757,378 lekë	8. Oferta fituese (pa tvsh) 27,878,892 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,121,108 lekë
11. Ankimime AK Ankesë nga “P. S.” nr. 2718/3 datë 05.01.2021 Terheqje ankese nr. 2718/4 datë 06.01.2021 Ankimime KPP ska	12. Përgjigje Ankesës Relacion nr. 2718/15 datë 22.01.2021	13. Përgjigje Ankesës nga KPP
14. Lidhja e kontratës: Nr. 2718/9 datë 24.02.2021		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 2 vite Zbatuar ___ ditë	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës	21. Akt i marrjes në dorëzim O. B. E. A. E. T.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi Pagesa me situacione intervalore	16. Likuiduar deri dt

Për sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr. 15 datë 19.11.2021, për të cilin janë paraqitur observacione me nr.1667/51 datë 10.01.2022 protokolluar në KLSH me 877/33 datë 12.01.2022.

Pretendimi i subjektit:

Në mbështetje dhe zbatim të urdhrit të brendshëm nr. 38/13 datë 26.03.2021 për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të “Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite” janë zbatuar me përpikëri të gjitha kërkesat e kontratës dhe të specifikimeve teknike bashkëlidhur kësaj kontrate.

Nga grupi i punës janë mbajtur së bashku me përfaqësues të kontraktuesit procesverbalet përkatëse për shërbimet e trajnimit dhe të konsulencës. Gjatë procesit janë trajnuar persona staf nga Posta Shqiptare të cilët janë përfshirë dhe në procesverbalet e mbajtura me kontraktuesi.

Malli i prokuruar konsiston vetëm në licenca dhe shërbime të cilat nuk kanë nevojë për mirëmbajtje nga vetë natyra e mallrave. Në këtë procedurë nuk është prokuror mall i natyrës software ose hardware për të cilin do të nevojitej mirëmbajtje. Grupi i punës ka shqyrtuar udhëzimet përkatëse të lëshuara nga AKSHI, udhëzim nr.2 datë 02.09.2013 “Për standardizimin e termave të referencës për projektet TIK në administratën publike”, ku nuk cilësohet parashikimi i zërit mirëmbajtje për mallra me natyrë licenca.

Në Shqipëri ekzistojnë disa kompani të cilat i zotërojnë këto certifikata dhe për këtë arsye nuk është kufizuar pjesëmarrja. Për vetë rëndësinë që ka realizimi i kësaj kontrate për shoqërinë "Posta Shqiptare" sh.a. kërkesat e vendosura nga hartuesit e dokumenteve standarde të tenderit, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar bindjen se operatori ekonomik ofertues zotëron kapacitet teknike dhe intelektuale për realizimin e kontratës për këtë arsye janë kërkuar licenca të nivelit Gold. Këto kritere gjejnë mbështetje në Udhëzimin nr.2 datë 02.09.2013 "Për standardizimin e termave të referencës për projektet TIK në administratën publike" të AKSHI, ku kërkohet garantimi i cilësisë së produkteve të mallrave dhe i sigurisë së lëvrimit të tyre . Vendosja e këtyre kritereve garanton që ofruesi i mallrave është partner i Microsoft si dhe demonstroi kapacitetin e kompanisë për të ofruar mallra dhe shërbimet e kërkuara në procedurën e prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Bazuar në Observacionin drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit me 1667/51 datë 10.01.2022 protokolluar në KLSH me nr. 877/33 prot. Datë 12.01.2022, grupi i auditimit mban qëndrimin si më poshtë:

Përsa i përket observacionit dërguar është i njëjti me observacionin drejtuar KLSH-së me nr.1667/29 datë 25.11.2021 protokolluar në KLSH me nr. 877/11 prot. Datë 26.11.2021, për të cilën personat përmendur në Akt Konstatim kanë marrë përgjigjen dhe sqarimet e nevojshme.

16. Titulli i gjetjes: Nuk është mbajtura asnjë procesverbal që fakton kryerjen e trajnimeve dhe konsulencave

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në caktim e specifikimeve teknike është përfshirë pika "Shërbime trajnimi dhe konsulencë për paketën M365, Power BI, Windows server, SQL server, Windows Desktop" si dhe në kriteret e veçanta është kërkuar "Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar nga prodhuesi si trajnues zyrtarë të produkteve Microsoft", por nuk është mbajtur asnjë procesverbal që fakton kryerjen e trajnimeve dhe konsulencave nga specialistët e certifikuar nga prodhuesi si trajnues zyrtarë të produkteve Microsoft.

Kriteri: Kushtet e Kontratës së nënshkruar nga të dyja palët.

Ndikimi/efekti: Mos përmbushje e qëllimit të prokurimit.

Shkaku: Mos rakordimi me praktikën më të mira mbi menaxhimin e sistemeve të reja të TI.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi marrjen në dorëzim të kontratës dhe zbatimit të saj të bëjnë të mundur së bashku me operatorin ekonomik fitues të zhvillojnë trajnime të stafit sipas pikave të specifikimeve teknike.

17. Titulli i gjetjes: Nuk kanë parashikuar Marrëveshjen në Nivel Shërbimi (MNSH)

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, gjatë hartimit të procedurës së prokurimit nuk është parashikuar zëri për mirëmbajtjen e procedurës në fjalë. Meqenëse janë shërbime të ndryshme në objektin e prokurimit atëherë duhet parashikuar dhe zëri i mirëmbajtjes për të siguruar krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup).

Kriteri: Praktikën më të mira dhe vendimi nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"

Ndikimi/efekti: Ndërprerje e ofrimit të shërbimit nga anomalitë e ndryshme.

Shkaku: Mos rakordimi me praktikën më të mira mbi menaxhimin e sistemeve të reja të TI.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.

18. Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të veçanta, kriterë diskriminues.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve për investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, kriteret e veçanta që Kompania duhet të ketë specializimet e mëposhtme me prodhuesit Microsoft:

-Gold Data Analytics për të demonstruar kapacitetin e kompanisë për të ofruar shërbime lidhur me platformen analitike Microsoft BI.

-Gold Data Platform për të demonstruar kapacitetin e kompanisë për të ofruar shërbime lidhur me platformën e bazës së të dhënave të microsoft SQL.

-Gold Collaboration and Content për të demonstruar kapacitetin e kompanisë për të ofruar shërbime lidhur me platformat e bashkëpunimit që ofrohet nga Microsoft, përbëjnë favorizim për kompani të caktuara duke mos lejuar Operatorë të tjerë të jenë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Kriteri: Nenin 20 i Ligjit për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Pjesëmarrje e ulët dhe zhvillimi i një gare jo të barabartë.

Shkaku: Vendosja e kriterëve diskriminuesë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.

II.2.3. Auditimi i Sigurisë së Informacionit

Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij.

Siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo vjen për arsye të rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private. Siguria e Informacionit është kosto dhe investim për subjektin dhe mund të përcaktohet si metoda për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë.

Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: *“Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”*.

a. Siguria e të dhënave dhe të drejtat e përdoruesve

Topologjia Hardware & Network

Qendra e të dhënave Primare:

Qendra e të dhënave e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a është infrastruktura kompjuterike ku bëhet përpunimi dhe ruajtja e gjithë informacionit mbi të gjithë shërbimet e ofruara në zyrat postare, degët dhe filialet e shoqërisë. Mbi këtë infrastrukturë është i ngritur sistemi qendror i shoqërisë për ofrimin e shërbimeve të informatizuara postare dhe financiare, ku nëpërmjet të cilit ofrohet një numër shumë i madh ndërfaqesh që mundësojnë lidhjen e sistemit qendrorë të shoqërisë me palët e treta.

Topologjia hardware & rrjetit të Qendrës së të Dhënave Primare

Siguria e Data Center përbëhet nga dy segmente firewall që mundësojnë ndarjen dhe implementimin e sigurisë në network në tre zona:

- Front End: Network-u në periferi i cili mundëson mbrojtjen dhe aksesimin e Data Center-it në distancë;
- DMZ: Network-u i cili përfshin të gjitha serviset dhe aplikacionet që aksesohen nga Internet por që mbeten të izoluara nga networku i brendshëm;
- Back-End: Network-u i cili përfshin të gjithë serverat që mbartin më së shumti sistemet dhe aplikimet më kritike.

Shërbimet e implementuara në këtë infrastrukturë janë të ndara në dy zona duke përdorur VLANs. Sistemet dhe aplikacionet janë instaluar në makinat të cilat janë të virtualizuara, duke përdorur virtualizimin reduktohen dhe përmirësohen kostot e hardware duke ofruar dhe qëndrueshmëri të funksionimit të sistemeve të instaluar.

Familja e serverave të instaluar që është përdorur në këtë data center është Sistem Blade Serverash. Sistemi Storage është i ndërtuar nga sisteme hardware me mundësi të ofrimit njëkohësisht të NAS (*Network Attached Storage*) dhe SAN (*Storage Area Network*) kombinuar me Backup Software të cilët ofrojnë backup të dhënash së pari VTP (*Virtual Tape Library*) dhe më pas transferimin e këtyre të dhënave në mënyrë asinkrone në Tape fizike për ruajtjen e të dhënave të dislokuara në Physical Tape Library.

➤ *Ambienti fizik i dhomave të serverëve primare*

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim, parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Auditimit mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave, u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Duke qenë se dhoma e serverëve është pika më delikate e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të drejtorisë së IT dhe Zhvillimit në Posta Shqiptare, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave të lokalizuar në katin e parë të Posta Shqiptare si dhe site DRC që ndodhet në Kinostudio.

Nga auditimi u konstatua se:

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave që ndodhet në zyrën qendrore pranë Postës Shqiptare sh.a u konstatuan disa problematika, konkretisht si më poshtë:

- Ambienti nuk ka të instaluar një sistem akses kontrolli i cili garanton hyrjen e personave të autorizuar;
- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Kabllimet dhe lidhjet e rrjetit në switch dhe patch panel nuk është i sistemuar;
- Në paradhomën e serverëve në të cilën janë të vendosur sistemi UPS dhe paneli elektrik, ishte jashtë funksionit sistemi i kondicionimit, kishte prani të lagështirës dhe hyrja në këtë ambient ishte e përbërë nga derë vetratë duralumini, faktor i cili ul sigurinë për në dhomën e serverëve;
- Nuk ka një plan testimi të sensorëve të zjarrit si dhe mirëmbajtje për sistemin elektrik dhe sistemin backup UPS;
- Nuk bëhen kolaudime për sistemin Antizjarr;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Managment System).

Figura nr.2: Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverëve në godinën qendrore të Posta Sh.a dhe aseteve të ndodhura në të.

Hyrja Kryesore




Paneli i UPS



Pjesa Server/Storage



Sistemi Anti zjarr



Kablime



Burimi: *Grupi i Auditimit*

➤ ***Qendra e të dhënave Disaster Recovery Site:***

Qendra e të dhënave Disaster Site mundëson sigurinë e ofrimit të shërbimeve të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a në mënyrë të pandërprerë, pavarësisht problemeve teknike ose fatkeqësive natyrore që mund të ndodhin në qendrën e të dhënave primare. Si dhe ruajtjen e gjithë të dhënave të përpunuara nga qendra e të dhënave primare.

Posta Shqiptare sh.a, përdor Site Backup DRC (Disaster Recovery Center) në filialin e degës Tiranë. E gjithë infrastruktura e qendrës së të dhënave Primare dhe asaj Disaster Recovery Site është e ndërtuar në VMware. Të dyja site-et janë të lidhura me linjë të dhënash - Fibër e dedikuar në të cilën do të kalojë gjithë informacioni që do shkëmbehet ndërmjet site-eve.

Replikimi i të gjithë storage realizohet nëpërmjet Storage Replication Adapters sipas skemave të mëposhtme.

Topologjia hardware dhe rrjetit të Qendrës së të dhënave Disaster Recovery Site:

Topologjia e Qendrës së të Dhënave Disaster Site është një arkitekturë 3-tier e përbërë nga dy segmente firewall që mundësojnë ndarjen dhe implementimin e sigurisë në network në tre zona kryesore:

- Front End: Network-u në periferi i cili mundëson mbrojtjen dhe aksesimin e Data Center-it në distancë.
- DMZ: Rrjeti i cili përfshin të gjitha serviset dhe aplikacionet që aksesohen nga Internet, por që mbeten të izoluar nga networku i brendshëm.
- Back-End: Rrjeti i cili përfshin të gjithë serverat që mbartin më së shumti sistemet dhe aplikimet me kritike.

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në këtë site u konstatuan disa problematika:

- Largësia dhe pozicionimi i site-it DRC nuk përputhet me përcaktimet ligjore që parashtojnë kushtet dhe distancën e ndërtimit të një DRC-je;
- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Nuk është instaluar akses kontrolli për të kontrolluar dhe monitoruar hyrjet dhe daljet e personave në ambientin e DRC. Hyrja në këtë ambient realizohet duke hapur derën me çelës;
- Nuk kishte sensorë për matjen e temperaturës dhe lagështirës;
- Sistemi i kondicionimit nuk ishte efektiv pasi për të arritur ftohjen e duhur të serverëve përdorehin pajisje të tjera ndihmese, si freskuese;
- Muret e dhomës së serverave në site-in DRC nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday).

Figura nr.3: Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverëve në godinën e DRC të Posta Sh.a dhe aseteteve të ndodhura në të.

Hyrja Kryesore



Sistemi Anti zjarr



Kabltime



Hyrja për në ambientin e DRC



Paneli i UPS



Pjesa Server/Storage



Paneli i kontrollit të energjisë elektrike



Paneli i kontrollit të energjisë elektrike



➤ **Të drejtat e përdoruesve**

a. *Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre*

Përdoruesit e Sistemit Eterna Financiare


Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i përdoruesve të sistemit Eterna Financiare realizohet nga Sektori i Aplikimit & Administrimit të Dhënave, detyrë kjo e atribuar pa një shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë së Postës Shqiptare sh.a. Pavarësisht se punonjësit e këtij sektori duke përfshirë përgjegjësen e sektorit znj. M. T. dhe 2 (dy) specialistet e këtij sektori znj. E. B. dhe znj. E. H., nuk janë emëruar zyrtarisht si Administrator sistemi, ato ushtrojnë të gjitha detyrat e administratorit të sistemit.

Në programin Eterna Financiare për të drejtat e përdoruesve përdoren 2 koncepte: rolet dhe profilet, për të cilat ekzistojnë 256 attribute për profilet dhe rolet.

Rolet përfshijnë 4 (katër) elementë të programit:

- Menu/ nënmenu e programit;
- Funksionet e formave të programit;
- Transaksionet;
- Raportet.

Figura nr. 4: Skeme ilustruese mbi dhënien e attributeve të userave.



Burimi: Posta Shqiptare sh.a.

Sektori i Aplikimit & Administrimit të Dhënave së bashku me operatorin ekonomik (H. S.) që është dhe administratori i sistemit kanë të drejta, të cilat nëpërmjet kombinimit të ndryshëm të roleve, krijojnë sipas kërkesave të punës profile unike, të përshtatura sipas pozicioneve të ndryshme të punës. Mënyra e hapjes së userave në rast të një punonjësi të ri, procedohet duke dërguar një e-mail pranë sektorit të Aplikimit dhe Administrimit të të Dhënave në drejtorinë e IT-së dhe Zhvillimit, duke vënë në dijeni “cc” eprorin direkt. Pas marrjes së kërkesës me e-mail nga specialisti i filialit përkatës, përgjegjësi i sektorit të aplikimit dhe administrimit të të dhënave në drejtorinë IT dhe zhvillimit, të cilit i janë atribuar rolet e administratorit të sistemit, bën hapjen e userit me rolet përkatëse.

Të dhënat që ruhen në krijimin e përdoruesit janë:

PF_FILIALI -filiali

branch_description- Zyra

user_id- Celes Primar auto inkrementues (në të cilin shënohet ID e përdoruesit)

username - useri me të cilin përdoruesi identifikohet në sistem;

fullname- Emër Mbiemër;

profile_desc- Profili të drejtave në sistem;

active_user- user aktiv ose jo;

last_login- tregon logimin e fundit;

change_password- tregon nëse duhet bere reset në logimin e radhës;

last_change_of_password- ndërrimi i fundit i password-it;

nr_failed_logon- nr i logimeve të dështuara;

created_on- kur është krijuar;

timestamp

partner_id- nuk përdoret;

printer_type_id- lloji i printerit të mandatit: termik ose matricore;

operator_id- operatori i fiskalizimit.

Posta Shqiptare sh.a. disponon 2158 përdorues aktiv të aplikacionit kryesor Eterna Financiare dhe 1653 përdorues aktiv të aplikacionit Eterna Postare.

Nga auditimi mbi përdoruesit e sistemit Sistemit Eterna Financiare dhe Eterna Postare u konstatua se:

- Nuk janë aplikuar në sistem kritere të detyrueshme për rritjen e sigurisë së fjalëkalimit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit.

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për përdoruesit fundor të sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten në fjalëkalimin e tyre të aplikohen, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

Nga verifikimi i detajuar mbi përdoruesit e Sistemit Eterna Financiare rezultuan:

- Fusha “user_id” është në formë progresiv rritës, por jo i vazhdueshëm dhe pa ndërprerje, e cila mund të na tregojë se janë fshirë përdorues nga sistemi. Nga verifikimi i përdoruesve në sistem u konstatua se mungojnë 25 “user_id” të përdoruesve, si user_id=2, user_id=3, user_id=4, user_id=5, user_id=18, user_id=479, user_id=494, user_id=519, user_id=593, user_id=647, user_id=654, user_id=899, user_id=918, user_id=942, user_id=1014,

user_id=1041, user_id=1283, user_id=1511, user_id=2042, user_id=2099, user_id=2100, user_id=2101, user_id=2102, user_id=2103, user_id=2104. Mungesa e këtyre Id-ve tregon se këto user-a janë fshirë. Nga auditimi u konstatua se për këto veprime nuk është mbajtur asnjë dokument justifikues për fshirjen e këtyre userve

- Mbajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie pune me Posta Shqiptare sh.a. Rastet e konstatuara, konkretisht, janë auditues i KLSH-së me username “klsh” dhe user_id “1862” i cili ka përfunduar detyrat e tij gjatë auditimit në terren dhe përdoruesi në sistem rezulton të jeta akoma aktiv, gjithashtu janë aktiv në sistem dhe punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Postën Shqiptare.

- Në të dhënat mbi përdoruesit rezultojnë 5 raste për të cilat ekziston user i përsëritur, konkretisht:

User-i “k. k.” është i përsëritur me të njëjtën “username” dhe “fullname” si dhe kanë të njëjtën datë krijimi, ndërsa atributin “last_login” e kanë NULL.

User-i me “username” “b.h.” është përsëritur me user-in me “username” “B. H.” i cili ka të njëjtën datë krijimi dhe atributin “last_login” e ka NULL.

User-i me “username” “elida.shehu” është përsëritur me user-in me “username” “E. Sh.” i cili ka të njëjtën datë krijimi dhe atributin “last_login” e ka NULL, gjithashtu atributi “Role” përveç rolit “Sportelist Universal” ka dhe rolin “Specialist POS” ndryshe nga useri “e.sh.”.

User-i me “username” “b.d.” është përsëritur me user-in me “username” “b.d.” për të cilin data e krijimit ka diferencë prej një dite nga krijimi i user-it “basten.dine” si dhe atributin “last_login” e ka NULL.

User-i me “username” “a.b.” është përsëritur me user-in me “username” “a.b.” për të cilin data e krijimit ka diferencë prej një dite nga krijimi i user-it “a.b.” si dhe atributin “last_login” e ka NULL.

- Nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e “username” dhe “fullname” ku pjesa më madhe është krijuar me emër.mbiemër për “username” dhe Emër Mbiemër për “fullname”. Në shumë raste ky model nuk është ndjekur dhe rezultuan 57 raste të përdoruesve për të cilët “fullname” është me gërma kapital;

- Emri i plotë “fullname” në disa raste është plotësuar me nga një prapashtesë “GABIM”, “GABIMM”, “_gabim” ose me emër qyteti. Rezultojnë 8 raste me prapashtesën “GABIM”, 1 rast me prapashtesën “GABIMM”, 1 rast me prapashtesën “_gabim”;

- Për “fullname” të përdoruesit rezultojnë 8 raste kur vetëm mbiemri është me gërma kapitale, 3 raste kur emri fillon me germë të vogël, 1 rast kur emri dhe mbiemri fillon me germë të vogël dhe 2 raste kur mbiemri nuk fillon me germë kapitale;

- Rezultojnë 46 përdorues për të cilët “username” dhe “fullname” kanë të njëjtin format emër.mbiemër, si dhe për 2 përdorues “username” është vendosur si standardi i “fullname” dhe “fullname” si standardi i përdorur për “username”;

- Rezultojnë 38 usera të pa identifikuar për financat e filialeve, për këto përdorues është përdorur standard financa.emrifilialit si për fushën “username” dhe “fullname”. 1 rast prej të cilave është i përsëritur. Ky fakt mbart një risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem duke mos lënë gjurmë mbi aktivitetin që kanë kryer.

Nga verifikimi i të dhënave mbi përdoruesit rezultojnë user të pa identifikuar. Raste për user-at “burimetraporte”, “ana.test” dhe “eposta”, si dhe për user-at “user2”, “test”, “usertest”, “menaxhertest” për të cilët atributi “last_login” është NULL.

Rezultojnë 298 user-a të cilët atributin e “last_login” e kanë NULL, fakt i cili tregon se për këto user-a është fshirë gjurma e veprimeve të fundit që kanë kryer në sistem.

Në sistemin Eterna Financiare janë 3 përdorues përveç specialistëve të Sektorit të Aplikimit dhe Administrimit të të Dhënave me Role “Përdorues-Administrator” të cilët nuk janë pjesë e sektorit të sipërpërmendur. User-i “m.s” është specialiste e Sektorit të Rrjetave, ndërsa user-i “e.m.” është pjesë e Sektorit të Sigurisë IT.

Gjithashtu rezultoi useri me “username” “e. s.” i cili ka të drejt Përdorues-Administrator i krijuar më datë 29.03.2021, e cila ka qenë e komanduar në pozicionin e specialistes e Sektorit të Sistemeve e cila është larguar me leje lindje. Për këtë user rezultoi se atributi “last_login” është NULL, gjithashtu ekziston po i njëjti user me këto kredenciale me username “e.s. Useri “b.q.” rezultoi ende aktiv në sistem edhe pse është larguar përfundimisht nga Posta Shqiptare sh.a.

Përdoruesit e Sistemit Eterna Postare

Eterna Postare është një program që mbulon të gjitha proceset e shërbimeve postare që nga momenti i pranimit të objektit postar deri tek dorëzimi në destinacion. Në Eterna Postare në ndryshim nga Eterna Financiare për të drejtat e përdoruesit ekziston vetëm koncepti i rolit për të cilat ekzistojnë 41tribute për rolet. Administrimi i përdoruesve (*krijimi, modifikimi dhe mbyllje*) në Eterna Postare realizohet nga Sektori i Aplikimit & Administrimit të Dhënave, ashtu siç është përmendur në material kjo detyrë e atribuar është pa një shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë së Postës Shqiptare sh.a. Kjo detyrë realizohet nga punonjësit e këtij sektorit të sipërcituar duke përfshirë përgjegjësen e sektorit znj. M. T. dhe 2 (dy) specialistet e këtij sektori znj. E. B.dhe znj. E. H., nuk janë emëruar zyrtarisht si Administrator sistemi, ato ushtrojnë të gjitha detyrat e administratorit të sistemit.

Të dhënat që ruhen në krijimin e përdoruesit janë:

CityName-Qyteti;

office_name-Zyra;

UserID- Çelës primar auto inkrementues (në të cilin shënohet ID e përdoruesit);

LoginID- username;

FullName- Emër Mbiemër;

RoleDescription- Roli i të drejtave në sistem;

CreatedOn- Kur është krijuar;

LastLoginTime-Logimi i fundit;

RoleType- nuk përdoret si fushë;

Login- tregon nëse useri aktiv ose jo;

OfficeCode- kodi i zyrës;

can_post_cash- nëse lidhet me arke tek Eterna Financiare për postimin e arkëtimeve;

c_safe- arka në financiar;

k_Branch-zyra ne financiar;

printer_type_id-printeri i konfiguruar për mandatet;

change_password

last_change_of_password- ndryshimi i fundit i password-it;

scale_type_id- peshorja e konfiguruar për userin;

userfin-useri në financiar.

Nga auditimi mbi përdoruesit e Sistemit Eterna Postare u konstatua se:

- fusha “user_id” nuk është e strukturuar në formë progresive rritëse e cila tregon se mund të jenë fshirë të dhëna nga sistemi dhe sjell risk për komprometimin e të dhënave dhe humbjes së gjurmës audituese;

- mbajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me Postën Shqiptare sh.a. Në një rast u konstatua se username “klsh” dhe user_id “3354” i cili ka përfunduar detyrat e tij gjatë auditimit në terren dhe përdoruesi rezultoi aktive në sistem, gjithashtu janë aktiv në sistem dhe punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Postën Shqiptare;

- emri i plotë “fullname” në disa raste është plotësuar me një prapashtesë me emër qyteti ose fshati. Rezultojnë 12 raste me prapashtesën _PE, Ulez, (Klos), Elb, (eruje), ELBASAN, FIER, (Benj), LIS, Selishte, Macukull dhe (Klos);
- nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e “loginID” dhe “fullname” ku pjesa më madhe është krijuar me emër.mbiemër për “loginID” dhe Emër Mbiemër për “fullname”. Në shumë raste ky model nuk është ndjekur, ku rezultuan 121 raste për të cilat “fullname” është me gërma kapital, ose raste kur atributi loginID përveç formatit emër.mbiemër ka prapashtesë gërma dhe dy raste me numrin “2”;
- për “fullname” të përdoruesit ka 9 raste kur vetëm mbiemri është me gërma kapitale, 4 rast kur emri dhe mbiemri fillon me gërmë të vogël dhe 1 raste kur mbiemri nuk fillon me gërmë kapitale;
- janë 39 përdorues për të cilët “loginID” dhe “fullname” kanë të njëjtin format emër.mbiemër, si dhe për 2 përdorues “loginID” është vendosur si standardi i “fullname” dhe “fullname” si standardi i përdorur për “loginID”;
- ekzistojnë 22 user-a me rolin “shofer” për të cilët nuk ka asnjë atribut në sistem. Përveçse atributit mungon edhe identifikimi i userit p.sh, mund të shtohet emër mbiemër për të identifikuar veprimtarinë e gjithsecilit, pasi janë 22 usera me rolin shofer por të pa identifikuar.
- janë 5 usera të pa identifikuar për ZVRPP, për këto përdorues është përdorur standard ZVRPP-Tirana Veri/ ZVRPP-Tirana Jug dhe ZVRPP- Rulale 1/ ZVRPP- Rulale 2 si për fushën “loginID” dhe “fullname”;
- ka usera të pa identifikuar si “test.test”, “fab.test”, “tranzit”, “fier.qender”, “KosovaEMS”, “KosovaPosta” dhe “EternaWeb”. Gjithashtu ekziston user me loginID “silvana.topulli” për të cilën fullname është “d”.

Në të dhënat mbi përdoruesit rezultojnë raste për të cilat “loginID” është e ndryshme nga “fullname”, fakt ky i cili sjell akses të paautorizuar në sistem dhe të pa monitoruar. User-i me fullname “al.s.” logohet me loginID “th.m.”, për të cilën të dhënat mbi përdoruesit në sistem rezulton se ekziston user-i me fullname “A. S.” dhe loginID “a.s.”. Nërsa user-i me fullname “th.m.” akseson sistemin me loginID “d.b.” për të cilën nuk rezulton të ketë user me atribut “fullname” me këtë emër. User-i me “fullname” “l. H.” logohet me loginID “s.m.”, ndërsa user-i me fullname “sanie.meshau” logohet në sistem me loginID “d.c.”. Gjithashtu user-i me fullname “l. H.” logohet me loginID “l.k.”, si dhe useri me fullname “L. K.” logohet në sistem me loginID “m.xh.”, për të cilën ekziston user-i me loginID “m.xh.” dhe fullname “M. Xh.”. Rastet e sipër përmendura sjellin risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem, duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.

Në sistemin Eterna Financiare janë 5 përdorues përveç specialistëve të Sektorit të Aplikimit dhe Administrimit të të Dhënave me Role “Administrator” të cilët nuk janë pjesë e sektorit të sipërpërmendur. User-i “b.d.” është specialiste e Sektorit të Rrjetave, user-i “e.t.” është përgjegjës i Sektorit të Sistemeve, user-i “m.s.” është specialiste e Sektorit të Rrjetave. Gjithashtu u konstatua se useri me “loginID” “e. s.” i cili ka të drejta Përdorues-Administrator i krijuar më datë 24.04.2018 dhe LastLoginTime me datë 19.05.2021, e cila ka qenë e komanduar në pozicionin e specialistes e Sektorit të Sistemeve.

Nga auditimi u konstatua se:

-Atributet dhe rolet e userave në sistemin Eterna Postar dhe Financiar nuk janë të përcaktuara sipas detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara në rregulloren e brendshme administrative por sipas funksionaliteteve që punonjësi ushtron në praktikë përgjatë procesit të punës.

-Administratori i sistemit eterna postar dhe financiar është përgjegjës i sektorit të aplikimit dhe administrimit të të dhënave në drejtorinë IT dhe zhvillimit, znj. M. T..

Detyra e Administratorit të sistemit eterna i është atribuuar pa asnjë shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë. Pavarësisht se nuk është e emëruar zyrtarisht si Administratore sistemi,

ajo ushtron të gjitha detyrat e administratorit të sistemit. “*Administratori i Përgjithshëm*” i sistemit Eterna që ka të drejta universale është kompania Heliuss e cila ka ndërtuar dhe zhvilluar sistemin Eterna.

- Për periudhën objekt auditimi, Posta Shiptare sh.a. nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve të Sistemit Eterna Financiare dhe Eterna Postare në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve.

Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email. Kërkesat për krijim/aktivizim/çaktivizim apo modifikim të përdoruesve (*ndryshim i zyrës së aksesit apo i profilit të të drejtave*) realizohen me email në dijeni nga Drejtoritë e Shërbimeve përkatëse, ose nga Shefja e shërbimit në Filialin përkatës apo specialistet e shërbimit.

Përdoruesit e sistemit IPS dhe sistemit CDS

Në sistemi IPS (*International Postal System*) dhe CDS (*Custom Declaration System*) përdoruesit menaxhohen nga Sektori i Aplikimit & Administrimit të Dhënave. Kërkesat për krijim/aktivizim/çaktivizim apo modifikim të përdoruesve (*ndryshim i zyrës së aksesit apo i profilit të të drejtave*) komunikohen me e-mail duke vendosur në dijeni Drejtoritë e Shërbimeve përkatëse, ose shefen e shërbimit në Filialin përkatës apo specialistët e shërbimit.

Në IPS për krijimin e një përdoruesi është kusht krijimi më parë i userit në domain, pastaj krijimi i login-sit në bazën e të dhënave i tipit “Windows Authentication”, passwordi ndjek politikën e ndryshimit të passwordit të vendosura në Domain.

Përveç Sektorit të Aplikimit dhe Administrimit të të Dhënave të cilët kanë akses të drejtpërdrejtë në Bazat e të dhënave të IPS me qëllim verifikimin/analizimin e problemeve në bashkëpunim me PTC (Postal Technology Center), nëpunësit e tjerë aksesojnë vetëm programin IPS, ku sipas pozicionit të tyre të punës, sektori i sipërpërmendur i përzgjedh rolet përkatëse në programin IPS.

Lista e roleve të të drejtave në Programin IPS paraqiten si më poshtë:

User groups	
Code	Description
<input type="checkbox"/> ACCOUNTING	IPS International Accounting
<input checked="" type="checkbox"/> COUNTERS	Sporteli
<input type="checkbox"/> DEFAULT	Default User Group
<input type="checkbox"/> DELIVERY	Delivery Information
<input type="checkbox"/> EMS	EMS EO Operations
<input type="checkbox"/> EMSMAN	EMS Management
<input type="checkbox"/> IPSADM	IPS Administration
<input type="checkbox"/> IPSMAN1	IPS Management 1
<input type="checkbox"/> IT	konfigurime IT
<input type="checkbox"/> KOLINB	koliposta tehyra
<input type="checkbox"/> KOLIOUT	Koliposta te dala
<input type="checkbox"/> LETINB	Letters Inbound
<input type="checkbox"/> LETOUT	letters outbound
<input type="checkbox"/> RATES	Rates Management
<input type="checkbox"/> TRACK & TRACE	TRACK & TRACE

Burimi: Posta Shiptare sh.a.

Grupi i auditimit konstatoi se edhe për sistemet IPS dhe CDS Posta Sh.a. nuk disponon asnjë akt rregullativ për administrimin e përdoruesve të sistemeve në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve. Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email. Nuk autorizohet në asnjë formë shkresore krijimi, ndryshimi, mbyllja apo fshirja e përdoruesve në këtë këto sisteme.

➤ ***Auditimi mbi pajisjet firewall, router dhe infrastruktura e networkut***

Posta Shqiptare sh.a përdor TI në përmbushjen e objektivave institucionale dhe ka ngritur një infrastrukturë të zgjeruar network në qendër e në rrethe. Për funksionimin e komunikimit në infrastrukturën network të Postës Shqiptare sh.a janë implementuar dy router-a të tipit Juniper SRX3400 të cilat janë të konfiguruar në cluster. Këto dy routera kanë si proces të gjitha lidhjet e brendshme të Postes Shqiptare filiale, degë dhe zyra postare.

Në filiale janë instaluar router *fortiget E50* të cilat janë të lidhu me zyrat qendrore nëpërmjet një rrjeti të dedikuar privat Layer 2.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare nuk ka zbatuar praktikën me të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network. Infrastruktura network në Postën Shqiptare menaxhohet pa krijuar grup userash me role të ndara me të drejta konfigurimi.

- Useri admin është i aktivizuar dhe nuk ka një user me emërtim ndryshe me të drejtat e Administratorit;

- Nuk ka të implementuar një procedurë kontrolli të log-eve për të parë erretet ose problemet e ndryshme;

- Posta Shqiptare nuk ka marrë masa për lidhje të dytë Backup, problem që evidentohet në të gjitha Filialet e saj.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptar nuk ka marrë masa për krijimin e një filtri i cili bllokton një IP të caktuar e cila ka tentuar të aksesojë porta ose subnete kritike.

- Posta Shqiptare për të bërë DST NAT përdor porta standarde Remote Desktop, SSH dhe Telnet;

- Useri admin është i aktivizuar dhe nuk ka një user me emërtim ndryshe me të drejtat e Administratorit;

- Nuk ka të implementuar një procedure kontrolli të log-eve për të parë erretet ose problemet e ndryshme.

- **Siguria e rrjetit, komunikimi me zyrat rajonale si dhe shërbimet që Posta Shqiptare ofron për palët e treta**

Posta Shqiptare përdor VPN IPSec “*site to site*” i cili përdor 2 nivele autentifikimi dhe për të gjithë palët e treta është një subnet i caktuar dhe i limituar për të aksesuar subnetet e tjera të postës. *Nga auditimi u konstatua se* Routerat e ndodhura në filialet e Postës Shqiptare kanë të aktivizuar userin admin.

- **Storage**

Posta Shqiptare përdor për storage EMC Clarion i cili shërben për tek datacenteri primar. Gjithashtu është edhe një storage i dytë i cili është IBM Storewize.

IBM dhe EMC shërben për makinat virtuale dhe për ruajtjen e të dhënave dhe data bazat e aplikacioneve që Posta ka në përdorim. Storage EMC Clarion është një produkt i cili është End Of Life dhe prodhuesi nuk ofron me suport për këtë model.

Nisur nga zhvillimet që Posta Shqiptare ka bërë në sistemet e saj, storage aktualisht ndodhet drejt ezaurimit të hapësirës dhe nevojitet shtimi i kapacitetit të hard drive.

- **Infrastruktura e Serverave**

Posta Shqiptare ka në përdorim Fujitsu Blade Server Primergy BX920S2 i cili shërben për hostimin e të gjitha makinave virtuale dhe janë të konfiguruar me Sotrage IBM dhe EMC.

Modeli i Fujitsu Blade Server Primergy BX920S2 nuk ofrohet më suport nga prodhuesi pasi është End of Life.

b. Ruajtja e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Bazuar në standardet ndërkombëtare, siguria e informacionit garantohet duke siguruar gatishmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin e incidenteve, aktiviteteve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme.

Në ambientet teknologjike të Postës Shqiptare është ndërtuar një sistem për ruajtjen, transformimin, administrimin dhe nxjerrjen e statistikave të aktivitetit të përdoruesve në sistemet Eterna Financiare dhe Eterna Postare. Sistemi i administrimit të logeve realizon 3 procese kryesore që janë:

- Gjenerimi i log-eve për çdo aktivitet të përdoruesve ose procese automatike në sistemet Eterna Financiare dhe Eterna Postare me qëllim përpunimin dhe analizimin e tyre
- Leximin e log-eve, përpunimin dhe indeksimin e tyre në ElasticSearch.
- Analizimin e log-eve, nxjerrjen e statistikave të ndryshme në lidhje me aktivitetin e përdoruesve ndërmjet përdorimit të Kibanës.

Për të mundësuar ruajtjen, transformimet dhe përpunimet e log-eve në ambientet teknologjike të Postës Shqiptare janë instaluar aplikacionet dhe shërbime mbështetëse: FileBeat, Logstash, ElasticSearch dhe Kibana. Me anë të këtyre aplikacioneve bëhet e mundur leximi, marrja, përpunimi, ruajtja dhe investigimi i të gjithë aktivitetit të përdoruesve në sistemet Eterna Financiare dhe Eterna Postare. Mekanizma e analizimit të logs Aplikacionet dhe ndërfaqet (web dhe Windows Services) Eterna ruajnë loge në files, ku koha e ruajtjes është e pa limituar. Shkrimi i këtyre logeve është implementuar në kodin burim. Këto loge përpunohen dhe transferohen në Elastic Search dhe analizohen në Sistemin e menaxhimit të logeve “Kibana” që disponon Posta Shqiptare sh.a.

Përmes Sistemit të Menaxhimit të Logeve “Kibana”, Sektori i Aplikimit & Administrimit të Dhënave në bashkëpunim me operatorin ekonomik (Helios) mund të gjurmojnë loget e të gjithë veprimeve të bëra në programet Eterna. Serverat e Eterna, IPS, CDS, Eurogiro përdorin si sistem operativ Windows Server 2012 R2 Standard. Për menaxhimin dhe monitorimin e logeve të serverave në të cilat janë ngritur sistemet e sipërpërmendura të Posta Shqiptare përdoret Windows Event Viewer.

Për programet IPS, CDS, Eurogiro në raste problematikash, për të bërë një analizë të shkaqeve, IT hyn në kontakt me suportin e këtyre aplikacioneve, duke shfrytëzuar loget e gjeneruara nga këto aplikacione.

Në loget e sistemit Eterna ruhet minimalisht të dhënat e përdoruesit që ka bërë veprimin, dega postare, data dhe ora e saktë e veprimit të bërë, niveli i log-ut (Debug, Info, Warn, Error ose Fatal), ip e kompjuterit si dhe një mesazh i standardizuar që përshkruan në mënyrë sa më të plotë veprimin.

Nga auditimi u konstatua se Posta Shqiptare sh.a.:

- Nuk disponon akte rregullatore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën e Postës, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06. 2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT). Institucioni duhet të përcaktojë një rregullore të shkruar për menaxhimin e log-eve sipas kërkesave të institucionit. Kjo rregullore duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi;

- Nuk janë përcaktuar burimet e nevojshme si dhe detyrat e personelit për menaxhimin e tyre;

- Posta Shqiptare sh.a. nuk zhvillon kontrolle mbi Audit Log, pavarësisht rëndësisë që kanë këto të dhëna në përmirësimin e sistemit, konstatimin dhe analizimin e problematikave të ngjashme.

➤ *Procedura e backup-it*

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Procedura e hartuar/e ndjekur nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në ndonjë dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet.

Nga administrimi i dokumentacionit u konstatua se procesi i gjenerimit të backup-eve në Postën Shqiptar sh.a. për bazat e të dhënave të sistemit Eterna i cili është dhe sistemi kryesor për administrimin e veprimeve operacionale në shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, realizohet në mënyrë automatik me skedulim në bazë ditore nga ku gjenerohen 3 lloje backup-esh:

- Full Backup: “Before End of Day” dhe “After End of Day”, sepse në orën 00:00 në Eterna Financiare behet procesi automatik i mbylljes së ditës së sistemit;
- Differential Backup: gjenerohet çdo 1 orë;
- LogShipping: gjenerohet backup të log-eve çdo 15 minuta.

Spektori i Aplikimit dhe Administrimit të të Dhënave merret me procesin e gjenerimit dhe ruajtjes së backup-eve të sistemeve: Eterna, IPS, CDS. Për sistemet IPS dhe CDS gjenerojnë çdo ditë me skedulim të automatizuar ‘Full backup’.

Llojet e Backup-ve që realizohen në Postën Shqiptare sh.a, përshkruhen si më poshtë:

Management Firewall bëhet backup në kohë reale në një makinë tjetër dhe është përcaktuar që të bëhet në mënyrë automatike. Gjithashtu çdo ditë të shtunë në orën 24:00 krijohet një file ku ruhen të gjitha konfigurimet e makinës dhe një kopje offline ruhet në ambientet e caktuara në Posta Shqiptare Sh.a, Firewall Internal bëhet backup në kohë reale në një makinë tjetër dhe është përcaktuar që të bëhet në mënyrë automatike pas çdo ndryshimi. Për Firewall-in e Internetit bëhen backup route-imet dhe IP-të e ndërfaqeve nga specialistët e IT.

Backup manual i konfigurimeve pas çdo ndryshimi madhor ruhen në skedare file.cfg, në ambientet e përcaktuara në Drejtorinë e Postes Shqiptare sh.a.

Proxy Server është ndërtuar në makinë virtuale.

DNS Server për backup përdoret një makinë tjetër, kopje e makinës origjinale. Makina *backup* përditësohet pas çdo ndryshimi madhor që bëhet në serverin origjinal.

Switch-et bëhet backup i konfigurimeve të gjithë switch-eve në Drejtorinë e Përgjithshme të Posta Shqiptare Sh.a të cilët ruhen në skedarë tekst dhe përditësohen pas çdo ndryshimi madhor. Backup-et ruhen në ambientet e caktuara në Posta Shqiptare sh.a.

MailServer bëhet backup ditor në një makinë tjetër backup e ndryshme nga pajisja ekzistuese në të cilën është vendosur Mailserver-i. Backup-i i makinës është përcaktuar që të bëhet në mënyrë automatike çdo ditë mbas orës 00.00 am dhe është përcaktuar që të transferohet në mënyrë automatike nga MailServeri në makinën backup çdo ditë mbas mbarimit të procesit të backup-it. **Domain** është i implementuar njëkohësisht në dy makina të ndryshme, të cilat replikojnë me njëra tjetrën. Secila prej tyre shërben si backup, në rast se njëra del jashtë pune, tjetra vazhdon funksionin normalisht pa ndërprerë punën e user-ave të Domainit në Drejtorinë e Përgjithshme të Posta Shqiptare Sh.a. Gjithashtu çdo muaj realizohet një backup manual, që ruhet në ambientet e caktuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Posta Shqiptare sh.a.

Websserver bëhet backup-i i fileve një here në javë (çdo të premte) në mënyrë manuale. Këto të dhëna transferohen në serverin backup të website-it. Pas transferimit në serverin backup,

bëhet restore.

Në **Database Server** ndodhen 2 baza të dhënash, për të cilat realizohen procedura backup-i (me schedule) çdo ditë dhe për dy prej tyre ruhen deri në 10 kopje, për secilën. Për bazën tjetër të të dhënave, ruhen 2 kopje brenda në server (në direktorinë e Backup). Për raste të mundshme dëmtimi, hiqet kopja e fundit e secilës bazë të dhënash (me FTP) dhe ruhet përkohësisht jashtë serverit.

Një herë në muaj bëhet backup-i i të dhënave të Database-it qendror, i cili ruhet në Server dhe 2 kopje të tij, transferohen në serverat backup (server raporte), i cili ndodhet në dhomën e serverave pranë Drejtorisë së Përgjithshme Posta Shqiptare sh.a., dhe një kopje (dmp file) transferohet (me ftp) në serverin. Backup-i fillon në orën 00:01 të ditës në vazhdim. Një specialist IT kontrollon nëse procesi dhe transferimi ka përfunduar në rregull, si dhe hapësirën e mbetur për backup-in pasardhës. Në ditën e transferimit, i bëhet restore vetëm kopjes që transferohet tek Serveri i Raporteve dhe një specialist IT verifikon nëse restore ka përfunduar në rregull.

▪ **Infrastruktura Server/Application**

Posta Shqiptare ka të organizuar në mënyrë profesionale sistemet e backup duke u bazuar në software të dedikuar BACKUP/Replication përmes kompanisë Veeam, e cila ka prodhuar software të dedikuar për ruajtjen dhe garantimin e sistemeve si dhe databazave.

Dhoma e serverit që ndodhet në godinën qendrore të Posta Shqiptare dhe DRC që ndodhet në filialin Tranzit të Posta Sh.a, në Kinostudio, replikojnë me njëra tjetrën në kohë reale dhe janë të lidhura me dark fibër që ofrohet nga operatori ekonomik (A.) që i ofron shërbimin e internetit dhe i mundëson dhe lidhjen ndërmjet dy dhomave të serverëve me anë të linjave të tyre.

Nga auditimi u konstatua se:

- Posta Shqiptare nuk ka një plan testimi për sistemet kyçe, të paktën 1 herë në muaj, duke përdorur Restore si dhe të gjitha replikimet të testohen duke analizuar të dhënat më të fundit në rastin e një strukture me baza të dhënash.
- Posta Shqiptare nuk ka marrë masa për mbrojtjen nga Cyber Security përmes një sistemi inteligjent i cili detekton dhe monitoron në kohë reale të gjitha strukturat Rrjet/Aplikacion/Database/Users si dhe sulme të tipit DDOS.
- Backup-et i kalojnë në një file server të dedikuar për ruajtjen e backup-eve për nuk përdoret enkriptim në transferim.
- nuk realizohet backup për loget e sistemit të hyrje-daljeve të personelit.

➤ **Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat**

Qëllimi i menaxhimit të vazhdimësisë, është të mirëmbahen kërkesat e vazhdimësisë së institucionit. Menaxhimi i vazhdimësisë përfshin rishikimin periodik dhe azhurnimin e afatit të rimëkëmbjes për të siguruar që ato janë në përputhje me Planet e Vazhdimësisë së Biznesit. Vazhdueshmëria a biznesit (BCP) është procesi që një institucion ndjek për të planifikuar dhe testuar rimëkëmbjen e operimit të saj pas një ndërprerjeje.

Auditimi mbi ofrimin e Vazhdimësisë së ofrimin të shërbimeve, u bazua mbi VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, risqeve të identifikuar dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je: “Çdo institucion i cili ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbimit të informacionit për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup), me qëllim mundësimin e ofrimin të shërbimit pa ndërprerje dhe

parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave". Në këtë VKM cilësohet gjithashtu edhe dokumentimi i politikave mbi planin e vazhdueshmërisë së punës dhe rikuperimit nga katastrofat, si dhe të bëhet i mundur evidentimi i sistemeve të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit 24/7.

Posta Shqiptare sh.a ka investuar për ngritjen e një Disaster Recovery Site (DRS) për të garantuar vazhdueshmërinë e biznesit, e cila ndodhet në filialin Tranzit të Posta Sh.a, në Kinostudio. Në DRS ndodhen 25 VMware core për të realizuar procesin e vazhdueshmërisë. Për secilën VMware është përcaktuar sipas prioritetit dhe është konfiguruar Protection Group dhe Recovery Plan. Në konfigurimin e DRS është testuar procedura e kalimit të funksionimit të secilës VMware në disaster Site. Procedura e realizimit dhe garantimit të funksionimit të vazhdimin të shërbimit në Disaster Recovery Site në rast dështimi nga katastrofat të site-t primar, realizohet nga punonjësit e drejtorisë së IT dhe Zhvillimit në bashkëpunim me operatorin ekonomik që realizon mirëmbajtjen e Data Center-it Primar.

Nga auditimi u konstatua se, Posta Shqiptare Sh.a, pavarësisht se ka marrë masa të konsiderueshme për ngritjen e një infrastrukture të nevojshme për sigurimin e vazhdueshmërisë së punës, nuk ka hartuar dokumenta të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013.

Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPOs (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e Sigurisë së Informacionit, mbajnë përgjegjësi z. L. D. në cilësinë e ish-Administratorit të Shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 7, 11 dhe 14 të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe "Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm" përcaktuar në rregulloren e brendshme "Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A", si dhe z. V. A. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Zhvillimit dhe Standardeve, znj. E. C. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve, z. E. K. në cilësinë e ish- Drejtorit të Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit dhe z. A. B. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit, sipas detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në rregulloren e brendshme institucionale "Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A" miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 10, datë 19.11.2021, protokolluar në Postën Shqiptare Sh.a me nr. 1667/12 datë 19.11.2021, si dhe është trajtuar në faqet 98-120 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione mbi Aktkonstatimin nr. 10, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 877/31, datë 06.12.2021.

1. Pretendimi i subjektit:

Dëshiroj tju bëjë me dije:

Nga ana e Drejtorisë së IT vazhdimisht janë marrë masat që të përmbushen kërkesat për sigurinë e informacionit sipas standardeve dhe zhvillimeve në fushën e sigurisë. Varësia e sektorit të sigurisë së informacionit nga drejtoria e IT do të krijonte lehtësinë operationale për të përmbushur detyrimet e Drejtorisë së IT në lidhje me konstatimet tuaja.

1.2. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Fakti është se përgjatë vizitës onsite gjatë fazës së auditimit në terren të zhvilluar nga grupi i auditimit të shoqëruar edhe nga specialisti i drejtorisë së IT-së, në dhomën e serverave u konstatuan problematikat e sqaruara në akt konstatim. Komentet nuk prekin dhe nuk hedhin poshtë konstatimet nga auditimi por në thelb i pranojnë ato. Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo problematikë, për pasojë konstatimi i grupit të auditimit mbetet i njëjtë.

1. Titulli i gjetjes: Dhoma e serverave primare dhe dhoma Disaster Recovery Site nuk plotësojnë standardet e përcaktuara.

Situata 1: Nga auditimi u konstatua se:

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave që ndodhet në zyrat qendrore pranë Postës Shqiptare Sh.a u konstatua:

- Ambienti nuk ka të instaluar një sistem akses kontrolli i cili garanton hyrjen e personave të autorizuar;
- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Kabllimet dhe lidhjet e rrjetit në switch dhe patch panel nuk janë të sistemuar;
- Në paradhomën e serverëve në të cilën janë të vendosur sistemi UPS dhe paneli elektrik, sistemi i kondicionimit ishte jashtë funksionit, kishte prani të lagështirës dhe hyrja në këtë ambient ishte e përbërë nga derë vetratë duralumini, faktor i cili ul nivelin e sigurisë në dhomën e serverëve;
- Nuk ka një plan testimi të sensorëve të zjarrit si dhe mirëmbajtje për sistemin elektrik dhe sistemin backup UPS;
- Nuk bëhen kolaudime për sistemin Antizjarr;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System).

Situata 2: Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në këtë site u konstatua:

Largësia dhe pozicionimi i site-it DRC nuk përputhet me përcaktimet ligjore që parashtrajnë kushtet dhe distancën e ndërtimit të një DRC-je;

- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Nuk është instaluar akses kontrolli për të kontrolluar dhe monitoruar hyrjet dhe daljet e personave në ambientin e DRC. Hyrja në këtë ambient realizohet duke hapur derën me çelës;
- Nuk kishte sensorë për matjen e temperaturës dhe lagështirës;
- Sistemi i kondicionimit nuk ishte efektiv pasi për të arritur ftohjen e duhur të serverëve përdoreshin pajisje të tjera ndihmese, si freskuese;
- Muret e dhomës së serverave në site-in DRC nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (*Kafazi Faraday*).

Kriteri: Rregullorja për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI.

Ndikimi/efekti: Cënim i sigurisë, hyrje e paautorizuara dhe risk humbje të të dhënave

Shkaku: Mos zbatim i bazës rregullatore mbi standardet dhe sigurinë fizike të ambienteve të infrastrukturave kritike.

Rëndësia: E Lartë

1.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverave në bazë të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim ruajtjen e sigurisë fizike të ambienteve të infrastrukturave kritike.

2.Titulli i gjetjes: Mungesë e bazës rregullatore në lidhje me menaxhimin e të dhënave, të drejtat dhe menaxhimin e përdoruesve.

Situata 1: Nga auditimi u konstatua se:

Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i përdoruesve të sistemit Eterna Financiare realizohet nga Sektori i Aplikimit & Administrimit të Dhënave, detyrë kjo e atribuar pa një shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë së Postës Shqiptare sh.a.

-Administratorin e sistemeve eterna postar dhe financiar si dhe IPS (*International Postal System*) dhe CDS (*Custom Declaration System*) e ushtron përgjegjësi i sektorit të aplikimit dhe administrimit të të dhënave në drejtorinë IT dhe zhvillimit. Detyra e Administratorit të sistemit eterna i është atribuar pa asnjë shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë. Pavarësisht se nuk është e emëruar zyrtarisht si Administratore sistemi, ajo ushtron të gjitha detyrat e administratorit të sistemit. “*Administratori i Përgjithshëm*” i sistemit Eterna që ka të drejta universale është kompania Helius e cila ka ndërtuar dhe zhvilluar sistemin Eterna.

-Atributet dhe rolet e userave në sistemin Eterna Postar dhe Financiar nuk janë të përcaktuara sipas detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara në rregulloren e brendshme administrative por sipas funksionaliteteve që punonjësi ushtron në praktikë përgjatë procesit të punës.

- Për periudhën objekt auditimi, Posta Shiptare sh.a. nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve të Sistemit Eterna Financiare dhe Eterna Postare në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve.

Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email. Kërkesat për krijim/aktivizim/çaktivizim apo modifikim të përdoruesve (*ndryshim i zyrës së aksesit apo i profilit të të drejtave*) realizohen me email në dijeni nga Drejtoritë e Shërbimeve përkatëse, ose nga shefja e shërbimit në filialin përkatës apo specialistet e shërbimit.

Ndërsa në sistemin IPS për krijimin e një përdoruesi është kusht krijimi më parë i userit në domain, pastaj krijimi i login-it në bazën e të dhënave i tipit “Windows Authentication”.

Situata 2: Nga auditimi mbi dhënat mbi përdoruesit u konstatuan raste për të cilat “loginID” është e ndryshme nga “fullname”, duke sjellë risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem si dhe duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.

Kriteri: Neni 27, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar; Ligji nr. 2/2017 “*Për sigurinë kibernetike*”; VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Pamundësi në përcaktimin e përgjegjësive të punonjësve në lidhje me administrimin, përdorimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të informacionit. Mos përcaktim dhe mosnjohje e të drejtave dhe detyrimeve që kanë të gjithë përdoruesit e sistemit.

Shkaku: Mungesa e planeve të mirë përcaktuara për zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: E Lartë

2.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që ka në përdorim institucioni, me qëllim pasqyrimin e saktë të përgjegjësive, detyrave dhe të drejtave për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemeve të IT.

2.2.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që Posta Sh.a ka në përdorim me qëllim përcaktimin e përgjegjësive dhe të drejtave të administratorit të sistemeve IT.

3.Titulli i gjetjes: Parregullsi që i adresohen sigurisë së identifikimit të përdoruesit.

Situata: Nga auditimi mbi përdoruesit e sistemit Sistemit Eterna Financiare dhe Eterna Postare u konstatua se:

- Nuk janë aplikuar në sistem kritere të detyrueshme për rritjen e sigurisë së fjalëkalimit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit;

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për përdoruesit fundor të sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten në fjalëkalimin e tyre të aplikohen, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b, të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

-Përdoruesit e rinj nuk aktivizohen automatikisht, nëse opsioni “Aktiv” nuk është zgjedhur, çfarë parandalon së pari veprime të tjera operationale, por dhe si një veprim i shpeshtë i cili duhet të jetë standard.

-Nuk janë aplikuar në sistem kritere të detyrueshme për rritjen e sigurisë së fjalëkalimit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit.

Kriteri: Pika 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a, e rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; Forcimin i fjalëkalimit si element sigurie është në standardin “Two Factor Authentication”.

Ndikimi/efekti: Fjalëkalim i dobët, ndryshon rrallë herë, risk në akses të paautorizuar.

Shkaku: Mos administrim i fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike.

Rëndësia: E Lartë

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit të marrë masa për adresimin e çështjeve të konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit. Të merren në konsideratë praktikatat e përcaktuara në rregulloren për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK. Gjithashtu, të aktivizohen automatikisht:

-Opsioni “Aktiv” për përdoruesit e rinj, çfarë parandalon së pari veprime të tjera operationale, por dhe si një veprim i shpeshtë i cili duhet të jetë standard.

-Ndryshimi i fjalëkalimit me forcë nëpërmjet opsionit “Ndrysho fjalëkalimin në log-imin e radhës”, as në rastet kur fjalëkalimi gjenerohet në mënyrë automatike si emri i përdoruesit për përdoruesit e rinj.

4.Titulli i gjetjes: Keq menaxhim dhe keq administrim i përdoruesve të sistemit Eterna Financiar dhe Postar, duke krijuar kushte për shkelje të sigurisë.

Situata 1: Nga auditimi mbi përdoruesit e Sistemit Eterna Financiare u konstatua se:

- Fusha “user_id” është në formë progresiv rritës, por jo i vazhdueshëm dhe pa ndërprerje, e cila mund të na tregojë se janë fshirë përdorues nga sistemi. Nga verifikimi i përdoruesve në sistem u konstatua se mungojnë 25 “user_id” të përdoruesve. Mungesa e këtyre Id-ve tregon se këto user-a janë fshirë. Nga auditimi u konstatua se për këto veprime nuk është mbajtur asnjë dokument justifikues për fshirjen e këtyre userave.

-Mbajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie pune me Posta Shqiptare sh.a, gjithashtu janë aktiv në sistem dhe punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Postën Shqiptare.

-Në të dhënat mbi përdoruesit rezultojnë 5 raste për të cilat ekziston user i përsëritur.

-Nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e “username” dhe “fullname” ku pjesa më madhe është krijuar me emër.mbiemër për “username” dhe Emër Mbiemër për “fullname”. Në shumë raste ky model nuk është ndjekur dhe rezultuan 57 raste të përdoruesve për të cilët “fullname” është me gërma kapital;

-Emri i plotë “fullname” në disa raste është plotësuar me nga një prapashtesë “GABIM”, “GABIMM”, “_gabim” ose me emër qyteti. Rezultojnë 8 raste me prapashtesën “GABIM”, 1 rast me prapashtesën “GABIMM”, 1 rast me prapashtesën “_gabim”;

-Për “fullname” të përdoruesit rezultojnë 8 raste kur vetëm mbiemri është me gërma kapitale, 3 raste kur emri fillon me germë të vogël, 1 rast kur emri dhe mbiemri fillon me germë të vogël dhe 2 raste kur mbiemri nuk fillon me germë kapitale;

-Rezultojnë 46 përdorues për të cilët “username” dhe “fullname” kanë të njëjtin format emër.mbiemër, si dhe për 2 përdorues “username” është vendosur si standardi i “fullname” dhe “fullname” si standardi i përdorur për “username”;

-Rezultojnë 38 usera të pa identifikuar për financat e filialeve, për këto përdorues është përdorur standard financa.emrifilialit si për fushën “username” dhe “fullname”. 1 rast prej të cilave është i përsëritur. Nga verifikimi i të dhënave mbi përdoruesit rezultojnë user të pa identifikuar. Raste për user-at “burimetraporte”, “ana.test” dhe “eposta”, si dhe për user-at “user2”, “test”, “usertest”, “menaxhertest” për të cilët atributi “last_login” është NULL.

Rezultojnë 298 user-a të cilët atributin e “last_login” e kanë NULL, fakt i cili tregon se për këto user-a është fshirë gjurma e veprimeve të fundit që kanë kryer në sistem.

Situata 2: Nga auditimi mbi përdoruesit e Sistemit Eterna Postare u konstatua se:

- fusha “user_id” nuk është e strukturuar në formë progresive rritëse e cila tregon se mund të jenë fshirë të dhëna nga sistemi dhe sjell risk për komprometimin e të dhënave dhe humbjes së gjurmës audituese;

- mbajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me Postën Shqiptare sh.a.

- emri i plotë “fullname” në disa raste është plotësuar me një prapashtesë me emër qyteti ose fshati. Rezultojnë 12 raste me prapashtesën _PE, Ulez, (Klos), Elb, (eruje), ELBASAN, FIER, (Benj), LIS, Selishte, Macukull dhe (Klos);

- nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e “loginID” dhe “fullname” ku pjesa më madhe është krijuar me emër.mbiemër për “loginID” dhe Emër Mbiemër për “fullname”. Në shumë raste ky model nuk është ndjekur, ku rezultuan 121 raste për të cilat “fullname” është me gërma kapital, ose raste kur atributi loginID përveç formatit emër.mbiemër ka prapashtesë gërma dhe dy raste me numrin “2”;

- për “fullname” të përdoruesit ka 9 raste kur vetëm mbiemri është me gërma kapitale, 4 rast kur emri dhe mbiemri fillon me germë të vogël dhe 1 raste kur mbiemri nuk fillon me germë kapitale;

- janë 39 përdorues për të cilët “loginID” dhe “fullname” kanë të njëjtin format emër.mbiemër, si dhe për 2 përdorues “loginID” është vendosur si standardi i “fullname” dhe “fullname” si standardi i përdorur për “loginID”;

- ekzistojnë 22 user-a me rolin “shofer” për të cilët nuk ka asnjë atribut në sistem. Përveçse atributit mungon edhe identifikimi i userit p.sh, mund të shtohet emër mbiemër për të identifikuar veprimtarinë e gjithsecilit, pasi janë 22 usera me rolin shofer por të pa identifikuar.

- janë 5 usera të pa identifikuar për ZVRPP, për këto përdorues është përdorur standard ZVRPP-Tirana Veri/ ZVRPP-Tirana Jug dhe ZVRPP- Rulale 1/ ZVRPP- Rulale 2 si për fushën “loginID” dhe “fullname”;

- ka usera të pa identifikuar si “test.test”, “fab.test”, “tranzit”, “fier.qender”, “KosovaEMS”, “KosovaPosta” dhe “EternaWeb”. Gjithashtu ekziston user me loginID “silvana.topulli” për të cilën fullname është “d”.

Kriteri: Ligji nr. 2/2017, datë 26.01.2017 “Për Sigurinë Kibernetike”; neni 27 i ligjit nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ISO/IEC 27001 “Information security management”.

Ndikimi/Efekti:

- Risk për komprometimin e të dhënave dhe humbjes së gjurmës audituese
- Risk për ndërhyrje të jashtme, me pasojë dëmtimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.
- Risk për kryerjen e veprimeve në sistem nga persona të paautorizuar.
- Risk për mos-evidentimin dhe mos-parandalimin e problematikave që lidhen me sigurinë e të dhënave.

Shkaku: Mos hartimi dhe miratimi i akteve rregullative.

Rëndësia: E Lartë

4.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të marrë masa për unifikimin e të dhënave për përdoruesit e sistemit Eterna financiare dhe postare të të njëjtës kategori, të plotësojë të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrole për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale të evidentuara nga auditimi në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave mbi përdoruesit e sistemeve Eterna financiare dhe postare.

4.2.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të ndërtojë mekanizma kontrolli për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit e sistemeve, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave që lidhen me sigurinë e të dhënave.

5.Titulli i gjetjes: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare nuk ka zbatuar praktikat me të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network.

Situata 1: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare nuk ka zbatuar praktikat me të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network. Infrastruktura network në Postën Shqiptare menaxhohet pa krijuar grup userash me role të ndara me të drejta konfigurimi.

- Useri admin është i aktivizuar dhe nuk ka një user me emërtim ndryshe me të drejtat e Administratorit si dhe Routerat e ndodhura në filialet e Postës Shqiptare kanë të aktivizuar userin admin.

- Nuk ka të implementuar një procedurë kontrolli të log-eve për të parë erroret ose problemet e ndryshme;

- Posta Shqiptare nuk ka marrë masa për lidhje të dytë Backup, problem që evidentohet në të gjitha Filialet e saj.

Situata 2: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptar nuk ka marrë masa për krijimin e një filtri i cili bllokon një IP të caktuar e cila ka tentuar të aksesojë porta ose subnete kritike.

-Posta Shqiptare për të bërë DST NAT përdor porta standarde Remote Desktop, SSH dhe Telnet;

-Posta Shqiptare nuk ka krijuar grup userash të cilët kanë role të ndara dhe të drejta konfigurimi.

Kriteri: Politikat dhe procedurat formojnë një mjedis të qëndrueshëm menaxherial për komunikimet e brendshme dhe të jashtme. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e ISACA-s), COBIT). Operacionet e rrjetit menaxhohen dhe kryhen në mënyrë të sigurt dhe efektive. (ref. ISO 270002, S15-IT Control (Standardet e ISACA-s), COBIT).

Ndikim/Efekti: Risk për thyerje të sigurisë.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave me të mira të sigurisë.

Rëndësia: E Lartë.

5.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare të marri masa për:

-Konfigurimin në routerin kryesor të një scripti i cili monitoron subnetet ku posta ka shërbimet e saj me qëllim detektimin në rastin e një sulmi ose hyrje të pa autorizuar IP-në e aksesimit dhe në mënyrë automatike ta vendosi në një “blacklist”.

-Të merren masa për të ndryshuar të gjitha portat e aksesimit të serverave, pajisjeve nga standarde në custom pasi sulmet bëhen gjithnjë në portat standarde të aksesimit Remote, me qëllim uljen e riskut për thyerje të sigurisë.

-Të bllokohet useri “admin” dhe të krijohet një user me emërtim ndryshe dhe me privilegje të plota.

-Të krijohen grup userash me të drejta të limituara. Një user i cili shërben për monitorimin SNMP me të drejta vetëm Read dhe një user i cili aksesohet nga stafi me të drejta vetëm Read.

-Të krijohet një procedure e kontrollit të log-eve javore për të parë dhe analizuar a ka patur tentative sulmesh, ose skanime të userit admin.

-Posta Shqiptare duhet të marrë masa për lidhje backup për të gjitha filialet e saj, duke garantuar shmangien e bllokimit të punës në rast të një defekti në lidhjen primare.

Gjithashtu të merren masa për administrimin dhe implementimin e të gjitha konfigurimeve të nevojshme të evidentuara nga auditimi dhe të tjera të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë së infrastrukturës network.

6.Titulli i gjetjes: Pajisjet hardware që Posta Shqiptare ka në përdorim nuk ofrohet me suport nga prodhuesi pasi janë në End of Life.

Situata 1: Posta Shqiptare përdor për storage EMC Clarion i cili shërben për tek datacenteri primar. Gjithashtu është edhe një storage i dytë i cili është IBM Storewize. IBM dhe EMC shërben për makinat virtuale dhe për ruajtjen e të dhënave dhe data bazat e aplikacioneve që Posta ka në përdorim. Storage EMC Clarion është një produkt i cili është End Of Life dhe prodhuesi nuk ofron me suport për këtë model. Nisur nga zhvillimet që Posta Shqiptare ka bërë në sistemet e saj, storage aktualisht ndodhet drejt ezaurimit të hapësirës dhe nevojitet shtimi i kapacitetit të hard drive.

Situata 2: Posta Shqiptare ka në përdorim Fujitsu Blade Server Primergy BX920S2 i cili shërben për hostimin e të gjitha makinave virtuale dhe janë të konfiguruar me Storage IBM dhe EMC. Modeli i Fujitsu Blade Server Primergy BX920S2 nuk ofrohet më suport nga prodhuesi pasi është End of Life.

Kriteri: Politikat dhe procedurat formojnë një mjedis të qëndrueshëm menaxherial për komunikimet e brendshme dhe të jashtme. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e ISACA-s), COBIT). Operacionet e rrjetit menaxhohen dhe kryhen në mënyrë të sigurtë dhe efektive. (ref. ISO 270002, S15-IT Control (Standardet e ISACA-s), COBIT).

Ndikim/Efekti: Mos garantim i vazhdimësisë së punës.

Shkaku: Mos zbatim i rekomandimeve të prodhuesve e praktikave me të mira.

Rëndësia: E Lartë.

6.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në Postën Shqiptare të marri masa për rritjen e kapacitetit të storage apo zëvendësimin e tyre në përputhje me nevojat institucionale që Posta Sh.a ka, duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike për të ardhmen në shoqërinë Posta Shqiptare, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së punës.

7.Titulli i gjetjes: Mungesa e menaxhimit të logeve.

Situata: Nga auditimi u konstatua se Posta Shqiptare sh.a.:

- Nuk disponon akte rregullatore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën e Postës, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06. 2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT). Institucioni duhet të përcaktojë një

rregullore të shkruar për menaxhimin e log-eve sipas kërkesave të institucionit. Kjo rregullore duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi;

- Nuk janë përcaktuar burimet e nevojshme si dhe detyrat e personelit për menaxhimin e tyre;
- Posta Shqiptare sh.a. nuk zhvillon kontrolle mbi Audit Log, pavarësisht rëndësisë që kanë këto të dhëna në përmirësimin e sistemit, konstatimin dhe analizimin e problematikave të ngjashme.

Kriteri: Rregullore për “Menaxhimin e Log-eve digjitale në administratën publike” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 109, datë 10.06.2016.

Ndikimi/Efekti: Risk në sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen, tjetërsimin e tyre.

Shkaku: Mungesa e strukturave për të dhënat në Posta Sh.a, mungesa e pajisjeve fizike për të ruajtur log-et në vend tjetër, mos zbatim i rregullores miratuar nga AKCESK.

Rëndësia: E Lartë

7.1.Rekomandim: Organet drejtuese në Posta Shqiptare Sh.a t’i japin rëndësi sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen dhe tjetërsimin e tyre. Në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

8.Titulli i gjetjes: Audit për Cyber Security

Situata: Nga auditimi u konstatua se, Posta Shqiptare nuk ka marrë masa për mbrojtjen nga Cyber Security përmes një sistemi inteligjent i cili detekton dhe monitoron në kohë reale të gjitha strukturat Rrjet/Aplikacion/Database/Users si dhe sulme të tipit DDOS.

Kriteri: Politikat dhe procedurat formojnë një mjedis të qëndrueshëm menaxherial për komunikimet e brendshme dhe të jashtme. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e ISACA-s), COBIT). Operacionet e rrjetit menaxhohen dhe kryhen në mënyrë të sigurtë dhe efektive. (ref. ISO 270002, S15-IT Control (Standardet e ISACA-s), COBIT)

Ndikim/Efekti: Risk për thyerjes së sigurisë nga sulme DDOS.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave me të mira të sigurisë.

Rëndësia: E lartë.

8.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në Postën Shqiptare të marrë masa për ndërtimin e mekanizmave inteligjent me qëllim monitorimin në kohë reale të të gjitha protokolleve të sigurisë për sistemet e operimit, databazat si edhe protokollat e rrjetit.

9.Titulli i gjetjes: Mungesë e planeve të vazhdimësisë së punës dhe procedurat e backup.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, Posta Shqiptare Sh.a, pavarësisht se ka marrë masa të konsiderueshme për ngritjen e një infrastrukture të nevojshme për sigurimin e vazhdueshmërisë së punës, nuk ka hartuar dokumenta të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013.

Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPOs (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.

-Procedura e hartuar/e ndjekur nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në ndonjë dokument administrativ si rregullore e brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet.

-Posta Shqiptare nuk ka një plan testimi për sistemet kyçe, të paktën 1 herë në muaj, duke përdorur Restore si dhe të gjitha replikimet të testohen duke analizuar të dhënat më të fundit në rastin e një strukture me baza të dhënash.

-Backup-et i kalojnë në një file server të dedikuar për ruajtjen e backup-eve për nuk përdoret enkriptim në transferim.

-nuk realizohet backup për lojet e sistemit të hyrje-daljeve të personelit.

Kriteri: VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar; Standardet nga Autoriteti Kombëtar Për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare (*COBIT dhe Manuali i Auditimit IT*).

Ndikimi/efekti: Humbje e të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.

Shkaku: Mos zbatim i standardeve të sigurisë mbi ruajtjen dhe përpunimin e informacionit

Rëndësia: E lartë

9.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në bashkëpunim me strukturat drejtuese në Postën Shqiptare të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

II.2.4. Auditimi i Sistemeve

Objektivi i Auditimit të sistemeve dhe kontrolleve të aplikacioneve, për të dhënat Input / Output që Posta Shqiptare sh.a administron, është vlerësimi mbi efektivitetin e ndërtimit, operimit të kontrolleve të brendshme dhe saktësinë e funksionaliteteve që lidhen me procese të automatizuara si rezultat i zhvillimit informatik, që shoqëria ka pasur gjatë viteve.

a Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output

Në përmbushje të drejtimit të auditimit “*Auditimi i sistemeve*”, u shqyrtuan dokumentacionet e mëposhtme:

- Përshkrim i përgjithshëm i Sistemit të Teknologjisë së Informacionit në Posta Sh.a;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemet për shërbimet e standardizuara;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e përgjithshme;
- U mor akses me përdorues me të drejta “lexues” në sistemin Eterna, Kibana dhe ndërfaqja e e-Albania e dedikuar për Posta Sh.a;
- Aktet rregullative të shoqërisë që lidhen me sistemet dhe veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit;
- Manualët e përdorimit të sistemeve;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administronin shërbime të caktuara;
- Të dhënat për përdoruesit e sistemeve Eterna Financiare dhe Eterna Postare;
- Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Posta sh.a dhe AKSHI;
- Të dhënat e përdoruesve në e-Albania;
- Evidencat që shoqëria gjeneron për qëllime rakordimi apo raportimi;
- Verifikimi i raporteve në sistemet Eterna.

I. Sistemi Eterna

Auditimi mbi sistemet e teknologjisë së informacionit u fokusua në aplikacionin e quajtur Eterna, i cili është sistemi kryesor për administrimin e veprimeve operacionale në shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, dhe është investimi më i rëndësishëm në teknologjinë e informacionit që është bërë në vitet e fundit në këtë subjekt.

- Eterna Financiare përfshin shërbime financiare si arkëtime, pagesa, shërbime bankare dhe transfertat. Të dhënat “*input*” janë të dhënat e klientit/faturës, për të cilin do të kryhet pagesa, arkëtimi apo transfertat.

- Eterna Postare është një program që mbulon proceset të shërbimeve postare që nga momenti i pranimit të objektit postar deri tek dorëzimi në destinacion. Të dhënat “*input*” janë të dhënat për objektin postar që po pranohet dhe dorëzohet.

Fondi i shpenzuar për sistemet Eterna Postar dhe Eterna Financiar që prej vitit 2012 është në vlerën 176,091,320 lekë pa TVSH dhe 211,309,000 lekë me TVSH ose afërsisht 1.7 milion euro, ndërsa mirëmbajtja deri në mesin e vitit 2023 është 158,200,00 lekë pa TVSH dhe 189,840,000 lekë me TVSH ose afërsisht 1.5 milion euro.

➤ *Mbi funksionalitetet e sistemit Eterna*

Grupi i auditimit në funksion të krijimit të një panorame sa më të qartë të mënyrës së funksionimit të sistemit Eterna dhe duke patur parasysh kompleksitetin e moduleve të sistemin, zhvilloi me praninë e përgjegjëses së sektorit të aplikimit dhe administrimit të të dhënave, demonstrim të funksionaliteteve të sistemit.

▪ Eterna Financiar

Në formën kryesore të aplikacionit janë: Lista e objektivave, Kalendari, Thënia e ditës, Ora, Makina llogaritëse, Shënime, Ditët pushim, Lajme.

Përdorimi i ndarjeve të renditura më sipër, është konceptuar për t'i ardhur në ndihmë çdo përdoruesi të sistemit në mënyra të ndryshme:

- *Lista e Objektivave*. E personalizuar për çdo përdorues. Çdo përdorues është i lirë të shënojë objektivat ditore që lidhen me punën e tij;
- *Kalendari*: Data dhe muaji lexohen nga kompjuteri local (local machine);
- *Thënia e Ditës*: Shprehjet e urta apo motivuese nën këtë rubrikë, lexohen në mënyrë rastësore nga baza e të dhënave dhe i shfaqet çdo ditë secilit përdorues.
- *Data, Ora*: Data dhe ora lexohen nga serveri;
- *Makina Llogaritëse*: Funksionalitet ndihmës për përdoruesin kur është i loguar në sistem që të përlllogarisë pa qenë nevoja të marrë makinën llogaritëse apo ta hapë atë në kompjuter;
- *Shënime*: E personalizuar për çdo përdorues. Secili përdorues mund të mbajë shënime në këtë sesion, por këto shënime përdoruesi nuk i lexon dot ditën e nesërme;
- *Ditët Pushim*: Ditët e pushimit mirëmbahen tek Administrimi i Sistemit/Kalendari i pushimeve.
- *Lajme*: Statike, HTML. Faqet web të renditura tek kjo rubrikë janë:
 - **Shqiptare**
 - o <https://www.zeriamerikes.com/>
 - o <https://www.gazetaexpress.com/>
 - o <http://www.albeu.com/>
 - **Të huaja**
 - o <https://www.bbc.com/>
 - o <https://www.reuters.com/>
 - o <https://www1.cbn.com/>

Nga auditimi mbi rubrikat që përmenden më sipër, u konstatua se:

- “*Ditët pushim*” të vitit 2020 nuk janë populluar në mënyrë të saktë sipas kalendarit të pushimeve të miratuar të po këtij viti, si dhe deri në datë 16.03.2020 ka informacion në lidhje me ditët e pushimit.

- “*Lajme*” është një rubrikë ku përdoruesi mund të informohet nëpërmjet faqeve web që janë përzgjedhur për t'u publikuar, ku faqja e vetë shoqërisë www.postashqiptare.al nuk bën pjesë, edhe pse në këtë faqe publikohen njoftime që duhen lexuar së pari prej punonjësve të saj si mënyra më e mirë për të transmetuar informacionin edhe tek publikun.

▪ Eterna Postare

Në formën kryesore të aplikacionit janë:

- *Të dhëna*: Përmban të dhëna mbi emrin mbiemrin e përdoruesit dhe dega postare ku ai bën pjesë;
- *Thënia e Ditës*: Shprehjet e urta apo motivuese nën këtë rubrikë, lexohen në mënyrë rastësore nga baza e të dhënave dhe i shfaqet çdo ditë secilit përdorues;
- *Menu*: Shfaqet paneli i menuve për përdoruesin.

Regjistrimi dhe trajtimi i ankesave

Kujdesi ndaj Klientit për shqyrtimin e ankesave ndjek hapat si më poshtë: Depozitim i ankesës së klientit realizohet në sportele ose në numrat e kontaktit.

Shqyrtim i ankesës nga ana e Sektorit të Kujdesit ndaj Klientit dhe delegim i saj pranë Drejtorive ose Filialeve përkatëse për informacionet e kërkuara.

Zgjidhja dhe kthimi i përgjigjes klientit brenda 24 orëve, ndërsa për rastet e veçanta zgjidhja dhe kthimi i përgjigjes kryhet brenda 3 ditëve, duke e njoftuar vazhdimisht klientin mbi ecurinë e shqyrtimit të ankesës së tij.

Posta Shqiptare, për regjistrimin dhe trajtimin e ankesave nga ana e klientit, ndjek 4 mënyra:

1. *Në sportel*. Në këtë rast në varësi të shërbimit ankesa mund të merret verbale apo me shkrim sipas formularit përkatës, si për shembull për reklamimet e ndryshme për humbje objektesh

kryhen nëpërmjet formularit të përcaktuar. Informacioni për ankesat në sportel nuk hidhet në sistemet elektronike.

2. *Nëpërmjet Live chat*. Ky modul lejon palët e treta të kryejnë ankimime nëpërmjet chat online. Këto ankesa menaxhohen nga punonjësit e drejtorisë marketing dhe ruajnë chat histori për ankesat. Në periudhën objekt auditimi kjo rubrikë nuk është në funksion pasi faqja web e Postës Shqiptare është në ndërtim e sipër (*po ndërtohet faqe e re web*)
3. *Nëpërmjet numrit të publikuar*. Këto ankesa/ kërkesa trajtohen nga drejtorja e marketing, por nuk regjistrohen në sisteme IT. Të dhënat mbahen në Excel nga specialistët e sektorit të kujdesit ndaj klientit.
4. *Nëpërmjet adresës email (asistence@postashqiptare.al)*. Palët e treta dërgojnë ankesat/ kërkesat drejt një adrese emaili dhe drejtorja e marketingut procedon me shqyrtimin e kërkesë/ankesës. Për këtë ruajnë historikun e email-eve.

Nga auditimi mbi ankesat e qytetarëve u konstatua se:

- *Mesatarja Javore e Ankesave/Përgjigjeve*
 - *Ankesa*
 - 80 ankesa telefonike në ditë
 - 60 e- maile çdo ditë
 - *Përgjigje*
 - 70% e tyre zgjidhen brenda ditës
 - 30% e tyre zgjidhen brenda 3-ditëve sepse, janë në proces për t'ju kthyer përgjigje nga Drejtoritë dhe Filialet përkatëse ku janë drejtuar ankesat nga klientët.

Problematikat janë të larmishme kryesisht, duke filluar me vonesat e mbërritjes së pakove në destinacionin final dhe kërkesat e klientëve për gjurmimin e objekteve postare.

Referuar të dhënave të raporteve ditore, telefonatave dhe emaile-ve evidentohet se problematikat më të ndjeshme qendrojnë me ankesat për vonesat e objekteve postare sipas afateve të paracaktuara që ka shërbimi përkatës.

Ndërsa, në lidhje me problematikat më sporadike janë si më poshtë vijon;

- Gjurmim objektsh postare;
- Reklamime objektsh postare;
- Bllokim objektsh në Doganë;
- Shpërndarje Pensionesh në shtëpi;
- Dëshmi penaltiteti;
- Pagesa e faturave OSHE;
- Informacion për tarifatat e shërbimeve Rekomande;
- Informacion mbi LM (lajmërim, marrjen);
- Legalizim dokumentesh në Ministrinë e Jashtme;
- Rikthim objektsh në origjine pasi kanë kaluar të gjithë afatet sipas rregullores së shërbimit Universal Postar;
- Informacion mbi pagesën e kempit invalid.


50% e telefonatave dhe e-mail-eve janë Gjurmim objektsh postare.

20% e telefonatave dhe e-mail-eve janë kthim përgjigje e Reklamacionit nga vendet marrëse.

30% e telefonatave dhe e-mail-eve janë informacione të ndryshme mbi shërbimin Postar.

-Telefonata dhe e-maile vjetore viti 2020 dhe 2021:

- 38,720 telefonata për vitet 2020-2021
- 29,040 e-maile për vitet 2020-2021



Sektori i kujdesit ndaj klientit është sektori përgjegjës në *Njoftimin dhe Dhënien e Informacionit* për të gjitha shërbimet që Posta Shqiptare Sh.a., ofron si dhe vonesat përkatëse që secili shërbim ka nga situata konkrete.

➤ **Eterna Financiar**

Hyrja dhe identifikimi i përdoruesve të sistemit Eterna Financiar kryhet me emër përdoruesi dhe fjalëkalim.

Fjalëkalimet për përdoruesin bazohen në rregulloren që shoqëria ka hartuar për “*Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, nenin 19 kriteret e të cilit janë:

1. Shumë nga aplikimet dhe sistemet kompjuterike janë të mbrojtura me një fjalëkalim.
2. Për arsye sigurie, këto fjalëkalime duhet të ndryshohen të paktën një herë në 6 muaj.
3. Rregulla mbi përdorimin dhe vendosjen e fjalëkalimeve:
 - a. Fjalëkalimi për aksesimin e burimeve të teknologjisë dhe informacionit (psh kompjuteri, etj) nuk duhet të ndahet me persona të tjerë brenda apo jashtë organit. Punonjësit janë përgjegjës për ruajtjen dhe mos shpërndarjen e këtij informacioni. Fjalëkalimet cilësohen sekrete dhe janë vetjake.
 - b. Gjatë vendosjes së fjalëkalimit, duhet të përfshihen fraza që nuk kanë lidhje me të dhënat personale, si p.sh: emri, adresa, datëlindje etj. Këshillohet të përdorni një fjalëkalim të fortë. Një fjalëkalim i fortë konsiderohet ai që përmban shkronja të mëdha, të vogla, numra dhe karaktere speciale.

Nga verifikimi në aplikacion, për të dhënat që nevojiten në hyrje (input), për krijimin e përdoruesit janë:

- Username;
- Emri i plotë;
- Printerit;
- Lista e profileve për këtë përdorues;
- Lista e zyrave të aksesit për këtë përdorues.

Opsioni “Aktiv” zgjidhet në rastet kur një përdorues mund të jetë larguar me leje të gjatë si raport shëndetësor apo leje lindje. Ky opsion nuk rezulton i zgjedhur në rastin e krijimit të një përdoruesi të ri, opsion i cili parandalon veprime të tjera operacionale ndërmjet përdoruesit dhe suportit teknik, në rastin kur nuk zgjidhet.

Opsioni “Ndrysho fjalëkalimin e radhës” i mundëson përdoruesit që nëpërmjet suportit të kërkojë ndryshim fjalëkalimi në çdo rast të nevojshëm. Përdoruesit i kërkohet nëpërmjet rregullores së sigurisë të ndryshojë fjalëkalimin për të garantuar sigurinë në identifikimin e tyre. Për përdoruesit e rinj, kjo kërkesë mund të garantohet nëse ky opsion do të ishte automatikisht i zgjedhur.

Figura nr. 5: Pamje nga moduli Eterna Financiare, mbi ndryshimin e fjalëkalimit

Username	<input type="text" value="perdorues1"/>	<input type="checkbox"/> Aktiv
Emri i plote	<input type="text" value="perdorues 1"/>	<input type="checkbox"/> Ndrysho fjalëkalimin ne logimin e rradhes
Printeri	<input type="text" value="Matricor"/>	

Lista e profileve per kete perdorues		Lista e zyrave te aksesit per kete perdorues		
+ Shto profil		Dega	Kodi	Qyteti
Profili		<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Fek: Profili Administrator		Posta-Administrata Qendro...	00	TIRANE


Nga grupi i auditimi u zhvilluan disa testime duke provuar identifikimin me fjalëkalim të gabuar me qëllim verifikimin e tentativave gabim në log-im, që bllokojnë përdoruesin. Nga ky testim u konstatua se, në 10 fjalëkalime të vendosura gabim përdoruesi nuk u bllokua. Kjo do të thotë se tentativat për të hyrë në mënyrë të paautorizuar tek një përdorues janë të pakufizuara, me qëllim rritjen e sigurisë që prej identifikimit në sistem të secilit përdorues. Me krijimin e një përdoruesi të ri, fjalëkalimi gjenerohet në mënyrë automatike si emri i përdoruesit dhe mos detyrimi me forcë për ndryshimin e tij, rrit mundësinë e aksesimit të tij nga të tjerë. Gjithashtu, nga testimet e zhvilluara nuk rezultoi të jenë vendosur të detyrueshme kriteret që rekomandohen në rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, për rritjen e vështirësisë së kompozimit të fjalëkalimit si: gjatësia e fjalëkalimit, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij.

➤ *Diagrama e rrjedhës së informacionit për sistemet TIK (Workflow)*

Nga auditimi u konstatua se nuk janë dokumentuar, diagramet e rrjedhës së informacionit², për çdo produkt apo shërbim të konfiguruar në sistemin Eterna Postar apo Eterna Financiar. Gjithashtu nga grupi i auditimit nuk u administrua një dokumentim skematik mbi proceset, rregullat dhe procedurat e implementuara për çdo modul apo shërbim që është informatizuar në sistemin Eterna. Drejtoria e IT dhe zhvillimit, për të identifikuar konfigurimet e nevojshme që duhen kryer në Eterna Financiar apo Eterna Postar sipas rastit, bazohen në ngjashmërinë e produkteve dhe specifikat e çdo kontrate.

Nuk rezulton të jetë dokumentuar, në asnjë formë skematike, procesi me specifikat mbi të dhënat hyrëse, pozicioni përgjegjës, kontrollin, autorizimi dhe procesimi nëpërmjet sistemit në të cilin të dhënat përpunohen për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e tyre, si dhe ruajtja e të dhënave dhe ndryshimi i rekordeve të miratuara.

Tre proceset kryesore që përfshihen në Workflow ilustruar dhe në figurën e mëposhtme janë: Hyrja e të dhënave (Input); Procesimi i tyre dhe Rezultati (Output)



Burimi: Përgatitur nga grupi i auditimit

²Termet që përdoren në gjuhën e TI për rrjedhën e informacionit janë: Workflow, Flowchart

Mungesa e dokumentimit të diagrameve shpjeguese se si informacioni rrjedh në sistemet e TI që mbështesin proceset e institucionet në vazhdimësi të plotësimit të gjurmës së auditimit, krijojnë pengesa në të paktën 3 drejtime, për:

- *Kuptimin*: Diagrami nxjerr në pah zona ku mungon kuptimi i sistemit dhe kontrolleve që janë implementuar në të.

- *Vlerësimin*: Nëpërmjet diagrameve, vetë punonjësit apo strukturat monitoruese mund të zbulojnë pikat e forta dhe dobësitë e kontrollit që është implementuar në sistem.

- *Gjurmimin*: Nëpërmjet diagrameve dokumentohet rruga që përshkon informacioni i regjistruar në sistem, deri në raportimin e të dhënave përfundimtare që janë institucionet tek të cilat shoqëria raporton. Ky gjurmim tek Posta Shqiptare nuk realizohet plotësisht nëpërmjet aplikacionit, si në rastin e evidencave të ndryshme të cilat kryhen manualisht dhe jo bazuar në veprimet të cilat hidhen në sistem.

➤ *Të dhënat Output për sistemin Eterna (Eterna Financiar)*

Përdoruesit, bazuar në të drejtat që ata kanë, gjenerojnë raporte të ndryshme në aplikacionin që janë duke punuar Eterna Postar apo Eterna Financiar. Raportimi nëpërmjet aplikacionit Eterna është organizuar në dy grupime bazuar në datë të quajtur:

- *Pema e Raporteve* - ku gjenerohen raporte me të dhëna të regjistruara për 3 ditët e fundit;

- *Pema e Raporteve (Arkiva)* - ku gjenerohen raporte me të dhëna të regjistruara për më shumë se 3 ditë më parë;

Sinkronizimi i të dhënave me arkivën kryhet disa herë gjatë ditës dhe në orarin e punës, çdo ditë rreth orës 12, një proces ky i cili nga auditimi u konstatua se nuk zgjat më shumë se 10 minuta.

- Nga auditimi mbi modulën e raporteve në të dy sistemet Eterna Financiar dhe Eterna Postar rezultojnë të jenë ndërtuar raporte të konsiderueshme në numër, por të thjeshta për nga përmbajtja. Përdoruesve ju nevojiten disa modifikime në Excel pasi i kanë eksportuar që ti përshatnin për raportet që ju nevojiten. Ky konstatim bazohet në faktin se nuk rezulton të jetë ndërtuar raport veprimesh ditore që ka kryer secili përdorues, por kontrolli që secili përdorues i nevojitet në mbyllje të ditës, realizohet duke gjeneruar raport të veçantë për çdo produkt që është prekur nëpërmjet sistemit duke krijuar një ngarkesë të panevojshme të sistemit dhe të punonjësit për veprime të cilat mund të gjeneroheshin të përmbledhura në një raport të vetëm të detajuar.

Në gjykimin tonë, mënyra e zgjedhur për raportimin që do ti paraqitet çdo përdoruesi për veprimet e tij ditore, rezulton të jetë jo efiçente si për sistemin ashtu dhe për përdoruesin.

Nga auditimi u konstatuan disa parregullsi në sistemin Eterna:

Mbështetur në testimet e ndryshme të zhvilluara në sistemin Eterna rezultuan disa mangësi të sistemit të cilat pengojnë kryerjen e veprimeve automatike, konkretisht:

- Nuk është e mundur në sistem të hidhet kursi ditor për monedhën EUR, apo të ndryshohet;

- Përditësimi i manualeve të Eternës nuk është bërë duke siguruar shtimin e produkteve/shërbimeve të reja;

- Raporti i pagave nga sistemi Eterna Financiar në modulën e burimeve njerëzore tregon se paga neto është e njëjtë me pagën bruto çfarë tregon se të dhënat për të dy fushat regjistrohen manualisht, duke rritur mundësinë për gabime operacionale;

- Fletëdaljet e artikujve dërgohen fizikisht në filiale, dhe po manualisht filiali i regjistron në sistem edhe pse disponojnë një modul magazine nga i cili këto veprime duhet të realizoheshin automatikisht;

- Moduli i blerjeve dhe moduli për menaxhimin e dokumenteve nuk rezultojnë se kanë të dhëna, që do të thotë se nuk janë në përdorim, edhe pse nevoja për të administruar këto të dhëna nëpërmjet sistemit është e madhe.

U konstatuan gjithashtu parregullsi/mangësi në gjenerimin e raporteve të ndryshme të sistemit, konkretisht:

I detajuar

Me komision

Prekje Llogarie

Grupim sipas
clear selection
Perdoruesit
Sherbimit


Nga data
12/11/2020

Ne daten
12/11/2020

Sherbimi
select all clear selection
Abi
Akomodimi i Studenteve
Albtelecom
Ambasada Italiane
Arketime Postari

- Raportet nxjerrin të dhëna për përdoruesit edhe në rastet kur grupimi është zgjedhur sipas shërbimit si në fig., çfarë tregon se opsioni i zgjedhur nuk është konfiguruar si duhet;
- Të gjitha raportet që janë verifikuar, kërkojnë patjetër përpunime në Excel sepse dhe raportet përmbledhëse janë konceptuar në nivel filiali edhe në rastet kur kërkesa për informacion ekzekutohet në nivel republike;
- Nuk ka asnjë opsion të gjenerosh të dhëna për të dy monedhat EUR dhe LEK;
- Nuk ka asnjë raport për përdoruesit, roli dhe zyrat në të cilat kanë akses;
- Përdoruesit i duhet që për çdo shërbim që ka dhënë të gjenerojë raportin ditor për të kryer mbylljen ditore. Në fund të ditës ai duhet të gjenerojë dhe printojë ditar veprimesh edhe pse ky rakordim kryhet dhe nga përgjegjësi i zyrës;
- Përgjatë gjenerimit të raporteve u shfaqen shumë vonesa të shumta në server.

Përgjatë testimeve për të gjeneruar raporte shfaqej herë pas here “error-ri i mëposhtëm”:



Nga auditimi mbi gjenerimin e të dhënave output për modulet Magazina, Moduli i Blerjeve, Inventari, Menaxhimi i Dokumenteve, për përdoruesit rezulton se nuk është ndërtuar asnjë raport në strukturën e raporteve, madje për këto shërbime nuk rezulton se janë hedhur të dhëna me qëllim vënien në funksion të tyre.

➤ Të dhënat Output për sistemin Eterna (Eterna Postar)

Përgjatë administrimit të të dhënave dhe gjenerimit të raporteve me anë të userit të vendosur në dispozicion grupit të auditimit, grupi i auditimit u fokusuar në raportimin e sistemit Eterna Postar e cila është organizuar në grupime sipas specifikës përkatëse.

Pema e Raporteve në sistemin Eterna Postare është e strukturuar si në figurën e mëposhtme.


Nga auditimi u konstatuan disa parregullsi/mangësi në gjenerimin e raporteve të ndryshme përgjatë gjenerimit të raporteve nga pema e raporteve, konkretisht:

Figura nr.6: Pema e raporteve në sistemin Eterna Postare



- sistemi nuk gjeneron raporte dorëzimi për një periudhë të gjatë kohore;
- opsionet RPP035, RPP036 dhe RPP040 të shfaqura si në figurën nr. 2 nuk shfaqin asnjë të dhënë që përdoruesi të përzgjedhi me qëllim gjenerimin e raporteve;
- opsioni RPP040 shfaq një tabelë pa asnjë të dhënë për opsionet e përzgjedhura nga përdoruesi;
- raporte supervizori kanë shumë vonesa në gjenerimin e raporteve.

Figura nr.7: Pema e raporteve në sistemin Eterna Postare (Zyrtare /Popullate i detajuar nivel zyre)




Nga gjenerimi i raportit për opsionin Zyrtare/Popullatë të detajuar në nivel zyre u konstatua se ky raport shfaqet jo i përmbledhur dhe nuk identifikohet se për cilat zyra është kryer shërbimi i caktuar. E njëjta gjë ndodh edhe kur zgjedhim opsionin Zyrtare/Popullate i detajuar nivel qyteti.

Nga intervistat e zhvilluara në zyrat postare Tiranë me punonjësit të cilët janë përdorues të sistemit Eterna Postare grupi i auditimit konstatoi raste kur janë fshirë në mënyrë automatike nga sistemi Eterna Postar, të dhënat e klientit (*marrësit*) i cili do të marrë këtë objekt. Këto raste kanë ndodhur kur pakot nuk i janë dorëzuar klientit përkatës dhe kanë ngelur në zyrat postare, gjë për të cilën punonjësit detyrohen të hedhin përsëri manualisht në sistem duke bërë edhe njëherë popullimin e të dhënave nga fillimi, proces i cili rrit riskun për gabime njerëzore në hedhjen e të dhënave.

Siç është ilustruar dhe në figurën e mëposhtme, pakoja është regjistruar në datën 02.11.2021, për objektin me kodin LT048891451A dhe në datë 05.11.2021, u konstatua se janë plotësuar të dhënat e klientit i cili do të marrë këtë objekt nga punonjësi i postës dhe më pas ato janë fshirë automatikisht nga sistemi.


Figura nr. 8: Dëftesë e gjeneruar nga sistemi Eterna Postare.



Burimi: Grupi i auditimit

Gjithashtu gjatë auditimit në terren mbi përdorimin e Eterna Postare, të dhënat përkatëse për pakot e ardhura duhet të popullohen nga specialistët, si emër, mbiemër, id dhe adresën e pritësit të postës. Në sistem u konstatua se edhe pse një klient (marrës) mund të ishte hedhur njëherë në sistem nga specialisti, të dhënat e tij nuk i shfaqeshin si sugjestion (*pra si propozim ose reminder*) nga sistemi me idenë që këto të dhëna mund të hidhen në mënyrë automatike nga sistemi pa qenë nevoja të ri plotësohen edhe njëherë nga specialisti. Kjo do të lehtësonte punën e specialistëve dhe shpejtonte procesin e hedhjes së të dhënave të klientëve (marrësve) të pakove në sistem.

➤ *Aksesimi i sistemit në Postën Shqiptare sh.a.*



Burimi: Përgatitur nga grupi i auditimit: *Aksesimi i sistemit në PSH sh.a*

Nga auditimi u konstatua se aksesimi i sistemit Eterna është mundësuar vetëm për 2 nivele duke filluar nga niveli Përgjegjës Sektori deri te niveli Specialist. Pra, niveli drejtues që është dhe niveli vendimmarrës, nuk informohet nëpërmjet sistemit, çfarë do i jepte mundësinë të kuptojë problematikat që shfaqen në sistem me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e sistemeve. Niveli drejtues në degën qendrore të cilët kanë qenë dhe vendim marrës lidhur me informatizimin dhe përmirësimin e sistemeve informatike, nuk kryejnë asnjë veprim monitorues, kontrollues, raportues apo autorizues nëpërmjet sistemit.

➤ *Gjurma e auditimit*

Bazuar në nenin 4, pika 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Nga auditimi u konstatua se në Postën Shqiptare sh.a, nuk është dokumentuar gjurma e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, si një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së çdo procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë, jep

informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Bazuar në nenin 16, pika 2 e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, janë titullarët e njësive publike që miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësive.

Kërkesa për gjurmën audituese vlerësohet shumë e rëndësishme nga grupi i auditimit nisur nga fakti që në këtë institucion përpunohen të dhëna personale, për të cilat mbrojtja dhe keqpërdorimi i tyre nuk mund të garantohet sa kohë institucioni nuk ka dokumentuar as mënyrën se si këto të dhëna qarkullojnë.

Për veprimet apo mosveprimet, që janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, grupi i auditimit ngarkon me përgjegjësi z. L. D. në cilësinë e ish -Administratorit të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

➤ *Të dhënat e informatizuara dhe të dhënat e pa informatizuara në sistemin Eterna Financiar.*

Shërbime të Biznesit

Nr.	EMËRTIMI	Në Sistem	Jo në Sistem
<i>Nga Biznesi (gjithsej)</i>			
1	Shitje Zarfi (Zarfet të cilët blihen për të mundësuar shërbimin e kërkuar)	Shërbime të veçanta te postari	manual
2	Fotokopje		manual
3	Shitje shtypi		manual
4	Kupona karta ID		manual
5	Kupona Pasaporte 7500 lek		manual
6	Kupona Pasaporte 18000 lek		manual
7	Rimbushje elektronike Telecom	sistemi asbs	
8	Rimbushje elektronike Vodafone	sistemi asbs	
9	Rimbushje elektronike Eagle	sistemi asbs	
10	Abonime Tring	sistemi asbs	
11	Rimbushje Digitalb	Sistemi gramo	
12	Shitje kartash (TeleSwiss)	Eterna Financiare - pagesa të përgjithshme (është zëvendësuar me Global Tel)	
13	Shitje dekoderash Neutron	Sistemi i neutron	
14	Shitje produkte Lotaria Kombëtare	Eterna Financiare - pagesa të përgjithshme (është mbyllur)	
15	Shitje të tjera	Eterna Financiare - pagesa të përgjithshme	

Zëri 15 i detajuar “Shitje të Tjera” Shërbimi Biznesit

Nr.	Përshkrim	Në Sistem	Jo në Sistem
1	Shitje Kutit ambalazhi	Sistem (eterna Postare në modul Shërbime të veçanta)	
2	Shitje Skoç për ambalazh	Sistem (eterna Postare në modul Shërbime të veçanta)	
3	Arkëtimet nga e-Albania	Sistem (Portali e-albania dhe Eterna)	
4	Shitje e Librezave FSHU dhe Ujësjellës	Sistem (Pagesa të Përgjithshme)	
5	Arkëtimet nga e-Albania	Sistem (Portali e-albania dhe Eterna)	
6	Shitje të pullave për filatelinë		Manuale

Shërbimi Financiare dhe Bankare


Nr.	Emërtimi	Në sistem	Jo në sistem
I	ARKËTIMET		

1	Tatim taksa gjithsej		
a	Tatime	Eterna Fianciare - modul më vete	
*	Për llogari të tatimeve	Eterna Fianciare - modul më vete	
*	Për llogari të Bashkive	Eterna Fianciare - modul më vete	
b	Taksa	Eterna Fianciare - modul më vete	
*	Për llogari të tatimeve	Eterna Fianciare - modul më vete	
*	Për llogari të Bashkive	Eterna Fianciare - modul më vete	
2	Tarifa shkollimi	Eterna Fianciare - modul më vete	
3	Arkëtim Kontribut sigurime shoqëror		
a	Kontribut vullnetar	Eterna Fianciare - pagesa të përgjithshme	
b	Kontribut bujku privat	Eterna Fianciare - pagesa të përgjithshme	
4	Pulla takse		manual
5	Arkëtim Energji	Eterna Fianciare - modul më vete	
6	Arkëtim Uji	Eterna Fianciare - modul më vete	
7	Arkëtim Qera		manual
8	Arkëtime telefonike	Eterna Fianciare - modul më vete	
9	Arkëtime Doganore	Eterna Fianciare - modul më vete	
a	Arkëtime doganore	Eterna Fianciare - modul më vete	
b	Zhdoganime	Eterna Fianciare - modul më vete	
10	Gjobat e policisë	Eterna Fianciare - modul më vete	
11	Legalizimet	Eterna Fianciare - modul më vete	
12	Dëshmi penaliteti	Eterna Fianciare - modul më vete	
13	Ark. Kopshte Çerdhe	Eterna Fianciare - modul më vete	
14	Arkëtime D.P.Arkivave	Eterna Fianciare - modul më vete	
15	Ark. Blerje on-line (brd.vendit)	Eterna Fianciare - pagesa te përgjithshme	
16	Arkëtim të Hipotekës ZVRPP	Eterna Fianciare	
17	Arkëtim detyrimi Digicom	Eterna Fianciare	
II	PAGESAT		
1	Pensionet:	Sistemi ISSH	
a	në qytet	Sistemi ISSH	
b	në fshat	Sistemi ISSH	
c	Ushtarakëve në lirim	Sistemi ISSH	
d	Minatorëve	Sistemi ISSH	
2	Leje lindje	Sistemi ISSH	
3	Pagesë shërbim funeral		manual
4	Papunësisë	Eterna Fianciare	manual
5	Rimb. librit shkollor	Eterna Fianciare	manual
6	Pagesa për llogari të Bashkive	Eterna Fianciare	
a	Ndihma ekonomike	Eterna Fianciare	
b	Persona me aftësi të kufizuar	Eterna Fianciare	
7	Pagesa për llogari të komunave	Eterna Fianciare	
a	Ndihma ekonomike	Eterna Fianciare	
b	Persona me aftësi të kufizuar	Eterna Fianciare	
III	Transporti i mësuesve		manual
IV	Transporti i nxënësve		manual
V	Nacional bingo		Manual (mbyllur kontrata)
VI	Të tjera		manual
	Shërbim financiar gjithsej		
I	TRANSFERTAT		
I	Urdhër-pagesa postare:		manual
a	UPP të pranuar		manual
b	UPP të paguara		manual
c	UPP telegrafike	-	
2	Urdhër-derdhje	-	

3	Money Gram		
a	Të pranuar	Sistemi i Money gram	
b	Të paguara	Sistemi i Money gram	
4	Eurogiro:		
a	Eurogiro të pranuar	Sistemi Eurogiro	
b	Eurogiro të paguara	Sistemi Eurogiro	
5	Cash to Cash	Eterna Fianciare - modul më vete	
II	Këmbim valutor		manual
III	Bono thesari	Eterna Fianciare - modul më vete	
IV	Pagesa pagash	-	
V	Pagesa Kredi & Mikrocredi	Eterna Fianciare	
	Shërbim Bankar gjithsej		

Nga auditimi mbi shërbimet që shoqëria Posta Shqiptare sh.a ofron për shtetasit shqiptarë, rezulton se rreth 20 shërbime kryhen në mënyrë manuale jashtë sistemit Eterna Financiar apo Eterna Postar.

Figura nr. 9: Skema e konceptuar nga grupi i auditimit sipas së cilës realizohet kryerja e shërbimit manualisht jo në sistem



Burimi: Grupi i auditimit


Aksesimi në sisteme të ndryshme. Punonjësit operacional në Postën Shqiptare aksesojnë disa sisteme për ofrimin e shërbimeve. Shërbimet më të shumta ofrohen nëpërmjet sistemeve kryesore të Postës, Eterna Financiar dhe Eterna Postar. Përveç sistemeve që Posta disponon, punonjësit e saj aksesojnë sisteme të tjera që kryejnë veprime dhe raporte mbi shitjet e kryera që administrohen në sistemet, konkretisht:

- Portali i pagesave të pensioneve;
- Neutron;
- Digitalb;
- E-Albania;
- Eurogiro;
- Moneygram;
- Digitalb;

Nga auditimi mbi shërbimet që kryhen në sisteme të ofruara nga palë të treta u konstatua se, shoqëria ka të drejta operacionale, por dhe administrative për veprimet e regjistruara në sistem nga punonjësit e saj. Nuk është vlerësuar në asnjë rast importimi i të dhënave ditore nga sistemet e të tretëve në sistemin financiar Eterna, me qëllim ruajtjen e tyre në sistemin e brendshëm të postës, nga ku këto të dhëna mund të ripërdoren për efekt kontrolli apo raportimi. Konkretisht po përshkruajmë disa shembuj shërbimesh të cilat ende nuk janë integruar dhe automatizuar në sistemin ETERNA:

Nga auditimi mbi shërbimet, që shoqëria Posta Shqiptare sh.a ofron për shtetasit shqiptarë, u konstatua se shërbimet që kryhen nëpërmjet portalit e-albania, kërkohet të regjistrohen manualisht në sistemin Eterna Finaciare, po ashtu dhe fatura printohet nga sistemi nëse regjistrimi është kryer.

Figura nr. 10: Skema e konceptuar nga grupi i auditimit sipas së cilës realizohet kryerja e shërbimit pjesërisht të informatizuar



Burimi: Grupi i auditimit

1. Shërbimi i gjenerimit të dokumenteve në e-Albania

Me shkresën nr. 221, datë 25.01.2019 ndërmjet Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Posta Shqiptare është nënshkruar një marrëveshje “Për shërbimet publike elektronike në portalin unik qeveritar e-Albania”, me objekt ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania ndaj subjekteve fizikë dhe juridikë, shtetëror dhe privat.

Mbështetur në marrëveshjen e sipërcituar Administratori i Posta Sh.a ka nxjerrë udhëzimin “Mbi kryerjen e shërbimit bazuar në marrëveshjen e lidhur me AKSHI-n” miratuar me shkresën nr. 221/1, datë 28.01.2019.

Sipas këtij udhëzimi zyrat e postës shqiptare do të ofrojnë shërbime qeveritare nëpërmjet portalit e-Albania në përmbushje të shtetasve shqiptar dhe ata të huaj kur është e mundur. Sipas udhëzimit për bizneset ofrohen 10 shërbime dhe për qytetarët ofrohen 13 shërbime. Sipas përcaktimeve të udhëzimit të sipërcituar tarifa, që Posta Sh.a do të përfitojë për kryerjen e shërbimit në portalin e-Albania e cila do të paguhet nga shtetasi që do të përfitojë shërbimin, është si më poshtë:

Produkti	Mënyra e pagesës së komisionit
Dokument për qytetarët (50 lekë)	Komisioni paguhet nga klienti
Dokumente për subjektet biznese (100 lekë)	Komisioni paguhet nga klienti

Shërbimi bazuar në marrëveshjen me AKSHI funksion si më poshtë:

- Punonjësi logohet me përdoruesin personal në portalin **e – Albania**, gjeneron nga portali dokumentin e kërkuar, nga shtetasit biznes / qytetar i cili është paraqitur me një dokument identifikimi
- Për tarifimin e shërbimit punonjësi logohet në sistemin **Eterna Financiare**
- Shërbimi kryhet në modulin “**Pagesa të Përgjithshme**”.
- Në listën e shfaqur të llogarive, zgjidhet llogaria **e – Albania**

Kodet e transaksioneve që zgjidhen janë:

5581 – Komision formular e – Albania individ (shfaqet automatikisht tarifa 50 lekë /dokument);

5582 – Komision formular e-Albania biznes (*shfaqet automatikisht tarifa 100 lekë /dokument*). Për pensionistë që tërheqin pensionet pranë Postës Shqiptare me prokurë/ autorizim, për të cilët është e nevojshme rinovimi i certifikatës personale sipas afateve të përcaktuara në marrëveshjen me ISSH, nuk mbahet komision për printimin e certifikatave. Shërbimi në këtë rast kryhet vetëm në portalin e-Albania dhe nuk regjistrohet në sistemin Eterna.

- Në fushën përshkrimi shënohen të dhënat e shtetasit emër mbiemër, dhe printim dokumenti e-Albania, lloji i dokumentit për biznes apo individ.
- Punonjësi pasi regjistron transaksionin nëpërmjet komandës Prano/ Posto, gjeneron nga sistemi Eterna Financiar, mandatin e arkëtimit.

Drejtorja e Shërbimeve Bankare & Financiare, që kryen dhe monitorimin e këtij shërbimi në zyrat qendrore të Postës Shqiptare, shprehet se:

- Aksesimi i portalit e - Albania nga Posta Shqiptare është në nivel përdoruesi /supervisor / administratori;
- Punonjësit që kryejnë këtë shërbim janë të pajisur me përdorues (usera) respektivë në portalin e – albania;
- Çdo filial gjeneron raporte përmbledhëse nga të dy sistemet Eterna Financiare dhe e-Albania duke i krahasuar, në funksion të rakordimeve periodike.

Grupi i auditimit e vlerësoi ofrimin e shërbimeve nga e-albania si një shërbim që shfaq risk të lartë për vet mënyrën se si administrohet, në dy sisteme të ndryshme, ku nga njëri sistem jepet shërbimi dhe nga tjetri faturimi.

Me qëllim thellimin e auditimit mbi të dhënat që administrohen në dy sisteme, u vlerësua e domosdoshme kryqëzimi i të dhënave gjeneruar nga e-Albania me të dhënat e gjeneruara nga Posta Shqiptare Sh.a (*Eterna Financiare*), në lidhje me bazën rregullatorë dhe printimin e dokumenteve nëpërmjet portalit e-Albania rezultuan disa parregullsi të cilat renditen më poshtë:

- Vlefshmëria e marrëveshjes së lidhur ndërmjet dy institucioneve ka përfunduar dhe rrjedhimisht edhe vlefshmëria e udhëzimit (*pikat 5.1 dhe 5.2, të nenit 5, Kohëzgjatja të marrëveshjes*). Posta shqiptare vazhdon ta ofrojë këtë shërbim edhe pse marrëveshja e ka mbaruar vlefshmërinë e saj.

- Nga verifikimi në modulën e e-Albania për ofrimin e shërbimeve nga Posta Sh.a, u konstatua se numri i shërbimeve që ofrohen nga Posta Shqiptare është më i lartë se ai që është i përcaktuar në udhëzimin e sipërcituar. Janë 8 shërbime më shumë nga sa është përcaktuar në udhëzimin për kryerjen e shërbimeve që ofrohen (*për qytetarët dhe bizneset*).

- Veprimtaria ose shërbimi që më parë ofrohej nga zyrat e gjendjes civile është zëvendësuar nga zyrat postare duke dalë jashtë objektivit strategjik të qeverisë, ku qytetarët duhet të marrin dokumente pa radhë, pa kosto dhe elektronikisht.

- Nga auditimi mbi aktet rregullative që disponon shoqëria Posta Shqiptare rezulton se rregullorja për mbrojtjen e të dhënave personale, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. me vendimin nr. 43, datë 28.12.2015 dhe e përditësuar në vitin 2019 e cila është ende e pa miratuar, tregon se nuk janë marrë masat e nevojshme nga Posta Shqiptare për sigurinë e të dhënave personale si detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, neni 20 “*Detyrimet e përpunuesit*”, neni 21 “*Përgjegjësia për të njoftuar*” dhe neni 27 “*Masat për sigurinë e të dhënave personale*”. Kjo do të thotë se punonjësit e Postës Shqiptare nuk janë të informuar se nëpërmjet shërbimeve e-albania janë duke punuar me të dhëna personale të shtetasve, të cilat mbrohen me ligjin e përmendur më lart.

- Në disa raste, i njëjti punonjës rezulton të ketë më shumë se dy përdorues aktiv tek e-Albania. Gjithashtu, ka punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Posta Shqiptare dhe

rezultojnë të kenë përdorues aktiv për leximin e shërbimeve nga e-Albania, nën llogarinë e shoqërisë.

Veprimet dhe mosveprimet e shoqërisë Posta Shqiptare janë në kundërshtim me:

a. Nenin 27, pikat b, c, ç, ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”;

b. Nenin 3, pikat 3.1.4 dhe 3.1.8 të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Posta Shqiptare me nr. 221 prot, datë 25.01.2019 dhe AKSHI-t me nr. 439 prot, datë 25.01.2019.

- Në asnjë nga zyrat që vizitoi grupi i auditimit në Tiranë, tarifat për shërbimet e gjeneruara nga e-albania nuk janë të afishuara në sportelet e shërbimit në kundërshtim me nenin 4, pika 4.1 të marrëveshjes ndërmjet dy institucioneve.

- Përgjatë vitit 2019, filialet duke qenë të pa udhëzuar saktë, i kanë raportuar shërbimet e-albania si të ardhura në zëra të ndryshëm. Kjo do të thotë se drejtoria ekonomike e ka pothuajse të pamundur të evidentojë numrin e rekordeve për të cilat është arkëtuar. Për vitin 2020, ky shërbim identifikohet si shërbim biznesi pavarësisht faktit se dokumenti mund të tërhiqet si biznes apo individ.

Sipas të dhënave të gjeneruara nga moduli i e-Albania për Posta Shqiptare, numri i printimeve nga e-Albania është 198,585³ dokumente që mendohet të jetë dhe numri i transaksioneve për të cilat është arkëtuar një komision. Nga sistemi Eterna Financiar në total dalin 62,292 transaksione.

Për veprimet dhe mosveprimet që shoqëria Posta Shqiptare ka kryer në lidhje me administrimin e shërbimeve që ofrohen nga platforma e-albania, të cilat prekin të dhëna personale të shtetasve dhe janë administruar në kundërshtim me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, marrëveshjen ndërmjet institucioneve, ngarkohet me përgjegjësi ish-Administratori i shoqërisë z. L. D.

2. Shërbimi i Rimbushjeve Elektronike

Bazuar në marrëveshjen me A. S. B. S., pranë sporteleve të Posta Shqiptare shërbimi i rimbushjeve dhe arkëtimit të faturave të Vodafone kryhet në sistemin e mundësuar nga kompania A. S. B. S.. Sistemi është i aksesueshëm nga Posta Shqiptare në nivel operacional dhe administrator për kryerjen e shërbimit dhe gjenerimin e raporteve mbi volumet e arkëtimeve. Punonjësja logohet në modul edhe kryen aktivitetin e arkëtimeve të rimbushjeve dhe faturave të Vodafone. Pas përfundimit të transaksionit klienti pajiset me mandatin e arkëtimit që në të dy rastet gjenerohet nga sistemi. Punonjësit disponojnë manualin e përdorimit të sistemit të rimbushjeve elektronike.

Moduli i rimbushjeve dhe arkëtimit të faturave të Vodafone është moduli i vetëm i vendosur në Sistemin Eterna Financiare edhe pse rimbushja kryhet nëpërmjet sistemit të mundësuar nga kompania private që kërkon kryerjen e këtij shërbimi.

3. Shërbimi i shitjes së zarfeve

Produkti *Zarfe i madhësive të ndryshme* është një produkt biznesi që ofrohet për klientët që përdorin shërbimin Postar gjatë pranimit të një objekti postar në sportel, për përpunimin e pensioneve në familje, por ofrohet edhe për klientët si produkt me vete.

- Në rastet e ofrimit të Zarfit, për klientët që postojnë një objekt postar, shërbimi i shitjes pasqyrohet në sistemin Eterna Postare në modul Shërbime të Veçanta, dhe vlera e tij pasqyrohet në mandatin (dëftesën e pranimit) që gjenerohet nga sistemi.

³ Në këtë shifër duhet patur parasysh se për pensionistët që tërheqin pensionin te Posta Shqiptare sportelisi gjeneron për çdo periudhë 6 mujore certifikatën personale të pensionistit të cilat nuk faturohen dhe nuk hidhen në sistemin eterna financiare dhe ka raste kur për të njëjtin klient certifikatat gjenerohen më shumë se një herë kur ka shpëputje të networkut, atëherë nga e-Albania gjenerohet dy herë dhe llogaritet si log i veçantë.

- Zarfet ofrohen si produkt për pagesat e pensioneve në familje. Tarifa e shërbimit të pensioneve në familje është 100 lekë, në të cilin përfshihet 90 lekë vlera për shërbimin postar dhe 10 lekë vlera e zarfit. Vlerat e zarfeve pasqyrohen në ditarët e arkëtimeve bazuar në udhëzimet mbi procesin e arkëtimeve dhe pagesave.
- Në rastet kur ofrohet për klientët si produkt biznesi, shërbimi kryhet manualisht, klienti pajiset me një mandat arkëtimi që pasqyron vlerën e produktit.

4. Shërbimi i shitjes së Shtypit

Bazuar në marrëveshjet me organet e shtypit shqiptar dhe të huaj, nga Posta Shqiptare ofrohet shërbimi i abonimeve vjetore mbi shpërndarjen periodike të shtypit të shkruar për Institucionet. Shërbimi i shtypit të shkruar ofrohet edhe në sportelet e zyrave postare. Shërbimi kryhet manualisht, klienti pajiset me një mandat arkëtimi që pasqyron vlerën e produktit.

5. Shërbimi i shitjes së kuponëve të ALEAT

Bazuar në marrëveshjen e lidhur me ALEAT, pranë sporteleve të Zyrave Postare ofrohet shërbimi i shitjes së kuponëve që shërbejnë për aplikimet e klientëve mbi pajisjen nga ALEAT me Karta Identiteti dhe Pasaporta. Produktet janë të specifikuara si më poshtë:

- Kuponu ID me vlerë 1,500 lekë (për aplikimet Kartë Identiteti)
- Kuponu Pass me vlerë 7,500 lekë (për aplikimet Pasaportë)
- Kuponu Pass me vlerë 18,000 lekë (për aplikimet Pasaportë me shërbim fast track)

Klientit i ofrohet produkti i cili vuloset me vulën e personalizuar të sportelit dhe mandati i arkëtitimit mbi depozitimin e vlerave monetare, në zbatim të udhëzimeve mbi rregullimin e proceseve të arkëtimeve dhe pagesave.

Shërbimi i Shitjes së Kuponëve të Aleat kryhet manualisht në sportel.

6. Shërbimi i shitjes së Pullës së Taksës

Posta Shqiptare në bashkëpunim me Degën e Tatim Paguesve të Mëdhenj kryen në sportelet e Zyrave Postare Shërbimin e Shitjes së Pullave të Taksës, të cilat kryesisht shërbejnë për tarifimin e shërbimit noterial. Pullat e taksës janë të prerjeve:


- Pulla takse me vlerë 50 lekë
- Pulla takse me vlerë 100 lekë
- Pulla takse me vlerë 200 lekë

Klientit i ofrohet produkti dhe mandati i arkëtitimit mbi depozitimin e vlerave monetare, në zbatim të udhëzimeve mbi rregullimin e proceseve të arkëtimeve dhe pagesave.

Shërbimi i Shitjes së Pullave të Taksës kryhet **manualisht** në sportel.

Nga auditimi mbi shërbimet, që shoqëria Posta Shqiptare sh.a ofron për shtetasit shqiptarë, rezulton se një numër i lartë shërbimesh kryhen nëpërmjet sistemit Eterna, pra rekordet regjistrohen në këtë sistem, po ashtu dhe fatura printohet nga sistemi.

Figura nr. 11: Skema sipas së cilës u konceptua nga grupi i auditimit kryerja e shërbimeve të informatizuara



Burimi: Përgatiti Grupi i auditimit

7. Shërbimi i arkëtimeve të blerjeve on - line

Bazuar në kontratat respektivë me subjektet, Posta Shqiptare ofron shërbimin e pranimit, përpunimit, transportit, dorëzimit dhe shërbimit të arkëtimit të vlerës së produkteve në dorëzim *cash on delivery*, për blerjet on – line të realizuara për 9 subjektet që operojnë me posta Shqiptare.

Nr	Subjektet	Mënyra e pagesës së komisionit
1	Subjekti A. Sh.	Komisioni paguhet nga subjekti
2	Subjekti Librari Al.	Komisioni paguhet nga subjekti
3	Subjekti Bio – P. F.	Komisioni paguhet nga subjekti
4	Subjekti F. L.	Komisioni paguhet nga subjekti
5	Subjekti Al. P. D.	Komisioni paguhet nga subjekti
6	Subjekti AL - Ch.	Komisioni paguhet nga klienti
7	Subjekti L. S.	Komisioni paguhet nga klienti
8	Subjekti F.	Komisioni paguhet nga klienti
9	Subjekti S. M.	Komisioni paguhet nga klienti

Shërbimi i arkëtimeve të kryera **Cash on Delivery**, për llogari të subjekteve për blerjet on – line kryhet në sistemin Eterna Financiare, në modulën **“Pagesa të Përgjithshme”**. Për çdo subjekt është krijuar llogari në sistem, ndërsa shërbimi kryhet duke ndjekur hapat si më poshtë:

- Në sistemin Eterna Financiare në modulën **“Pagesa të Përgjithshme”**, në dritaren e arkëtimit klikojmë **“Llogaritë”** dhe zgjedhim llogarinë përkatëse të Subjektit që i përket arkëtimi.
- Zgjedhim kodin e transaksionit **5514 – Arkëtim për blerje on-line**
- Në fushën **“Shuma”** vendosim vlerën e objektit bazuar në faturën shoqëruese të tij, dhe klikojmë komandën **“Prano”**.
- Bazuar në skemat e komisioneve për çdo kontratë të blerjeve on-line, në rastet kur komisionin e paguan klienti, duhet të pasqyrohet në mandat edhe transaksioni i komisionit. Për këtë zgjedhim kodin e transaksionit **354 – Komision Shërbimi**, në fushën **“Shuma”** vendosim vlerën e komisionit në bazë të skemës dhe klikojmë komandën **“Prano”**.
- Për përfundimin e transaksionit klikojmë **“Posto”** dhe në këtë moment gjenerohet mandati i arkëtimit në të cilin pasqyrohet vlera e objektit dhe komisioni i shërbimit.

8. Shërbimi i shitjes së Librave N. dhe A.

Bazuar në marrëveshjen e lidhur me Kompaninë N. Sh.p.k dhe Librari A., Posta Shqiptare kryen në sportelet e Zyrave Postare shërbimin e shitjes së produkteve libra.

<i>Produktet</i>	<i>Paketimet</i>	<i>Mënyra e pagesës së komisionit</i>
<i>Librat N.</i>	<i>Paketime 10 libra me vlerë 1,500 lekë</i> <i>Paketime 7 libra me vlerë 1,050 lekë</i> <i>Paketime 5 libra me vlerë 750 lekë</i>	<i>Komisioni paguhet nga subjekti</i>
<i>Librat A.</i>	<i>Paketime 5 libra me vlerë 3,100 lekë</i> <i>Paketime 3 libra me vlerë 1,800 lekë</i>	<i>Komisioni paguhet nga subjekti</i>

Shërbimi i shitjes së produkteve më lart kryhet në sistemin Eterna Financiare në modulën **“Pagesa të Përgjithshme”**. Secili nga subjektet kanë llogarinë e tyre në sistem. Shërbimi i shitjes në sistem kryhet si për shërbimin me lart të blerjeve on – line.

Zgjedhin llogaritë:

- **“Biblioteka ime”** për librat e shtëpisë botuese N.
- **“Librari A.”** për librat e shtëpisë botuese D. A.

Për Librat N. zgjedhim kodet e transaksionit në sistem:

- 631 – Arkëtim Libri Familjes, 10 libra
- 632 – Arkëtim Libri Shqip, 7 libra
- 633 – Arkëtim Libri për Fëmijë, 5 libra

Për Librat A. zgjedhim kodet e transaksionit në sistem:

- 5677 – Arkëtim Libri A., 5 libra
- 5678 – Arkëtim Libri A., 3 libra

Vlerat e çdo paketimi shfaqen automatikisht me zgjedhjen e kodeve me lart të transaksionit. Duke qene se për këto shërbime nuk aplikohet komision në sistem për klientin, nuk zgjidhet kod transaksioni për Komisionin. Pasi përfundon transaksioni, nga sistemi gjenerohet mandati i arkëtimit në të cilin pasqyrohet vlera e arkëtuar.

9. Shërbimi i shitjes së Librezave të Energjisë Elektrike & Ujit si dhe Librezave FSHU

Bazuar në marrëveshjen e lidhur me Kompaninë Inpres Sh.p.k dhe Teledoc Albania Sh.p.k, Posta Shqiptare kryen në sportelet e Zyrave Postare shërbimin e shitjes së produkteve:

<i>Produktet</i>	<i>Mënyra e pagesës së komisionit</i>
<i>Librezat FSHU, vlerë 50 lekë</i>	<i>Produkt biznesi Çmimi i shitjes - Çmimi blerjes</i>
<i>Libreza të Ujit dhe të Energjisë Elektrike , vlerë 50 lekë</i>	

Shërbimi i shitjes së produkteve me lart kryhet në sistemin Eterna Financiare në modulën **“Pagesa të Përgjithshme”**. Ndiqet e njëjta procedure si për shërbimet me lart

Zgjedhim llogaritë:

- **“Libreze Energjie FSHU”**, për librezat bazuar në kontratën me XXXXXXXXXX
- **“Libreze Uji dhe Energji Elektrike”**, për librezat bazuar në kontratën e dhurimit me kompaninë Teledoc Albania.

Për Librezat FSHU dhe Librezat e Ujit dhe të Energjisë zgjidhet kod transaksioni në sistem:

- 5502 – Blerje Libreze

Vlerat në shitje të librezave shfaqen automatikisht me zgjedhjen e kodit më lart të transaksionit. Duke qene se për këto shërbime nuk aplikohet komision në sistem për klientin, nuk është e nevojshme zgjedhja e kodit të transaksionit të Komisionit. Pasi përfundon transaksioni, nga sistemi gjenerohet mandati i arkëtimit në të cilin pasqyrohet vlera e arkëtuar.

10. Shërbimi i shitjes së kartave të telefonisë fikse Global Tel

Bazuar në marrëveshjen e lidhur me Kompaninë ESDE Consulting Sh.p.k, Posta Shqiptare kryen në sportelet e Zyrave Postare shërbimin e shitjes së produkteve:

Produktet	Mënyra e pagesës së komisionit
<i>Karta Global Tel, me vlerë 500 lekë</i>	<i>Komisioni paguhet nga subjekti</i>
<i>Karta Global Tel, me vlerë 1000 lekë</i>	<i>Komisioni paguhet nga subjekti</i>

Shërbimi i shitjes së produkteve me lart kryhet në sistemin Eterna Financiare në modulin **“Pagesa të Përgjithshme”**. Ndiqet e njëjta procedure si për shërbimet me lart.

Zgjedhim llogarinë:

- **“Global Tel”**

Për evidentimin e shitjes në sistem të secilit produkt zgjedhim kodet e transaksionit:

- 5518 - Arkëtim Global Tel 500

- 5519 - Arkëtim Global Tel 1000

Vlerat në shitje të kartave shfaqen automatikisht me zgjedhjen e kodeve me lart të transaksionit. Duke qene së për këto shërbime nuk aplikohet komision në sistem për klientin, nuk është e nevojshme zgjedhja e kodit të transaksionit të Komisionit. Pasi përfundon transaksioni, nga sistemi gjenerohet mandati i arkëtimit në të cilin pasqyrohet vlera e arkëtuar.

11. Shërbimi i shitjes së kartave Mjekësore Teledoc

Bazuar në marrëveshjen e lidhur me Kompaninë Teledoc Albania Sh.p.k, Posta Shqiptare kryen në sportelet e Zyrave Postare shërbimin e shitjes së produkteve:

Produktet	Mënyra e pagesës së komisionit
<i>Karta Teledoc Single, me vlerë 3,990 lekë</i>	<i>Komisioni paguhet nga subjekti</i>
<i>Karta Teledoc Family, me vlerë 7,490 lekë</i>	<i>Komisioni paguhet nga subjekti</i>

Shërbimi i shitjes së produkteve me lart kryhet në sistemin Eterna Financiare në modulin **“Pagesa të Përgjithshme”**. Ndiqet e njëjta procedure si për shërbimet me lart.

Zgjedhim llogarinë:

- **“TeleDoc”**

Për evidentimin e shitjes në sistem të secilit produkt zgjedhim kodet e transaksionit:

- 5520 - Teledoc Personal

- 5521 - Teledoc Familjare

Vlerat në shitje të Kartave Mjekësore shfaqen automatikisht me zgjedhjen e kodeve me lart të transaksionit. Duke qene se për këto shërbime nuk aplikohet komision në sistem për klientin, nuk është e nevojshme zgjedhja e kodit të transaksionit të Komisionit. Pasi përfundon transaksioni, nga sistemi gjenerohet mandati i arkëtimit në të cilin pasqyrohet vlera e arkëtuar.


12. Kontribut i sigurimeve shoqërore, kontribut Vullnetar dhe kontribut i bujkut

Komisioni për shërbimin **“Kontribut i sigurimeve shoqërore, Kontribut Vullnetar dhe Kontribut i bujkut”** është 0.5% e shumës, jo më pak se 100 lekë dhe jo më shumë se 1000 lekë. Punonjësit bëjnë përlllogaritjen e shumës jashtë sistemit në Excel apo makinë llogaritëse dhe pas përlllogaritjes e regjistrojnë vlerën e komisionit manualisht në sistemin Eterna. Ndiqet kjo rrugë pasi sistemi Eterna nuk e ofron këtë mundësi, duke bërë që të rritet risku i gabimit njerëzor.

Nga auditimi u konstatua se ky parametrizim i përlllogaritjes së shumës së komisionit që duhet të paguajë klienti, nuk është ndërtuar dhe konfiguruar në mënyrë të tillë që të lehtësojë veprimet manuale të punonjësve. Probabiliteti i gabimit njerëzor në përlllogaritje dhe në regjistrimin e vlerës së komisionit është shumë i lartë, për të cilat vetë punonjësi penalizohet, pasi çdo gabim në regjistrim të shumave është përgjegjësi individuale.

Disa prej shërbimeve që realizohen nëpërmjet sistemit Eterna, regjistrohen në module specifike të ndërtuara dhe parametrizuara në mënyrë specifike për çdo shërbim me qëllim identifikim më të saktë si në të dhënat që regjistrohen, ashtu dhe në komisionet që aplikohen apo raportet periodike që nevojiten për vendimmarrje të ndryshme. Në këtë mënyrë janë konfiguruar shërbimet për OSHEE, Ujësjellës, Gjjobat e Policisë etj.

Figura nr. 12: Skema sipas së cilës u konceptua nga grupi i auditimit kryerja e shërbimeve me ndërveprim të sistemeve të tjera



Burimi: Përgatiti Grupi i auditimit

➤ Evidencat statistikore

Posta Shqiptare edhe pse vepron në një sistem informatik i cili është investuar në vite, gjeneron jashtë sistemit të dhëna të shumta në formën e evidencave statistikore në lidhje me: burimet njerëzore, shitjet, arkëtimet, efektivitetin, shërbimet e ndryshme, të dhëna mbi të cilat bazohet për raportimin në institucione si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, INSTAT dhe AKEP. Raportimi në këto institucione është me periodicitet 3 mujour, 6 mujour dhe 1 vjeçar.

Drejtori të ndryshme në shoqëri hartojnë evidenca sipas përgjegjësive që lidhen me kryerjen e detyrave si dhe raportimin e tyre në nivele më të larta brenda institucionit, ndërsa është Drejtoria Ekonomike që raporton evidencat për të gjithë shoqërinë Posta Shqiptare në institucionet: MFE, MIE, INSTAT dhe AKEP.

Tabela nr. 2: Llojet e evidencave që filialet raportojnë tek kjo drejtori

Nr.	Evidenca	Tipi i Raportit	Punonjësi përgjegjës për raportim
1	a/Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve b/Detajimi i zërit "shpenzime të tjera"	Mujor progresiv	Spektori shërbimeve mbështetëse në filial
2	Evidenca e realizimit të volumit dhe të ardhurave	Mujor progresiv	Spektori shërbimeve mbështetëse në filial
3	a/Evidenca e realizimit të volumit dhe të ardhurave. B/Popullata	Mujor progresiv	Spektori shërbimeve mbështetëse në filial
4	Evidenca e realizimit të volumit dhe të ardhurave nga shërbimi financiar	Mujor progresiv	Spektori shërbimeve financiare në filial
5	Evidenca e realizimit të volumit dhe të ardhurave nga shërbimi i biznesit	Mujor progresiv	Struktura e shitjes në filial
6	Objekte të pranuar për brenda rrethit	Mujor progresiv	Spektori shërbimeve postare dhe ekspres në filial
7	Evidenca e objekteve të pranuar e të shpërndara për brenda dhe jashtë vendit	Mujor progresiv	Spektori shërbimeve postare dhe ekspres në filial
8	Evidenca e volumit të shërbimeve ndërkombëtare të shpërndara.	Mujor progresiv	Spektori shërbimeve postare dhe ekspres në filial
9	Evidenca e volumit të shërbimeve ndërkombëtare të pranuar	Mujor progresiv	Spektori shërbimeve postare dhe ekspres në filial

10	Evidenca për punonjësit 1PU	Çdo 3 muaj	Struktura e burimeve njerëzore në filial
11	Evidenca për punonjësit 2PU. Numri i të punësuarve dhe fondi i pagave	Çdo 3 muaj	Struktura e burimeve njerëzore në filial

Burimi: *Posta Shqiptare Sh.a*

➤ *Drejtoria e Shërbimeve Bankare dhe Financiare*

Kjo drejtori menaxhon Shërbimet Financiare, Bankare dhe Produkteve sa i takon ecurisë së tyre, por mban edhe marrëdhëniet me institucionet lidhur me problematikat, zhvillimet, dhe marrëdhëniet financiare për një kategori të caktuar të shërbimeve mbi likuidimin e detyrimeve. Lidhur me kategorinë e shërbimeve për të cilat likuidimet e detyrimeve për llogari të institucioneve kontraktore kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Posta Shqiptare, kjo e fundit mban aktrakordimet me Filialet e Postës Shqiptare, për raportimin e detyrimeve të tyre për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme.

Aktrakordimet e Filialeve të Postës kryhen nëpërmjet e-mail ose dërgimin e këtij informacioni të dokumentuar fizikisht për Drejtorinë e Përgjithshme pasi janë rakorduar vlerat e detyrimeve nga Sektorët përkatës, të Shërbimeve dhe Financës së Filialit.

Në lidhje me Shërbimet Financiare, për të cilat likuidimet apo faturimet kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme dhe rrjedhimisht është e nevojshme mbajtja e rakordimeve për:

Tabela nr. 3: *Ilojet e akt rakordimeve me filialet*

<i>Shërbimi</i>	<i>Likuidimi</i>	<i>Faturimi</i>	<i>Akt rakordimet</i>
OSHEE/FSHU	<i>Filialet e Postës</i>	<i>Drejtoria e Përgjithshme</i>	<i>Filialet – Drejtoria e Përgjithshme - FSHU</i>
Dogana	<i>Drejtoria e Përgjithshme</i>	<i>Komisioni i mbahet klientit</i>	<i>Filialet – Drejtoria e Përgjithshme</i>
Ujësjetësi	<i>Filialet e Postës, Drejtoria e Përgjithshme për arkëtimet e Rretheve</i>	<i>Filialet, për kontratat me faturim</i>	<i>Filialet – Drejtoria e Përgjithshme Filialet – Kompanitë Ujësjetës respektiv</i>
Albtelekom	<i>Drejtoria e Përgjithshme</i>	<i>Drejtoria e Përgjithshme</i>	<i>Filialet – Drejtoria e Përgjithshme</i>
Legalizimet	<i>Drejtoria e Përgjithshme</i>	<i>Komisioni i mbahet klientit</i>	<i>Filialet – Drejtoria e Përgjithshme</i>
Dëshmitë e Penalitetit	<i>Drejtoria e Përgjithshme</i>	<i>Komisioni i mbahet klientit</i>	<i>Filialet – Drejtoria e Përgjithshme</i>
Arkiva	<i>Drejtoria e Përgjithshme</i>	<i>Komisioni i mbahet klientit</i>	<i>Filialet – Drejtoria e Përgjithshme</i>

Burimi: *Posta Shqiptare sh.a*

- Nga auditimi mbi akt rakordimet që kryen zyra qendrore, me Drejtorinë e Përgjithshme, rezultuan se disa prej tyre kryhen duke gjeneruar të njëjtat të dhëna në trajtën e raporteve nga sistemi. Ky kontroll apo siç quhet akt rakordim nuk është i vlefshëm për sa kohë krahasohen të dhëna të njëjta.

- Nga verifikimet si dhe njohja me procesin që realizohet nëpërmjet sistemit, na rezultoi se rakordimet që bëjnë përgjegjësit e sektorit për shërbimet që realizohen në filiale, rakordimi me përgjegjësit në zyrat qendrore bëhet bazuar në të njëjtin raport të gjeneruar nga sistemi. Pavarësisht rakordimit periodik që filialet bëjnë me përgjegjësit në zyrën qendrore, përsëri evidencat e ndryshme i plotësojnë manualisht jo vetëm për produktet që nuk hedhin në sistem, por edhe për ato produkte që administrohen vetëm nëpërmjet sistemit.

- Nga auditimi rezultoi se raportimi që kryen Posta në MFE, MIE dhe INSTAT për të gjitha periudhat e ndryshme që raporton, është një mbledhje të dhënash plotësisht manuale, çfarë

tregon për kryerje të veprimeve dhe mos ndjekje të regjistrimit të dhënave dhe raportimit të tyre nëpërmjet sistemit nga niveli drejtues në shoqëri.

- U konstatua se në të gjitha raportimet statistikore angazhohen të gjithë strukturat në filiale dhe qendër, ku çdo filial e dërgon në degën qendrore në formë të dokumentuar çdo të dhënë mbi shërbimet që ka kryer, për periudhat që kërkohet të raportojnë tek zyra qendrore e specifikisht tek Drejtoria Ekonomike. Kjo tregon se Posta edhe pse ka investuar në sisteme, nuk regjistron të gjitha shërbimet në sistem, nuk monitoron nëpërmjet sistemit dhe nuk raporton bazuar në të dhënat që gjenden në të.

Përgjegjësinë për raportimin e të dhënave të sakta, shoqëria e ka transferuar tek filiali dhe punonjësit e tij, të cilët hartojnë evidencat që në mënyrë të dokumentuar raportohen në Drejtorinë Ekonomike.

➤ *Performanca e sistemit*

Madhësia e bazës së të dhënave të sistemit Eterna me fillimin e auditimit është 445 GB për të dy sistemet. Duke qenë se sistemet Eterna Financiar dhe Eterna Postar janë konceptuar dhe ndërtuar të ndarë nga njëri tjetri, monitorimi mbi performancën e tyre kryhet gjithashtu i ndarë. Ky monitorim sipas rregullores së brendshme të shoqërisë, kërkohet të kryhet nga pozicionet “Drejtori i IT & Zhvillimit” dhe “Përgjegjësi i Sektorit të Sistemeve”, ndërsa mjeti që disponojnë është SQL Server Analysing tool. Periodiciteti i monitorimit kryhet vetëm në rastet kur përdoruesit ankohen për ngadalësi apo shkëputje nga sistemi.

Nëpërmjet sistemit Jira të kompanisë që realizon mirëmbajtjen e sistemit Eterna janë dokumentuar disa raste që kanë shkaktuar vonesa në sistem. Nga intervistat e zhvilluara në disa nga zyrat postare të filialit Tiranë me punonjësit të cilët janë përdorues sistemi mbi problematikat që konstatojnë gjatë punës me sistem, janë:

- Vonesa në gjenerimin e raporteve ditore;
- Shkëputje të vazhdueshme të sistemit;
- Ndërprerje e internetit;
- Në mungesë të sistemit punonjësit nuk bëjnë asnjë veprim dhe nuk kanë një procedurë të caktuar se si duhet të veprojnë në rast të shkëputjes së sistemit.

➤ *Rrjeti Intranet i Postës Shqiptare Sh.a.*

Rrjeti Intranet i Postës Shqiptare sh.a. është një rrjet privat për shkëmbimin e të dhënave me akses në të gjitha zyrat postare, filialet dhe degët postare me Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare ku ndodhet site-i primarë dhe për arsye redundance në filialin e Tiranës ku ndodhet site-i disaster recovery sipas kontratës “*Blerje Intranet/Internet*”.

Ka 403 pika (ZP-ISP-HQ_Posta) shërbimi Intranet me kapacitete të renditura si më poshtë dhe në 1 pikë (ISP-HQ_Posta) shërbim Internet me kapacitet 200 Mbps.


- Pika Filiali Tranzit - Drejtoria Përgjithshme Posta Shqiptare me kapacitete 100 Mbps.
- Pika ZP Tirana 5 - Drejtoria Përgjithshme Posta Shqiptare me kapacitete 100 Mbps.
- Pikat Filiale - Drejtoria Përgjithshme Posta me kapacitete 10 Mbps.
- Pikat Dege - Drejtoria Përgjithshme Posta me kapacitete 6 Mbps.
- Pikat Zyra Postare - Drejtoria Përgjithshme Posta me kapacitete 3 Mbps.

Rrjeti intranet i pikave postare përbëhet nga dy linja data:

- Linja data primare primare kabllore (*fibër optike, koaksial, dsl*) ose valore (radio);
- Linja data backup, nëpërmjet teknologjisë valore 3G.

Ky shërbimi është shpërndarë vetëm në pikat ku ndodhen filialet dhe degët e kompanisë, në të gjithë pikat e tjera që korrespondojnë me zyrat postare të kompanisë ky shërbim është i bllokuar. Zyrat Postare kanë akses vetëm në ndërfaqet ku janë publikuar shërbimet e palëve të treta me të cilat Posta Sh.a ka marrëveshje për ofrimin e shërbimit.

Monitorimi i linjave të shërbimit Intranet mundësohet nëpërmjet softit të monitorimit të rrjetit PRTG. Ky monitorim kryhet nga ofruesit e shërbimit, specialistet IT në filialet e Postës Shqiptare dhe nga Sektori i Rrjetit pranë Drejtorisë IT & Zhvillimit të Postës Shqiptare. Në figurën më poshtë janë pasqyruar raportet dhe konsumi internet për periudhën shtator 2020 - shtator 2021.



Burimi: Posta Shqiptare sh.a.

Raportimi i problemeve me linjat:

Niveli i parë i konstatimit të mungesës së shërbimit janë specialistet IT në filiale sipas varësisë administrative në të cilën ndodhet pika që ka mungesë shërbimit. Specialisti IT pasi merr informacionin e nevojshëm (mungesë shërbimi, mungesë energjie elektrike, djegie pajisjesh etj.) në mënyrë telefonike bën menjëherë njoftimin telefonik të personave përgjegjës të kompanisë që ofron shërbimin e Intranet/Internetit si dhe nëpërmjet email-it zyrtar në adresën e ofruesit të shërbimit cphdesk@commprog.com dhe në adresën e sektorit të rrjetit itrrjeta@postashqiptare.al. Në vijim problematika ndiqet nga specialistet e Sektorit të Rrjetit dhe nga specialisti i IT-së së filialit të cilës pika i përket.

Nga auditimi u konstatua se në rregulloret e brendshme për: filialin e Postës Shqiptare sh.a, Qendra Tranzit, Filialet e kategorisë së parë dhe të dytë, dhe të degëve të kategorisë së parë dhe të dytë të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. nuk është e përcaktuar mënyra se si ndiqet monitorimin i linjave data nga specialistët IT.

Komunikimin e problematikave në drejtorin e përgjithshme përdoret telefon dhe email, zgjidhja ndiqet rast pas rasti, nuk monitorohet apo dokumentohet koha dhe natyra e problematikës së konstatuar apo punonjësit që janë angazhuar për zgjidhjen e saj.

Gjithashtu u konstatua se Filiali Kukës nuk ka akses në Sistemin PRTG, çka do të thotë se për këtë filial nuk bëhet monitorimi i shërbimit dhe konstatim i konektivitetit të linjave, si dhe në rast të identifikimit të problemeve nuk bëhet raportimi i tyre në kohë duke ndikuar në vazhdimësinë e punës së filialit dhe zyrave postare përkatëse.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e sistemeve, mbajnë përgjegjësi z. L. D. në cilësinë e ish-Administratorit të Shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 7, 11 dhe 14 të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe "Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm" përcaktuar në rregulloren e brendshme "Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A", si dhe znj. A. K. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Administrimit të Shoqërisë, z. V. A. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Zhvillimit dhe Standardeve, znj. E. C. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve, znj. N. B. në cilësinë e Drejtorit të Shërbimeve Bankare dhe Financiare, z. E. B. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike, z. E. K. në cilësinë e ish- Drejtorit të Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit dhe z. A. B. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit, sipas detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në rregulloren e brendshme institucionale "Për organizmin, funksionimin e administratës

qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 11, datë 19.11.2021, protokolluar në Postën Shqiptare Sh.a me nr. 1667/13 datë 19.11.2021, si dhe është trajtuar në faqet 121-151 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione mbi Aktkonstatimin nr. 11, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 877/31, datë 06.12.2021.

1. Pretendimi i subjektit:

Ju sqaroj se në dijeninë time, në Posta Shqiptare Sh.a, ekziston sistemi i identifikimit dhe raportimit të problemeve i cili përdoret për të komunikuar me kompaninë përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemit Eterna. Sektorët përkatës të Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit në mënyrë periodike nxjerrin në pah probleme së bashku me zgjidhjen e tyre duke përcaktuar në mënyrë të saktë orën e raportimit, orën e përgjigjes dhe orën e zgjidhjes, shoqëruar me komentet përkatëse.

1.1.Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Sqarojmë se në dijeni të grupit të auditimit sistemi “Jira” është platformë në përdorim nga ana juaj dhe pronë e kompanisë që mirëmban sistemin Eterna, pra nuk është sistem i Postës por i kompanisë. I vetmi person që hap problematikat në këtë sistem rezulton të jetë zj. M. T. e cila në dijeninë tonë është përgjegjëse sektori dhe njëkohësisht kryen dhe rolin e administratorit të sistemit.

Gjatë fazës së auditimit në terren grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion ndonjë dokumentacion mbi problematikat që lidhen me ngadalësi apo shpëputjet të sistemit, apo vonesa në gjenerimin e raporteve, etj. Në lidhje me këtë çështje është observuar dhe në fazën e projektraportit të auditimit hd e grupi i auditimit ka bërë reflektimet përkatëse në projekt raportin e auditimit.

Duke qenë se argumentet e parashtruara nga subjekti i audituar janë përgjithësisht shpjeguese pa fakte të reja, për pasojë konstatimet e grupit të auditimit nuk ndryshojnë. Konstatimet e grupit të auditimit lidhen me nevojën për përmirësim që ka kjo problematikë në vijimësi.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 11, datë 19.11.2021, protokolluar në Postën Shqiptare Sh.a me nr. 1667/13 datë 19.11.2021, si dhe është trajtuar në faqet 121-151 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1667/48, datë 10.01.2022, protokolluar në KLSH me nr. 877/33, datë 12.01.2022. “Observacion në lidhje me Projektraportin për Auditimit e Teknologjisë së Informacionit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” nga z. D. M.

1. Pretendimi i subjektit:

***I.a.**Duke marrë referencë rastin e objektit me bar kod LT048891451AA), sqarojmë se: Objekti postar me bar kod LT048891451AA është :Lajmërim- Dëftesë për dorëzim”, i cili gjenerohet nga sistemi për të njoftuar marrësin për mbërritjen nga jashtë vendit të objektit postar. Ky lajmërim i dorëzohet në adresë marrësit të objektit postar dhe në rastin kur marrësi nuk paraqitet brenda 5 ditëve për tërheqjen e tij, punonjëset printojnë në lajmërim të dytë. Nga verifikimet e objekteve të ndryshme rezulton se gjatë printimit të një lajmërimi të dytë të dhënat e marrësit janë ruajtur dhe konstatimi i mësipërm i grupit të auditimit, nuk qëndron. Po ashtu sqarojmë se lajmërimi (LT048891451AA) i përket objektit postar me barkod CF114676403CH dhe nga verifikimi në sistem i tij, rezulton se të dhënat e marrësit janë të ruajtura dhe mund të printohen nëse kërkohen. Sa më sipër çështja e ngritur nga ju nuk qëndron, mbi të gjitha pasi nuk janë cënuar të dhënat e marrësit të objektit postar, pra nuk ka risk të tjetërsimit të tij.*

I.b. Sa i përket aksesimit të sistemit ETERNA nga drejtori i Shërbimeve Postare sqarojmë se Eterna është një sistem operacional i cili përdoret nga usera të profilit pranues (sportel), përpunues (në zyrë postare dhe qendër përpunimi) dhe dorëzues (korrier). Mbarëvajtja e këtij sistemi monitorohet si detyrë funksionale, nga kryetari i shërbimeve dhe specialist i shërbimeve postare në çdo filial si dhe në nivel makro nga përgjegjësit e sektorit dhe specialistët e shërbimeve postare në Drejtorinë e Përgjithshme e Posta Shqiptare Sh.a. Në drejtim të menaxhimit dhe administrimit, me synim përmirësimin dhe optimizmin e procesit të punës, identifikimin e problemeve të workflow si dhe logjikes operationale, prej më shumë se 6 vjetësh, çdo javë kryhen mbledhje nën drejtimin e drejtorit të Shërbimeve Postare nëpërmjet aksesit në sistem me pjesëmarrjen dhe kredencialet e përgjegjësve të sektorëve të Shërbimeve Postare si dhe pjesës më të madhe të specialistëve të shërbimeve Postare. Rezultatet e këtyre monitorimeve periodike janë kërkesat e vazhdueshme që Drejtoria e Shërbimeve Postare (pa patur nevojën e aksesit të veçantë nga Drejtori i Shërbimeve Postare) i ka adresuar Drejtorisë së IT-se me synim përmirësimin dhe optimizmin e sistemit Eterna.

I.c. Meqënëse grupi i auditimit të KLSH-së në asnjë rast nuk kërkoi takim me Drejtorinë Postare, z. D. M, jemi të gatshëm që këto kërkesa t'ua paraqesim në rastin më të parë që do ti kërkon.

Sa më sipër kërkojmë heqjen e emrit të Drejtorit të Shërbimeve Postare z. D. M. si person i ngarkuar me përgjegjësi, të vendosura nga ana e grupit të auditimit në mënyrë të padrejtë në material.

1.1. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

I.a. Në lidhje me sa më lart sqarojmë se grupi i auditimit konstatimet e tij, gjatë fazës së auditimit në terren i ka të bazuara mbi dokumentacionin e venë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe nga auditimi në terren ku grupi i auditimit ka qenë i shoqëruar nga personat e autorizuar nga Posta Sh.a për të audituar procesin e hedhjes së të dhënave nga specialistët e zyrave postare.

Konstatimi mbi fshirjen automatike nga sistemi i të dhënave të marrësit të objekteve postare u demonstruar nga operatori i zyrës postare në prani të audituesve dhe përfaqësuesve të Postës. Në momentin e gjenerimit të lajmërimit që ne e kemi vendosur foto në material duket qartë që mungojnë të dhënat e marrësit. Njëkohësisht grupit të auditimit kjo gjë iu parashtrua si anomali në sistem nga specialistët dhe operatorët e zyrës postare të cilët punojnë përditë me të, gjë e cila kishte nevojë adresohet dhe të përmirësohet në sistem. Në asnjë rast grupi i auditimit nuk është shprehur se janë cënuar të dhënat apo tjetërsimi i tyre, grupi është shprehur që rritet risku për gabime njerëzore në ri hedhjen e të dhënave. Kjo çështje ka qenë e trajtuar edhe në Aktkonstatimet që grupi i auditimit ka mbajtur, për të cilat nuk janë bërë observacione. Po kështu, argumentet e parashtruara nga subjekti i audituar janë përgjithësisht shpjeguese dhe pa fakte të reja të bashkëlidhura observimit.

I.b. Sa i përket nivelit të aksesimit të sistemit ETERNA sqarojmë se kjo çështje është adresuar për të përmirësuar sistemin në lidhje nivelin e aksesimit dhe informimit nga sistemi i nivelit drejtues që është dhe niveli vendimmarrës. Ky atribut ose konfigurim i aksesit të sistemit në gjykimin tonë duhet zgjeruar, në mënyrë që niveli drejtues të cilët kanë qenë dhe vendim marrës lidhur me informatizimin dhe përmirësimin e sistemeve, duhet të kryejnë veprime monitoruese, kontrolloese apo edhe autorizuese nëpërmjet sistemit.

I.c. Në lidhje me këtë çështje sqarojmë se, grupi i auditimit që në takimin fillestar me subjektin ka bërë me dije mënyrën e zhvillimit të auditimit në terren, mënyrën e kërimit të informacioneve dhe takimet verbale me prezence. Grupit të auditimit i është caktuar një person kontakti nga subjekti i audituar, që në rastin tuaj ishte përcaktuar z. B., Drejtor i Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit, i cili ka mundur të gjithë bashkëpunimin ndërmjet grupit të auditimit dhe subjektit të audituar për zbatimin me korrektesë nga ana e subjektit të afateve ligjore në

marrjen e informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit. Grupi i auditimit të gjitha kërkesat, pyetësorët, informacionet, takimet etj, ja ka komunikuar personit të kontaktit, i cili ka bërë të mundur marrjen e informacioneve, vendosjen e takimeve, informimin e personave të subjektit etj. Kur grupi i auditimit kishte përcaktuar për të audituar në terren zyrat postare, i ka komunikuar personit të kontaktit mbi këtë çështje, që dikush nga subjekti të na shoqëronte dhe informonte përgjatë kësaj kohe. Dhe personi që na njoftuan që do na shoqëronte ka qenë z. Janina. Fakti është që grupi i auditimit e ka kërkuar tek personi i kontaktit dhe në dijëni tonë ju jeni informuar dhe ka qenë e drejta juaj të na shoqëronit apo të ja delegonit dikujt tjetër këtë gjë dhe nuk është aspak e vërtetë që grupi i auditimit nuk kërkoi takim.

Për sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë dhe reflektohet në raportin përfundimtar të auditimit, vetëm në lidhje me adresimin e përgjegjësisë së Drejtorit të Shërbimit Postar. Vendosja e emrit në projektraport, me cilësinë e drejtuesit të Drejtorisë së Shërbimit Postar, është bërë që të jeni në dijëni me problematikat që kanë rezultuar nga auditimi mbi sistemin Eterna Postar, me qëllimin e vetëm përmirësimit e veprimtarisë së punës së drejtorisë së Shërbimit Postar në lidhje me përdorimin dhe funksionimin e këtij sistemi.

1. Titulli i gjetjes: Në shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, nuk është miratuar gjurma e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, si dhe nuk ka asnjë dokumentim të rrjedhës së informacionit “Workflow” për hapat që kryhen nëpërmjet sistemit informatik.

Situata 1: Nga auditimi u konstatua se në Postën Shqiptare sh.a, nuk është dokumentuar gjurma e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, si një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë dhe institucionit, si dhe jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta apo për t’i verifikuar ato.

Situata 2: Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, kryen veprime operationale në sisteme informatike të cilat janë zhvilluar me qëllim informatizimin e veprimeve që kjo shoqëri ofron për shtetasit e saj, por në mungesë të diagrameve shpjeguese se si informacioni rrjedh nëpërmjet sistemit të TI që mbështet proceset kryesore të institucionit. Mungesa e diagrameve krijon pengesa në kuptueshmërinë, vlerësimin dhe gjurmimin e veprimeve që kryhen nëpërmjet sistemit.

Kriteri: Neni 4, pika 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Ndikimi/efekti: Në manualin e MFK shprehet qartë se mungesa e gjurmës së auditimit pengon menaxhimin e lartë të ketë një vizion të qartë për:

- Ecurinë e proceseve;
- Objektivat e proceseve;
- Strukturat brenda njësisë që përfshihen në proces;
- Strukturat jashtë njësisë që përfshihen në proces;
- Aktivitetet e ndryshme të procesit;
- Sistemet e TI-së që mbështesin proceset;
- Afatin e zbatimit të aktiviteteve që janë pjesë e proceseve;
- Burimet e përdorura dhe produktet e përfutuara.

Shkaku: Bazuar në nenin 16, pika 2 e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, janë titullarët e njësisive publike që miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Rëndësia: E lartë

1.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, në bashkëpunim me drejtorët e përgjithshëm të cilët drejojnë sipas strukturës Departamentin e Shërbimeve, Administrimin e Shoqërisë dhe Zhvillimit dhe Standardeve të hartojnë, dokumentojnë dhe miratojnë gjurmën e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, ku të jenë identifikuar procedurat dhe operacionet që shoqëria ndjek me qëllim qartësinë dhe kuptueshmërinë e mjedisit të kontrollit.

1.2.Rekomandimi: Drejtuesit e Departamentit të Shërbimeve, Administrimit të Shoqërisë dhe Zhvillimit dhe Standardeve krahas identifikimit të proceseve që nevojiten për dokumentimin e gjurmës audituese, në bashkëpunim me Drejtorinë e IT dhe Zhvillimit dhe Drejtorinë e Sigurisë dhe Cilësisë duhet të hartojnë dhe dokumentojnë diagramet e rrjedhës së informacionit për çdo proces që realizohet nëpërmjet sistemit me qëllim përcaktimin e të dhënave hyrëse, roleve, ndryshimit, miratimit dhe përfundimit për çdo shërbim që realizohet nëpërmjet sistemit informatik.

2.Titulli i gjetjes: Mos pasqyrim i ndryshimeve në sistem të statusit të përdoruesve të larguar me leje të gjatë dhe atyre jo aktiv në periudha të përkohshme.

Situata: Nga auditimi mbi ndryshimin e statusit të përdoruesve në sistem, rezulton se nuk pasqyrohen ndryshime për përdoruesit përkohësisht jo aktiv apo përdorues të cilët mund të jenë larguar me leje të gjatë si raport shëndetësor apo leje lindje, çfarë cenon sigurinë e të dhënave e cila nuk është përgjegjësi e punonjësit të larguar, por e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së TI dhe Zhvillimit, mbi pasqyrimin e ndryshimeve në sistem.

Kriteri: Rregullorja e brendshme administrative e Posta Shqiptare sh.a; ligji nr. 2/2017, datë 26.01.2017 “Për Sigurinë Kibernetike”; neni 27 i ligjit nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Cenim i sigurisë së të dhënave nga punonjës të paautorizuar për të vepruar.

Shkaku: Mos zbatim i akteve rregullative dhe mos menaxhim i ndryshimit

Rëndësia: E Lartë

2.1.Rekomandimi: Burimet Njerëzore të përditësojnë në sistem ndryshimet e punonjësve me status të larguar me leje të gjatë apo përkohësisht jo aktiv, me qëllim gjenerimin sistematik për këto të dhëna nga Drejtoria e TI dhe Zhvillimit të cilat duhen administruar për kufizimin e të drejtave të këtyre përdoruesve, veprime të cilat do të përmirësonin procesin e statusit të përdoruesve dhe do të parandalonte çdo mundësi për akses të paautorizuar në të dhëna. Gjithashtu të marren masa për monitorimin e vazhdueshëm të statusit të përdoruesve.

3.Titulli i gjetjes: Parregullsi të konstatuara gjatë testeve të sistemit të cilat ndikojnë në veprimet operacionale të përdoruesve.

Situata: Mbështetur në testimet e ndryshme të zhvilluara në sistemin Eterna rezultuan disa mangësi të sistemit të cilat pengojnë kryerjen e veprimeve automatike, konkretisht:

- Nuk është e mundur në sistem të hidhet kursi ditor për monedhën EUR, apo të ndryshohet.
- Përditësimi i manualeve të Eternës nuk është bërë duke siguruar shtimin e produkteve/shërbimeve të reja.
- Raporti i pagave nga sistemi Eterna Financiar në modulin e burimeve njerëzore tregon se paga neto është e njëjtë me pagën bruto çfarë tregon se të dhënat për të dy fushat regjistrohen manualisht, duke rritur mundësinë për gabime operacionale. Theksojmë se kjo është më pak se sa ofron Excel në të cilën paga neto del si rezultat i implementimit të formulave të thjeshta.
- Fletëdaljet e artikujve dërgohen fizikisht në filiale, dhe po manualisht filiali i regjistron në sistem edhe pse disponojnë një modul magazine nga i cili këto veprime duhet të realizoheshin automatikisht.
- Moduli i blerjeve dhe moduli për menaxhimin e dokumenteve nuk rezultojnë se kanë të dhëna, që do të thotë se nuk janë në përdorim, edhe pse nevoja për të administruar nëpërmjet sistemit është e madhe.

Kriteri: Informatizimi i të dhënave në sistemin Eterna

Ndikimi/efekti: Pamundësi për të punuar nëpërmjet sistemit për shkak të mangësive që konstatuam të cilat pengojnë veprimet operacionale të përdoruesve. Punë e kryer paralelisht jashtë sistemit si rezultat i mos raportimit të këtyre problematikave nga personat e kontaktit tek ofruesit e shërbimit.

Shkaku: Mangësi të sistemit

Rëndësia: E Lartë

3.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, të marrë masa për përditësimin e manualeve të sistemit Eterna me qëllim shtimin e produkteve/shërbimeve të reja si dhe të marrë masa për sistemin e mangësive në sistem për mirëmbajtjen e kursit të këmbimit për monedhën EUR.

3.2.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të përfundojë regjistrimin e të dhënave të sakta në modulën e burimeve njerëzore dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e TI dhe Zhvillimit të identifikojë të dhëna që nevojiten të regjistrohen nga përdoruesi dhe të dhënat që gjenerohen automatikisht prej sistemit si në rastin e raportit të pagave nga sistemi Eterna Financiar ku paga neto rezulton e njëjtë me pagën bruto që tregon se të dhënat për të dy fushat regjistrohen manualisht, duke rritur mundësinë për gabime operacionale, me qëllim uljen e problematikave me veprimet operacionale të përdoruesve.

3.3.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, të marrin masa për vënien në funksion sa më shpejtë të funksionaliteteve ekzistuese në Eterna lidhur me fletëdaljet e artikujve të modulit magazine me qëllim realizimin e këtyre veprimeve në mënyrë automatike si dhe vënien në funksion modulën e blerjeve dhe modulën për menaxhimin e dokumenteve të cilët nuk janë në përdorim, edhe pse nevoja për të administruar nëpërmjet sistemit është e madhe.

4.Titulli i gjetjes: Pasaktësi ose pamundësi në gjenerimin e të dhënave - output

Situata 1: Nga auditimi mbi raportet e gjeneruara prej sistemit Eterna Financiar u konstatuan disa problematika në lidhje me gjenerimin e tyre, konkretisht:

- Të gjitha raportet që u gjeneruan, kërkojnë patjetër përpunime në Excel sepse dhe raportet përmbledhëse janë konceptuar në nivel filiali edhe në rastet kur kërkesa për informacion ekzekutohet në nivel republike;

- Nuk ka asnjë opsion të gjenerosh të dhëna për të dy monedhat EUR dhe LEK;

- Nuk ka asnjë raport për përdoruesit, roli dhe zyrat në të cilat kanë akses;

- Për përdoruesit në modulet Magazina, Moduli i Blerjeve, Inventari, Menaxhimi i Dokumenteve rezulton se nuk është ndërtuar asnjë raport në strukturën e raporteve, madje për këto shërbime nuk rezulton se janë hedhur të dhëna me qëllim vënien në funksion të tyre.

Situata 2: Nga testime të ndryshme në sistemin Eterna Postar përgjatë gjenerimit të raporteve nga pema e raporteve u konstatuan disa parregullsi/mangësi, konkretisht:

- sistemi nuk gjeneron raporte dorëzimi për një periudhë të gjatë kohore;

- nuk shfaqet asnjë e dhënë që përdoruesi të përzgjedhi me qëllim gjenerimin e raporteve;

- opsioni RPO40 shfaq një tabelë pa asnjë të dhënë për opsionet e përzgjedhura nga përdoruesi;

- raporte supervizori kanë shumë vonesa në gjenerimin e raporteve.

Kriteri: Filtrat e raportimit implementuar në sistemin Eterna Financiar.

Ndikimi/efekti: Shtim të veprimeve manuale për nxjerrjen e informacionit të kërkuar.

Shkaku: Mangësi në performancën e sistemit

Rëndësia: E Lartë

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi mbi raportet që gjenerojnë të dhëna të sistemit të cilat nuk kanë filtrat e aplikuar, nuk zgjidhin kërkesat e përdoruesve të cilët krijojnë mënyra alternative të përpunimit të mëtejshëm të informacionit jashtë sistemit Eterna Financiar dhe Postar, çfarë do të lehtësonte veprimet manuale të punonjësve.

5.Titulli i gjetjes: Sistemi Eterna Postar ka raste kur fshin në mënyrë automatike të dhënat e rregjistruara për klientët marrës së pakove që janë në pritje për tu tërhequr.

Situata:

-Nga auditimi onsite në zyrat postare të Posta shqiptare në Tiranë u konstatuan raste kur janë fshirë në mënyrë automatike nga sistemi Eterna Postar, të dhënat e klientit (*marrësit*) i cili do të marri këtë objekt. Këto raste kanë ndodhur kur pakot nuk i janë dorëzuar klientit përkatës dhe kanë ngelur në zyrat postare, gjë për të cilën punonjësit detyrohen ti hedhin përsëri manualisht në sistem duke bërë edhe njëherë popullimin e të dhënave nga fillimi, proces i cili rrit riskun për gabime njerëzore në hedhjen e të dhënave.

- Të dhënat për pakot e ardhura që popullohen nga specialistët janë: emër, mbiemër, id dhe adresën e pritësit të postës. Nga auditimi në sistemin Eterna Postar u konstatua se ky sistem nuk ofron si opsion që të dhënat e klientit marrës të cilat janë populluar njëherë në sistem të shfaqen si sugestion nga sistemi me idenë që këto të dhëna mund të hidhen në mënyrë automatike, pa qenë nevoja të ri plotësohen në mënyrë manuale edhe njëherë.

Kriteri: Automatizimi dhe informatizimi i të dhënave në sistemin Eterna Postar

Ndikimi/efekti: Gabime në popullimin e të dhënave manualisht

Shkaku: Mangësi në performancën e sistemit

Rëndësia: E lartë

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi mbi fshirjen në mënyrë automatike nga sistemi Eterna Postar të të dhënave të marrësit të pakove që janë në pritje si dhe të merren masa për shtimin e funksionaliteteve të reja mbi popullimin e informacioneve të klientëve ekzistues në mënyrë të automatizuar, çfarë do të lehtësonte veprimet manuale të punonjësve.

6.Titulli i gjetjes: Përfundimi i marrëveshjes ndërmjet AKSHI-t dhe Postës Shqiptare sh.a.

Situata: Nga auditimi u konstatua se ndërmjet Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Posta Shqiptare është nënshkruar një marrëveshje “*Për shërbimet publike elektronike në portalin unik qeveritar e-Albania*”, me objekt ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania ndaj subjekteve fizikë dhe juridikë, shtetëror dhe privat, miratuar me shkresën nr. 221, datë 25.01.2019.

Mbështetur në marrëveshjen e sipërcituar, Administratori i Posta Sh.a ka nxjerrë udhëzimin “*Mbi kryerjen e shërbimit bazuar në marrëveshjen e lidhur me AKSHI-n*” miratuar me shkresën nr. 221/1, datë 28.01.2019.

Nga auditimi u konstatua se vlefshmëria e marrëveshjes së lidhur ndërmjet dy institucioneve ka përfunduar dhe rrjedhimisht edhe vlefshmëria e udhëzimit (*pikat 5.1 dhe 5.2, të nenit 5, Kohëzgjatja të marrëveshjes*). Posta shqiptare vazhdon ta ofrojë këtë shërbim edhe pse marrëveshja e ka mbaruar vlefshmërinë e saj.

Kriteri: Marrëveshja “*Për shërbimet publike elektronike në portalin unik qeveritar e Albania*” ndërmjet AKSHI-t dhe Posta Shqiptare sha.a.

Ndikimi/efekti: Ndërprerje e ofrimit të shërbimeve kundrejt qytetareve, biznesit, etj

Shkaku: Mos marrje e masave për rinovimin e marrëveshjes sipas përcaktimeve të nenit 5 (*pikat 5.1,5.2*), të marrëveshjes

Rëndësia: E lartë

6.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a. në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masat e nevojshme për rinovimin/hartimin dhe miratimin e marrëveshjes me qëllim koordinimin për ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania, ndaj subjekteve fizikë dhe juridikë, shtetëror dhe privat.

7.Titulli i gjetjes: Grupi i auditimit e vlerësoi ofrimin e shërbimeve nga e-albania si një shërbim që shfaq risk të lartë për vetë mënyrën se si administrohet, në dy sisteme të ndryshme, ku nga njëri sistem jepet shërbimi dhe nga tjetri faturimi.

Situata: Nga auditimi mbi ofrimin e shërbimeve nga e-Albania, nga shoqëria Posta Shqiptare u konstatua se:

- Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave personale, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. me vendimin nr. 43, datë 28.12.2015 dhe e përditësuar në vitin 2019 e cila është ende e pa miratuar, tregon se nuk janë marrë masat e nevojshme nga Posta Shqiptare për sigurinë e të dhënave personale si detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, neni 20 “Detyrimet e përpunuesit”, neni 21 “Përgjegjësia për të njoftuar” dhe neni 27 “Masat për sigurinë e të dhënave personale”. Kjo do të thotë se punonjësit e Postës Shqiptare nuk janë të informuar se nëpërmjet shërbimeve e-Albania janë duke punuar me të dhëna personale të shtetasve, të cilat mbrohen me ligjin e përmendur më lart.

- Në disa raste, i njëjti punonjës rezultoi të ketë më shumë se dy përdorues aktiv tek portali e-Albania. Gjithashtu, ka punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Posta Shqiptare dhe rezultojnë të kenë përdorues aktiv për leximin e shërbimeve nga e-Albania, nën llogarinë e shoqërisë.

- Sipas të dhënave të gjeneruara nga moduli i e-Albania për Posta Shqiptare, numri i printimeve nga e-Albania është 198,585 dokumente që mendohet të jetë dhe numri i transaksioneve për të cilat është arkëtuar një komision. Nga sistemi Eterna Financiar në total dalin 62,292 transaksione. Përgjatë vitit 2019, filialet i kanë raportuar shërbimet e-albania si të ardhura në zëra të ndryshëm dhe përgjatë vitit 2020 ky shërbim identifikohet si shërbim biznesi pavarësisht faktit se dokumenti mund të tërhiqet si biznes apo individ. Kjo do të thotë se drejtoria ekonomike e ka pothuajse të pamundur të evidentojë numrin e rekordeve për të cilat është arkëtuar.

Kriteri: Nenin 27, pikat b, c, ç, ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; Nenin 3, pikat 3.1.4 dhe 3.1.8 të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Posta Shqiptare me nr. 221 prot , datë 25.01.2019 dhe AKSHI-t me nr. 439 prot, datë 25.01.2019; Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, neni 20 “Detyrimet e përpunuesit”, neni 21 “Përgjegjësia për të njoftuar” dhe neni 27 “Masat për sigurinë e të dhënave personale”;

Ndikimi/efekti: Pasaktësi në regjistrimin e të dhënave, mungesë administrimi i aksesit të përdoruesve, Cenim i të dhënave personale

Shkaku: Menaxhimi i ndryshimit dhe mungesa e kontrollit të brendshëm

Rëndësia: E lartë

7.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për gjetjen e mekanizmave të kontrollit në ofrimin e shërbimeve nga e-albania, që garantojnë regjistrimin e çdo dokumenti të printuar apo elementëve të tij unik, në sistemin e brendshëm Eterna Financiar me qëllim monitorimin dhe parandalimin e keqpërdorimit si rezultat i aksesit të paautorizuar.

Gjithashtu të merren masa për adresimin e konstatimeve të auditimit mbi trajtimin e të dhënave personale sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, mbi “përgjegjësinë për të njoftuar” “detyrimet e përpunuesit” si dhe “masat për sigurinë e të dhënave personale”.

7.2.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe të marrin masa mbi përdoruesit që kanë më shumë se dy user-a aktiv tek portali e-Albania si dhe përdoruesit që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Postën Shqiptare dhe rezultojnë të kenë përdorues aktiv për leximin e shërbimeve nga e-Albania, me qëllim uljen e riskut për akses të paautorizuar dhe keqpërdorimin e të dhënave.

8.Titulli i gjetjes: Mbledhje të dhënash në mënyrë manuale për veprime të cilat regjistrohen në sistem.

Situata: Nga auditimi mbi të dhënat “output” gjeneruar prej sistemit si dhe të dhënave të raportuara tek institucionet që administrojnë dhe hartojnë politikat e shoqërisë Posta Shqiptare, u konstatuan disa parregullsi, konkretisht:

- Aktrakordimet që kryen zyra qendrore, me Drejtorinë e Përgjithshme, rezultuan se disa prej tyre kryhen duke gjeneruar të njëjtat të dhëna në trajtën e raporteve nga sistemi. Ky kontroll apo siç quhet akt-rakordim nuk është i vlefshëm për sa kohë bazohet në të dhëna të njëjta dhe jo në kryqëzime të dhënash të cilat do t’i jepnin kuptim kontrollit në një hallkë më sipër, por dhe verifikimit dhe saktësisë së të dhënave të regjistruara në sistem.

- Nuk gjenerohet asnjë evidencë prej sistemit edhe pse pjesa më e madhe e të dhënave që kërkohen në raportim, punonjësit i regjistrojnë në sistem. Punonjësit në filiale, kryejnë të njëjtën punë dy herë, një herë nëpërmjet regjistrimit në sistem dhe një herë në përmbledhjen e të dhënave për muajin e kaluar, 3 mujorin e kaluar, 6 mujorin apo 1 vjetorin ku në disa raste këto raportime janë progresive. Punonjësit në drejtorinë ekonomike përmbledhin të gjithë informacionin e ardhur për efekt raportimi.

- Raportimi që kryen Posta në MFE, MIE dhe INSTAT për të gjitha periudhat e ndryshme që raporton, është një mbledhje të dhënash plotësisht manuale. Raportimi në këto institucione është me periodicitet 3 mujor, 6 mujor dhe 1 vjeçar.

- Kontrolli i brendshëm realizohet me dokumentacion fizik nga filiali në drejtorinë qendrore.

- Asnjë nga tipet e evidencave nuk rezulton të jetë kërkuar të gjenerohet nga Datawarehouse BI, të cilin posta e ka implementuar në vitin 2020, qëllimi i të cilit është orientuar po tek veprimet e përdoruesit dhe aspak tek raportimi të cilit kjo magazinë të dhënash do i shërbente më shumë

Kriteri: Informatizimi i të dhënave “Input” si dhe raportimi i tyre “Output”

Ndikimi/efekti: Kontroll jo efektiv për arsye se është bazuar në raporte të njëjta, Veprime të dubluara të punonjësve të caktuar, mos ndjekje e të dhënave nëpërmjet sistemit e detyrimisht edhe mungesë garancie për atë që gjendet në sistem.

Shkaku: Mos regjistrimi në sistem i disa prej shërbimeve; Mungesa e raporteve periodike apo progresive në sistemin Eterna me të dhënat e shërbimeve që kryhen nëpërmjet sistemit që shoqëria raporton tek pronarët apo institucionet që rregullojnë veprimtarinë e saj;

Rëndësia: E lartë

8.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masat e nevojshme për:

- a. informatizimin e shërbimeve që kryhen manualisht;
- b. importimin e të dhënave në Datawarehouse BI, për shërbimet që kryhen tek sistemet e të tretëve në mënyrë automatike, ditore;
- c. implementimin e raporteve me të dhëna përmbledhëse nga Datawarehouse BI, që i shërbejnë monitorimit, vendimmarrjes, raportimit dhe transparencës.

9.Titulli i Gjetjes: Rrjeti Intranet i Postës Shqiptare Sh.a.

Situata: Nga auditimi mbi monitorimin e Intranetit/Internetit, u konstatua se:

- në rregulloret e brendshme për: Filialin e Postës Shqiptare sh.a, Qendra Tranzit, Filialet e kategorisë së parë dhe të dytë, dhe të degëve të kategorisë së parë dhe të dytë të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. nuk është e përcaktuar mënyra se si ndiqet monitorimin i linjave data nga specialistët IT.

- në lidhje me problematikat, komunikimi me drejtorin e përgjithshme bëhet me telefon dhe email, zgjidhja ndiqet rast pas rasti, nuk monitorohet apo dokumentohet koha dhe natyra e problematikës së konstatuar apo punonjësit që janë angazhuar për zgjidhjen e saj.

- Filiali Kukës nuk ka akses në Sistemin PRTG, çka do të thotë se për këtë filial nuk bëhet monitorimi i shërbimit dhe konstatim i konektivitetit të linjave.

Kriteri: Neni 13, Rregullorja e brendshme filiali i Postës sh.a Tiranë, Rregullorja e brendshme, “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a” “Detyrat dhe kompetencat e drejtorisë së IT dhe zhvillimit”

Ndikim/Efekt: Nuk bëhet raportimi në kohë i problematikave me lidhje rrjetin intranet, duke ndikuar në vazhdimësinë e punës së filialit dhe zyrave postare përkatëse.

Shkaku: Praktikrat më të mira dhe mos përditësim i akteve nënligjore

Rëndësia: E mesme

9.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a. të marri masa për përditësimin e rregulloreve të brendshme me qëllim përcaktimin e mënyrave se si ndiqet monitorimi i linjave data, gjithashtu të konsiderojë dhe implementojë zgjidhje të tjera “open source” për monitorimin e linjave data për pikat e filialeve me qëllim monitorim më të detajuar mbi konsumin e bandwithit, çfarë do të ndihmonte Postën Shqiptare në një planifikim më të mirë të kapaciteteve që i nevojiten.

II.2.5. Të Tjera

Struktura e auditit të brendshëm është e organizuar në nivel drejtorie dhe është e përbërë nga 7 auditues, nga ku 6 prej tyre janë auditues me profil financiar dhe 1 auditues me profil të teknologjisë së informacionit (informatikë).

Misioni i drejtorisë së auditit të brendshëm, bazuar në nenin 2 të ligjit nr. 114/2015 *Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” përkufizohet:

“Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes”.

Me qëllim arritjen e qëllimit të veprimtarisë së auditit të brendshëm, struktura e auditit të brendshëm prej vitesh, ka në përbërje të saj dhe auditues me profil në teknologjinë e informacionit, detyrat e të cilit bazohen dhe përcaktohen në ligjin nr. 114/2015, *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, si dhe në rregulloren së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Drejtoria e auditit të brendshëm gjatë periudhës objekt auditimi janar 2019 - qershor 2021, ka zhvilluar dhe realizuar auditime sipas planit vjetor të auditimeve, ku pjesë e programeve të auditimit, ka qenë dhe pika mbi trajtimin e teknologjisë së informacionit. Auditimet e ushtruara nga auditi i brendshëm për këtë periudhë janë zhvilluar në filialet Gjirokastër, Fier, Lushnje, Shkodër, Tranzit, Korçë, Mat, Sarandë dhe Vlorë, ku si pjesë e programit të auditimit është trajtuar edhe teknologjia e informacionit. Drejtoria e teknologjisë së informacionit, sot Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në drejtorinë e përgjithshme të Postës Shqiptare sh.a. është audituar nga auditi i brendshëm për herë të fundit në shtator të vitit 2013, për periudhën 01.01.2012 – 01.09.2013.

Nisur nga administrimi i raporteve të auditit të brendshëm të realizuar në periudhën objekt auditimi, grupi i auditimit ka përmbledhur informacionin në formë tabelare, të paraqitur si më poshtë.

Tabela nr. 4: Më poshtë listohen filialet në të cilat është trajtuar si pjesë e programit të auditimit edhe Auditimi i Teknologjisë së Informacionit nga Auditi i Brendshëm

Struktura e audituar	Pika e programit: D. Auditimi i Sistemit të TI-së	Kryerja e auditimit
Filiali Fier	1. Auditim në zbatim e udhëzimeve të Drejtorisë së Shoqërisë dhe të gjithë akteve ligjore e n/ligjore që rregullojnë dispozitat ligjore. 2. Auditimi mbi zbatimin e procedurave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	Periudha e audituar: 01.12.2017-31.03.2019 Afati i auditimit: 26.03.2019 - 18.04.2019
Filiali Lushnje	1. Auditim në zbatim e udhëzimeve të Drejtorisë së Shoqërisë dhe të gjithë akteve ligjore e n/ligjore që rregullojnë dispozitat ligjore. 2. Auditimi mbi zbatimin e procedurave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	Periudha e audituar: 01.12.2017-31.09.2019 Afati i auditimit: 14.10.2019 - 30.10.2019
Filiali Shkodër	1. Auditim në zbatim e udhëzimeve të Drejtorisë së Shoqërisë dhe të gjithë akteve ligjore e n/ligjore që rregullojnë dispozitat ligjore. 2. Auditimi mbi zbatimin e procedurave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	Periudha e audituar: 01.10.2017-31.01.2019 Afati i auditimit: 20.02.2019 - 14.03.2019 02.04.2019 – 10.04.2019

Filiali Tranzit	1. Auditim në zbatim e udhëzimeve të Drejtorisë së Shoqërisë dhe të gjithë akteve ligjore e n/ligjore që rregullojnë dispozitat ligjore.	Periodha e audituar: 01.06.2017-31.12.2019 Afati i auditimit: 18.01.2019 - 01.02.2019
Filiali Gjirokastrë	1. Auditim në zbatim e udhëzimeve të Drejtorisë së Shoqërisë dhe të gjithë akteve ligjore e n/ligjore që rregullojnë dispozitat ligjore. 2. Auditimi mbi zbatimin e procedurave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	Periodha e audituar: 01.10.2017-31.05.2020 Afati i auditimit: 29.06.2020 - 30.07.2020
Filiali Korçë	1. Auditim në zbatim e udhëzimeve të Drejtorisë së Shoqërisë dhe të gjithë akteve ligjore e n/ligjore që rregullojnë dispozitat ligjore. 2. Auditimi mbi zbatimin e procedurave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	Periodha e audituar: 01.09.2018-31.09.2020 Afati i auditimit: 14.10.2020 - 06.11.2020
Filiali Mat	1. Auditim në zbatim e udhëzimeve të Drejtorisë së Shoqërisë dhe të gjithë akteve ligjore e n/ligjore që rregullojnë dispozitat ligjore. 2. Auditimi mbi zbatimin e procedurave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	Periodha e audituar: 01.10.2018-31.05.2020 Afati i auditimit: 01.07.2020 - 24.07.2020
Filiali Sarandë	1. Auditim në zbatim e udhëzimeve të Drejtorisë së Shoqërisë dhe të gjithë akteve ligjore e n/ligjore që rregullojnë dispozitat ligjore. 2. Auditimi mbi zbatimin e procedurave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	Periodha e audituar: 01.04.2018-31.08.2020 Afati i auditimit: 22.09.2020 - 15.10.2020
Filiali Vlorë	1. Auditim në zbatim e udhëzimeve të Drejtorisë së Shoqërisë dhe të gjithë akteve ligjore e n/ligjore që rregullojnë dispozitat ligjore. 2. Auditimi mbi zbatimin e procedurave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	Periodha e audituar: 01.09.2018-31.08.2020 Afati i auditimit: 29.09.2020 - 21.10.2020

Burimi: Përmbledhje e Raporteve të Auditit të Brendshëm në Postën Shqiptare sh.a, për auditimin e TI-së

Pikat e programit të auditimit të ushtruar nga auditimi i brendshëm në çdo filial dhe trajtimi i tyre nga audituesi i brendshëm me profil në teknologjinë e informacionit, është shumë i ngjashëm në të gjitha raportet e periudhës 2018-2020. Modeli i ndjekur për auditimin e TI është bazuar në atë ekzistues edhe pse audituesit dhe sistemet kanë ndryshuar gjatë 2 viteve të fundit.

Kryerja e auditimeve të IT mbi veprimet operacionale në IT bazohet në dokumentet, "Politikën e Përdorimit dhe Sigurisë së Sistemeve TIK të Postës Shqiptare", miratuar me shkresën nr. 1952/2, datë 19.08.2008 dhe "Procedurat e Sigurimit të Postës Shqiptare", miratua me vendimin nr. 465, datë 13.11.2006.

Nga auditimi u konstatua se auditimi i brendshëm i referohet dokumenteve të sipërcituara edhe pse këto dokumente nuk janë të përditësuara, duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në fushën e teknologjisë së informacionit në Posta Shqiptare sh.a.

Në manualin e auditimit të brendshëm i jepet rëndësi auditimit të teknologjisë së informacionit duke e përkufizuar këtë auditim si: "Auditimi i Teknologjisë së Informacionit përfshin vlerësimin e kontrolleve të vendosura nga menaxhimi me ndihmën e infrastrukturës së TI-së në lidhje me ruajtjen e asetëve, integritetin e të dhënave dhe funksionimin efektiv për të arritur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike. Për shkak të natyrës së kësaj fushe, audituesi i brendshëm duhet të ketë njohuri specifike të teknologjisë së informacionit dhe të gëzojë ekspertizën e nevojshme në kryerjen e këtij lloji auditimi".

Gjithashtu, në të njëjtin manual cilësohet se: "Auditimi i brendshëm bazohet mbi njohjen e thellë të veprimtarisë dhe sistemeve të informacionit që kontribuojnë tek kontrolli i brendshëm dhe raportimi financiar. Njësia e auditimit duhet të marrë në konsideratë risqet e përgjithshme me të cilët përballlet njësia, mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm ku vepron, kuadrin ligjor dhe


rregullator, performancën e mëparshme financiare dhe sistemet e kontrollit të brendshëm të njësisë”.

Grupi i auditimit, e vlerëson shumë të nevojshëm për shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, auditimin e TI nga auditimi i brendshëm, për arsye se institucioni disponon të dhëna personale të cilat mbrohen me ligj dhe është licencuar si institucion për përdorimin e parasë elektronike.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e auditit të brendshëm në drejtim të auditimit të TI, u konstatua se:

- Pozicionimi i strukturës së auditit të brendshëm në organikën e Postës Shqiptare rezulton të jetë nën Këshillin Mbikëqyrës, për të garantuar pavarësinë e kësaj strukture por nga auditimi u konstatua se është përgjegjësi e Administratorit të shoqërisë të bëjë emërimet e punonjësve në strukturën e auditimit të brendshëm, ndërkohë që emërimi i drejtorit të auditit të brendshëm është kompetencë e Këshillimit Mbikëqyrës. Emërimi i audituesve të kësaj strukture nga Administratori, është në kushtet e konfliktit të interesit, për arsye se vendimmarrjet e Administratorit duhet gjithashtu të jenë objekt kontrolli pasi ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Figura nr. 13: Pozicioni i Auditit të Brendshëm në strukturën e miratuar për shoqërinë Posta Shqiptare sh.a



Burimi: Organigrama e Postës Shqiptare sh.a

- Planifikimi për auditimin e brendshëm dhe sidomos në drejtimin e TI nuk është bazuar mbi sistemet e informacionit që disponon shoqëria të cilat ndikojnë tek kontrolli i brendshëm dhe raportimi financiar, në kundërshtim me manualin për auditimin e brendshëm.

- Nga administrimi i raporteve të auditit të brendshëm për filialet Fier, Lushnje, Shkodër, Tranzit dhe Gjirokastrë, Korçë, Mat, Sarandë dhe Vlorë u konstatua se në drejtim të auditimit të teknologjisë së informacionit nuk është ndjekur metodika që përcakton manuali i auditimit të brendshëm.

- Nga administrimi i raporteve të auditit të brendshëm në drejtim të auditimit të sistemeve të TI-së nuk janë konstatuar çështje që mund të ndihmonin në përmirësimin e sistemit, por vetëm çështje me karakter udhëzues mbi përdoruesit, në kundërshtim me detyrat 1 dhe 5 të përshkruara për Audituesin e TI në rregulloren e brendshme institucionale të Posta Shqiptare.

- Posta Shqiptare nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe nuk ka planifikuar, kryer misionet auditimi mbi sistemet e TI-së në Drejtorinë e IT-së dhe Zhvillimit dhe Sektorin e Sigurisë së Informacionit pranë Posta Shqiptare.

Auditimi i brendshëm në Posta Shqiptare:

- nuk përdor standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare mbi auditimin e IT;
- nuk përdor teknika të auditimit të bazuara në teknologji informacioni, për auditim të bazave të të dhënave;
- nuk vlerëson nëse qeverisja e teknologjisë së informacionit në Posta Shqiptare mbështet strategjitë dhe objektivat institucionale.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e IT nga auditi i brendshëm, mbajnë përgjegjësi z. L. D. në cilësinë e ish-Administratorit të Shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 7, 11 dhe 14 të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe “Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm” përcaktuar në rregulloren e brendshme “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A”, si dhe z. H. O. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, sipas detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në rregulloren e brendshme institucionale “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 12, datë 19.11.2021, protokolluar në Postën Shqiptare Sh.a me nr. 1667/14 datë 19.11.2021, si dhe është trajtuar në faqet 152-158 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1667/49, datë 10.01.2022, protokolluar në KLSH me nr. 877/33, datë 12.01.2022. “Observacion në lidhje me Projektraportin për Auditimit e Teknologjisë së Informacionit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” nga z. H. O. dhe znj. I. B.

1. Pretendimi i subjektit:

Planifikimi i auditimeve dhe hartimi i programit të punës nga auditi i IT gjithmonë bazohet në sistemet e teknologjisë në lidhje me të gjitha shërbimet që kryhen në Postën Shqiptare Sh.a. duke zbatuar ligjet, manualin e auditimit të brendshëm dhe rregulloret e shërbimeve të shoqërisë.

Referuar pikës ku realizimi i programit të auditimit të IT është i ngjashëm për të gjithë filialet pasi në të gjithë filialet kryhet e njëjta procedurë pune, ku të gjithë punonjësit përdorin të njëjta sisteme, përveç rasteve kur ka patur problematika të ndryshme nëpër filiale të ndryshme të cilat janë konstatuar në raporte. Duke qenë se këto dy vitet e fundit nuk janë vënë në përdorim sisteme të reja të cilat do të ndikojnë në ndryshimin e procedurës së punës të punonjësve për këtë arsye edhe auditimi i auditit të IT është i ngjashëm për çdo filial.

Sqarojmë se sistemi i Postës Shqiptare sh.a. është një sistem i krijuar në bazë të kërkesave të punonjësve për të krijuar sa më shumë lehtësi në proceset e tyre të punës. Ky sistem është upgrade-uar dhe janë bërë përmirësime të vazhdueshme për të cilat janë kryer komunikime të vazhdueshme ndërmjet Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Shërbimit Postar, pra është një procedurë ongoing e cila është në vazhdim. Këto përmirësime kryhen nga kompania zhvilluese e sistemit e cila është në kontakt të drejtpërdrejtë me Drejtorin e Teknologjisë së Informacionit. Duke qenë se auditi i IT ka qenë pjesë e kësaj Drejtorie nuk është kryer kontroll për evidentimin e çështjeve për përmirësim të sistemit pasi ka qenë në konflikt interesi duke u bazuar në Ligjin nr. 114/2015 Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik Neni 18. Konflikti i Interesave për audituesit e brendshëm, pika 2.a) punësimi gjatë 3 viteve të fundit në njësinë publike që do të auditohet, me përjashtimin të funksionit të audituesit të brendshëm;”. Për këto raste nuk është vepruar në kundërshtim me rregulloren e brendshme, detyrat funksionale të Auditit të IT pika 1 dhe 5.

1.1.Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion, rezultoi se, këto observacione janë të njëjta dhe përsëritje të observacioneve të bëra mbi aktkonstatimin e mbajtur, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në Projektraport se, ato nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë. Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo problematikë, pa anashkaluar punën e bërë deri në këtë kohë nga ana e Postës.

1.Titulli i gjetjes: Mbivendosje e kompetencave mbi emërimet e audituesve në Auditin e Brendshëm dhe pavarësia e aktivitetit të kësaj strukture në zhvillimin e auditimeve të brendshme.

Situata: Nga auditimi u konstatua se pozicionimi i strukturës së auditit të brendshëm në organikën e Postës Shqiptare rezulton të jetë nën Këshillin Mbikëqyrës, për të garantuar pavarësinë e kësaj strukture, por nga auditimi u konstatua se është përgjegjësi e Administratorit të shoqërisë të bëjë emërimet e punonjësve në strukturën e auditimit të brendshëm, ndërkohë që emërimi i drejtorit të auditit të brendshëm është kompetencë e Këshillimit Mbikëqyrës. Emërimi i audituesve të kësaj strukture nga Administratori, është në kushtet e konfliktit të interesit, për arsye se vendimmarrjet e Administratorit duhet gjithashtu të jenë objekt kontrolli pasi ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Kriteri: Neni 6, neni 10/pika 2 të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Struktura e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Ndikimi/efekti: Cenim i të drejtës së audituesit për të qenë i pavarur në ushtrimin e detyrave funksionale.

Shkaku: Nuk janë kërkuar të kryhen ndryshimet e nevojshme të kompetencave për të garantuar pavarësinë.

Rëndësia: E lartë

1.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të miratojë ndryshimet e nevojshme për marrjen e kompetencës për emërimet e audituesve në Auditin e Brendshëm dhe heqjen e kësaj të drejte nga Administratori i shoqërisë, me qëllim garantimin e pavarësisë së funksionaliteteve dhe objektivave që kërkohen të arrihen nga struktura e Auditit të Brendshëm si dhe shmangien nga kushtet e konfliktit të interesit për ushtrimin e detyrave të audituesit.

2.Titulli i gjetjes: Mos zbatim i ligjit, manualit të auditit të brendshëm në drejtim të IT, mos zbatim i rregullores në drejtim të TI.

Situata: Nga auditimi u konstatua se:

- Planifikimi për auditimin e brendshëm dhe sidomos në drejtimin e TI nuk është bazuar mbi sistemet e informacionit që disponon shoqëria të cilat ndikojnë tek kontrolli i brendshëm dhe raportimi financiar, në kundërshtim me manualin për auditimin e brendshëm.

- Nga administrimi i raporteve të auditit të brendshëm për filialet Fier, Lushnje, Shkodër, Tranzit dhe Gjirokastrë, Korçë, Mat, Sarandë dhe Vlorë u konstatua se në drejtim të auditimit të teknologjisë së informacionit nuk është ndjekur metodika që përcakton manuali i auditimit të brendshëm. Pikat e programit të auditimit të ushtruar nga auditit i brendshëm në çdo filial dhe trajtimi i tyre nga audituesi i brendshëm me profil në teknologjinë e informacionit, është shumë i ngjashëm në të gjitha raportet e periudhës 2018-2020.

- Nga administrimi i raporteve të auditit të brendshëm në drejtim të auditimit të sistemeve të TI-së nuk janë konstatuar çështje që mund të ndihmonin në përmirësimin e sistemit, por vetëm çështje me karakter udhëzues mbi përdoruesit, në kundërshtim me detyrat 1 dhe 5 të përshkruara për Audituesin e TI në rregulloren e brendshme institucionale të Posta Shqiptare.

- Posta Shqiptare nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe nuk ka planifikuar, kryer misionet auditimi mbi sistemet e TI-së në Drejtorinë e IT-së dhe Zhvillimit dhe Sektori i Sigurisë së Informacionit pranë Posta Shqiptare.

Kriteri: Ligji nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Neni 2, thuhet se “*Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes*”

- Nenin 4, pika 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në të cilën citohet se “*Auditimi i teknologjisë së informacionit*” përfshin vlerësimin e kontrolleve të menaxhimit në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive për të arritur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike”

- Nenin 11, pika 2/ç të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si mbikëqyrësi dhe si epror i drejtpërdrejtë i Audituesit IT në Posta Shqiptare sh.a në të cilën citohet se “ç) *punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si "Auditues i brendshëm", por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t'i nënshtrohet detyrimit procedurës së certifikimit si "Auditues i brendshëm". Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si "Auditues i brendshëm", punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji”*

- Pika 2 e rregullore së brendshme të shoqërisë miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës në të cilën citohet se “*Vlerëson përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve dhe kontrolleve të brendshme në Drejtorinë e Përgjithshme dhe Filiale, duke u fokusuar kryesisht në: identifikim, vlerësim dhe menaxhimin e riskut. Përputhshmërinë e veprimtarisë me kuadrin rregullator duke u fokusuar kryesisht në: ruajtjen e aseteve, besueshmërinë dhe gjithë përfshirjen e informacionit financiar dhe operacional; kryerjen e veprimtarisë me ekonomi, efektivitet dhe efijencë. Përmbushjen e detyrave dhe arritjen objektivave e qëllimeve të Posta Shqiptare sh.a.”*

- Manuali i auditimit të brendshëm;

- Pika 4 e rregullore së brendshme të shoqërisë miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës në të cilën citohet se “*Për auditimet në fusha specifike kërkon ndërhyrjen e Administratorit për angazhimin e ekspertëve të fushave të tjera”.*

- Pika 6 e rregullore së brendshme të shoqërisë miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës në të cilën citohet se “*Për problemet specifike - teknike kanë të drejtë të kërkojnë angazhimin e specialistëve apo të ekspertëve të fushave të ndryshme. Në raste kur afati i auditimit është i pamjaftueshëm, i paraqet Drejtorit, arsyet apo vështirësitë e dala gjatë auditimit IT, duke kërkuar konsulencën e nevojshme si dhe shtyrjen e afatit të përcaktuar në program”*

Ndikimi/efekti: Mos zbatim i ligjit, manualit të auditit të brendshëm në drejtim të IT, mos zbatim i rregullores.

Shkaku: Mungesa e ekspertizës së nevojshme në drejtim të auditimit të Teknologjisë së Informacionit nga auditi i brendshëm.

Rëndësia: E lartë

2.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të vlerësojnë me prioritet auditimin e IT, duke implementuar metodologjinë e përcaktuar në manualin e auditimit IT, dhe duke u thelluar në kontrolle të vazhdueshme me qëllim dhënien e sigurisë objektive, si dhe këshillimin e menaxhimit për arritjen e objektivave nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike të veprimeve që realizohen nëpërmjet sistemit për të garantuara sigurinë e të dhënave, si dhe minimizimin e kostove operacionale. Gjithashtu të merren masa për mbulimin me auditim të brendshëm IT të sistemeve IT, në Drejtorinë e IT-së dhe Zhvillimit në përputhje me përcaktimet ligjore.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Posta shqiptare Sh.a, nuk ka plan strategjik institucional të miratuar me qëllim përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave institucionale. Gjithashtu u konstatua se nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planifikimeve strategjike institucionale mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (14-27) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a, duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimeve postare dhe financiare që ofron shoqëria si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni zotëron dhe përpunon me qëllim përcaktimin e objektivave dhe adresimin e burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Postës, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik Institucional ku të përfshihet edhe planifikimi strategjik mbi teknologjinë e informacionit dhe ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare. Gjithashtu organet drejtuese të Postës Shqiptare Sh.a të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësisht të objektivave të përcaktuara.

Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Rregullorja e Brendshme, “Për organizimin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare nuk është përshtatur (*amenduar*) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Posta Shqiptare, konkretisht:

- Në rregulloren e brendshme të Posta Shqiptare Sh.a. detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara jo në mënyrë të detajuar. Në përcaktimin e kompetencave të drejtorit të IT dhe zhvillimit, në rregulloren e brendshme “Për organizimin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a” ka mbivendosje të këtyre kompetencave, pasi disa prej tyre tejkalojnë nivelin hierarkik të drejtorit të drejtorisë. Për shembull në pikën 16 të rregulloreve të brendshme ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e drejtorit të IT dhe zhvillimit, ku citohet se drejtori i IT “Përcakton, zhvillon dhe përsos më tej strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të automatizimit të Posta Shqiptare SH.A”, drejtori i IT, merr përgjegjësi të Administratorit.

Në disa raste përgjegjësi i sektorit të sistemeve ka më shumëtribute se sa drejtori i drejtorisë, për shembull në pikën 2, të Detyrave dhe Përgjegjësi të përgjegjësit të sektorit dhe sistemeve. Kjo problematikë haset edhe në sektorët e tjerë ku ka raste që kalojnë kompetencat hierarkike.

- Në disa raste konstatohet se mungojnë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi për disa funksione që janë në strukturën organizative por nuk gjenden të reflektuara në rregulloren e brendshme të funksionit të administratës qendrore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (14-27) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojë, amendojë dhe miratojë, rregulloren e brendshme, “Për organizimin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a”, me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në shoqëri. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në

konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

Brenda 6 mujorit të parë 2022 dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë fazës së auditimit në terren grupi i auditimit administroi një sërë rregulloresh dhe manualesh, të tjera nga ku u konstatua se institucioni administroi dhe ka në përdorim një bazë rregullative, konkretisht:

- Rregullore mbi veprimtarinë operacionale;
- Rregullore për lidhjen në distancë (Remote Access);
- Rregullore për Transparencën;
- Log management user and administration manual;
- Përdorimi i e-mail në smart phone;
- Si të ndërrohet password në kompjuterin e punës në zyrë dhe nga faqja e web.

Nga auditimi u konstatua se këto dokumente nuk janë të miratuara nga asnjë prej organeve drejtuese të Posta Shqiptare. Ato i janë paraqitur grupit të auditimit si përgjigje ndaj pyetësorit dhe përdorën si bazë rregullatore nga administrata e Postës, pavarësisht se nuk janë të miratuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (14-27) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masa për miratimin e këtyre rregulloreve dhe amendimin e tyre me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në shoqëri.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.Gjetje nga auditimi: Nga administrimi dhe auditimi i bazës rregullatore si: Politikat e përdorimit dhe sigurisë së sisteme TIK (*shkresa 1952/2, datë 19.08.2008*); Analiza e riskut për sistemet TIK (*shkresa nr. 1952/2, datë 19.08.2008*); Standardi i menaxhimit të problemeve dhe incidenteve (*shkresa 1952/2, datë 19.08.2008*); Procedurat e sigurimit të Postës Shqiptare (*shkresa 3678, datë 16.11.2006*); u konstatua se kjo bazë rregullatore nuk ka reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite dhe ndryshimet në investime në fushën e teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare. Disa nga dokumentet e mësipërme mbajnë të njëjtën datë dhe numër protokoll në kundërshtim me nenet 36-41 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Aktualisht këto rregullore janë ende në përdorim nga administrata e Postës.

4.2.Gjetje nga auditimi: Nga administrimi i “Rregullores mbi procedurat e backup-it të Posta Shqiptare Sh.a” miratuar me shkresën nr. 583/1, datë 25.02.2019, të drejtorit të sigurisë dhe cilësisë u konstatua se kjo rregullore është nënshkruar jo nga organet drejtuese të Posta Sh.a, por nga një nivel menaxherial që nuk ka kompetenca juridike për nënshkrimin dhe nxjerrjen e akteve administrative institucionale, në kundërshtim me nenet 7, 11 dhe 14 të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare.

4.3.Gjetje nga auditimi: Nga administrimi i Rregullores “Për Administrimin e Rrezikut Operacional” u konstatua se kjo rregullore është miratuar dy herë brenda vitit. Kjo rregullore është miratuar me shkresën nr. 583/2, datë 25.02.2019, të administratorit të shoqërisë, e cila ka shfuqizuar rregulloren nr. 1579, datë 31.08.2011 “Për administrimin e rrezikut operacional”. Nga auditimi u konstatua se kjo rregullore është miratuar edhe me shkresën nr. 2144, datë 09.08.2019 të administratorit të Postës, e cila është e njëjtë në përmbajtje por nuk ka shfuqizuar rregulloren me shkresën nr. 583/2, datë 25.02.2019. Kjo gjë sjell konfuzion në përdorim dhe në zbatim të këtij dokumenti nga administrata sepse në disa raste i referohen rregulloreve të ndryshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (14-27) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojnë, amendojnë dhe miratojnë, aktet rregullative të cituara më lart në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në Postën Shqiptare.

Gjatë hartimit dhe miratimit të tyre të respektohen rigorozisht përcaktimet ligjore për arkivat në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1.Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021 struktura e sektorit të sistemeve në Drejtorisë së IT-së dhe Zhvillimit është e paplotësuar sipas strukturës organike të përcaktuar. Gjatë periudhës së auditimit ka patur 3 (tre) largime të stafit IT 2 (dy) prej të cilave janë zëvendësuar me lëvizje brenda përbrenda Drejtorisë, dhe 3 (tre) pozicione janë zëvendësuar me staf të ri.

Nga auditimi u konstatua se mungojnë përshkrimet e punës për stafin e Drejtorisë së IT dhe Zhvillimit mbi mënyrën dhe ndarjen e përgjegjësive specifike të roleve, punëve dhe veprimeve operacionale brenda drejtorisë, në mospërputhje me përcaktimet në nenin 4 pika 20, neni 20 pika c dhe neni 22 pika b të ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

5.2.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Posta Shqiptare, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2019-6-mujori i parë i vitit 2021 për burimet njerëzore të drejtorisë së Teknologjisë e Informacionit dhe Zhvillimit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Mbështetur në rregulloren për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SH.A, është detyrë dhe kompetencë e niveleve menaxheriale propozimi dhe hartimi i kërkesave për trajnime.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (14-27) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Administratori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare Sh.a në bashkëpunim me Departamentet përkatëse në Posta Sh.a dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për menaxhimin e burimeve njerëzore, me qëllim adresimin e përgjegjësive dhe përcaktimin e detyrave si dhe plotësimin e vendeve vakante sipas strukturës organike. Gjithashtu të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndërtimin dhe organizmin e strukturës së Posta Shqiptare Sh.a. u konstatua se Sektori i Sigurisë së Informacionit është në varësi të Drejtorisë së Sigurisë dhe Cilësisë pjesë e Departamentit të Zhvillimit dhe Standardeve. Ky sektor ka qenë nën varësinë e Drejtorisë TIK dhe që prej vitit 2018 ka kaluar në varësinë e Drejtorisë së Sigurisë dhe Cilësisë. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të këtij sektori përcaktohet kryerja e auditimit të rrjetit dhe sistemeve, gjetja e dobësive në sisteme si dhe shqyrtimi i raporteve të auditit të sistemeve, detyrë kjo e cila sjell mbivendosje të kompetencave me auditin IT. Një ndër detyrat e përcaktuara për Specialistin e Sektorit të Sigurisë së Informacionit është “sigurimi që të jenë zhvilluar dhe zbatuar procedurat standarde, udhëzimet e sigurisë dhe masat që mbështesin sigurinë e të gjithë rrjetit dhe sistemeve si dhe të gjithë komponentët e rrjetit”.

Nisur nga shtrirja e teknologjisë së informacionit në institucion si dhe nga rëndësia e të dhënave që ruhen dhe përpunohen nga Sektori i Sigurisë së Informacionit dhe ofrimit të shërbimeve postare dhe financiare me anë të sistemit informatik “Eterna”, gjykojmë se organizimi i kësaj strukture nën Drejtorinë e Sigurisë dhe Cilësisë, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Postën Shqiptare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (14-27) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe strukturat këshilluese mbi IT, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrin masa për pozicionimin e Sektorit të Sigurisë së Informacionit në varësi të Drejtorisë së IT-së dhe Zhvillimit me qëllim përmbushjen në mënyrë sa më efektive të objektivave sektoriale dhe koordinimin e aktivitetit të saj me sektorët e tjerë që janë pjesë e të njëjtës fushë duke sjellë rritjen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e Postës Shqiptare.

Brenda vitit 2022

7.Gjetje nga auditimi: Nga administrimi i dokumentacionit se si Posta Shqiptare, identifikon dhe menaxhon risqet institucionale dhe risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se Posta Shqiptare nuk disponon regjistër rrisht të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet Eterna, IPS, CDS, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekte negative përsa i përket arritjes së objektivave institucionale.

Nisur sa më sipër rezulton se shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar regjistrin e riskut ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit, kjo mbështetur në nenin 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (14-27) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me Drejtorët e Departamenteve të marrin masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, në të cilin të përcaktohen edhe risqet në teknologjinë e informacionit. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin/ parandalimin e risqeve të identifikuar, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

Brenda 6 mujorit të vitit 2022 dhe në vijimësi

8.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave që ndodhet në zyrat qendrore pranë Postës Shqiptare Sh.a u konstatua:

- Ambienti nuk ka të instaluar një sistem akses kontrolli i cili garanton hyrjen e personave të autorizuar;
- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Kabllimet dhe lidhjet e rrjetit në switch dhe patch panel nuk janë të sistemuar;
- Në paradhomën e serverëve në të cilën janë të vendosur sistemi UPS dhe paneli elektrik, sistemi i kondicionimit ishte jashtë funksionit, kishte prani të lagështirës dhe hyrja në këtë ambient ishte e përbërë nga derë vetratë duralumini, faktor i cili ul nivelin e sigurisë në dhomën e serverëve;
- Nuk ka një plan testimi të sensorëve të zjarrit si dhe mirëmbajtje për sistemin elektrik dhe sistemin backup UPS;
- Nuk bëhen kolaudime për sistemin Antizjarr;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System).

8.2 Gjetje nga auditimi: Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në këtë site u konstatua:

- Largësia dhe pozicionimi i site-it DRC nuk përputhet me përcaktimet ligjore që parashtojnë kushtet dhe distancën e ndërtimit të një DRC-je;
- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Nuk është instaluar akses kontrolli për të kontrolluar dhe monitoruar hyrjet dhe daljet e personave në ambientin e DRC. Hyrja në këtë ambient realizohet duke hapur derën me çelës;
- Nuk kishte sensorë për matjen e temperaturës dhe lagështirës;
- Sistemi i kondicionimit nuk ishte efektiv pasi për të arritur ftohjen e duhur të serverëve përdorëshin pajisje të tjera ndihmese, si freskuese;
- Muret e dhomës së serverave në site-in DRC nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday).

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (103-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverave në bazë të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim ruajtjen e sigurisë fizike të ambienteve të infrastrukturave kritike.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i përdoruesve të sistemit Eterna Financiare realizohet nga Sektori i Aplikimit & Administrimit të Dhënave, detyrë kjo e atribuar pa një shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë së Postës Shqiptare sh.a.

-Administratorin e sistemeve eterna postar dhe financiar si dhe IPS (*International Postal System*) dhe CDS (*Custom Declaration System*) e ushtron përgjegjësi i sektorit të aplikimit dhe administrimit të të dhënave në drejtorinë IT dhe zhvillimit. Detyra e Administratorit të sistemit eterna i është atribuar pa asnjë shkresë zyrtare nga organet drejtuese të shoqërisë. Pavarësisht se nuk është e emëruar zyrtarisht si Administratore sistemi, ajo ushtron të gjitha detyrat e administratorit të sistemit. “*Administratori i Përgjithshëm*” i sistemit Eterna që ka të drejta universale është kompania Helius e cila ka ndërtuar dhe zhvilluar sistemin Eterna.

-Atributet dhe rolet e userave në sistemin Eterna Postar dhe Financiar nuk janë të përcaktuara sipas detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në rregulloren e brendshme administrative por sipas funksionaliteteve që punonjësi ushtron në praktikë përgjatë procesit të punës.

- Për periudhën objekt auditimi, Posta Shqiptare sh.a. nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve të Sistemit Eterna Financiare dhe Eterna Postare në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve.

Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email. Kërkesat për krijim/aktivizim/çaktivizim apo modifikim të përdoruesve (*ndryshim i zyrës së aksesit apo i profilit të të drejtave*) realizohen me email në dijeni nga Drejtoritë e Shërbimeve përkatëse, ose nga shefja e shërbimit në filialin përkatës apo specialistet e shërbimit.

Ndërsa në sistemin IPS për krijimin e një përdoruesi është kusht krijimi më parë i userit në domain, pastaj krijimi i login-it në bazën e të dhënave i tipit “*Windows Authentication*”.

9.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dhënat mbi përdoruesit u konstatuan raste për të cilat “*loginID*” është e ndryshme nga “*fullname*”, duke sjellë risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem si dhe duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (103-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që ka në përdorim institucioni, me qëllim pasqyrimin e saktë të përgjegjësive, detyrave dhe të drejtave për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemeve të IT.

9.2.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që Posta Sh.a ka në përdorim me qëllim përcaktimin e përgjegjësive dhe të drejtave të administratorit të sistemeve IT.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit e sistemit Eterna Financiare dhe Eterna Postare u konstatua se:

- Nuk janë aplikuar në sistem kritere të detyrueshme për rritjen e sigurisë së fjalëkalimit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit;

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për përdoruesit fundor të sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten në fjalëkalimin e tyre të aplikohen, bazuar në pikën 4 “*Kërkesat e Sigurisë*” pika a. të rregullores për “*Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike*” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “*Kërkesat e Sigurisë*” pika b, të rregullores për “*Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike*” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

-Përdoruesit e rinj nuk aktivizohen automatikisht, nëse opsioni “Aktiv” nuk është zgjedhur, çfarë parandalon së pari veprime të tjera operationale, por dhe si një veprim i shpeshtë i cili duhet të jetë standard.

-Nuk janë aplikuar në sistem kritere të detyrueshme për rritjen e sigurisë së fjalëkalimit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (103-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit të marrë masa për adresimin e çështjeve të konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit. Të merren në konsideratë praktikrat e përcaktuara në rregulloren për “*Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike*” miratuar nga AKCESK. Gjithashtu, të aktivizohen automatikisht:

-Opsioni “Aktiv” për përdoruesit e rinj, çfarë parandalon së pari veprime të tjera operationale, por dhe si një veprim i shpeshtë i cili duhet të jetë standard.

-Ndryshimi i fjalëkalimit me forcë nëpërmjet opsionit “Ndrysho fjalëkalimin në log-imin e radhës”, as në rastet kur fjalëkalimi gjenerohet në mënyrë automatike si emri i përdoruesit për përdoruesit e rinj.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit e Sistemit Eterna Financiare u konstatua se:

- Fusha “user_id” është në formë progresiv rritës, por jo i vazhdueshëm dhe pa ndërprerje, e cila mund të na tregojë se janë fshirë përdorues nga sistemi. Nga verifikimi i përdoruesve në sistem u konstatua se mungojnë 25 “user_id” të përdoruesve. Mungesa e këtyre Id-ve tregon se këto user-a janë fshirë. Nga auditimi u konstatua se për këto veprime nuk është mbajtur asnjë dokument justifikues për fshirjen e këtyre userave.

-Mbajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie pune me Posta Shqiptare Sh.a, gjithashtu janë aktiv në sistem dhe punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Postën Shqiptare.

-Në të dhënat mbi përdoruesit rezultojnë 5 raste për të cilat ekziston user i përsëritur.

-Nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e “username” dhe “fullname” ku pjesa më madhe është krijuar me emër.mbiemër për “username” dhe Emër Mbiemër për “fullname”. Në shumë raste ky model nuk është ndjekur dhe rezultuan 57 raste të përdoruesve për të cilët “fullname” është me gërma kapital;

-Emri i plotë “fullname” në disa raste është plotësuar me nga një prapashtesë “GABIM”, “GABIMM”, “_gabim” ose me emër qyteti. Rezultojnë 8 raste me prapashtesën “GABIM”, 1 rast me prapashtesën “GABIMM”, 1 rast me prapashtesën “_gabim”;

-Për “fullname” të përdoruesit rezultojnë 8 raste kur vetëm mbiemri është me gërma kapitale, 3 raste kur emri fillon me germë të vogël, 1 rast kur emri dhe mbiemri fillon me germë të vogël dhe 2 raste kur mbiemri nuk fillon me germë kapitale;

-Rezultojnë 46 përdorues për të cilët “username” dhe “fullname” kanë të njëjtin format emër.mbiemër, si dhe për 2 përdorues “username” është vendosur si standardi i “fullname” dhe “fullname” si standardi i përdorur për “username”;

-Rezultojnë 38 usera të pa identifikuar për financat e filialeve, për këto përdorues është përdorur standard financa.emrifilialit si për fushën “username” dhe “fullname”. 1 rast prej të cilave është i përsëritur. Nga verifikimi i të dhënave mbi përdoruesit rezultojnë user të pa identifikuar. Raste për user-at “burimetraporte”, “ana.test” dhe “eposta”, si dhe për user-at “user2”, “test”, “usertest”, “menaxhertest” për të cilët atributi “last_login” është NULL.

Rezultojnë 298 user-a të cilët atributin e “last_login” e kanë NULL, fakt i cili tregon se për këto user-a është fshirë gjurma e veprimeve të fundit që kanë kryer në sistem.

11.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit e Sistemit Eterna Postare u konstatua se:

- fusha “user_id” nuk është e strukturuar në formë progresive rritëse e cila tregon se mund të jenë fshirë të dhëna nga sistemi dhe sjell risk për komprometimin e të dhënave dhe humbjes së gjurmës audituese;

- mbajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me Postën Shqiptare sh.a.

- emri i plotë “fullname” në disa raste është plotësuar me një prapashtesë me emër qyteti ose fshati. Rezultojnë 12 raste me prapashtesën _PE, Ulez, (Klos), Elb, (eruje), ELBASAN, FIER, (Benj), LIS, Selishte, Macukull dhe (Klos);

- nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e “loginID” dhe “fullname” ku pjesa më madhe është krijuar me emër.mbiemër për “loginID” dhe Emër Mbiemër për “fullname”. Në shumë raste ky model nuk është ndjekur, ku rezultuan 121 raste për të cilat “fullname” është me gërma kapital, ose raste kur atributi loginID përveç formatit emër.mbiemër ka prapashtesë gërma dhe dy raste me numrin “2”;

- për “fullname” të përdoruesit ka 9 raste kur vetëm mbiemri është me gërma kapitale, 4 rast kur emri dhe mbiemri fillon me germë të vogël dhe 1 rast kur mbiemri nuk fillon me germë kapitale;

- janë 39 përdorues për të cilët “loginID” dhe “fullname” kanë të njëjtin format emër.mbiemër, si dhe për 2 përdorues “loginID” është vendosur si standardi i “fullname” dhe “fullname” si standardi i përdorur për “loginID”;

- ekzistojnë 22 user-a me rolin “shofer” për të cilët nuk ka asnjë atribut në sistem. Përveçse atributit mungon edhe identifikimi i userit p.sh, mund të shtohet emër mbiemër për të identifikuar veprimtarinë e gjithsecilit, pasi janë 22 usera me rolin shofer por të pa identifikuar.
- janë 5 usera të pa identifikuar për ZVRPP, për këto përdorues është përdorur standard ZVRPP-Tirana Veri/ ZVRPP-Tirana Jug dhe ZVRPP- Rulale 1/ ZVRPP- Rulale 2 si për fushën “loginID” dhe “fullname”;
- ka usera të pa identifikuar si “test.test”, “fab.test”, “tranzit”, “fier.qender”, “KosovaEMS”, “KosovaPosta” dhe “EternaWeb”. Gjithashtu ekziston user me loginID “silvana.topulli” për të cilën fullname është “d”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (103-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të marrë masa për unifikimin e të dhënave për përdoruesit e sistemit Eterna financiare dhe postare të të njëjtës kategori, të plotësojë të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrole për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale të evidentuara nga auditimi në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave mbi përdoruesit e sistemeve Eterna financiare dhe postare.

11.2.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit të ndërtojë mekanizma kontrolli për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit e sistemeve, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave që lidhen me sigurinë e të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare nuk ka zbatuar praktikën me të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network. Infrastruktura network në Postën Shqiptare menaxhohet pa krijuar grup userash me role të ndara me të drejta konfigurimi.

- Useri admin është i aktivizuar dhe nuk ka një user me emërtim ndryshe me të drejtat e Administratorit si dhe Routerat e ndodhura në filialet e Postës Shqiptare kanë të aktivizuar userin admin.

- Nuk ka të implementuar një procedurë kontrolli të log-eve për të parë erretet ose problemet e ndryshme;

- Posta Shqiptare nuk ka marrë masa për lidhje të dytë Backup, problem që evidentohet në të gjitha Filialet e saj.

12.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare nuk ka marrë masa për krijimin e një filtri i cili bllokoi një IP të caktuar e cila ka tentuar të aksesojë porta ose subnete kritike.

- Posta Shqiptare për të bërë DST NAT përdor porta standarde Remote Desktop, SSH dhe Telnet;

- Posta Shqiptare nuk ka krijuar grup userash të cilët kanë role të ndara dhe të drejta konfigurimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (103-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në postën Shqiptare të marrë masa për:

- Konfigurimin në routerin kryesor të një skripti i cili monitoron subnetet ku posta ka shërbimet e saj me qëllim detektimin në rastin e një sulmi ose hyrje të pa autorizuar IP-në e aksesimit dhe në mënyrë automatike ta vendosi në një “blacklist “.

- Të merren masa për të ndryshuar të gjitha portat e aksesimit të serverave, pajisjeve nga standarde në custom pasi sulmet bëhen gjithnjë në portat standarde të aksesimit Remote, me qëllim uljen e riskut për thyerje të sigurisë.

- Të bllokohet useri “admin” dhe të krijohet një user me emërtim ndryshe dhe me privilegje të plota.

-Të krijohen grup userash me të drejta të limituara. Një user i cili shërben për monitorimin SNMP me të drejta vetëm Read dhe një user i cili aksesohet nga stafi me të drejta vetëm Read.

-Të krijohet një procedure e kontrollit të log-eve javore për të parë dhe analizuar a ka patur tentative sulmesh, ose skanime të userit admin.

-Posta Shqiptare duhet të marrë masa për lidhje backup për të gjitha filialet e saj, duke garantuar shmangien e bllokimit të punës në rast të një defekti në lidhjen primare.

Gjithashtu të merren masa për administrimin dhe implementimin e të gjitha konfigurimeve të nevojshme të evidentuara nga auditimi dhe të tjera të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë së infrastrukturës network.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

13.1 Gjetje nga auditimi: Posta Shqiptare përdor për storage EMC Clarion i cili shërben për tek datacenteri primar. Gjithashtu është edhe një storage i dytë i cili është IBM Storewize. IBM dhe EMC shërben për makinat virtuale dhe për ruajtjen e të dhënave dhe data bazat e aplikacioneve që Posta ka në përdorim. Storage EMC Clarion është një produkt i cili është End Of Life dhe prodhuesi nuk ofron me suport për këtë model. Nisur nga zhvillimet që Posta Shqiptare ka bërë në sistemet e saj, storage aktualisht ndodhet drejt ezaurimit të hapësirës dhe nevojitet shtimi i kapacitetit të hard drive.

13.2 Gjetje nga auditimi: Posta Shqiptare ka në përdorim Fujitsu Blade Server Primergy BX920S2 i cili shërben për hostimin e të gjitha makinave virtuale dhe janë të konfiguruar me Storage IBM dhe EMC. Modeli i Fujitsu Blade Server Primergy BX920S2 nuk ofrohet më suport nga prodhuesi pasi është End of Life.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (103-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në Postën Shqiptare të marrë masa për rritjen e kapacitetit të storage apo zëvendësimin e tyre në përputhje me nevojat institucionale që Posta Sh.a ka, duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike për të ardhmen në shoqërinë Posta Shqiptare, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së punës.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi u konstatua se Posta Shqiptare Sh.a.:*

- Nuk disponon akte rregullatore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën e Postës, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06. 2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT). Institucioni duhet të përcaktojë një rregullore të shkruar për menaxhimin e log-eve sipas kërkesave të institucionit. Kjo rregullore duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi;

- Nuk janë përcaktuar burimet e nevojshme si dhe detyrat e personelit për menaxhimin e tyre;

- Posta Shqiptare Sh.a. nuk zhvillon kontrole mbi Audit Log, pavarësisht rëndësisë që kanë këto të dhëna në përmirësimin e sistemit, konstatimin dhe analizimin e problematikave të ngjashme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (103-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1.Rekomandim: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a t’i japin rëndësi sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen dhe tjetërsimin e tyre. Në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Posta Shqiptare nuk ka marrë masa për mbrojtjen nga Cyber Security përmes një sistemi inteligjent i cili detekton dhe monitoron në kohë reale të gjitha strukturat Rrjet/Aplikacion/Database/Users si dhe sulme të tipit DDOS. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (103-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në Postën Shqiptare të marri masa për ndërtimin e mekanizmave inteligjent me qëllim monitorimin në kohë reale të të gjitha protokolleve të sigurisë për sistemet e operimit, databazat si edhe protokollat e rrjetit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Posta Shqiptare Sh.a, pavarësisht se ka marrë masa të konsiderueshme për ngritjen e një infrastrukture të nevojshme për sigurimin e vazhdueshmërisë së punës, nuk ka hartuar dokumente të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPOs (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.

-Procedura e hartuar/e ndjekur nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në ndonjë dokument administrativ si rregullore e brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet.

-Posta Shqiptare nuk ka një plan testimi për sistemet kyçe, të paktën 1 herë në muaj, duke përdorur Restore si dhe të gjitha replikimet të testohen duke analizuar të dhënat më të fundit në rastin e një strukture me baza të dhënash.

-Backup-et i kalojnë në një file server të dedikuar për ruajtjen e backup-eve për nuk përdoret enkriptim në transferim.

-nuk realizohet backup për loget e sistemit të hyrje-daljeve të personelit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (103-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1.Rekomandim: Drejtoria e IT dhe Zhvillimit në bashkëpunim me strukturat drejtuese në Postën Shqiptare të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

Në vijimësi

17.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Postën Shqiptare Sh.a, nuk është dokumentuar gjurma e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, si një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë dhe institucionit, si dhe jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta apo për t'i verifikuar ato.

17.2. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Posta Shqiptare Sh.a, kryen veprime operacionale në sisteme informatike të cilat janë zhvilluar me qëllim informatizimin e veprimeve që kjo shoqëri ofron për shtetasit e saj, por në mungesë të diagrameve shpjeguese se si informacioni rrjedh nëpërmjet sistemit të TI që mbështet proceset kryesore të institucionit. Mungesa e diagrameve krijon pengesa në kuptueshmërinë, vlerësimin dhe gjurmimin e veprimeve që kryhen nëpërmjet sistemit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (126-157) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, në bashkëpunim me drejtorët e përgjithshëm të cilët drejojnë sipas strukturës Departamentin e Shërbimeve, Administrimin e Shoqërisë dhe Zhvillimit dhe Standardeve të hartojnë, dokumentojnë dhe miratojnë gjurmën e auditimit për

rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, ku të jenë identifikuar procedurat dhe operacionet që shoqëria ndjek me qëllim qartësinë dhe kuptueshmërinë e mjedisit të kontrollit.

17.2.Rekomandimi: Drejtuesit e Departamentit të Shërbimeve, Administrimit të Shoqërisë dhe Zhvillimit dhe Standardeve krahas identifikimit të proceseve që nevojiten për dokumentimin e gjurmës audituese, në bashkëpunim me Drejtorinë e IT dhe Zhvillimit dhe Drejtorinë e Sigurisë dhe Cilësisë duhet të hartojnë dhe dokumentojnë diagramet e rrjedhës së informacionit për çdo proces që realizohet nëpërmjet sistemit me qëllim përcaktimin e të dhënave hyrëse, roleve, ndryshimin, miratimin dhe përfundimin për çdo shërbim që realizohet nëpërmjet sistemit informatik.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimin e statusit të përdoruesve në sistem, rezultojnë se nuk pasqyrohen ndryshime për përdoruesit përkohësisht jo aktiv apo përdorues të cilët mund të jenë larguar me leje të gjatë si raport shëndetësor apo leje lindje, çfarë cenon sigurinë e të dhënave e cila nuk është përgjegjësi e punonjësit të larguar, por e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së TI dhe Zhvillimit, mbi pasqyrimin e ndryshimeve në sistem.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (126-157) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1.Rekomandimi: Burimet Njerëzore të përditësojnë në sistem ndryshimet e punonjësve me status të larguar me leje të gjatë apo përkohësisht jo aktiv, me qëllim gjenerimin sistematik për këto të dhëna nga Drejtoria e TI dhe Zhvillimit të cilat duhen administruar për kufizimin e të drejtave të këtyre përdoruesve, veprime të cilat do të përmirësonin procesin e statusit të përdoruesve dhe do të parandalonte çdo mundësi për akses të paautorizuar në të dhëna. Gjithashtu të marren masa për monitorimin e vazhdueshëm të statusit të përdoruesve.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Mbështetur në testimet e ndryshme të zhvilluara në sistemin Eterna rezultuan disa mangësi të sistemit të cilat pengojnë kryerjen e veprimeve automatike, konkretisht:

- Nuk është e mundur në sistem të hidhet kursi ditor për monedhën EUR, apo të ndryshohet.
- Përditësimi i manualeve të Eternës nuk është bërë duke siguruar shtimin e produkteve/shërbimeve të reja.
- Raporti i pagave nga sistemi Eterna Financiar në modulën e burimeve njerëzore tregon se paga neto është e njëjtë me pagën bruto çfarë tregon se të dhënat për të dy fushat regjistrohen manualisht, duke rritur mundësinë për gabime operacionale. Theksojmë se kjo është më pak se sa ofron Excel në të cilën paga neto del si rezultat i implementimit të formulave të thjeshta.
- Fletëdaljet e artikujve dërgohen fizikisht në filiale, dhe po manualisht filiali i regjistron në sistem edhe pse disponojnë një modul magazine nga i cili këto veprime duhet të realizoheshin automatikisht.
- Moduli i blerjeve dhe moduli për menaxhimin e dokumenteve nuk rezultojnë se kanë të dhëna, që do të thotë se nuk janë në përdorim, edhe pse nevoja për të administruar nëpërmjet sistemit është e madhe.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (126-157) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, të marrë masa për përditësimin e manualeve të sistemit Eterna me qëllim shtimin e produkteve/shërbimeve të reja si dhe të marrë masa për sistemin e mangësive në sistem për mirëmbajtjen e kursit të këmbimit për monedhën EUR.

19.2.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të përfundojë regjistrimin e të dhënave të sakta në modulën e burimeve njerëzore dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e TI dhe Zhvillimit të identifikojë të dhëna që nevojiten të regjistrohen nga përdoruesi dhe të dhënat që gjenerohen automatikisht prej sistemit si në rastin e raportit të pagave nga sistemi Eterna Financiar ku paga neto rezultojnë e njëjtë me pagën bruto që tregon se të dhënat për të dy fushat

regjistronen manualisht, duke rritur mundësinë për gabime operacionale, me qëllim uljen e problematikave me veprimet operacionale të përdoruesve.

19.3.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në shoqërinë Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masa për vënien në funksion sa më shpejtë të funksionaliteteve ekzistuese në Eterna lidhur me fletëdaljet e artikujve të modulit magazine me qëllim realizimin e këtyre veprimeve në mënyrë automatike si dhe vënien në funksion modulit e blerjeve dhe modulit për menaxhimin e dokumenteve të cilët nuk janë në përdorim, edhe pse nevoja për të administruar nëpërmjet sistemit është e madhe.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

20.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportet e gjeneruara prej sistemit Eterna Financiar u konstatuan disa problematika në lidhje me gjenerimin e tyre, konkretisht:

- Të gjitha raportet që u gjeneruan, kërkojnë patjetër përpunime në Excel sepse dhe raportet përmbledhëse janë konceptuar në nivel filiali edhe në rastet kur kërkesa për informacion ekzekutohet në nivel republike;

- Nuk ka asnjë opsion të gjenerosh të dhëna për të dy monedhat EUR dhe LEK;

- Nuk ka asnjë raport për përdoruesit, roli dhe zyrat në të cilat kanë akses;

- Për përdoruesit në modulet Magazina, Moduli i Blerjeve, Inventari, Menaxhimi i Dokumenteve rezulton se nuk është ndërtuar asnjë raport në strukturën e raporteve, madje për këto shërbime nuk rezulton se janë hedhur të dhëna me qëllim vënien në funksion të tyre.

20.2. Gjetje nga auditimi: Nga testime të ndryshme në sistemin Eterna Postar përgjatë gjenerimit të raporteve nga pema e raporteve u konstatuan disa parregullsi/mangësi, konkretisht:

- sistemi nuk gjeneron raporte dorëzimi për një periudhë të gjatë kohore;

- nuk shfaqet asnjë e dhënë që përdoruesi të përzgjedhi me qëllim gjenerimin e raporteve;

- opsioni RPO40 shfaq një tabelë pa asnjë të dhënë për opsionet e përzgjedhura nga përdoruesi;

- raporte supervizori kanë shumë vonesa në gjenerimin e raporteve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (126-157) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi mbi raportet që gjenerojnë të dhëna të sistemit të cilat nuk kanë filtrat e aplikuar, nuk zgjidhin kërkesat e përdoruesve të cilët krijojnë mënyra alternative të përpunimit të mëtejshëm të informacionit jashtë sistemit Eterna Financiar dhe Postar, çfarë do të lehtësonte veprimet manuale të punonjësve.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

21. Gjetje nga auditimi: -Nga auditimit onsite në zyrat postare të Posta shqiptare në Tiranë u konstatuan raste kur janë fshirë në mënyrë automatike nga sistemi Eterna Postar, të dhënat e klientit (*marrësit*) i cili do të marrë këtë objekt. Këto raste kanë ndodhur kur pakot nuk i janë dorëzuar klientit përkatës dhe kanë ngelur në zyrat postare, gjë për të cilën punonjësit detyrohen ti hedhin përsëri manualisht në sistem duke bërë edhe njëherë popullimin e të dhënave nga fillimi, proces i cili rrit riskun për gabime njerëzore në hedhjen e të dhënave.

- Të dhënat për pakot e ardhura që popullohen nga specialistët janë: emër, mbiemër, id dhe adresën e pritësit të postës. Nga auditimi në sistemin Eterna Postar u konstatua se ky sistem nuk ofron si opsion që të dhënat e klientit marrës të cilat janë populluar njëherë në sistem të shfaqen si sugestion (*propozime*) nga sistemi me idenë që këto të dhëna mund të hidhen në mënyrë automatike, pa qenë nevoja të ri plotësohen në mënyrë manuale edhe njëherë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (126-157) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi mbi fshirjen në mënyrë automatike nga sistemi Eterna Postar të të dhënave të marrësit të pakove që janë në

pritje si dhe të merren masa për shtimin e funksionaliteteve të reja mbi popullimin e informacioneve të klientëve ekzistues në mënyrë të automatizuar, çfarë do të lehtësonte veprimet manuale të punonjësve.

Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2022

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ndërmjet Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Posta Shqiptare është nënshkruar një marrëveshje “*Për shërbimet publike elektronike në portalin unik qeveritar e-Albania*”, me objekt ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania ndaj subjekteve fizikë dhe juridikë, shtetëror dhe privat, miratuar me shkresën nr. 221, datë 25.01.2019.

Mbështetur në marrëveshjen e sipërcituar, Administratori i Posta Sh.a ka nxjerrë udhëzimin “*Mbi kryerjen e shërbimit bazuar në marrëveshjen e lidhur me AKSHI-n*” miratuar me shkresën nr. 221/1, datë 28.01.2019.

Nga auditimi u konstatua se vlefshmëria e marrëveshjes së lidhur ndërmjet dy institucioneve ka përfunduar dhe rrjedhimisht edhe vlefshmëria e udhëzimit (*pikat 5.1 dhe 5.2, të nenit 5, Kohëzgjatja të marrëveshjes*). Posta shqiptare vazhdon ta ofrojë këtë shërbim edhe pse marrëveshja e ka mbaruar vlefshmërinë e saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (126-157) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a. në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masat e nevojshme për rinovimin/hartimin dhe miratimin e marrëveshjes me qëllim koordinimin për ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania, ndaj subjekteve fizikë dhe juridikë, shtetëror dhe privat.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ofrimin e shërbimeve nga e-Albania, nga shoqëria Posta Shqiptare u konstatua se:

- Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave personale, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. me vendimin nr. 43, datë 28.12.2015 dhe e përditësuar në vitin 2019 e cila është ende e pa miratuar, tregon se nuk janë marrë masat e nevojshme nga Posta Shqiptare për sigurinë e të dhënave personale si detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, neni 20 “*Detyrimet e përpunuesit*”, neni 21 “*Përgjegjësia për të njoftuar*” dhe neni 27 “*Masat për sigurinë e të dhënave personale*”. Kjo do të thotë se punonjësit e Postës Shqiptare nuk janë të informuar se nëpërmjet shërbimeve e-Albania janë duke punuar me të dhëna personale të shtetasve, të cilat mbrohen me ligjin e përmendur më lart.

- Në disa raste, i njëjti punonjës rezulton të ketë më shumë se dy përdorues aktiv tek portali e-Albania. Gjithashtu, ka punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Posta Shqiptare dhe rezultojnë të kenë përdorues aktiv për leximin e shërbimeve nga e-Albania, nën llogarinë e shoqërisë.

- Sipas të dhënave të gjeneruara nga moduli i e-Albania për Posta Shqiptare, numri i printimeve nga e-Albania është 198,585 dokumente që mendohet të jetë dhe numri i transaksioneve për të cilat është arkëtuar një komision. Nga sistemi Eterna Financiar në total dalin 62,292 transaksione. Përgjatë vitit 2019, filialet i kanë raportuar shërbimet e-albania si të ardhura në zëra të ndryshëm dhe përgjatë vitit 2020 ky shërbim identifikohet si shërbim biznesi pavarësisht faktit se dokumenti mund të tërhiqet si biznes apo individ. Kjo do të thotë se drejtoria ekonomike e ka pothuajse të pamundur të evidentojë numrin e rekordeve për të cilat është arkëtuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (126-157) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a të marrin masa për gjetjen e mekanizmave të kontrollit në ofrimin e shërbimeve nga e-albania, që garantojnë regjistrimin e çdo dokumenti të printuar apo elementëve të tij unik, në sistemin e brendshëm Eterna

Financiar me qëllim monitorimin dhe parandalimin e keqpërdorimit si rezultat i aksesit të paautorizuar.

Gjithashtu të merren masa për adresimin e konstatimeve të auditimit mbi trajtimin e të dhënave personale sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, mbi “përgjegjësinë për të njoftuar” “detyrimet e përpunuesit” si dhe “masat për sigurinë e të dhënave personale”.

Në vijimësi

23.2.Rekomandimi: Drejtoria e TI dhe Zhvillimit, të analizojë dhe të marri masa mbi përdoruesit që kanë më shumë se dy user-a aktiv tek portali e-Albania si dhe përdoruesit që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Postën Shqiptare dhe rezultojnë të kenë përdorues aktiv për leximin e shërbimeve nga e-Albania, me qëllim uljen e riskut për akses të paautorizuar dhe keqpërdorimin e të dhënave.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat “output” gjeneruar prej sistemit si dhe të dhënave të raportuara tek institucionet që administrojnë dhe hartojnë politikat e shoqërisë Posta Shqiptare, u konstatuan disa parregullsi, konkretisht:

- Aktrakordimet që kryen zyra qendrore, me Drejtorinë e Përgjithshme, rezultuan se disa prej tyre kryhen duke gjeneruar të njëjtat të dhëna në trajtën e raporteve nga sistemi. Ky kontroll apo siç quhet akt-rakordim nuk është i vlefshëm për sa kohë bazohet në të dhëna të njëjta dhe jo në kryqëzime të dhënash të cilat do t’i jepnin kuptim kontrollit në një hallkë më sipër, por dhe verifikimit dhe saktësisë së të dhënave të regjistruara në sistem.

- Nuk gjenerohet asnjë evidencë prej sistemit edhe pse pjesa më e madhe e të dhënave që kërkohen në raportim, punonjësit i regjistrojnë në sistem. Punonjësit në filiale, kryejnë të njëjtën punë dy herë, një herë nëpërmjet regjistrimit në sistem dhe një herë në përmbledhjen e të dhënave për muajin e kaluar, 3 mujorin e kaluar, 6 mujorin apo 1 vjetorin ku në disa raste këto raportime janë progresive. Punonjësit në drejtorinë ekonomike përmbledhin të gjithë informacionin e ardhur për efekt raportimi.

- Raportimi që kryen Posta në MFE, MIE dhe INSTAT për të gjitha periudhat e ndryshme që raporton, është një mbledhje të dhënash plotësisht manuale. Raportimi në këto institucione është me periodicitet 3 mujor, 6 mujor dhe 1 vjeçar.

- Kontrolli i brendshëm realizohet me dokumentacion fizik nga filiali në drejtorinë qendrore.

- Asnjë nga tipet e evidencave nuk rezulton të jetë kërkuar të gjenerohet nga Datawarehouse BI, të cilin posta e ka implementuar në vitin 2020, qëllimi i të cilit është orientuar po tek veprimet e përdoruesit dhe aspak tek raportimi të cilit kjo magazinë të dhënash do i shërbente më shumë

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (126-157) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a, të marrin masat e nevojshme për:

a. informatizimin e shërbimeve që kryhen manualisht;

b. importimin e të dhënave në Datawarehouse BI, për shërbimet që kryhen tek sistemet e të tretëve në mënyrë automatike, ditore;

c. implementimin e raporteve me të dhëna përmbledhëse nga Datawarehouse BI, që i shërbejnë monitorimit, vendimmarrjes, raportimit dhe transparencës.

Brenda vitit 2022

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi monitorimin e Intranetit/Internetit, u konstatua se:

- në rregulloret e brendshme për: Filialin e Postës Shqiptare Sh.a, Qendra Tranzit, Filialet e kategorisë së parë dhe të dytë, dhe të degëve të kategorisë së parë dhe të dytë të Shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a. nuk është e përcaktuar mënyra se si ndiqet monitorimin i linjave data nga specialistët IT.

- në lidhje me problematikat, komunikimi me drejtorin e përgjithshme bëhet me telefon dhe email, zgjidhja ndiqet rast pas rasti, nuk monitorohet apo dokumentohet koha dhe natyra e problematikës së konstatuar apo punonjësit që janë angazhuar për zgjidhjen e saj.

- Filiali Kukës nuk ka akses në Sistemin PRTG, çka do të thotë se për këtë filial nuk bëhet monitorimi i shërbimit dhe konstatim i konektivitetit të linjave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (126-157) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1.Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a. të marri masa për përditësimin e rregulloreve të brendshme me qëllim përcaktimin e mënyrave se si ndiqet monitorimi i linjave data, gjithashtu të konsiderojë dhe implementojë zgjidhje të tjera “open source” për monitorimin e linjave data për pikat e filialeve me qëllim monitorim më të detajuar mbi konsumin e bandwidthit, çfarë do të ndihmonte Postën Shqiptare në një planifikim më të mirë të kapaciteteve që i nevojiten.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pozicionimi i strukturës së auditit të brendshëm në organikën e Postës Shqiptare rezulton të jetë nën Këshillin Mbikëqyrës, për të garantuar pavarësinë e kësaj strukture, por nga auditimi u konstatua se është përgjegjësi e Administratorit të shoqërisë të bëjë emërimet e punonjësve në strukturën e auditimit të brendshëm, ndërkohë që emërimi i drejtorit të auditit të brendshëm është kompetencë e Këshillimit Mbikëqyrës. Emërimi i audituesve të kësaj strukture nga Administratori, është në kushtet e konfliktit të interesit, për arsye se vendimmarrjet e Administratorit duhet gjithashtu të jenë objekt kontrolli pasi ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (158-163) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të miratojë ndryshimet e nevojshme për marrjen e kompetencës për emërimet e audituesve në Auditin e Brendshëm dhe heqjen e kësaj të drejte nga Administratori i shoqërisë, me qëllim garantimin e pavarësisë së funksionaliteteve dhe objektivave që kërkohen të arrihen nga struktura e Auditit të Brendshëm si dhe shmangien nga kushtet e konfliktit të interesit për ushtrimin e detyrave të audituesit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Planifikimi për auditimin e brendshëm dhe sidomos në drejtimin e TI nuk është bazuar mbi sistemet e informacionit që disponon shoqëria të cilat ndikojnë tek kontrolli i brendshëm dhe raportimi financiar, në kundërshtim me manualin për auditimin e brendshëm.

- Nga administrimi i raporteve të auditit të brendshëm për filialet Fier, Lushnje, Shkodër, Tranzit dhe Gjirokastrë, Korçë, Mat, Sarandë dhe Vlorë u konstatua se në drejtim të auditimit të teknologjisë së informacionit nuk është ndjekur metodika që përcakton manuali i auditimit të brendshëm. Pikat e programit të auditimit të ushtruar nga audit i brendshëm në çdo filial dhe trajtimi i tyre nga audituesi i brendshëm me profil në teknologjinë e informacionit, është shumë i ngjashëm në të gjitha raportet e periudhës 2018-2020.

- Nga administrimi i raporteve të auditit të brendshëm në drejtim të auditimit të sistemeve të TI-së nuk janë konstatuar çështje që mund të ndihmonin në përmirësimin e sistemit, por vetëm çështje me karakter udhëzues mbi përdoruesit, në kundërshtim me detyrat 1 dhe 5 të përshkruara për Audituesin e TI në rregulloren e brendshme institucionale të Posta Shqiptare.

- Posta Shqiptare nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe nuk ka planifikuar, kryer misione auditimi mbi sistemet e TI-së në Drejtorinë e IT-së dhe Zhvillimit dhe Sektori i Sigurisë së Informacionit pranë Posta Shqiptare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (158-163) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Postën Shqiptare Sh.a dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të vlerësojnë me prioritet auditimin e IT, duke implementuar metodologjinë e përcaktuar në manualin e auditimit IT, dhe duke u thelluar në kontrole të vazhdueshme me qëllim dhënien e sigurisë objektive, si dhe këshillimin e menaxhimit për arritjen e objektivave nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike të veprimeve që realizohen nëpërmjet sistemit për të garantuar sigurinë e të dhënave, si dhe minimizimin e kostove operacionale. Gjithashtu të merren masa për mbulimin me auditim të brendshëm IT të sistemeve IT, në Drejtorinë e IT-së dhe Zhvillimit në përputhje me përcaktimet ligjore.

Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Posta Shqiptare, që prej vitit 2012 e në vazhdim, për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të Eternës ka investuar (blerë) në totale **176,091,320** lekë, pa TVSH. Ndërsa për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve që nga viti 2014 ka lidhur 10 kontrata të njëpasnjëshme që vazhdojnë të kenë afat deri në mesin e vitit 2024, me vlerë të përgjithshme **158,200,000 lekë pa TVSH**. Sistemet e Eterna përfshijnë dhe mbulojnë, shërbimet financiare (arkëtime, pagesa, transfertat bankare, etj.) dhe proceset e shërbimeve postare. Të gjitha procedurat e prokurimeve si të blerjeve të sistemit ashtu edhe të mirëmbajtjes së tij, janë fituar nga i njëjti Operator Ekonomik, “H. S.”. Fillimisht në korrik të vitit 2012 është realizuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje informatizimi i sporteleve, gjurmimi kombëtar i objekteve postare dhe euroxhiro kombëtare”. Kjo blerje e sistemit është realizuar me procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për arsye të së drejtës së autorit dhe është konkretizuar më lidhjen kontratës së furnizimit nr.1029/4, datë 21.08.2012, me operatorin fitues “H. S.”, **me vlerë 51,791,320 lekë**, pa TVSH. Mbas vënies në funksionim së sistemit, në datën 03.04.2014 është realizuar edhe procedura me negociim për mirëmbajtjen e këtij sistemi, me afat 3 vjet, me vlerë totale 26,850,000 lekë, pa TVSH. Në këtë procedurë për arsye të së drejtës së autorit i është dërguar ftesë për ofertë operatorit “H. S.” me të cilin është lidhur edhe **kontrata e mirëmbajtjes nr.1069/7, datë 14.05.2014, me vlerë 26,850,000 lekë**, pa TVSH, me afat 3 vjet (deri në datën 13.05.2017). Hartimi dhe kohëzgjatja e kontratës së mirëmbajtjes, ka buruar nga kërkesat e VKM nr. 723, datë 01.09.2010, i ndryshuar me VKM. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, e cila përcakton se, kontratat e mirëmbajtjes duhet të jenë jo më të shkurtra se 2 (dy) vjet. Në zbatim të kësaj VKM, Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, ka nxjerrë Udhëzimin nr.2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimit e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”. Në germën “e”, të pikës 8, të kreut II, të këtij udhëzimi përcaktohet se, për propozimet e kërkuara, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK duhet të marrin në konsideratë çështjet që: **“Të sigurojnë pronësinë e Kodeve Burimore (source code) dhe /ose të drejtën për të blerë Kodet Burimore. Pronësinë e Kodeve Burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë”**

Kontrata e mirëmbajtjes e sipërcituar me nr.1069/7, datë 14.05.2014, në asnjë nen të saj nuk ka të përcaktuar këtë dispozitë, por në nenin 11, ka përcaktuar se: **“Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit”**. Pra, Posta Shqiptare ndryshe nga ç ‘kërkohet në përcaktimet apo rekomandimet e këtij udhëzimi, nuk ka marrë dhe nuk ka bërë pronë të saj Kodet në Burim, Analizat e Projektimit, burimin dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha moduleve të sistemeve të Eternës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

28.1. Rekomandimi: Posta Shqiptare, në Dokumentet e Tenderit dhe në kushtet e kontratave të çdo procedure prokurimi që do të realizojë për blerjen edhe mirëmbajtjen e çdo sistemi teknologjia informacioni që do të aplikojë dhe zhvillojë, duhet të përcaktojë që:

-“Posta Shqiptare, në përfundim të kontratës së furnizimit apo të afatit të garancisë së pajisjeve dhe sistemit, apo në përfundim të afatit të kontratës së parë të mirëmbajtjes (sipas përcaktimeve të VKM. 710, datë 21.8.2013), pronësia e Kodeve Burimore (source code), analizat e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të sistemit, do ti kalojnë Postës Shqiptare Sh.a, pa asnjë kosto shtesë”.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Problematika e trajtuar më sipër, është mbartur dhe konstatuar në të gjitha procedurat e prokurimeve të realizuara për blerjen edhe mirëmbajtjen e sistemeve Eterna edhe gjatë periudhës objekt auditimi. Gjate kësaj periudhe, janë realizuar 6 procedura prokurimi të “Hapura” me fond limit në totale 103,649,850 lekë, pa TVSH dhe janë lidhur 6 kontrata për mirëmbajtjen e sistemeve të Eterna me vlerë totale 103,550,000 lekë, pa TVSH. Konkretisht: “Blerje Posta retail outlet dhe mirëmbajtje për 4 vjet”, me fond limit: 30,999,850 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 13.05.2019, me fitues OE “H. S.”, me vlerë oferte të barabartë me fondin limit; “Mirëmbajtje Eterna Gateway Application për 4 vite”, me fond limit 20,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 14.05.2019, me fitues OE “H. S.”, me vlerë oferte të barabartë me fondin limit; “Mirëmbajtja e Moduleve të Eternes për 4 vjet”, me fond limit 9,450,000lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 31.05.2019, me fitues OE “H. S.”, me vlerë oferte të barabartë me fondin limit; “Blerje Eterna BI dhe Mirëmbajtje BI për 4 vite”, me fond limit 41,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 22.07.2019, me fitues OE “H. S.”, me vlerë oferte të barabartë me fondin limit; “Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për 3 vite”, me fond limit 27,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 05.05.2020, me fitues OE “H. S.”, me vlerë oferte të barabartë me fondin limit; “Mirëmbajtja E-Posta për 4 vite”, me fond limit 20,000,000 lekë, pa TVSH, të realizuar në datën 03.08.2020, me fitues OE “H. S.”, me vlerë oferte të barabartë me fondin limit. U konstatua:

29.1. Gjetje nga auditimi: Të 6 procedurat janë zhvilluara të hapura, por në procedura ka pasur mungesë të theksuar konkurrence pasi në to ka marrë pjese vetëm operatori “H. S.”, i cili është shpallur edhe fitues dhe ka lidhur kontratat e zbatimit. Mungesa e theksuar e konkurrencës ka ardhur si pasojë e hartimit dhe vendosjes në DT të kërkesave të veçantë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Konkretisht është kërkuar që: *“OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program”*; *“Operatori ekonomik, qofte zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod”*.

Kërkesa këto që sipas germës b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe germës b, të pikës 2, të nenit 36, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” duhet të vendoset dhe përdoret për procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, pasi në këto dispozita përcaktohet se: për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik dhe ekzistenca e kushti duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

Pra në bazë të këtyre dispozitave zhvillohen vetëm procedurat me negociim, dhe jo procedurat e hapura apo dhe procedurat e tjera. Vendosja e këtyre kërkesave nuk argumentohet sepse, Posta Shqiptare mbas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes të lidhur me **nr. 1069, datë 14.05.2014**, duhet të kishte marrë dhe të bënte pronë të saj, Kodet në Burim të sistemeve të Eternës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.2. Gjetje nga auditimi: Përveç se është konstatuar nga auditimi që këto kritere të veçanta kualifikuese janë hartuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, janë vërejtur si të tilla dhe janë rekomanduar për ti ndryshuar edhe nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP). Me shpalljen e të 6 procedurave në sistemin elektronik, APP për çdo procedurë, nëpërmjet email-eve, ka njoftuar Postën Shqiptare duke i sjell në vëmendje nevojën e saktësisimit dhe mirë argumentimin ligjor dhe teknik në lidhje me disponimin e së Drejtës së Autorit për programin Eterna Software, duke mbajtur parasysh faktin se, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen, jo diskriminuese dhe konform rregullave të prokurimit publik. Po kështu, rekomandon një argumentim teknik në lidhje me faktin e mos disponimit të Kodit në Burim nga ana e AK se, sistemi në fjalë është ekzistues, dhe rrjedhimisht ***mund të ishte i disponueshëm nga vetë AK pas implementimit të sistemit aktual, nga OE fitues.***

Mirëpo, AK nuk ka bërë ndryshimin e këtyre kritereve, por për të 6 procedurat i ka dërguar informacion APP se, vendosja e këtyre kritereve mbështetet në, germën b, të pikës 2, të nenit 33 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 55, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Dhe ka interpretuar se, këto kërkesa janë vendosur, për arsye teknike dhe artistike që kanë lidhje me të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale dhe kontrata mundë të ekzekutohet vetëm me një operatorë të veçantë. Ky sqarim apo interpretim i AK është i pakuptimit sepse nga njëra anë përpiket të argumentojë se, hartimi dhe vendosja e këtyre kërkesave është mbështetur dhe bazuar në nenin 33 të LPP dhe nenin 55 të VKM, dispozita të cilat përcaktojnë rastet kur përdoret procedura “me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” dhe nga ana tjetër ka organizuar procedura të “Hapura”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.3. Gjetje nga auditimi: Po kështu në të 6 kontratat e mirëmbajtjes së lidhur me OE “H. S.” është vendosur kushti që: “Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. ***Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit***”.

Ky veprim ka bërë që ky operatorë të këtë të drejtën ekskluzive ose të drejtën e autorit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi për një kohë të gjatë, të paktën deri në përfundimin e kontratës së datës 31.08.2020 që ka afat deri në mesin e vitit 2024.

Pra, me vendosjen e këtij kushti në përfundim të çdo kontrate, kodet në burim nuk i kalojnë në pronësi Postës Shqiptare, por mbeten përsëri pronë e kontraktuesit, madje deri në amortizimin e plotë dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të sistemit Eterna. Për pasojë nga vendosja e këtij kushti kontraktual, blerja e moduleve të tjera të sistemit Eterna dhe shërbimi i mirëmbajtjes së tyre, përqendrohet dhe monopolizohet vetëm te operatori “H. S.”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.1. Rekomandim: Posta Shqiptare Sh.a, të gjejë rrugët e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit për të negociuar me OE “H. S.” me qëllim heqjen nga kontrata e datës 31.08.2020, për “Mirëmbajtjen E-Posta për 4 vite” të kushtit: “Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktuesi gjatë kontratës do ti përkasin Kontraktuesit si vazhdimësi e të drejtës aktuale të autorit që gëzon kontraktuesi mbi këtë sistem kompjuterik. Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit është dhe vazhdon të mbetet pronë e Kontraktuesit”.

Menjëherë

29.2. Rekomandim: Posta Shqiptare, në Dokumentet e Tenderit të çdo procedure prokurimi të hapur që do të realizojë për blerjen e moduleve dhe për mirëmbajtjen e sistemeve Eterna, të marrë në konsideratë rekomandimet e APP, dhe të mos vendosë kërkesat e veçanta që: “OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta

Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program”; “Operatori ekonomik, qofte zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod”.

Në vijimësi

29.3. Rekomandim: Posta Shqiptare Sh.a, me përfundimin të kontratës së lidhur në datën 31.08.2020, me OE “H. S.” për “Mirëmbajtjen E-Posta për 4 vite”, me vlerë 20,000,000 lekë, pa TVSH, në DT, në kushtet e Veçanta dhe të Përgjithshme të kontratave që do të realizohen në procedurat e prokurimeve vijuese për shërbimin e mirëmbajtjes të sistemeve Eterna, të vendosë kushtin që: “Pronësia intelektuale, Kodi në Burim dhe e drejta e autorit do të jetë dhe do të mbetet pronë e Postës Shqiptare”.

Në përfundimin të kontratës

30. Gjetje nga auditimi: Në të 6 procedurat e prokurimit, vlerat e kontratave të mirëmbajtjes (fondet limite) janë llogaritur në zbatim të zbatimit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin Publik” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për çdo procedurë janë marrë në treg, 3 apo 4 oferta dhe fondi limit është llogaritur bazuar në ofertën më të ulët. Në të 6 procedurat e prokurimit, një nga operatorët që u është kërkuar dhe marrë ofertë është edhe OE “H. S.”.

Pra nga njëra anë AK, vendos kufizimin e konkurrencës në treg nëpërmjet të drejtës së autorit dhe nga ana tjetër ka marrë oferta në treg të cilat nuk mund të përgjigjen vlerës së shërbimit të prokuruar sepse të drejtën e mirëmbajtjes së këtij sistemi sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të mëparshme të mirëmbajtjes e ka në mënyrë ekskluzive vetëm operatori “H. S.”. Po kështu, në llogaritjen e fondit limit për të gjitha kontratat e mirëmbajtjes nuk është marrë në konsideratë raporti kosto-përfitim, bazuar në amortizimin moral dhe fizik të këtij sistemi dhe në vlerën e mbetur në kontabilitet sipas pasqyrave financiare të çdo viti.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

30.1. Rekomandim: Posta Shqiptare, të analizojë shpenzimet dhe kostot faktike të shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemeve Eterna dhe në procedurat e tjera të prokurimeve që do të realizojë, të llogarisë vlerën e kontratës së mirëmbajtjes (fondin limit) duke marrë në konsideratë, amortizimin moral dhe fizik të këtij sistem, vlerën e pasqyruar në kontabilitet dhe raportin kosto-përfitim.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Siç u trajtua më sipër, mungesa e pronësisë së kodeve në burime ka bërë që të gjitha kontratat e mirëmbajtjes së sistemit Eterna duke filluar që nga viti 2017, edhe pse janë zhvilluar me procedura të hapura, janë lidhur në mungesë të theksuar të konkurrencës, pasoja e të cilës ka sjellë ekskluzivitetin dhe monopolizimin e blerjeve dhe të mirëmbajtjes së sistemit Eterna, duke i përqendruar këto mallra dhe shërbime vetëm te i njëjti operator, te operator “H. S.”.

Nga ky veprim nuk është rritur pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit dhe nuk është siguruar mirë përdorimi i fondeve dhe ulja e shpenzimet procedurale për shërbimin e mirëmbajtjes, pasi ky operatorë në të gjitha procedurat e prokurimit ka ofruar ofertën ekonomike pothuajse të barabartë me fondin limit. Për pasojë shpenzimet e mirëmbajtjes janë relativisht të larta kundrejt kostos së blerjeve së vetë sistemit Eterna, të cilat shkojnë rreth 15-18 % për çdo vit.

Kështu, për gjatë gjithë kohës së funksionimit të sistemit që nga viti 2014 deri në vitin 2024, shpenzimet progresive për shërbimin e mirëmbajtjes kanë shkuar në vlerën **158,200,000** lekë pa TVSH, ose përbëjnë 90%, të vlerës progresive të blerjeve të gjithë sistemit Eterna që janë në shumën **176,091,320** lekë, pa TVSH.

Megjithatë kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemeve të teknologjisë së informacionit vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtij shërbimi, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në tregun vendas sepse ato nuk janë të natyrës fizike por me tepër janë të një natyre intelektuale që lidhen me të drejtën ekskluzive apo të drejtën e autorit dhe për këto shpenzime në treg nuk ka kosto të normuara apo çmime referuese. Kjo dhe për faktin se, AKSH apo ministria e linjës që mbulon fushën e Teknologjisë së Informacionit nuk kanë hartuar normative, manuale, preventiva, apo udhëzues të veçantë, për përcaktimin e çmimeve orientuese, mbështetur në specifikimet teknike të çdo lloj sistemi teknologjie informacionit dhe në modelet dhe praktikatat më të mira të vendeve Evropiane dhe mbi bazën e këtyre çmimeve të llogariteshin shpenzimet e mirëmbajtjes.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

31.1. Rekomandim: Posta Shqiptare, bazuar në modelet dhe praktikatat më të mira të vendeve Evropiane, të marrë iniciativën dhe ti kërkojë, MFE me cilësinë e aksionarit, AKSH dhe Ministrisë së linjës që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit që, të hartojnë normative, manuale, apo udhëzues të veçantë, për përcaktimin e çmimeve orientuese për çdo lloj sistemi që ka të bëjë me teknologjinë e informacionit dhe mbi bazën e tyre të llogariten vlerat e kontratave të blerjeve dhe kontratave të shërbimeve për mirëmbajtjen e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitin 2013, por dhe para këtij viti, Posta Shqiptare Sh.a. ka blerë dhe ka vendosur në funksionim rrjetin dhe pajisjet e rrjetit Data Center (serverët). Sipas regjistrimit në kontabilitet në fund të vitit 2013, këto pajisje janë në vlerën **totale 35,500,200 lekë**, pa TVSH. Deri në fund të vitit 2018 (31.12.2018) kane akumuluar një amortizim në vlerën 29,908,996 lekë dhe vlera e mbetur e tyre në fund të këtij viti është 5,591,2014 lekë. Po në vitin 2018 është bërë rivlerësimi i aseteve të Postës Shqiptare dhe rrjeti dhe pajisjet e Data Center kanë marrë një vlerë të re, duke u rivlerësuar në vlerën 10,650,080 lekë.

Për mbulimin me shërbimin e mirëmbajtjes së Data Center, nga vënia në funksionim në vitin 2014 dhe deri në datën 30.06. 2021, Posta shqiptare ka realizuar 6 procedura prokurimi të hapura dhe ka lidhur 6 kontrata me afate 1 vjeçare, me vlerë totale 73,291,455 lekë, pa TVSH (87,949,746 lekë, me TVSH). Konkretisht: kontrata me nr.1751/5, datë 16.09.2013, me vlerë 16,187,280 lekë; kontrata me nr.3388/5, datë 30.12.2015, me vlerë 15,208,376 lekë; kontrata me nr.406/15, datë 22.12.2017, me vlerë 13,721,520 lekë; kontrata me nr.3377/13, datë 18.03.2019, me vlerë 14,277,720 lekë; kontrata me nr.751/13, datë 23.06.2020, me vlerë 14,277,720 lekë; kontrata me nr.1069/8, datë 06.08.2021, me vlerë 14,277,600 lekë.

Siç tregojnë këto shifra, vlera vjetore e shpenzimeve për mirëmbajtjen kundrejt vlerës së blerjes së sistemit dhe të pajisjeve Data Center, shkojnë për çdo vit rreth 34-35%, ose, vlera e shpenzimeve progresive të mirëmbajtjes kundrejt vlerës totale të blerjes së sistemit dhe pajisjeve Data Center që, nga viti 2014 deri në datën 30.06.2021, ka shkuar rreth 206% (73,291,455 lekë/ 35,500,200 lekë). Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe të rrjetit Data Center vjen edhe si pasojë e vetë natyrës së këtij shërbimi, të cilat nuk janë shumë të mirënjohura në treg vendas sepse përveç se janë të natyrës fizike janë edhe të një natyre intelektuale profesionale dhe për shpenzimet e këtij shërbimi në tregun vendas nuk ka kosto të normuar apo çmime referuese.

Kosto e lartë e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit dhe pajisjeve Data Center, tregohet qartazi edhe në procedurat prokurimeve të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, për shërbimin e mirëmbajtjes. Konkretisht, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 3 procedura prokurimi të hapura me fond limit në total 36,000,000 lekë, pa TVSH (12,000,000 lekë për procedurë). Të tre procedurat të realizuara për çdo vit, janë fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) "D. & B." me ofertë ekonomike pothuajse të barabartë me fondin limit, me një kursim të vogël në vlerën 305,800 lekë. Me këtë BOE janë lidhur 3 kontrata për shërbimin e mirëmbajtjes së

Data Center, me vlerë totale 35,694,200 lekë, pa TVSH (42,833,040 lekë, me TVSH), përkatësisht, kontrata e datës 18.03.2019, me vlerë 14,277,720 lekë; kontrata e datës 23.06.2020, me vlerë 14,277,720 lekë dhe kontrata e datës 06.08.2021, me vlerë 14,277,600 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

32.1. Rekomandim: Posta Shqiptare, të ngrëjë një grup pune të veçantë me specialistë të fushës për të analizuar gjendjen teknike e fizike të rrjetit dhe pajisjeve Data Center dhe në varësi të amortizimit të tyre, të analizoje kostot e mirëmbajtjes duke marrë në konsideratë raportin kosto-përfitim. Në rast se, përfitimi është në raport të zhdrejtë me koston, pra shpenzimet e mirëmbajtjes tejkalojnë vlerën e sistemit dhe të pajisjeve, atëherë të shikohet mundësia e blerjes së sistemit dhe pajisjeve të reja. Në procedurat e prokurimit që do të realizohen, në dokumentet e tenderit të kërkohet që, shërbimi i mirëmbajtjes të kryhet nga operatori fitues, me afat sipas përcaktimeve të VKM 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Të shtrirë në vitin 2020 dhe vitin 2021, Posta Shqiptare ka realizuar procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Tonerë, Bojëra Printerit”, me fond limit 60,034,800 lekë. Në tenderin e zhvilluar në datën 13.05.2020, kanë marrë pjesë 2 operatorë: OE “I. O.”, me ofertën ekonomike në vlerën 38,597,810.82 lekë, pa TVSH, ose 35.7%, më të ulët se fondi limit dhe OE “E. C.” me ofertën ekonomike në vlerën 47,130,000 lekë, pa TVSH, ose 21.5 %, më ulët se fondi limit. U konstatua se, AK në kundërshtim me parashikimet e neneve 20 dhe 46 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka kërkuar dhe vendosur në DT, disa kriteret të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk janë hartuar në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohen dhe nuk janë konform rregullave të prokurimit publik. Pikërisht këto kërkesa janë bërë shkak që, KVO gjatë shqyrtimit të ofertave teknike të 2 operatorëve pjesëmarrës, ka s’kualifikuar OE “I. O.” i cili ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori tjetër, me diferencë **10,238,628 lekë me TVSH**.

Për pasojë, OE “I. O.”, ka bërë disa ankime pranë AK dhe KPP, dhe për këtë arsye procesi i realizimit të kësaj procedurë është tej zgjatur, gati rreth 1 vit (ka filluar me shpalljen e kontratës për prokurim në datën 26.03.2020 dhe ka përfunduar me lidhjen e kontratës së furnizimit në datën 15.02.2021). Veprime apo mosveprime këto që, kanë cenuar, qëllimin e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të parashikuar në pikën 2 të nenit 1, që është: “Rritja efiçencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik; sigurimi për mirë përdorimin e fondeve publike dhe për uljen e shpenzimeve procedurale; nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë; nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë; trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit; sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurën e prokurimit publik”. Pasojat e kësaj parregullsie janë shmangur nga KPP, e cila me Vendimin nr. 600, datë 24.12.2020, ka vendosur kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE “I. O.”, duke eliminuar kështu, shkeljet dhe dëmin ekonomik që mund ti shkaktohej Postës Shqiptare në vlerën 10,238,628 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

33.1. Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, në të gjitha procedurat e tjera të prokurimeve, duhet të mbajë parasysh faktin që, kriteret e veçanta të kualifikimit, të hartohen konform rregullave të prokurimit publik, të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet dhe të sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Në të 6 procedurat e prokurimit të mirëmbajtjes së sistemeve Eterna, në 3 procedurat e prokurimit të mirëmbajtjes së Data Center dhe në procedurën e prokurimit për blerjen e tonerëve dhe bojërave të printerit, të trajtuar më sipër, konstatohet se: dy nga kriteret e veçanta kualifikuese që kanë lidhje me përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik, janë vendosur në interpretim të gabuar të pikës 3 dhe germës b, të pikës 4, të nenit 28 të, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht në DT të çdo procedure është kërkuar që: “OE duhet të paraqesë furnizime me natyrë ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet”; “OE duhet të paraqesë, vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore të tre viteve të fundit me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet”. Pra vendosja e kufirit 39% për përmbushjen e këtyre kërkesave, kuptohet sikur vlera e xhiros vjetore dhe vlera e kontratave të ngjashme duhet të jete mbi 40% të vlerës që prokurohet, në kundërshtim kjo me dispozitat e sipërcituara të cilat përcaktojnë se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit dhe në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”;

“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon, kopje të deklaratave të xhiros vjetore, dhe në çdo rast, vlera e kërkuar nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

34.1. Rekomandimi: Posta Shqiptare Sh.a, në të gjitha procedurat e tjera të prokurimeve, duhet të mbajë parasysh faktin që, për përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe teknik kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen dhe të jenë në përputhje dhe brenda kufijve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

Në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Mirëmbajtje Sistemit VOIP*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, krahas faturës së shërbimit mungojnë procesverbalet e monitorimit të ofrimit të shërbimit nga ana e përfaqësuesit të “Posta Shqiptare Sh.a” dhe përfaqësuesit të Kontraktuesit, ashtu siç janë sjell për muajin Nëntor, Dhjetor 2019 dhe Janar, Shkurt, Mars 2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (22-97) të Projekt Raportit të Auditimit)

35.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të mbajnë procesverbalet mbi monitorimin e ofrimit dhe cilësisë të shërbimit sipas kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Mirëmbajtje Sistemit VOIP*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, mungojnë librat e historikut (LogBook) për secilën pajisje në të cilën shënohen të gjitha veprimet e kryera mbi pajisje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

36.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur që për secilën pajisje të shoqërohet me logbook-un përkatës sipas kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Mirëmbajtje Sistemit VOIP*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, mungon njoftimi me shkrim për listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e

mirëmbajtjes duke përfshirë sasinë, vendndodhjen e këtyre pajisjeve 90 ditë para fillimit të negocimit për rinovim të marrëveshjes së mirëmbajtjes pasi më datë 1.10.2021 ka përfunduar Kontrata e mirëmbajtjes së Sistemit VOIP.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

37.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur që 90 ditë para fillimit të negocimit për rinovim të marrëveshjes së mirëmbajtjes të bëjnë njoftimin me shkrim për ndryshimet në listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Mirëmbajtje Sistemit VOIP*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, mungojnë raportet mujore që duhet të ishin sjellë nga O.E. ku parashtrohen të gjitha aktivitetet e realizuara në atë muaj edhe nëse nuk ka pasur problematika, në kundërshtim me Nenin 10 pika 5 të Kontratës me objekt “*Mirëmbajtje Sistemi VOIP*” nr. 1702/9 datë 01.10.2019.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

38.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur që 90 ditë para fillimit të negocimit për rinovim të marrëveshjes së mirëmbajtjes të bëjnë njoftimin me shkrim për ndryshimet në listën e pajisjeve të mbuluar me shërbimin e mirëmbajtjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje Hibrid Mail*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, shpenzimet për projekte investimesh ku përfshihen shpenzimet kapitale në infrastrukturë, ku në këtë rast janë blerje e pajisjeve të mëdha teknologjike, në fazën e planifikimit buxhetor të shpenzimeve nuk është kryer një analizë kosto-përfitim e projektit për një menaxhim sa më efektiv të shpenzimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

39.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi planifikimin buxhetor të shpenzimeve të njësisë, në rastet kur vlera e shpenzimeve/investimeve është në vlera të larta, të kryejnë një analizë kosto-përfitim të shpenzimeve/investimeve në fjalë.

Menjëherë dhe në vijimësi

40. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje Hibrid Mail*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, meqenëse Sistemi i Hibrid Mail është sistem i ri në fushën e TIK-ut dhe ka nevojë për mirëmbajtje, duhet të ishte parashikuar MNSH-në, si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këtë sistem si dhe kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet ishte jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

40.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.

Menjëherë dhe në vijimësi

41. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje Hibrid Mail*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, me anë të urdhrin nr. 34/26 datë 23.01.2020 është ngritur Komisioni mbi marrjen në dorëzim të “*Blerje Hibrid Mail*”, por mungon Procesverbali mbi marrjen në dorëzim gjithashtu i cili shoqërohet dhe më një kolaudim mbi funksionimin e saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

41.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore.

Menjëherë dhe në vijimësi

42. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, gjatë hartimit të specifikimeve teknike nuk janë sqaruar qartë zërat mbi skicimet mbi instalimin e pajisjeve, pozicionet e tyre për të arritur më pas në caktimin e dy zërave si F.V. Kabull Alarmi dhe F.V. Kabull rg59 + Ushqimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

42.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, të bazohen në rregulloret dhe legjislacionin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

43. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, vendosja e kriterëve të veçanta që O.E duhet të ketë kompatibiliteti me sistemet ekzistuese që janë kamerat Hikvision, sistemet e alarmit Messer GPRS dhe Radio, Sistemet GPS Meitrack nuk lejon zhvillimin e një gare të barabartë, dhe duket një kriter diskriminues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

43.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.

Menjëherë dhe në vijimësi

44. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje palmar profesional, barkod reader me wireless, lexues barkodesh*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, kriteri i veçantë nr. 2.5 ku thuhet që produktet e ofruara duhet të jenë Brand i njohur Ndërkombëtar është kriter diskriminues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

44.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë, pasi në shpjegimin tuaj ky lloj kriteri do të plotësojë kërkesat e cilësisë, origjinalitetin e mallrave nuk qëndron sepse janë certifikatat ato që i japin këto attribute dhe jo emri.

Menjëherë dhe në vijimësi

45. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje palmar profesional, barkod reader me wireless, lexues barkodesh*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, Komisioni mbi marrjen në dorëzim të procedurës, nuk ka përpiluar procesverbalin mbi marrjen në dorëzim gjithashtu i cili shoqërohet dhe më një kolaudim mbi funksionimin e saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

45.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore.

Menjëherë dhe në vijimësi

46. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Shërbim Printimi dhe fotokopje*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në caktimin e kritereve të veçanta është caktuar dhe certifikata ISO 14001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit e cila nuk është në proporcion me objektin e procedurës së prokurimit si dhe caktimi i 3 punonjësve të certifikuar për pajisjet multifunksionale, duke vënë theksin në numrin 3 do të s’kualifikonte nga gara shumë Operatorë të tjerë duke e bërë garën diskriminuese.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

46.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kritereve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.

Menjëherë dhe në vijimësi

47. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Shërbim Printimi dhe fotokopje*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në caktimin e kritereve të veçanta cilësohet se shërbimi i kërkuar është i bazuar në një nivel të caktuar shërbimi SLA (Service Level Agreement), por që në asnjë rast kontrata nuk është trajtuar si një SLA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

47.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.

Menjëherë dhe në vijimësi

48. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Shërbim Printimi dhe fotokopje*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk është mbajtur asnjë procesverbal mbi ecurinë e shërbimit, duke matur cilësinë e shërbimit për të arritur afrimin optimal të tij.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

48.1.Rekomandimi: Personat e autorizuar mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të bëjnë të mundur kryerjen e kolaudimit të pajisjes dhe mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë intervalore.

Menjëherë dhe në vijimësi

49. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje pajisje sigurie (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi DVR/NVR 4 kamera, 8 kamera, 16 kamera + instalim kabull ...*” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, salla e monitorimit të O.E. për eliminimin e defekteve mbulohet nga O.E. për 2 vite që është dhe garancia e produkteve. Pas dy vitesh meqenëse tërësia e produkteve funksionon si një sistem nuk është parashikuar mirëmbajtje dhe nuk është përcaktuar se kujt do ti kalojnë të drejtat e sallës së monitorimit. Meqenëse është zhvilluar një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit atëherë në procedurën e prokurimit duhet të ishte parashikuar dhe mirëmbajtja me qëllim ofrimin e shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit të të dhënave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

49.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.

Menjëherë dhe në vijimësi

50. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në caktim e specifikimeve teknike është përfshirë pika “Shërbime trajnimi dhe konsulence për paketën M365, Power BI, Windows server, SQL server, Windows Desktop” si dhe në kriteret e veçanta është kërkuar “Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar nga prodhuesi si trajnues zyrtarë të produkteve Microsoft”, por nuk është mbajtur asnjë procesverbal që fakton kryerjen e trajnimeve dhe konsulencave nga specialistët e certifikuar nga prodhuesi si trajnues zyrtarë të produkteve Microsoft.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

50.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi marrjen në dorëzim të kontratës dhe zbatimit të saj të bëjnë të mundur së bashku me operatorin ekonomik fitues të zhvillojnë trajnime të stafit sipas pikave të specifikimeve teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

51. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, gjatë hartimit të procedurës së prokurimit nuk është parashikuar zëri për mirëmbajtjen e procedurës në fjalë. Meqenëse janë shërbime të ndryshme në objektin e prokurimit atëherë duhet parashikuar dhe zëri i mirëmbajtjes për të siguruar krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup).

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

51.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e procedurës së prokurimit në fjalë të hartojnë MNSH-në bazuar në praktikat më të mira.

Menjëherë dhe në vijimësi

52. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Licenca Microsoft + shërbime të ndryshme për 2 vite” u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, kriteret e veçanta që Kompania duhet të ketë specializimet e mëposhtme me prodhuesit Microsoft:

-Gold Data Analytics për të demonstruar kapacitetin e kompanisë për të ofruar shërbime lidhur me platformën analitike Microsoft BI.

-Gold Data Platform për të demonstruar kapacitetin e kompanisë për të ofruar shërbime lidhur me platformën e bazës së të dhënave të Microsoft SQL.

-Gold Collaboration and Content për të demonstruar kapacitetin e kompanisë për të ofruar shërbime lidhur me platformat e bashkëpunimit që ofrohet nga Microsoft, përbëjnë favorizim për kompani të caktuara duke mos lejuar Operatorë të tjerë të jenë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

52.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta në procedurat e ardhshme të prokurimeve, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta, të kenë kujdes që kriteret e vendosura të mos jenë diskriminuese duke penalizuar operatorë që të jenë pjesëmarrës në garë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT